



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në MIE, AKBN dhe Albpetrol sh.a “Mbi auditimin e përputhshmërisë për Marrëveshjet Hidrokarbure të lidhura në Republikën e Shqipërisë”**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMI**  
**MBI “AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”**  
**PËR**  
**MARRËVESHJET HIDROKARBURE TË LIDHURA NË**  
**REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

**TIRANË, dhjetor 2024**

<b>NR.</b>	<b>Përmbajtja</b>	
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	
1	Objektivat dhe qëllimi	
2	Identifikimi i çështjes	
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4	Përgjegjësitë e audituesve	
5	Kriteret e vlerësimit	
6	Standardet e auditimit	
7	Metodat e auditimit	
8	Dokumentimi i auditimit	
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	
	<b>I. AUDITIMI I FAZËS PROCEDURIALE: PROPOZIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTIT</b>	
	1. Auditimi i propozimit të marrëveshjes, vlerësimit dhe vendimmarrjes për pranimin e tij	
	2. Mbi përputhshmërinë e procedurës së lidhjes së marrëveshjes me legjislacionin përkatës në fuqi	
	3. Mbi vlerësimin e elementëve në kuadër të lidhjes së kontratës dhe ristrukturimi i saj	
	<b>II. ZBATIMI I KONTRATËS</b>	
	1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për marrëveshjet hidrokarbure dhe identifikimi i risqeve nga ana e strukturave përgjegjëse	
	2. Auditimi i fazës së investimit të marrëveshjeve hidrokarbure	
	3. Auditimi i zbatimit të marrëveshjes dhe arritja e objektivave	
	4. Trajtimi kontabël i standarteve dhe politikave kontabël të marrëveshjeve hidrokarbure	
	5. Mbi zbatimin e buxhetit të marrëveshjeve hidrokarbure	
	6. Vlerësimi i ristrukturimit apo ndryshimeve të bëra në marrëveshjes gjatë zbatimit të saj	
	7. Ndikimi në mjedis dhe adresimi përkatës	
	<b>III. TË ARDHURAT E PËRFITUARA NGA MARRËVESHJET HIDROKARBURE DHE PËRDORIMI I TYRE</b>	
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

Në bazë dhe në zbatim të Ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkim, prodhim)”, të ndryshuar, Ministria përgjegjëse për sektorin hidrokarbur mundet, të hyjë në Marrëveshje Hidrokarburesh me çdo Person, duke autorizuar atë Person sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të kërkojë, zhvillojë dhe të prodhojë hidrokarbure në Zonën e Kontratës.

Ministria nuk do të lidhë Marrëveshje Hidrokarburesh me asnjë Person në qoftë se Ministria nuk bindet se Personi me të cilin do të lidhet Marrëveshja Hidrokarbure ka ose mund të sigurojë burimet financiare dhe kompetencën teknike të kërkuar për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit nën Marrëveshjen e Hidrokarbureve.

Një Marrëveshje Hidrokarbure për një zonë të caktuar në të, përmban të drejtën e kryerjes së operacioneve hidrokarbure të ndarë në:

1. Të drejtën ekskluzive për të kryer kërkimin brenda Zonës së Kontratës për një periudhë e cila përveç ndonjë kohe shtesë të kërkuar për të përfunduar punën e marrë përsipër për të vlerësuar një Zbulim, nuk do të kalojë 5 vjet gjithsej, përveçse kur Kontraktori bind Ministrinë se ekzistojnë kushte specifike të cilat kërkojnë një periudhë më të gjatë, atëherë Kontraktori mund t’i jepet një periudhë që nuk i kalon 7 vjet gjithsej.

2. Të drejtën ekskluzive për një periudhë që nuk i kalon 25 vjetët, për të zhvilluar dhe prodhuar rezervat e hidrokarbureve në Zonën e Kontratës, në përputhje me kushtet e një Plani Zhvillimi të miratuar nga Ministria, si dhe për të ripërtërirë këtë të drejtë aty dhe në masën që parashikon Marrëveshja e Hidrokarbureve.

Në një Marrëveshje Hidrokarbure përmbahen të drejta dhe detyrime për kontraktorin si dhe për Ministrinë përgjegjëse për hidrokarbure ose përfaqësuesin e saj.

Një marrëveshje hidrokarburesh, nënshkruhet nga ministri i përgjegjëse për hidrokarbure ose nga një person i autorizuar me shkrim prej tij dhe hyn në fuqi pas miratimit në Këshillin e Ministrave.

Nga auditimi rezultuan në mënyrë të përmbledhur:

- Nga auditimi i dokumentacionit të inicimit, propozimit dhe shprehjes së interesit të paraqitur nga shoqëria “E. N. G.” shpk rezultoi se:

Kompania që ka shprehur interesin për shfrytëzimin e vendburimeve të lira “Frakull” dhe “Povelcë”, nuk ka të bashkëlidhur me dokumentin e Shprehjes së Interesit, CV me profilin e shoqërisë “E. N. G.” shpk ose një prezantim të shkurtër për sipërmarrje të njëjta me objektin e shprehjes së interesit, duke pasur në konsideratë rëndësinë e këtij sektori për ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare, autoritetet shtetërore përgjegjëse duhet të sigurohen që të përfshijë në këto procese me përparësi të lartë kompani me potenciale dhe kapacitete të larta profesionale (veçanërisht kompanitë që kanë një eksperiencë të konsoliduar në këtë sektor) në përputhje me Ligjin Nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet” i ndryshuar neni 5, pika 2.

- Në momentin e shprehjes së interesit, referuar Ekstraktit historik të QKB-së, aktiviteti i operacioneve hidrokarbure, nuk është pjesë e Objektivit të aktivitetit të shoqërisë “E. N. G.” shpk. Referuar sa më lart, kompania “E.” rezultoi se nuk ka eksperiencë në fushën e kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit natyror jo në përputhje me Ligjin Nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet” i ndryshuar neni 5, pika 2. Ndryshimit i objektivit të aktivitetit të kompanisë është bërë në 16.12.2020 ndërsa propozimi daton në Maj 2020. Ky fakt duhej të çonte në skualifikimin e propozimit dhe ndërprerjen e procesit.

- Nga MIE, AKBN dhe Albpetrol sha nuk janë hartuar dhe miratuar specifitime ekonomike, teknike e objektive që duhet të plotësojë operatorët pjesëmarrës në procedurë (kriteret bazë të nevojshme). Grupi i punës për vlerësimin e aplikantëve në asnjë rast nuk ka shprehur një

gjykim apo vlerësim mbi kritere objektive por thjesht janë shprehur që mendojmë ose gjykojmë por jo vlerësim objektiv mbi zëra specifik se çfarë nuk plotësojnë operatorët, bazuar kjo edhe në Nenit 5, pika 2 e Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar.

- Referuar dokumentacionit konstatohet se nuk ka një MH (kontratë) tip ku të jenë të përcaktuar detyrimet kryesore që duhet të përmbushin subjektet që kanë shprehur interes dhe ti lihet hapësirë vetëm negocimit të termave ekonomike të MH-së.

- AKBN dhe Albpetrol sh.a si institucione monitoruese të zbatimit të kontratës nuk kanë çmime reference (module çmimi) të blerjeve apo shërbimeve që lidhen me investimet në operacione hidrokarbure. Nisur nga ky fakt Albpetrol sh.a, AKBN gjenden përpara riskut që buxheti i paraqitur të jetë i fryrë për shkak të kostove të larta gjatë vlerësimit dhe auditimit të situacioneve të kostove të rimbursueshme (cost recovery) të cilat mund të jenë larta.

Objekt i këtij auditimi është dhënia e konkluzionit mbi përputhshmërinë, dhe rregullshmërisë financiare të Marrëveshjeve, nëpërmjet një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen në të gjitha aspektet materiale me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj. Dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

Qëllimi i auditimit është raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit nëpërmjet sigurimit të një evidence të mjaftueshme, të saktë dhe të plotë, mbështetur në standardet e auditimit (ISSAI/FPP-100; 400; 4000), ku ne të japim siguri të arsyeshme, në dhënien e opinionit të auditimit nëse subjekti i audituar ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe të evidentojmë devijimet nga kriteret e pranuar, shkeljen e parimeve të rregullshmërisë dhe korrektësisë/ përshtatshmërisë, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese.

Disa nga gjetjet dhe rekomandimet kryesore:

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se vlerësimi paraprak i të dhënave teknike për të dy vendburimet “Frakull” dhe “Povelçë” është vetëm në gjuhën angleze dhe nuk ka asnjë nënshkrim apo elementë që të faktojnë apo të vërtetojnë që ky raport është hartuar nga kompani konsulente të fushës I. P. T. dhe P. E. T., ashtu sikurse citohet në shkresën ku shprehet interesi për shfrytëzim të vendburimeve të lira “Frakull” dhe “Povelçë”. në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimin nr. 4, datë 19.6.2017, neni 4, pika 9, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”, e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

**1.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, AKBN dhe Albpetrol sh.a që dokumentacioni i shprehjes së interesit, vlerësimet paraprake të të dhënave teknike të pranohen vetëm në gjuhën shqipe duke e lënë opsionale shoqërimin me variantin në gjuhën angleze.

**2.Gjetje nga auditimi:** Relacioni i hartuar nga grupi i punës për vlerësimin e aplikantëve nuk përmban analiza të kryera nga vet grupi i punës, është sipërfaqësor, ka karakter përmbledhës, paraqet vetëm konkluzione dhe nuk shoqërohet me analiza të detajuara apo vlerësim të plotë në lidhje me dokumentacionin që ka dorëzuar shoqëria në kundërshtim me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar Nenit 5, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 19 të Raportit të Auditimit)

**2.1.Rekomandimi:** Grupi i punës për vlerësimin e aplikimeve, të hartojë dhe të paraqesë në Ministri Relacionin me analiza të detajuara si skema financiare (value for money), mbi vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe financiare sipas dokumentacionit të dorëzuar nga kompania e interesuar, konkurrenca apo aftësia e projektit për të tërhequr subjekte të tjera të mundshëm dhe financime private dhe të mos mjaftohet vetëm me listim dokumentacioni të paraqitur duke argumentuar vendimin mbi zgjedhjen e kompanisë.

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i formularit të ofertës të paraqitur nga “E. N. G.” shpk për vendburimet “Povelcë” dhe “Frakull” në lidhje me vlerësimin e kapaciteteve financiare dhe teknike u konstatua se:

- Kompania nuk rezulton rentabël (me rezultat pozitiv) për vitet 2018 dhe 2019 si dhe vlera e likuiditeteve të lira, gjendje në Bankë janë të pamjaftueshme për angazhime në sektorin hidrokarbur.

- Kompania e bazon financimin e projektit me një marrëveshje huaje me O. B., e cila ka pasigurinë e aprovimit nga autoritetet e Bankës si dhe marrëveshja e huasë ka efekte në të ardhmen me risqet që mund të përballlet vetë shteti shqiptar me rastin e mungesës së likuiditetit apo pamundësie paguese të kompanisë të huasë.

- Në lidhje me Kapacitetet teknike në dokumentet e ofertës së paraqitur është një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë “I. C.” shpk (person juridik shqiptar regjistruar pranë QKB me Nipt M.....S), marrëveshje e cila nuk është e lidhur para Noterit. Referuar sa më sipër edhe kompania bashkëpunuese nuk ka eksperiencë dhe përvojë në fushën e hidrokarbureve pasi ka objekt aktiviteti “Konsulencë për biznesin”.

Nisur sa më sipër, Kompania nuk disponon Burimet Financiare si dhe Kapacitetet Teknike për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit që vijnë nga lidhja e një Marrëveshje Hidrokarbure në kundërshtim me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar Nenit 5, pika 2.

**3.1.Rekomandimi:** Të merren masa që grupet e punës që ngrihen për vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe financiare të aplikantëve të argumentojnë marrjen e vendimeve mbi bazën e vlerësimeve të mirëfillta teknike-financiare në përputhje me kriteret ligjore të cilat sjellin pasoja në lidhjen dhe zbatimin e MH.

Organet drejtues të MIE, si organ vendim marrës, të sigurohen që relacionet mbi vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe financiare të kanë ekspertizën e nevojshme teknike financiare për tu bindur nëse subjekti i interesuar mund të sigurojë burimet financiare dhe kompetencën teknike të kërkuar për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit nën Marrëveshjen e Hidrokarbureve.

**4.Gjetje nga auditimi:** Referuar praktikës për përgatitjen dhe miratimin e MH rezultoi se:

- Për vendburimet “Frakull” dhe “Povelcë” nuk janë respektuar afatet ligjore në lidhje me përcjelljen e dokumentacionit të nevojshëm të vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe financiare në Ministri, në kundërshtim me pikën II/2/i të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018, të Ministrisë të MIE. Kjo vonesë ka sjellë marrjen e vendimeve jo në përputhje me afatet ligjore të parashikuara e cila për nga niveli i rëndësisë është e mesme. (Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 20-22 të Raportit të Auditimit).

- Për zonën e kërkimit Blloku 4 referuar praktikës të vendosur në dispozicion nuk justifikohet vonesa në kohë e vijimit të procedurave të miratimit të finalizimit të MH-së. Ministri i MIE më datë 31.07.2015, ka autorizuar AKBN të vazhdojë procedurat e mëtejshme me subjektet e interesuara për të negociuar për Termat dhe Kushtet Kryesore të MH respektive. Afërsisht një vit më vonë, me datë 20.07.2016 (31.07.2015- 20.07.2016) AKBN i ka dërguar MIE për miratim termat dhe kushtet kryesore për të lidhur Marrëveshjet Hidrokarbure për vendburimet respektive. Në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018, të Ministrisë të MIE, kjo kohë nuk është parashikuar, afatet kohore janë parashikuar

vetëm pas nënshkrimit të Termave dhe Kushteve Kryesore të MH nga grupi negociator. Kjo vonesë ka sjellë në zvarritjen e praktikës dhe procedurës për përgatitjen dhe miratimin e MH.

**4.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga Albpetrol sh.a dhe AKBN që në të ardhmen të respektohen afatet ligjore në lidhje me paraqitjen në MIE të dokumentacionit të nevojshëm të vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe financiare të kompanisë së interesuar.

**4.2.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE në përcaktimin e afateve të proceseve gjithëpërfshirëse të mirëpërcaktuara për fazën e negocimit të termave dhe kushteve kryesore si dhe negocimit të tekstit të MH me finalizimin e procedurave pa vonesa.

**5.Gjetje nga auditimi:** Referuar procedurës për miratimin e LM, rezultoi se nuk janë respektuar afatet Ligjore në lidhje me hartimin e Draft Licence Marrëveshjes nga AKBN, konkretisht kërkesa e ardhur nga Albpetrol sh.a datë 14.05.2021 dhe Drafti i Licencë Marrëveshjes është përcjell nga AKBN në Albpetrol datë 13.07.2021, në kundërshtim me pikën III/2 të Rregullores “Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018 të Ministrit të MIE. Kjo vonesë ka sjellë marrjen e vendimeve jo në përputhje me afatet ligjore të parashikuara e cila për nga niveli i rëndësisë është e mesme.

**5.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga AKBN që në të ardhmen të respektohen afatet ligjore në lidhje me miratimin e LM.

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se MH për vb “Povelçës” dhe “Frakullës” janë lidhur me të njëjtën kompani “E. N. G.” shpk, me të njëjtin NIPT, M.....T, në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit 153/2020 “Operacionet e veçanta Hidrokarbure” dhe pikën 2 e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe MIE nr. 21, datë 14.07.2021 “Për operacionet e veçanta hidrokarbure dhe parashikimet financiare”. Referuar këtyre përcaktimeve operatorët ekonomik që kryejnë operacione hidrokarbure llogarisin dhe paguajnë detyrimin e tatimit mbi fitimin të ndarë për secilin “nga operacionet e veçanta hidrokarbure”, kjo do ti jepte fund që shpenzimet e një vendburimi ti ngarkoheshin vendburimit tjetër duke parandaluar shmangien e regjimit fiskal.

**6.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, Albpetrol sh.a që çdo operacion të veçantë hidrokarbur të lidhen dhe të miratohen MH me persona juridike me numra të veçantë NIPTI, kjo do të ndikojë në forcimin e kontrollit fiskal, mbledhjen e të ardhurave tatimore, shmangien e evazionit si dhe në respektimin e legjislacionit tatimor në Sektorin Hidrokarbur.

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se:

-Nga MIE, AKBN, Albpetrol sh.a nuk është zgjidhur problemi i Garancisë Bankare duke mosrespektuar detyrimin ligjor të parashikuar në Nenin 26.6 të MH. Referuar dokumentacionit, Garancia Bankare është paraqitur nga subjekti por nuk është pranuar nga AKBN me pretendimin se Garancitë Bankare të paraqitura nga subjekti për vb Povelcë dhe vb Frakull nuk janë sipas Aneksit E “Forma e garancisë bankare” të parashikuar në MH dhe nuk kanë vlefshmëri juridike. Pavarësisht korrespondencës midis kontraktorit, MIE, AKBN DHE Albpetrol sh.a, ky problem nuk është zgjidhur duke i ekspozuar këto institucione ndaj riskut të mos respektimit nga ana e kontraktorit të planit të punës, të vlerës së angazhimit të investimit minimal në Periudhën e Vlerësimit për vb Povelcë dhe vb Frakull (secila në vlerën 500,000 usd) e cila ndikon në vijueshmërinë normale të procesit të zbatimit MH.

- Edhe sikur ti Referohemi Formatit të Garancisë të lëshuar nga B., të paraqitur nga Kompania, kjo garanci është e vlefshme deri më 13.06.2024 (pra garancia është liruar vetë pasi afati maksimal ka kaluar) si dhe faktit që Garancia Bankare është pjesë integrale e MH dhe LM, Albpetrol sh.a dhe AKBN kanë humbur mbrojtjen, instrumentin ligjor apo garancinë financiare kundrejt Kontraktorit për përmbushjen e detyrimeve kontraktore në lidhje me angazhimin të investimit minimal financiar të Programit të Punës për periudhën e vlerësimit. Si përfundim s’ka garanci të vlefshme bankare dhe për më tepër kjo garanci që ka është çliruar në kundërshtim me nenin 26.6 si dhe Aneksit E të MH dhe LH.

-Gjithashtu Albpetrol sh.a nuk ka marrë asnjë masë në lidhje me Kompaninë, ku kuadri ligjor e shpreh qartë që mos paraqitja e Garancisë Bankare bëhet shkak për zgjidhjen e menjëhershme të këtyre marrëveshjeve duke vepruar jo në përputhje me Nenin 24, pika 24.3/b të MH.

**7.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, AKBN, Albpetrol sh.a për intensifikimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për identifikimin dhe zgjidhjen në kohë të problemeve dhe mangësive që lindin gjatë fazave të miratimit dhe zbatimit të MH.

**7.2.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, AKBN, Albpetrol sh.a për të ndjekur dhe për të realizuar paraqitjen e Garancisë Bankare brenda afatit ligjor për vetë rëndësinë që ka si pjesë integrale e MH-së dhe LM-së dhe si instrument ligjor mbrojtje për përmbushjen e detyrimeve kontraktore në lidhje me realizimin e angazhimit të investimit minimal financiar të Programit të Punës për periudhën e vlerësimit.

**8.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me afatet e parashikuara në MH dhe LM konstatohet se Kompania që ka lidhur MH duhet të filloj punën 10 ditë pas datës efektive sipas nenit 8.1 të MH dhe brenda 60 ditëve duhet të miratohet plani i punës ndërkohë që kontraktori ka detyrimin ligjor të paraqesë Garancinë Bankare brenda 60 ditëve (kusht ky që në rast mosplotësimi sjell revokimin e LM dhe MH). AKBN dhe Albpetrol si pasojë e moskoherencës në afate përballen me faktin që operacionet hidrokarbure kanë filluar, plani i punës mund të jetë miratuar ndërkohë që garancia si instrument ligjor mbrojtës nuk është dorëzuar ose nuk pranohet nga AKBN-ja për arsye të ndryshme, vështirësi serioze këto për një zbatim normal të MH.

- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion grupi i auditimit ka konstatuar se edhe pse kompania P. P. C. nuk ka bërë asnjë pagesë për Garancinë Bankare, Bonusin e Nënshkrimit dhe Bonusin e trajnimeve është lejuar të vijojë me operacione hidrokarbure.

P. P. C. nuk ka marrë masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve.

**8.1 Rekomandimi:** Për një zbatim normal të MH, të merren masa nga MIE, AKBN, Albpetrol sh.a për vendosjen në koherencë të afateve gjatë hartimit dhe miratimit të MH dhe LM si dhe paraqitja dhe pranimi i garancisë të jetë si kusht themelor për fillimin e operacioneve hidrokarbure.

**8.2 Rekomandimi:** Nisur nga fakti që baza e MH janë ligjet dhe aktet nënligjore shqiptare strukturat përkatëse të MIE, AKBN, Albpetrol sh.a gjatë fazës së hartimit të marrëveshjeve hidrokarbure të parashikohen penaltitete dhe gjoha në rastin e mosplotësimin në kohë të detyrimeve të kësaj marrëveshje me qëllim garantimin e barazisë në të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**9. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me angazhimin minimal të investimit në vlerën prej 500,000 usd, grupi i auditimit konstatoi se kjo vlerë nuk jepet e detajuar për zërat që përmban programi i vlerësimit. Ky programi paraqitet si Aneksi G i MH ku jepet i detajuar në aktivitete por pa vlera.

Mos detajimi i vlerave përkatëse sipas zërave të përfshirë në Programin e Vlerësimit të investimit sjell paqartësi në gjykimin e përmbushjes së këtij programi në vlerën e angazhimit minimal të investimit prej 500,000 USD si kusht kryesor për çlirimin e garancisë bankare si dhe zbatimin e MH-së.

**9.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, AKBN, Albpetrol sh.a që programi i vlerësimit, që njihet si Aneksi G i MH-së, të jetë i detajuar në aktivitete dhe me vlera përkatëse si operacione hidrokarbure për të gjykuar mbi realizimin e strukturës së operacioneve të vlerësimit në zëra specifik sipas ofertës teknike.

**10.Gjetje nga auditimi:** Procesverbalet e kalimit të aseteve dhe të dhënave teknike kanë bashkangjitur inventarin e detajuar të çdo pusi por nuk janë të nënshkruara nga të gjithë pjesëmarrësit që përfaqësojnë palët, Albpetrol sh.a dhe “E. N. G.” shpk dhe të miratuara nga Administratorët përkatës siç përcaktohet në Nenin 3, Pika 4 a, b, c të LM si dhe në Aneksin F të MH.

- U konstatua se në Procesverbalin e datës 12.10.2023 (Fr-49) nuk është nënshkruar nga A. B. (përfaqësues Albpetrol Sha) si dhe ky procesverbal në faqen e parë është nënshkruar nga 8 prej 11 anëtarëve.

- U konstatua se në Procesverbalin e datës 25.07.2022 (Fr – 19, 109, 36/b) nuk është nënshkruar nga S. A. (përfaqësues Albpetrol Sha).

- U konstatua se në Procesverbalin e datës 06.02.2023 (Pov 1b, 9, 13, 23) nuk është nënshkruar nga A. Xh. (përfaqësues Albpetrol Sha) si dhe ky procesverbal në faqen e parë është nënshkruar nga 9 prej 13 anëtarëve.

**10.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga Albpetrol sh.a dhe AKBN që proces-verbalet e kalimit të aseteve dhe të të dhënave teknike për vetë rëndësinë e procesit të jenë të nënshkruara nga gjithë anëtarët e komisioneve të përbashkëta të ngritura për këtë qëllim. (AKBN-Albpetrol-E.).

**11.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me Programet e Punës dhe Buxhetet që kontraktori paraqet tek Albpetrol dhe/ose AKBN si dokumenti ku parashtrohet dhe propozon operacionet Hidrokarbure për tu kryer gjatë Periudhës Vlerësimit, si dhe faktit që ky program duhet të jetë konsistent me Programin e Vlerësimit, konstatohet se nuk ka një format tip të planit të punës dhe të buxhetit ku të jetë parashikuar më parë në Marrëveshje (si Aneks) për tu paraqitur në mbledhjet e Komitetit Këshillimor, e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësishme së mesme.

Programet e Punës dhe Buxhetet e paraqitura nga Sh. U. A. paraqitet në prezantime power point dhe word, të pa detajuara dhe analizuara të përmbledhura në 3 zëra (sizmik, kosto menaxhimi, të tjera).

**11.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Albpetrol Sha dhe AKBN për një unifikim të formatit (Programi i Punës dhe Buxhetit) si dokument ku Kontraktori parashtrohet Operacionet Hidrokarbure dhe i propozon AKBN, Albpetrol sha për tu kryer gjatë periudhës Vlerësimit duke e parashikuar në Marrëveshje (si Aneks) gjatë fazës së hartimit të MH.

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk ka një dokument ku të komunikohet data e fillimit të operacioneve hidrokarbure nga kompania. Në lidhje me fillimin e operacioneve, referuar Raport-Progressit të Q3 2022(Qershor, Korrik - Shtator), Q4 2022 (Tetor-Dhjetor) për vb “Frakull” dhe vb “Povelcë” konstatohet se Operacionet Hidrokarbure nuk kanë filluar në 10 ditët e mbetur pas datës efektive të muajit Qershor sipas MH si dhe 60 ditë nga data efektive sipas LM, duke mos zbatuar afatet e mësipërme. Në këto situacione shprehen vetëm në mënyrë të përgjithshme se çfarë do të kryhen dhe jo çfarë është kryer faktikisht deri në Dhjetor 2022. Referuar Treguesve Financiarë të raportuar vihet re se shpenzimet kapitale në këtë periudhë janë zero në kundërshtim me afatet e përcaktuara në neni 7.1 të LM si dhe neni 8.1 të MH.

**12.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga Drejtoria Hidrokarbure pranë AKBN dhe Albpetrol sha për të kryer analiza të mirëfillta dhe të vlerësojë informacionet teknike në lidhje me Operacionet Hidrokarbure si dhe të reflektojë çdo angazhim apo detyrim teknik në planet dhe buxhetet 3/mujore dhe situacionet që raporton kompania pranë AKBN dhe Albpetrol sha.

**13.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me zbatimin e afateve të pagesës së Bonusit të Trajnimit u konstatua se:

Kompania E. N. G. ka paguar Bonusin e Trajnimit dhe Administrativ vetëm për vitin 2022 (për pjesën e mbetur si vit kalendarik dhe jo si vit kontraktual) Pagesa e bonusit të trajnimit për vitin 2023 dhe 6- muajor 2024 është kryer në datën 29.07.2024 rreth një vit me vonesë, në kundërshtim me Nenin nr.10.1 të MH-së për vb Frakull.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Albpetrol Sha për mosmarrjen e masave në kohë për përmbushjen e detyrimeve nga Kontraktori. (Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 41 të Raportit të Auditimit)



- Kompania Sh. U. A. për vitet 2019, 2022 dhe 2023 nuk ka zbatuar afatet ligjore për kryerjen e pagesës pasi data efektive e kontratës është 14.06.2019 dhe pagesat duhet të kryhen minimalisht 30 ditë përpara fillimit të vitit kontraktual domethënë pagesat duhet të kryhen brenda datës 14 maj të çdo viti në kundërshtim me nenin 27/3.1 të KNP.

**13.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga Albpetrol Sha dhe AKBN për zbatimin e afateve të pagesës së Bonusit të Trajnimit nga kontraktori si një nga përfitimet që ka nga nënshkrimi i marrëveshjeve.

**14.Gjetje nga auditimi:** Nuk është ngritur brenda afatit grupi i Komitetit Këshillimor për vendburimet Frakull dhe Povelçë. Titullari i Albpetrol Sha nuk ka zbatuar afatin prej 30 ditësh për ngritjen e grupit të përfaqësuesve, nuk ka Urdhër ose Vendim për caktimin e përfaqësuesve të Albpetrol SHA në Komitetin Këshillimor si dhe përfaqësuesit alternative jo në përputhje me nenin nr.5, pikën 5.1.1, 5.1.2, 5.1.3 të MH-së për vendburimet Frakull dhe Povelçë. Nga auditimi u konstatua se përfaqësuesit e Albpetrol Sha, caktohen përpara çdo mbledhje të Komitetit nëpërmjet komunikimit elektronik (email).

-nuk është mbledhur minimalisht 2 herë në çdo vit fiskal (deri në 31.12.2023 kemi vetëm 2 mbledhje) jo në përputhje me nenin nr.5, 5.1.4., të MH-së për vendburimet Frakull dhe Povelçë.

-Protokolli me procesverbalin me minutat e takimit të mbledhjes së Komitetit Këshillimor të datës 20.07.2022 nuk janë të firmosura nga palët, çdo faqe është nënshkruar vetëm nga 3 firma, nuk identifikohen se cilës palë i përkasin duke vënë në dyshim mbajtjen e mbledhjes si dhe vlefshmërinë e vendimeve të marra, jo në përputhje me nenin nr. 5, pikën 5.1.3 të MH-së për vb e “Frakullës” dhe “Povelçës”.

**14.1.Rekomandimi:** Për një zbatim normal të Marrëveshjeve Hidrokarbure, Titullari i Albpetrol sha në të ardhmen të marrë masa për ngritjen e Komitetit Këshillimor brenda afatit ligjor të parashikuar në MH, të respektohet periodiciteti ligjor i mbajtjes së mbledhjeve të këtij Komiteti si dhe në fund të çdo takimi të përgatitet nga Kontraktori protokollin me minutat e takimit dhe të miratohen duke u nënshkruar në çdo faqe nga palët.

**15.Gjetje nga auditimi:** Duke analizuar përqindjen e realizimit ndërmjet vlerave të Buxhetit të dakortësuar dhe Raportimit të Shpenzimeve faktike për vb Frakull dhe vb Povelçë, ka një diferencë të madhe edhe pse kontrata ua njeh të drejtën e rishikimit të vlerave të buxhetit (që të ngushtohet diferenca midis planifikimit dhe realizimit) e cila mund të kërkohet për arsye operacionale ose si rezultat i veprimtarisë së Kërkimit dhe të Vlerësimit. Sa më sipër në lidhje me Programin e punës dhe Buxhetet respektive konstatohet se E. N. ka raportuar vlera të larta planifikimi por realizimi i tyre është në nivele shumë të ulëta (konkretisht për vb Frakull vitin 2022 është 33% dhe vitin 2023 është 63 % dhe për vb Povelçë për vitin 2022 është 4,5% dhe vitin 2023 është 13.2 %). Kjo vë në dyshim procesin e përgatitjes dhe planifikimit të buxhetit pa një studim të mirëfilltë, monitorimin e zbatimit të buxhetit për performancën financiare si dhe vë në dyshim ekzistencën e kapaciteteve financiare të Kompanisë në kundërshtim me nenin 7.2 të LM dhe nenit 8 të MH për vb Frakull dhe Povelçë e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësishme së lartë.

- Konstatohet se për vb Povelçë shpenzimet e njohura për përmbushjen e angazhimit minimal të periudhës së vlerësimit janë ato të raportuara në zërin CAPEX që për periudhën qershor 2022- dhjetor 2023 janë në vlerën 122,436 USD, ose me një mos realizim në vlerën 377,564 USD (deri në 31.12.2023). Albpetrol Sha dhe AKBN duke parë trendin e mos realizimit të CAPEX në 6 tremujorët duhet rriste monitorimin e realizimit si dhe të diskutohej në mbledhjet e Komitetit Këshillimor.

- Grupi i auditimit konstatoi se ka një mospërputhje të vlerave të buxheteve fillestare dhe të rishikuara në raportet e progresit të sjella nga kompania. Edhe pse jemi para faktit se si AKBN dhe Albpetrol Sha nuk kanë kryer asnjë auditim të kostove dhe pasqyrave financiare, këto institucione nuk kanë kontrolluar/kuadruar as shifrat e sjella nga kompania.)

**15.1.Rekomandimi:** Të merren masat nga Albpetrol Sha, AKBN, Komiteti Këshillimor që në të ardhmen diskutimin në lidhje me përcaktimin e Buxhetit dhe realizimin e tyre ti paraprijë analiza dhe studime të mirëfillta tekniko-financiare, të nxjerrin shkaqet e mosrealizimit, të bëhen verifikime dhe rishikime si dhe të merren hapat e nevojshme për tu orientuar në monitorimin e MH në kuadër të vlerësimit të performancës së saj dhe vlerës së shtuar që ofron Kompania.

**16.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me detyrimet ligjore të MH, u konstatua se përmbajtja e marrëveshjes në Aneksin C, pika I.2.1 për vendburimin e Gazit “Frakull” dhe “Povelcë”, ka një boshllëk interpretimi në lidhje me detyrimin e dorëzimit të situacioneve tremujore në periudhën e vlerësimit pasi:

*“Kontraktori do ti dorëzoje Albpetrol-it dhe AKBN-s, sa me shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga përfundimi i çdo Tremujori Kalendarik, një Situacion të Veprimtarisë së Zhvillimit sipas Nenit 7 të Marrëveshjes, ku pasqyrohen të gjitha detyrimet dhe kreditimet në lidhje me Zhvillimin dhe Prodhimin për atë Tremujor Kalendarik (Shpenzimet e Zhvillimit dhe Shpenzimet Operative), që të përfshijë totalin për të gjithë vitin dhe detyrimet dhe kreditimet kumulative që prej fillimit, të përmbledhura sipas klasifikimeve të duhura që tregojnë natyrën e tyre”.* Për sa më sipër periudha e vlerësimit është lënë jashtë interpretimit detyrimin ligjor.

**16.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, “Albpetrol” sha, AKBN që në të ardhmen nëpërmjet intensifikimit dhe bashkëpunimit ndër institucional gjatë fazës së hartimit të MH dhe LM të përfshijë të gjithë detyrimet dhe të drejtat e palëve sipas fazave të operacioneve hidrokarbure.

**17.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në lidhje me Monitorimin e MH, Albpetrol Sha dhe AKBN si përfaqësues i autoritetit në kontratë nuk disponojnë programe apo plane periodike vjetore për të ushtruar kontrole në subjekte si zotërues të lejeve Hidrokarbure. Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion informacion apo praktikë të ndjekur në lidhje me Monitorimin, Mbikëqyrjen e përgjithshme të MH apo inspektime për vendburime ku të bëhen krahasime apo vlerësime konkrete të treguesve teknologjikë apo të realizimit të investimeve etj, me planet e punës apo buxhetet e fillestare apo të rishikuara me treguesit e raportuar në situacionet përkatës, në kundërshtim me Nenin e MH-së dhe LM-së respektive sipas marrëveshjeve të vendburimeve, Pikës 9 të Rregullores së Brendshme të AKBN.

**17.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga strukturat drejtuese të Albpetrol Sha, strukturat drejtuese të AKBN, që në të ardhmen të merren hapa konkretë në lidhje me Monitorimin dhe mbikëqyrjen e MH drejt vlerësimit të performancës së saj dhe vlerës së shtuar të angazhimit të subjekteve privat në këtë sektor, si hartimi i planeve vjetore te detajuar për të ushtruar kontrole në subjekte që ushtrojnë të drejtën e operacioneve hidrokarbure.

### **I.1. Konkluzioni i auditimit.**

Nga auditimi i ushtruar në MIE, AKBN dhe Albpetrol Sha në sektorin hidrokarbur rezultoi, ka pasur disa shkelje të kuadrit ligjor në fuqi në lidhje me procedurën e inicimit, shprehjen e interesit, përzgjedhjes, negociimit, lidhjes dhe zbatimit të LM dhe MH.

Nga auditimi i kryer pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, “Albpetrol” SHA, dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyrore (AKBN) për marrëveshjet hidrokarbure të lidhura në Republikën e Shqipërisë për veprimtarinë nga periudha e identifikimit/propozimit të lidhjes së marrëveshjeve deri në datën 31.12.2023, lidhur me përputhshmërinë sa i takon Fazës procedurale, propozimi dhe miratimi i projektit: *propozimit të marrëveshjes, vlerësimit dhe vendimmarrjes për pranimin e tij, procedurën e lidhjes së marrëveshjes hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin me legjislacionin përkatës në fuqi, vlerësimin e elementëve në kuadër të lidhjes së kontratës dhe ristrukturimi i saj, Zbatimit të*

kontratës: vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, auditimi i fazës së investimit të MH, trajtimi kontabël i standardeve dhe politikave kontabël të marrëveshjeve hidrokarbure, etj., të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike, rezultuan:

- Nga evidencat e marra për veprimtarinë në sektorin hidrokarbur rezulton se MIE, AKBN dhe “Albpetrol” SHA nuk kanë programe apo plane periodike, vjetore për të ushtruar kontrole në subjekte si zotërues të lejeve Hidrokarbure.

- Nga MIE, AKBN dhe “Albpetrol” SHA nuk u paraqit asnjë informacion apo praktikë e ndjekur në lidhje me Monitorimin, Mbikëqyrjen e përgjithshme të Marrëveshjeve Hidrokarbure apo inspektimet për vendburimet me krahasime apo vlerësime konkrete të treguesve teknologjikë, realizimit të investimeve etj, me planet e punës, buxhetet e fillestare apo të rishikuara, me treguesit e raportuar në situacionet përkatëse, në kundërshtim me Nenet e MH-së dhe LM-së respektive sipas marrëveshjeve të vendburimeve, Pikës 9 të Rregullores së Brendshme të AKBN.

- Grupi i Komitetit Këshillimor për vendburimet “Frakull dhe Povelçë” nuk është ngritur brenda afatit dhe se Titullari i “Albpetrol” SHA nuk ka zbatuar afatin prej 30 ditësh për ngritjen e grupit të përfaqësuesve dhe se nuk ka Urdhër ose Vendim për caktimin e përfaqësuesve të “Albpetrol” SHA në Komitetin Këshillimor si dhe përfaqësuesit alternative sipas kërkesave të nenin nr.5, pika 5.1.1, 5.1.2, 5.1.3 të MH-së për vendburimet “Frakull” dhe “Povelçë”.

- Nga auditimi i formularit të ofertës të paraqitur nga “E. N. G.” shpk për vendburimet “Povelçë” dhe “Frakull” në lidhje me vlerësimin e kapaciteteve financiare dhe teknike u konstatua se kompania e mësipërme nuk rezulton rentabël (me rezultat pozitiv) për vitet 2018 dhe 2019 si dhe vlera e likuiditeteve të lira, gjendje në Bankë janë të pamjaftueshme për angazhime në sektorin hidrokarbur.

Kompania “E. N. G.” shpk nuk disponon Burimet Financiare si dhe Kapacitetet Teknike për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit që vijnë nga lidhja e Marrëveshjes Hidrokarbure në kundërshtim me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar Nenet 5, pika 2.

- “Sh. U. A.” B.V nuk ka përmbushur detyrimin në lidhje me fondin për investime sociale prej 1,000,000 USD si detyrim i kompanisë gjatë periudhës së pezullimit, bazuar në VKM Nr.652, datë 10.10.2022 “Kontraktori do të investojë 1,000,000 USD në projekte të investimeve sociale të lidhura me burimet e rinovueshme dhe tranzicionin energjetik siç ka rënë dakord me MIE ” si e ardhur dhe investim i munguar.

- Nuk ka negociata mbi kushtet e amendimit të Kontratës me Ndarje Prodhimi (KNP-së), Grupit Negociator i ngritur me Urdhrin nr. 86, datë 04.05.2022, nuk ka të përcaktuar me emra konkret përfaqësuesit e AKBN. Amendimi i KNP është dakordësuar dhe nënshkruar në datën 12.05.2022 midis Ministrit i MIE dhe Përfaqësuesit Ligjor të S. 4. AKBN ,S. 4 dhe MIE kanë filluar zbatimin e Amendimit të KNP pa pritur miratimin e saj me VKM.

- Referuar Aneksit C “Procedura kontabël”, pika 3 “Auditimet dhe rregullimet” të Marrëveshjes Hidrokarbure për Bllokun 4 në lidhje me kostot e kundërshtuara dhe kostot e pezulluara, palët, deri në përfundim të periudhës së auditimit nuk kanë gjetur një zgjidhje në lidhje me statusin e kostove pezull, në vlerën 2,954,441 USD (pagesë e ekspertëve të filialeve të Sh., në vende tjera për punën e kryer për llogari të Bllokut 4), si shpenzim i kryer pa ekonomikitet.

- Nga AKBN nuk është shfrytëzuar mundësia e trajnimit në institucionet ndërkombëtare të stafit të AKBN, e drejtë kjo që rrjedh nga Neni 27.4 të KNP-së Blloku “Dumrea” në vlerën 600,000 euro për vit kontraktual për periudhën e kërkimit si dhe nuk u paraqit programi i trajnimit mbi baza vjetore i përgatitur bashkërisht (E. dhe AKBN). si e ardhur dhe investim i munguar.

- Detyrimi i B. për sasinë totale prej 54,009.978 Ton naftë bruto, e pa tërhequr për vitin 2019 - 2023 për llogari të Prodhimi Para Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol SHA (PPA) sipas Marrëveshjes Hidrokarbure është 18,659,033.93 USD, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara për “Albpetrol” SHA.

- Konstatohet se “B. P. A.” Ltd nuk paguan detyrimin për energjinë elektrike ndaj Albpetrol SHA, vlerë e cila deri në 31.12.2023 është 1,654,040,397 lekë.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 544/1, prot. datë 22/04/2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 23/04/2024 deri në datën 26/07/2024, në subjektet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Albpetrol Sha për periudhën nga identifikimi / propozimi i lidhjes së marrëveshjeve deri në datën 31/12/2023, u krye auditimi “Mbi auditimin e Përputhshmërisë për Marrëveshjet Hidrokarbure të lidhura në Republikën e Shqipërisë”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. I. S. (Përgjegjëse grupi),
2. T. Gj., anëtar,
3. E. K., anëtar,
4. K. H., anëtar,
5. E. S., anëtar,
6. Q. M., anëtar.

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

### 1. Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Dhënia e opinionit dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve si dhe nëse është kryer përdorimi i përshtatshëm i kuadrit ligjor për administrimin e pronës publike.

### 2. Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë që lidhet me këtë sektorin hidrokarbur nga identifikimi / propozimi i lidhjes së marrëveshjeve deri në datën 31/12/2023, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e tij.

Përputhshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e strukturave përkatëse pranë MIE, AKBN dhe Albpetrol sha, të cilat zhvillojnë procedurat nga iniciimi, miratimi deri në monitorimin e zbatimit të MH dhe LM.

### 3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Strukturat në Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Albpetrol Sha janë përgjegjëse për procedurën e inicimit, shprehjen e interesit, përzgjedhjes, negocimin, lidhjes dhe zbatimit të LM dhe MH

### 4. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me implementimin e projektit shkallën e realizimit të objektivave etj.. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

### 5. Kriteret e vlerësimit:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”  
Dekret i Presidentit nr. 782, datë 22.02.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve”  
Ligji nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar  
Ligji nr.7811, datë 12.4.1994 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.782, datë 22.2.1994  
“Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)””  
Ligji nr. 10049, datë 24.12.2008 “Për një ndryshim në ligjin nr.7811, datë 12.4.1994  
“Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.782, datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin  
e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)””  
Ligji nr. 32/2012 Për një ndryshim në Ligjin nr. 7811, datë 12.4.1994 “Për miratimin me  
ndryshime të Dekretit nr. 782, datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve  
(kërkim – prodhim)””  
Ligji nr. 183/2013 Për një ndryshim në Ligjin nr. 7811, datë 12.4.1994, “Për miratimin me  
ndryshime të Dekretit nr. 782, datë 22.2.1994, “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve  
(kërkim-prodhim)””  
Ligji nr. 153/2020 “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbureve”  
Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar  
Ligji nr. 8438, datë 28.12.21998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.  
Vendimi i KM nr.445, datë 3.9.1993 Për krijimin e agjencisë kombëtare të hidrokarbureve  
Vendimi i KM nr. 547, datë 9.8.2006 Për krijimin e agjencisë kombëtare të burimeve natyrore,  
i ndryshuar  
Vendimi i KM nr. 33, datë 19.01.2011, si dhe akti normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë  
16.06.2010, i dalë në zbatim të ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”, i ndryshuar.  
Vendimi i KM për miratimin e marrëveshjeve hidrokarbure.  
Rregullore për procedurat e miratimit të Marrëveshjeve hidrokarbure dhe licencë marrëveshjet  
si dhe afatet përkatëse. (në fuqi deri në vitin 2017)  
Urdhër i Ministrit nr. 121, datë 08.05.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për  
përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si  
dhe afatet përkatëse”  
Urdhër i Ministrit nr. 246, datë 12.03.2018 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e  
procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet  
përkatëse”, Etj.

#### **6. Standardet e auditimit:**

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI/IFPP 100; 200; 400 etj.;

ISSAI 5220 Udhëzime Mbi Praktikën Më Të Mirë Të Auditimit Të Financimit Privat /Publik  
Dhe Koncesioneve

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);  
Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë-KLSH;  
Manuali i Auditimit Financiar-KLSH;  
Manuali i Zbatimit të Rekomandimeve;

#### **7. Metodatat e auditimit:**

Auditim i njëpasnjëshëm, me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

#### **8. Dokumentimi i auditimit:**

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara akt konstatimeve dhe akt  
verifikimeve, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar do të  
përgatitet Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit  
Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

### III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

#### 1. Informacioni i përgjithshëm:

Në bazë dhe në zbatim të Ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkim, prodhim)”, të ndryshuar, Ministria përgjegjëse për sektorin hidrokarbur mundet, të hyjë në Marrëveshje Hidrokarburesh me çdo Person, duke autorizuar atë Person sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të kërkojë, zhvillojë dhe të prodhojë hidrokarbure në Zonën e Kontratës.

Ministria nuk do të lidhë Marrëveshje Hidrokarburesh me asnjë Person në qoftë se Ministria nuk bindet se Personi me të cilin do të lidhet Marrëveshja Hidrokarbure ka ose mund të sigurojë burimet financiare dhe kompetencën teknike të kërkuar për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit nën Marrëveshjen e Hidrokarbureve.

Një Marrëveshje Hidrokarbure për një zonë të caktuar në të, përmban të drejtën e kryerjes së operacioneve hidrokarbure të ndarë në :

1. Të drejtën ekskluzive për të kryer kërkimin brenda Zonës së Kontratës për një periudhë e cila përveç ndonjë kohe shtesë të kërkuar për të përfunduar punën e marrë përsipër për të vlerësuar një Zbulim, nuk do të kalojë 5 vjet gjithsej, përveçse kur Kontraktori bind Ministrinë se ekzistojnë kushte specifike të cilat kërkojnë një periudhë më të gjatë, atëherë Kontraktorit mund t’i jepet një periudhë që nuk i kalon 7 vjet gjithsej.

2. Të drejtën ekskluzive për një periudhë që nuk i kalon 25 vjetët, për të zhvilluar dhe prodhuar rezervat e hidrokarbureve në Zonën e Kontratës, në përputhje me kushtet e një Plani Zhvillimi të miratuar nga Ministria, si dhe për të ripërtërirë këtë të drejtë aty dhe në masën që parashikon Marrëveshja e Hidrokarbureve.

Në një Marrëveshje Hidrokarbure përmbahen të drejta dhe detyrime për kontraktorin si dhe për Ministrinë përgjegjëse për hidrokarbure ose përfaqësuesin e saj.

Një marrëveshje hidrokarburesh, nënshkruhet nga ministri i përgjegjëse për hidrokarbure ose nga një person i autorizuar me shkrim prej tij dhe hyn në fuqi pas miratimit në Këshillin e Ministrave.

#### 2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

##### I. AUDITIMI I FAZËS PROCEDURIALE: PROPOZIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTIT

1. Auditimi i propozimit të marrëveshjes, vlerësimit dhe vendimmarrjes për pranimin e tij
2. Mbi përputhshmërinë e procedurës së lidhjes së marrëveshjes me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mbi vlerësimin e elementëve në kuadër të lidhjes së kontratës dhe ristrukturimi i saj.

Për shkak të hapësirës së madhe kohore nga viti 2004 – 2023 një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit për fazën e inicimit është dorëzuar pranë Arkivit të Shtetit, nisur nga ky fakt procedura e inicimit të marrëveshjeve hidrokarbure për kërkimin zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, është audituar për këto vendburime:

##### **Marrëveshjet Hidrokarbure për vendburimin e Povelcës dhe Frakullës.**

Kjo marrëveshje është iniciuar me shprehjen e interesit për shfrytëzimin e vendburimeve të lira “Frakull” dhe “Povelcë” me shkresën nr. 3825 datë 18.05.2020 drejtuar MIE dhe për njoftim Albpetrol Sha nga Kompania “E. D. G.” sha së bashku me partnerin e saj R. C.. Bashkëlidhur kësaj kërkesë kompania ka paraqitur një vlerësim paraprak i të dhënave teknike për të dy vendburimet.

**Gjetja 1.** Nga auditimi u konstatua se: vlerësimi paraprak i të dhënave teknike për të dy vendburimet “Frakull” dhe “Povelcë” është vetëm në gjuhën angleze dhe nuk ka asnjë nënshkrim apo elementë që të faktojnë apo të vërtetojnë që ky raport është hartuar nga kompani konsulente të fushës I. P. T. dhe P. E. T., ashtu sikurse citohet në shkresën ku shprehet interesi për shfrytëzim të vendburimeve të lira “Frakull” dhe “Povelcë”. në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimin nr. 4, datë 19.6.2017, neni 4, pika 9, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” , “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”, e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të MIE dhe Albpetrol sha.

**Gjetja 2:** Kompania që ka shprehur interesin për shfrytëzimin e vendburimeve të lira “Frakull” dhe “Povelcë”, nuk ka të bashkëlidhur me dokumentin e Shprehjes së Interesit, profilin e shoqërisë “E. N. G.” shpk ose një prezantim të shkurtër për sipërmarrje të njëjta me objektin e shprehjes së interesit. Duke pasur në konsideratë rëndësinë e këtij sektori për ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare, autoritetet shtetërore përgjegjëse duhet të sigurohen që të përfshijë në këto procese me përparësi të lartë kompani me potenciale dhe kapacitete të larta profesionale (veçanërisht kompanitë që kanë një eksperiencë të konsoliduar në këtë sektor) në përputhje me Ligjin Nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet” i ndryshuar neni 5, pika 2. CV me profilin e kompanisë përbën një fakt shumë të rëndësishëm për MIE për tu parabindur nëse Kompania që ka shprehur interesin ka përvojën apo mund të sigurojë burimet financiare dhe kompetencën teknike të kërkuar për të përmbushur detyrimet e kontraktorit nën MH, e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të MIE dhe Albpetrol sha.

**Gjetja 3.** Në momentin e shprehjes së interesit, referuar Ekstraktit historik të QKB-së, aktiviteti i operacioneve hidrokarbure, nuk është pjesë e Objektivit të aktivitetit të shoqërisë “E. N. G.” shpk. Referuar sa lart, Kompania E. rezulton se nuk ka eksperiencë në fushën e kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit natyror jo në përputhje me Ligjin Nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet” i ndryshuar neni 5, pika 2. Ndryshimit i objektivit të aktivitetit të kompanisë është bërë në 16.12.2020, gjashtë muaj më vonë nga shprehja e interesit (Maj 2020). Për sa i përket eksperiencës në fushën e hidrokarbureve kompania që ka paraqitur ofertën rezulton të mos ketë eksperiencë dhe përvojë në këtë fushë. (shtuar në QKB në datë 16.12.2020 ose 12 ditë më vonë nga publikimi i “Ftesë për shprehje interesi” datë 04.12.2020).

Eksperienca dhe përvoja në fushën e hidrokarbureve apo angazhimi ligjor në një fushë kaq të rëndësishme përbën fakt të rëndësishëm për të plotësuar një nga kushtet kryesore, sigurimin e kapaciteteve teknike dhe financiare. Ky fakt duhej të çonte në skualifikimin e propozimit dhe ndërprerjen e procesit, e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të MIE.

Me shkresën nr 3825/1 datë 14.10.2020, Sekretari i Përgjithshëm i MIE i ka përcjellë Albpetrol sha kërkesën e Kompanisë “E. D. G.” sha së bashku me partnerin e saj R. C. për qëndrim dhe vlerësim.

Duke qenë se në modelin e paraqitur nga Kompania “E. D. G.” sha së bashku me partnerin e saj R. C. së bashku me konsulentët teknik I. P. T. dhe P. E. T. kanë arritur në përfundimin se këto dy vendburime kanë model pozitiv ekonomik që mund të jetë eficientë duke i vënë në punë pusët e ndaluara.



**Gjetja 4:** Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua se MIE, ka përcjellë me vonesë aplikimin e kompanisë pranë Albpetrol Sha. Konkretisht shprehja e interesit nga Kompania është në datë 18.05.2020 dhe përcjellja e kërkesës për shqyrtim në Albpetrol Sha në datë 14.10.2020, ose me 6 muaj vonesë, vonesë kjo e pajustificuar, e cila për nga niveli i rëndësisë është e mesme.

Gjithashtu referenca që vendburimet kanë një model pozitive ekonomik është e pabazuar pasi në kërkesën e paraqitur nga kompania ka vetëm një vlerësim paraprak i të dhënave teknike e pashoqëruar kjo me një analizë teknike me analizë rentabiliteti ekonomik.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të MIE.

Me shkresën nr. 5763 datë 22.10.2020, Albpetrol Sha ka shprehur dakortësinë për shpalljen e procedurës dhe tërheqjen e aplikantëve të tjerë të mundshëm.

Me Urdhrin nr. 317, datë 30.10.2020 (shkresë nr. 3825/3 prot.) “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Povelcë” dhe “Frakull”, Ministri i MIE ka urdhëruar fillimin e procedurave për dhënien e vendburimeve “Povelcë” dhe “Frakull” me afat shprehje interesi minimalisht 90 ditë, ky urdhër i është drejtuar Albpetrol Sha. Me shkresën nr. 3825/4, datë 05.11.2020, Sekretari i Përgjithshëm i MIE ka përcjellë për zbatim Urdhrin e mësipërm.

Në vijim të urdhrin të Ministrit, Administratori i Albpetrol, me Urdhrin e Brendshëm nr. 258, datë 24.11.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e aplikantëve për vendburimet ekzistuese të gazit natyror “Frakull” dhe “Povelcë”, ka ngritur grupin e punës si më poshtë:

1. E. T., Kryetar
2. A. P., zv. Kryetar
3. R. C., Anëtar
4. J. Gj., Anëtar
5. J. S., Anëtar
6. A. Gj., Anëtar
7. A. L., Anëtar
8. I. Gj., Përfaqësues i MIE

Si dhe ka përcaktuar detyrat në lidhje me vlerësimin e aplikantëve për vendburimet “Povelcë” dhe “Frakull” si më poshtë:

- Të vlerësojë aplikimet e mundshme bazuar në kapacitetin teknik, financiar të kompanive që do të aplikojnë në këtë proces dhe t’ia paraqes për miratim administratorit.

- Drejtoria e Marketingut dhe Marrëdhënieve me publikun të publikojë menjëherë me daljen e këtij Urdhri hartën e vendburimeve ekzistuese “Povelcë” dhe “Frakull”, si dhe formularin e aplikimit. Harta e vendburimeve dhe formularët e aplikimit të dërgohen me shkresë zyrtare në MIE brenda datës 24.10.2020 si edhe në adresën elektronike të saj.

- Për kryerjen e detyrave të mësipërme, Grupi i Punës, ka të drejtë të kërkojë nga çdo strukturë e Albpetrol SHA informacione apo dokumenta të nevojshme, si dhe të angazhojë specialist përkatës për kryerjen e veprimeve që kërkohen.

- Ngrihet nëngrupi i punës për hartimin e paketës së të dhënave teknike për vendburimet ekzistuese “Povelcë” dhe “Frakull” në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, paketë e cila do të jetë në dispozicion të aplikantëve të mundshëm sipas rregullave të përcaktuara brenda datës 03.12.2020. Ky grup përbëhet nga:

1. A. P., Kryetar
2. A. Gj., Anëtar
3. J. S., Anëtar
4. G. X., Anëtar
5. I. M., Anëtar
6. R. H., Anëtar.

Në vijim të punës, me Urdhrin nr. 258/1, datë 24.11.2020 “Mbi përcaktimin e çmimit të paketave të të dhënave të vendburimeve ekzistuese të gazit natyror “Povelcë” dhe “Frakull” dhe procedurën që do të ndiqet nga Albpetrol për shitjen e tyre”, Administratori i Albpetrol ka vendosur vlerën e shitjes së paketës së të dhënave për dy vendburimet që do të jetë 6,500 USD për secilën ku do të përfshijë dokumentacionin fizik dhe kopje elektronike në CD si dhe praktikën që do të ndiqet për marrjen e paketave nga palët e interesuara.

Albpetrol SHA, në datë 04.12.2020, njofton “Ftesë për shprehje interesi” për shpalljen e dy fushave të gazit në Shqipëri “Povelcë” dhe “Frakull”, zona të cilat janë nën administrimin e Albpetrol SHA.

Aplikimet duhet të dorëzohen zyrtarisht në Albpetrol jo më vonë se data 05.03.2021, ora 15:00, në ftesë përcaktohet personi i kontaktit si dhe adresa elektronike e tij, vlera e paketës me të dhënat teknike 6,500 USD (me TVSH), blerja e paketës me të dhënat është një parakusht i detyrueshëm për palët e interesuara, ku mos zbatimi i tij sjell skualifikimin nga gara.

**Gjetja 5:** Nga auditimi konstatohet se nga MEI dhe Albpetrol Sha nuk janë hartuar dhe miratuar specifikime ekonomike, teknike e objektive që duhet të plotësojnë operatorët pjesëmarrës në procedurë (kriteret bazë të nevojshme). Grupi i punës në asnjë rast nuk ka shprehur një gjykim apo vlerësim mbi kriteret objektive por thjesht janë shprehur që mendojnë ose gjykojnë por jo vlerësim objektiv mbi zëra specifik se çfarë nuk plotësojnë operatorët , bazuar kjo edhe në Nenit 5, pika 2 e Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar ku citohet se:

*“Ministria lidh marrëveshje hidrokarbure apo autorizon Albpetrolin, nëpërmjet një licence për lidhjen e një marrëveshjeje hidrokarbure, me një person, në qoftë se vlerëson se personi ka burimet financiare dhe kompetencën teknike të kërkuar për të përmbushur detyrimet e kontraktorit nën marrëveshjen hidrokarbure.”*, e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi MIE për hartimin e akteve nënligjore, rregulloreve, udhëzimeve në zbatim të Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar dhe Albpetrol SHA si përgjegjëse për vlerësimin e kapaciteteve teknike, financiare të kompanive që do të aplikojnë.

Me Urdhrin nr. 258/2, datë 22.02.2021 “Për një ndryshim në urdhrin Brendshëm nr. 258, datë 24.11.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e aplikantëve për vendburimet ekzistuese të gazit natyror “Frakull” dhe “Povelcë”, përbërja e grupit të punës ndryshohet si më poshtë:

1. A. P., Kryetar
2. F. A., zv. Kryetar
3. R. C., Anëtar
4. J. S., Anëtar
5. A. Gj., Anëtar
6. A. L., Anëtar
7. I. Gj., Anëtar përfaqësues i MIE

Me Urdhrin nr. 258/3, datë 03.03.2021, për shkak të situatës së Covid-it janë bërë ndryshime në përbërjen e grupit të punës si më poshtë:

Z. J. S. zëvendësohet me znj. G. X.

Z. A. Gj. zëvendësohet me z. Z. M.

Me proces-verbalin nr. 6673/4, datë 05.03.2021, është mbyllur aplikimi si dhe përcaktohet se brenda afateve është dorëzuar vetëm një aplikim për këtë procedurë, konkretisht nga kompania “E. D. G.” sha, me Nipt K.....R.

Nga grupi i Auditimit u konstatua se në grupin e punës që kanë firmosur proces verbalin është përfshirë dhe ka firmosur znj. O. R. e cila nuk është në përbërjen e grupit të punës në kundërshtim me Urdhrin e Brendshëm nr. 258, datë 24.11.2020, i ndryshuar.

Kompania "E. D. G." sha, me Nipt K.....R, ka aplikuar për vendburimin e lirë të prodhimit dhe kërkimit të gazit natyror Frakull dhe Povelçës më datë 04.03.2021 si dhe ka dorëzuar fizikisht dosjen me dokumentacionin mbështetës për ofertën e paraqitur.

Grupi i punës me relacionin nr. 6673/5, datë 08.03.2021 "Për vlerësimin dhe shqyrtimin e ofertave të paraqitura nga aplikuesi bazuar ne kapacitetin teknik dhe financiar për vendburimet ekzistuese të gazit natyror Frakull dhe Povelçë", ka renditur të gjithë dokumentacionin e paraqitur në të dy aplikimet (për dy vendburimet), konkretisht për vendburimin Frakull dhe Povelçë dhe shprehet se Shoqëria "E. D. G." sha:

1. Zotëron kapacitetet teknike për zhvillimin e vendburimit të gazit natyror Povelçë dhe Frakull.

2. Në bazë të angazhimit të marrë nga një institucion Financiar dhe fitimi nga pjesëmarrja në dy kompani të tjera sipërmarrëse në aksione me mbi 50 % kapital, do të ketë kapacitetet financiare për zhvillimin e vendburimit të gazit natyror Povelçë.

Në përfundim të vlerësimit, grupi i punës ka konkuduar se kompania "E. D. G." Sha disponon kapacitetet financiare dhe teknike të nevojshme për zhvillimin dhe prodhimin e vendburimeve "Frakull" dhe "Povelçë", ky procesverbal është i nënshkruar nga 6 anëtarë dhe nuk është nënshkruar nga z. I. Gj., me cilësinë e anëtarit dhe përfaqësues i MIE, gjithashtu ky relacion nuk është nënshkruar në çdo faqe nga të 7 anëtarë por vetëm 4 prej tyre.

**Gjetja 6:** Relacioni i hartuar nga grupi i punës nuk përmban analiza të kryera nga vet grupi i punës, është sipërfaqësor, ka karakter përmbledhës, paraqet vetëm konkluzione dhe nuk shoqërohet me analiza të detajuara apo vlerësim të plotë në lidhje me dokumentacionin që ka dorëzuar shoqëria në kundërshtim me pikën 1 të Urdhrit të Brendshëm nr. 258, datë 24.11.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e aplikantëve për vendburimet ekzistuese të gazit natyror "Frakull" dhe "Povelçë" të Administratorit të Albpetrol SHA si dhe Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për Hidrokarburet", i ndryshuar Nenit 5, pika 2 ku citohet se:

*"Ministria lidh marrëveshje hidrokarbure apo autorizon Albpetrolin, nëpërmjet një licence për lidhjen e një marrëveshjeje hidrokarbure, me një person, në qoftë se vlerëson se personi ka burimet financiare dhe kompetencën teknike të kërkuar për të përmbushur detyrimet e kontraktorit nën marrëveshjen hidrokarbure."* Kjo ka sjellë marrjen e vendimeve jo mbi bazën e vlerësimeve të mirëfillta teknike - financiare në përputhje me kriteret ligjore të cilat sjellin pasojë në zbatimin MH e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e Grupit të punës për vlerësimin e ofertave të aplikantëve.

**Gjetja 7:** Grupi i auditimit verifikoi formularin e ofertës në lidhje me kapacitetet financiare dhe teknike si dhe gjithë dokumentacionin justifikues dhe rezultoi se:

Për pasqyrat financiare të "E. D. G." Sha për vitet 2018, 2019 rezultojnë me humbje, konkretisht:

Viti 2017 me fitim 2,729,444 lekë

Viti 2018 me humbje (1,369,815) lekë

Viti 2019 me humbje (2548,636) lekë

Likuiditete të lira në aktive monetare, referuar pasqyrave financiare, janë:

Viti 2017: 66,802 lekë

Viti 2018: 4,793 lekë

Viti 2019: 18,353 lekë

Nisur nga sa më sipër rezultoi se kompania nuk rezultoi rentabël (me rezultat pozitiv) për vitet 2018 dhe 2019 si dhe vlera likuiditeteve të lira gjendje në Bankë janë të pamjaftueshme për angazhime në operacione hidrokarbure.

Në lidhje me kapacitetet financiare, operatori gjithashtu ka shprehur se O. B. A. ka shprehur interes bashkëpunimi dhe financimin e projektit deri në vlerën 3,000,000 USD por kjo kushtëzohet me faktin nëse kompania fiton të drejtën e shfrytëzimit si dhe miratimin nga

autoritetet përkatëse të Bankës në përputhje me rregulloren e BSH. Ky dokument nuk përfaqëson asnjë angazhim apo detyrim të ndërsjelltë midis palëve. Për sa më sipër në lidhje me kapacitetet financiare, grupi i auditimit, konstaton se kompania e bazon financimin e projektit me një marrëveshje huaje me O. B., e cila ka pasigurinë e aprovimit nga autoritetet e Bankës si dhe marrëveshja e huasë ka efekte në të ardhmen me risqet që mund të përballlet vetë shteti shqiptar në rastin e mungesës së likuiditetit apo pamundësisë paguese të kompanisë.

Në lidhje me Kapacitetet teknike në dokumentat e ofertës së paraqitur është edhe një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë I. C. (person juridik shqiptar regjistruar pranë QKB me Nipt M.....S), marrëveshje e cila nuk është e lidhur para Noterit. Referuar sa më sipër edhe kompania bashkëpunuese nuk ka eksperiencë dhe përvojë në fushën e hidrokarbureve pasi ka objekt aktiviteti “Konsulencë për biznesin”.

Nisur sa më sipër, Kompania nuk disponon Burimet Financiare si dhe Kapacitetet Teknike për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit që vijnë nga lidhja e një Marrëveshje Hidrokarbure në kundërshtim me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar Nenit 5, pika 2.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi Grupi i Punës i përbërë nga: z.A. P., Kryetar, zj. F. A., zv. Kryetar, z. R. C., zj.G. X., z. Z. M., z. A. L., z. I. Gj. (përfaqësues i MIE).

Relacioni i grupit të punës për vlerësimin e aplikantëve i është përcjell Ministrit të MIE dhe Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së me shkresën nr. 1894 prot., datë 17.03.2021.

**Gjetje 8:** Referuar praktikës, nuk janë respektuar afatet ligjore në lidhje me përcjelljen e dokumentacionit të nevojshëm të vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe financiare në Ministri, në kundërshtim me pikën II/2/i të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018, të Ministrit të MIE. Kjo vonesë ka sjellë marrjen e vendimeve jo në përputhje me afatet ligjore të parashikuara e cila për nga niveli i rëndësisë është e mesme.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi Strukturat Drejtuese pranë Albpetrol SHA.

Në vijim të procedurës me shkresën nr. 2706/2, datë 19.03.2021 “Për vazhdimin e procedurave për lidhjen e Marrëveshjeve hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve për vendburimet ekzistuese “Frakull” dhe “Povelcë”, MIE, ka përzgjedhur dhe miratuar subjektin fitues dhe kërkon nga ana e Albpetrol Sha të vazhdojë procedurat për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure.

Me Urdhrin nr. 146, datë 19.03.2021 “Për ngritjen e grupit negociator për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Frakull” dhe “Povelcë”, Ministri ka ngritur grupin negociator për fillimin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve për vendburimet “Frakull” dhe “Povelcë”, grupi përbëhet nga:

1. I. B., Kryetar
2. I. Gj., Anëtar
3. S. D., Anëtar
4. K. N., Anëtar
5. M. B., Anëtar
6. A. P., Anëtar
7. F. A., Anëtar

Në këtë urdher janë përcaktuar detyrat që ka grupi negociator për negocimin me kompaninë “E. D. G.” Sha. Procedura që do të ndiqet do të jetë në përputhje me përcaktimet në Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018 “Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave të

miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” të Ministrit të MIE.

Në mbështetje të urdhrin të mësipërm, në përbërjen e grupit negociator duhet të jenë përfaqësues të organeve kompetente, por në urdhër nuk specifikohen institucionet që anëtarët e grupit përfaqësojnë (psh përfaqësues i MIE, përfaqësues Albpetrol etj.) në kundërshtim me pikën II/4 të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” të miratuar me Urdhrin e Ministrit të MIE nr. 246, datë 12.03.2018. Nga Titullari i MIE është respektuar afati ligjor i miratimit të termave dhe kushteve kryesore të marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin “Frakull” dhe “Povelcë”.

Në zbatim të shkresës së MIE me nr. 2706/2, datë 19.03.2021 si dhe Urdhrin nr. 146, datë 19.03.2021 “Për ngritjen e grupit negociator për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Frakull” dhe “Povelcë”, grupi negociator ka zhvilluar takimet e përbashkëta me grupin negociator të shoqërisë “E. D. G.” Sha në datat 26.03.2021, 02.04.2021 dhe 07.04.2021. Për çdo takim janë mbajtur procesverbalet përkatëse dhe minutat e takimit dhe janë të nënshkruara nga të gjithë pjesëmarrësit në takim.

Në datën 15.04.2021, është përpiluar versioni përfundimtar i draftit të arritur pas negociatave për termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin “Frakull” dhe “Povelcë”, dhe me shkresën nr. 2622 prot., datë 20.04.2021 (protokolluar në MIE me nr. 3695 prot., datë 26.04.2021) “Përcillen për miratim termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimin “Frakull” dhe “Povelcë” janë përcjellë për vlerësim dhe miratim termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjes Ministrit të MIE. Me shkresën nr. 3695/1 prot., datë 06.05.2021 “Për vazhdimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve për vendburimet ekzistuese “Frakull” dhe “Povelcë”, Ministri i MIE shpreh miratimin e termave dhe kushteve kryesore si dhe në zbatim në pikën II/6 të rregullores Grupi Negociator të filloj procesin e negociimit të marrëveshjeve hidrokarbure për këto dy vendburime, gjithashtu nëpërmjet kësaj shkrese Ministri i MIE kërkon nga Albpetrol Sha dhe AKBN që në përputhje me pikën III të përgatisë draft Licencë Marrëveshjen.

#### Për Licencë Marrëveshjet

**Gjetje 9:** Me vijim të praktikës, Albpetrol SHA i drejtohet AKBN me shkresën nr. 3106 prot., datë 14.05.2021 “Kërkesë për pajisjen me Licencë Marrëveshje për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet “Frakull” dhe “Povelcë” kërkon pajisjen me Licencë Marrëveshje.

AKBN në vijim të kërkesës së mësipërme të Albpetrol me shkresën nr. 1314/4 prot., datë 01.06.2021 “Mbi kërkesën tuaj lidhur me pajisjen me Licencë Marrëveshje për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet “Frakull” dhe “Povelcë” ka paraqitur komente dhe rezerva në lidhje me termat dhe kushtet kryesore të Marrëveshjes.

Në lidhje me pretendimet, AKBN ka sugjeruar mbajtjen e një takimi të përbashkët MIE, AKBN dhe Albpetrol, për të vijuar më tej me pajisjen me Licencë Marrëveshje.

Për sa më sipër grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion dokumentacioni mbi takimin e sugjeruar dhe vendimmarrjen për këto çështje.

Me shkresën nr. 1314/6, datë 13.07.2021 “Mbi kërkesën tuaj në lidhje me pajisjen me Licencë Marrëveshje për zhvillimin dhe prodhimin e Hidrokarbureve Povelcë dhe Frakull”, AKBN i ka përcjellë Albpetrol Sha, Draft Licencë Marrëveshjen për zhvillimin dhe prodhimin e Hidrokarbureve për këto dy vendburime.

Me shkresën nr. 4153 datë 16.07.2021 “Përcillet për miratim Drafti i Licence Marrëveshjeve për zhvillimin dhe prodhimin e Hidrokarbureve për vendburimet Povelcë dhe Frakull” Albpetrol Sha i ka përcjellë MIE, Draft Licencë marrëveshje për zhvillimin dhe prodhimin e Hidrokarbureve për këto vendburime si dhe miratimin në parim.

Nisur sa më sipër grupi i auditimit ka konstatuar se nuk janë respektuar afatet Ligjore në lidhje me hartimin e Draft Licence Marrëveshjes nga AKBN, konkretisht kërkesa e ardhur nga Albpetrol Sha datë 14.05.2021 dhe Drafti i Licencë Marrëveshjes është përcjell nga AKBN në Albpetrol datë 13.07.2021, në kundërshtim me pikën III/2 të rregullores të miratuar me Urdhër nr. 246, datë 12.03.2018 *“Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse”* të Ministrit të MIE, ku citohet se:

*“AKBN përgatit dhe i dërgon Albpetrol Sha brenda 20 ditësh nga marrja e kërkesës nga Albpetrol, Draftin e Licencë Marrëveshjes. Drafti i Licencë marrëveshjes diskutohet brenda një afati 20 ditor, ndërmjet Albpetrol dhe AKBN dhe më pas firmoset në çdo faqe”*. Kjo vonesë ka sjellë marrjen e vendimeve jo në përputhje me afatet ligjore të parashikuara e cila për nga niveli i rëndësisë është e mesme.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi Strukturat Drejtuese të AKBN.

Me autorizimin nr. 4189/4 prot., datë 27.07.2021, Ministria ka autorizuar AKBN për të vijuar me nënshkrimin e Licencë Marrëveshjeve si dhe reflektimin e ndryshimeve të sugjeruar nga Albpetrol sha. Në vijim me shkresën nr. 4189/5 prot. datë 27.07.2021, Ministria ka përcjellë Autorizimin si dhe ka miratuar ndryshimet e sugjeruara nga Albpetrol Sha për Licence Marrëveshjet.

Dokumentacioni mbi takimet e organizuara të grupit negociator dhe kontraktorit, procesverbalet, minutat e takimit për negociimin e marrëveshjeve hidrokarbure nga ana e MIE u vendosën në dispozicion fotokopje.

Grupi negociator ka vijuar me mbledhjet e negociimit të tekstit të marrëveshjes hidrokarbure në datat 14.06.2021, 17.06.2021, 02.07.2021. Procesverbalet e mbledhjeve janë protokolluar në Albpetrol, Patos në datën 28.12.2021 me numrat respektiv, nr. 2937/1 prot., nr. 10709/1 prot., nr. 10702/2 prot..

Me përfundimin e negociatave nga takimet e përbashkëta, Albpetrol sha me shkresën nr. 4672 prot., datë 08.07.2021 (protokolluar në MIE me nr. 2707/3 prot., datë 09.07.2021) ka përcjellë në MIE për miratim draftin e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimet Frakull dhe Povelcë. Me shkresën nr. 6012, datë 02.08.2021 *“Kërkohe mendim për projektvendimin për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Povelcë dhe Frakull”*, Ministri i MIE i drejtohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit me të cilën kërkon Mendim në lidhje me Projekt vendimin e Këshillit të Ministrave.

MIE ka dërguar draftin për mendim në Ministrinë e Financave, Ministrinë Drejtësisë, Avokaturës së shtetit dhe Ministrisë së Turizmit dhe e Mjedisit.

Grupi negociator ka vijuar me mbledhjet e negociimit të tekstit të marrëveshjes hidrokarbure në datën 20.12.2021. Procesverbal i mbledhjes është protokolluar në Albpetrol me nr. 10702/3 prot., datë 28.12.2021. Ky procesverbal pasqyron ndryshimet e draft marrëveshjes në bazë të vendimeve të MFE, Ministrisë së Mjedisit dhe Avokaturës së Shtetit, të cilat u reflektuan në tekstin e marrëveshjes hidrokarbure dhe është pasuar nga relacioni për projektvendimin.

Me shkresën nr. 430, datë 18.01.2022 *“Dërgohet për miratim një Projektvendim”* MIE ka dërguar pranë Këshillit të Ministrave projektvendimin për miratim. Ky projektvendim për të dy vendburimet është i shoqëruar nga një Relacion ku përmban reflektimet ose jo të sugjerimeve të Institucioneve përkatëse.

Me shkresën e datës 21.02.2022 Këshilli i Ministrave ka kthyer projekt-aktin me qëllim bashkërendimin me ministrinë të cilat kishin përcjellë komente. Gjithashtu u sugjerua miratimi i marrëveshjeve me dy vendime të ndara.

Me shkresën nr. 1161, datë 03.02.2022, MIE ka ridërguar për mendim për Vendburimin e gazit natyror “Frakull” Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit .

Me shkresën nr. 28/4, datë 28.04.2022, MIE dërgon për miratim Projektvendimin për “Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror “Frakull” pranë Këshillit të Ministrave.

Me shkresën nr. 6/6, datë 06.06.2022, MIE dërgon për miratim Projektvendimin “Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror “Povelcë” pranë Këshillit të Ministrave.

Me VKM nr. 401, datë 09.06.2022 “Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Frakull”, Këshilli i Ministrave miraton Marrëveshjen Hidrokarbure për këtë vendburim me kompaninë E. N. G. Shpk me NIPT M.....T.

Me VKM nr. 402, datë 09.06.2022 “Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Povelcë”, Këshilli i Ministrave miraton Marrëveshjen Hidrokarbure për këtë vendburim me kompaninë E. N. G. Shpk me NIPT M.....T.

#### **Marrëveshjet Hidrokarbure për Bllokun 4 me Sh. U. A.**

Me kërkesën nr. 309, datë 29.05.2013 (protokolluar në AKBN me nr. 3641, datë 29.05.2013) P. A. GmbH, drejtuar Ministrit të MIE, Drejtorit Ekzekutiv të AKBN dhe për dijëni Kryeministrit, ka paraqitur kërkesën për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për Bllokun 4, 5 dhe Dumreja në tokë.

Me shkresën nr.16, datë 15.01.2014 (protokolluar në AKBN me nr. 672, datë 15.01.2014) P. A. GmbH, ka informuar Albpetrol Sha dhe për dijëni Ministrit të MIE dhe AKBN se P. A. GmbH ka rënë dakord që të përfshijë Sh. si palë në aplikimin e datës 1 gusht në raport Sh. 75% dhe P. A. GmbH 25%. P. A. GmbH do të jetë negociatori kryesor për këto aplikime por kushtet e kontratës do të miratohen nga të dyja kompanitë.

Me shkresën nr. 221, datë 26.03.2014 “Mbi aplikimet për të drejtat e kërkimit në Blloqet 4-5 dhe Dumre” (protokolluar në AKBN me nr. 2568, datë 26.03.2014) P. A. GmbH i është drejtuar Ministrit të MIE dhe për dijëni AKBN dhe Albpetrol Sha, kërkojnë liçencat për shfrytëzimin e zonave si dhe vijimin e procedurës së negociimit duke mos sjell vonesa.

Me shkresën nr 3251, datë 20.03.2015 “Kërkohet të riaplikohet për blloqet e lira të kërkimit”, AKBN i është drejtuar Sh. U. A. dhe P. A. GmbH për të risjell aplikimet pasi ka ndryshuar kuadri rregullator në Shqipëri si dhe zonat për të cilat kanë shprehur interes i kanë kaluar në administrim AKBN.

Me Urdhër nr. 124, datë 12.05.2015 “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure”, Ministri i MIE urdhëron:

- AKBN të publikojë në faqen e saj të internetit hartën e blloqeve të lira si dhe formularin e aplikimit, afati i dorëzimit të aplikimit për blloqet 4, 5 dhe Dumre të jetë deri në 15.06.2015.
- Dokumentacioni që do të publikohet do të dërgohet në MIE dhe një kopje e tij do të dërgohet në adresën elektronike të saj. MIE të publikojë në faqen e saj këtë dokumentacion.
- AKBN, të ngrejë grupin negociator për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure të mundshme për tu lidhur si dhe përfaqësuesi i MIE do të jetë z. I. Gj..

Ky Urdhër i përcillet për njohje dhe zbatim AKBN me shkresën nr. 3891 prot., datë 13.05.2015 “Dërgohet për njohje dhe zbatim Urdhri nr 124, datë 12.05.2015”.

Me Urdhrin nr. 170, datë 10.07.2015 “Për ndryshimin e Urdhrit nr. 124, datë 12.05.2015 “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure” i ndryshuar dhe Urdhrin nr. 132, datë 15.05.2015 “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure”, i ndryshuar”, ku ndryshon si më poshtë:

1. Pika 1 e Urdhrit nr. 124, datë 12.05.2015 ndryshon: Afati i dorëzimit të aplikimit për Blloqet 4 dhe Dumre do të jetë deri në datën 15.07.2015 ndërsa për Bllokun 5 do të jetë 15.10.2015.

2. Pika 1 e Urdhrit nr. 132, datë 15.05.2015 ndryshon: Pjesë e publikimit në faqen e internetit do të jetë edhe vendosja e afatit të dorëzimit të aplikimit për Blloqet C dhe Panaja, afati i dorëzimit të aplikimit do të jetë deri në datën 15.10.2015, ndërsa për Blloqet e detit do të shtyhet për një afat tjetër.

Ky Urdhër i përcillet për njohje dhe zbatim AKBN me shkresën nr. 5050 prot., datë 10.07.2015 “Dërgohet për njohje dhe zbatim Urdhri nr 170, datë 10.07.2015”.

Në vijim të praktikës me Urdhrin nr. 1183, datë 15.07.2015 “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga kompanitë hidrokarbure” Drejtori Ekzekutiv i AKBN ka ngritur grupin e punë me anëtarët e mëposhtëm:

1. z. K. G., Drejtor i Drejtorisë së Hidrokarbureve, AKBN
2. z. L. N., Këshilltar i Drejtorit Ekzekutiv, AKBN
3. znj. A. A., Këshilltare e Drejtorit Ekzekutiv, AKBN
4. z. D. D., Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, AKBN
5. z. I. Gj., Përfaqësues i MIE

Në kuadër të shqyrtimit të propozimeve, referuar procesverbalit me nr. 1217/1 prot., mbajtur në takimin e zhvilluar më datë 16.07.2015, Komisioni i ngritur për shqyrtimin e propozimeve të paraqitura nga kompanitë hidrokarbure, bazuar në dokumentacionin e administruar nga zyra e Protokollit ka listuar kompanitë që kanë aplikuar.

Pranë AKBN janë depozituar aplikime nga 3 kompani:

1. Sh. U. A. B.V. dhe P. A. GmbH (Blloku 4 dhe Dumre)
2. N. P., D. G. (Blloku Dumre)
3. I. I. S.A dhe E. D. S.A (Blloku 4 dhe Dumre)

Në lidhje me Bllokun 4 dhe Dumrenë, komisioni administroi secilin nga aplikimet si dhe përmbajtjen e dosjes për secilin aplikim.

Ky procesverbal është sigluar nga anëtarët e komisionit në çdo fletë të procesverbalit.

Në vijimi me shkresën nr.7383 prot., datë 21.07.2015, “Raport i Komisionit për Shqyrtimin e Propozime të Paraqitura nga Kompanitë Aplikuese” , Komisioni i ka përcjellë Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, Raportin e Shqyrtimit të Propozimeve si dhe dokumentacionin e dorëzuar për secilin aplikim.

Me shkresën nr.7383/1 prot., datë 22.07.2015, “Dërgimi i Raportit të komisionit për shqyrtimin e propozimeve të paraqitura nga Kompanitë Aplikuese”, Drejtori Ekzekutiv i AKBN i dërgon MIE Raportin e Komisionit si dhe dokumentacionin e dorëzuar për çdo aplikim.

Në vijim të praktikës me Urdhrin nr. 183, datë 27.07.2015 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e kompanive e kërkim – prodhimit për Bllokun 4 dhe Bllokun e Dumresë”, Ministri i MIE ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e raportit dhe dokumentacionit të dërguar nga AKBN me shkresën nr. 7383/1, datë 22.07.2015. Grupi i punës do të përbëhet nga:

1. K. B., MIE, Kryetar
2. E. Gj., MIE, Anëtar
3. D. S., MIE Anëtar
4. E. K., MIE, Anëtar
5. M. B., MIE, Anëtar

Objekti i punës do të jetë vlerësimi i aplikimeve të bëra:

#### **Për Bllokun 4:**

1. Sh. U. A. dhe P. A. GmbH B.V.



## 2. I. I. S.A

Raporti duhet të përfundojë brenda datës 31.07.2015.

Grupi i punës ka përpiluar raportin me nr. 5241 prot., pa datë, mbi dokumentacionin e dërguar nga AKBN dhe ka vlerësuar aplikimet e kompanive të interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara, që ishte 15.07.2015.

Grupi i Punës, i propozon Ministrit të MIE që për bllokun 4 ti jepet e drejta për të vazhduar procedurat për të negociuar për të lidhur MH me kompanitë Sh. U. A. BV dhe P. A. GmbH dhe për bllokun e Dumresë ti jepet e drejta për të vazhduar procedurat për të negociuar për të lidhur MH me kompaninë N. P. L. kontrolluar nga D. G. LTD.

Ky dokument është i nënshkruar dhe sigluar nga anëtarët e komisionit në çdo fletë të raportit, por nuk përmban datën e hartimit të Raportit.

Me shkresën nr. 5241/1 Prot., datë 31.07.2015 “Për vazhdimin e procedurave për lidhjen e Marrëveshjeve Hidrokarbure për blloqet e kërimit 4 dhe Dumre” Ministri i MIE, ka autorizuar AKBN të vazhdojë procedurat e mëtejshme për të negociuar për Termat dhe Kushtet Kryesore për të lidhur të Marrëveshjet Hidrokarbure përkatësisht:

- Për Bllokun “4” me kompanitë Sh. U. A. B.V, pjesë e R. D. Sh. dhe P. A..
- Për Bllokun “Dumrea” me kompanitë N. P. L., kontrolluar nga D. G. LTD.

Me shkresën datë 23.09.2015 “Kushtet dhe Termat Kryesore për Bllokun 4, në tokë”, Sh. U. A. B.V., i drejtohet AKBN-së mbi nisjen e negociatave për lidhjen e marrëveshjes.

Me shkresën nr. 8293/2, datë 01.10.2015, “Përgjigje Tuajës datë 23.09.2015” AKBN i është drejtuar Sh. U. A. B.V. për gatishmërinë e vijimit të negociatave.

Është zhvilluar takimi për fillimin e negociatave në datën 14.10.2015 midis grupit negociator të AKBN dhe përfaqësuesve Sh. U. A. B.V. për Bllokun 4.

Me shkresën nr 1242 prot., datë 25.01.2016 “Kërkohet vazhdimi i negociatave për Bllokun 4”, drejtuar Sh. U. A. B.V. për vijimin e procedurave me negocimin.

**Gjetja 1:** Referuar praktikës të vendosur në dispozicion nuk justifikohet vonesa në kohë e vijimit të procedurave të miratimit të finalizimit të MH-së për vendburimet e bllokut 4. Ministri i MIE më datë 31.07.2015, ka autorizuar AKBN të vazhdojë procedurat e mëtejshme me subjektet e interesuara për të negociuar për Termat dhe Kushtet Kryesore të MH respektive. Afërsisht një vit më vonë, me datë 20.07.2016 (31.07.2015- 20.07.2016) AKBN i ka dërguar MIE për miratim termat dhe kushtet kryesore për të lidhur Marrëveshjet Hidrokarbure për vendburimet respektive. Në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018, të Ministrit të MIE, kjo kohë nuk është parashikuar, afatet kohore janë parashikuar vetëm pas nënshkrimit të Termave dhe Kushteve Kryesore të MH nga grupi negociator. Kjo vonesë ka sjellë në zvarritjen e praktikës dhe procedurës për përgatitjen dhe miratimin e MH.

Me shkresën nr. 5346/1 prot., datë 19.07.2016 (protokolluar në MIE me nr. 4795 datë 20.07.2016) “Dërgohet informacioni mbi takimet e zhvilluara nga grupet e negocimit si dhe kërkohet miratimi për termat bazë të marrëveshjes me ndarje prodhimi për Bllokun 4 në tokë”, AKBN i ka dërguar MIE-së për miratim termat dhe kushtet e referencës së diskutuara në takimet e zhvilluara ndërmjet grupeve të negocimit të AKBN dhe Sh. U. A. B.V. për Marrëveshjen Hidrokarbure me ndarje prodhimi për bllokun 4, në tokë.

**Gjetja 2:** Bashkëlidhur ndodhet përmbledhëse e takimeve dhe video konferencave të zhvilluara (kryer gjithsej 9 takime) ndërmjet grupit negociator të AKBN-së dhe kompanisë Sh. U. A. B.V. Ky dokument është vetëm në gjuhën angleze, i nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN dhe përfaqësuesi ligjor i Sh. U. A. B.V. Grupit të Auditimit nuk ju vunë në dispozicion proces verbal i minutat e takimit për të nëntë takimet e organizuara në kundërshtim me pikën II/4/ të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure,

*Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse*” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018, të Ministrit të MIE ku citohet se:

*“Në rast miratimi nga Ministria të kërkesës së AKBN ose Albpetrol sha, me urdhër të ministrit ngrihet grupi negociator, i cili fillon negociata me subjektin e përzgjedhur fitues nga Ministria për Termat dhe Kushtet Kryesore të MH, në bazë të aplikimit të paraqitur nga subjekti fitues.....Pasi palët bien dakort, dokumenti nënshkruhet nga grupi negociator dhe shoqëria aplikuese dhe i përcillet Ministrisë për miratim. Gjatë procesit të negociatave mbahen minutat e takimeve”, e cila për nga niveli i rëndësisë është e mesme.*

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi grupi negociator për termat dhe kushtet kryesore të MH pranë AKBN.

Në vijim sa më sipër me shkresën pa numër më datë 27.07.2016 nga Përgjegjësi i Sektorit të Politikave dhe Zhvillimit në Fushën e Naftës, është përgatitur Memo “Termat Kryesore për negociimin e Marrëveshjes Hidrokarbure për bllokun 4 me Sh. U. A. BV” ku informon ministrin në lidhje me negociatat e zhvilluar dhe dakortësinë e arritura.

Me shkresën nr. 4795/1 Prot., datë 01.08.2016 (protokolluar në AKBN 5349/2, datë 01.08.2016) Ministri i MIE shpreh miratimin e Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure për bllokun 4 si dhe të vijojnë procedurat e mëtejshme për negociimin e Marrëveshjes Hidrokarbure duke tentuar gjithmonë që gjatë kësaj procedure të arrihet përmirësimi i mëtejshëm i Termave dhe Kushteve Kryesore.

Me shkresën nr. 5346/3, datë 05.08.2016 “Përgjigje Tuajës nr. 4795/1 prot., datë 01.08.2016” (prot ne MIE me nr. 4795/2, datë 05.08.2016), AKBN nëpërmjet Drejtorit Ekzekutiv shprehet në lidhje me pa mundësinë e përmirësimit të mëtejshëm i Termave dhe Kushteve Kryesore gjatë negociimit për tekstin e marrëveshjes pasi kjo bie në kundërshtim me pikën 2 “Rregullores për procedurat e miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjeve si dhe afateve përkatëse”, ku thuhet se: *“Ministria do të japë miratimin apo refuzimin e saj për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes brenda 10 ditëve nga marrja e dokumentit të nënshkruar të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes”*. Si përfundim, AKBN kërkon nga MIE shprehjen e qartë mbi miratimin apo refuzimin e Termave dhe Kushteve Kryesore për Bllokun 4. Në vijim të kërkesës së mësipërme, MIE me shkresën nr. 4795/3 prot., datë 08.08.2016, konfirmon miratimin e termave bazë për negociimin e marrëveshjes hidrokarbure për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Bllokun 4 të nënshkruar ndërmjet AKBN dhe kompanisë Sh. U. A. B.V. Me shkresën nr. 5346/5, datë 12.08.2016 “Për vazhdimin e negociatave për përfundimin e MH për Bllokun 4” drejtuar Sh. U. A. B.V., ku konfirmon vazhdimin e negociatave për lidhjen e marrëveshjes si dhe kërkon nga kompania paraqitjen e draft propozimit për negociim.

Me shkresën datë 18.08.2016 (protokolluar në AKBN me nr. 5346/6, datë 25.08.2016) Sh. U. A. B.V. sjell draft propozimin për MH Blloku 4 dhe kërkon fillimin e negociatave në lidhje me këtë draft.

Sh. U. A. B.V. dërgon në formatin e printuar edhe elektronik draft propozimin e MH me shkresën 26.08.2016 (protokolluar në AKBN me nr. 5346/7, datë 29.08.2016).

**Gjetja 3:** Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nuk justifikohet vonesa në kohë (afërsisht 1 vit e 3 muaj, 08.08.2016-23.11.2017) e vijimit të procedurave të miratimit të finalizimit të MH për vendburimet e bllokut 4. Ministri i MIE më datë 08.08.2016, ka konfirmuar miratimin e termave dhe kushteve kryesore dhe ka autorizuar AKBN për negociimin e tekstit të marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Blloku 4, ndërsa draft kontrata përmban datën 23.11.2017. Në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018, të Ministrit të MIE, kjo kohë nuk është parashikuar, afatet kohore janë parashikuar

vetëm pas përfundimit dhe nënshkrimit të draftit përfundimtar të MH nga grupi negociator. Kjo vonesë ka sjellë në zvarritjen e praktikës dhe procedurës për përgatitjen dhe miratimin e MH.

**Gjetja 4:** Grupit të Auditimit nuk ju vunë në dispozicion Proces-Verbalet dhe minutat e takimit të mbledhjeve të Grupit Negociator mbi procesin e negociimit të tekstit të MH, në kundërshtim me pikën II/6 të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018, të Ministrit të MIE, pasi nuk dokumentohet procesi i negociimit të tekstit të MH. e cila për nga niveli i rëndësisë është e mesme.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi grupi negociator të MH.

Praktika vijon me shkresën nr.7854 prot., datë 23.11.2017 (protokolluar në MIE me nr.2310 prot., datë 23.11.2017) “Dërgohet Kontrata me Ndarje Prodhimi për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në tokë, Blloku nr. 4 me kompaninë Sh. U. A. BV”, AKBN i dërgon MIE kopje origjinale të njëvlefshme, në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe të kontratës si dhe kërkon nga Ministria vazhdimin e mëtejshëm të procedurës për miratimin e saj nga Këshilli i Ministrave.

Kjo shkresë shoqërohet me një relacion shpjegues ku paraqet në mënyrë të përmbledhur procedura, ku citohet që janë kryer shumë takime dhe negociata në harkun kohor të rreth 2 vjetëve deri në nënshkrimin e kësaj Marrëveshje të Re. Cilësohet që riaktivizimi i operacioneve të kërkimit në Bllokun 4 përbën një premisë pozitive për zbulimin e rezervave hidrokarbure në këtë bllok si dhe faktin që kjo kompani ka deklaruar një zbulim të ri hidrokarburesh në Blloqet 2-3 duke sjellë një arritje të rëndësishme në situatën aktuale.

Nga grupi i Auditimit u konstatua që kjo draft-kontratë është në versionin shqip dhe anglisht por në çdo faqe ka vetëm 4 firma, të pidentifikuar, që mund të jenë përfaqësuesit e AKBN, të ministrisë apo të Sh. U. A. BV.

Në lidhje me Draftin e MH dhe Projektvendimit janë marrë mendimet zyrtare nga Ministria e Financave, Avokatura e Shtetit dhe Ministria e Drejtësisë.

Me VKM nr. 350, datë 12.06.2018 (protokolluar në MIE me nr. 7474/6, datë 14.06.2018) “Për miratimin mbi kontratën me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, Blloku nr. 4 ndërmjet MIE përfaqësuar nga AKBN dhe Sh. U. A. B.V.”, Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të MIE, ka miratuar kontratën për këtë zonë, ky vendim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

Me shkresën nr. 7474/7, datë 25.06.2018, MIE i dërgon AKBN për njohje dhe zbatim VKM nr. 350, datë 12.06.2018.

Me Shkresën nr. 5542/3, datë 27.06.2018, AKBN i ka përcjell Sh. U. A. B.V, kopjen për njohje dhe zbatim VKM nr. 350, datë 12.06.2018 dhe bënë të ditur se kjo VKM është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 14.06.2018. Data Efektive e kësaj Marrëveshje Hidrokarbure është data 14.06.2019.

### **Marrëveshjet Hidrokarbure për Bllokun e Dumresë.**

Kjo marrëveshje është iniciuar me shprehjen e interesit për Bllokun e “Dumresë”, në tokë me shkresën nr. s’ka., datë 20.05.2019 drejtuar AKBN nga Kompania “E.” s.p.a, në anglisht.

Me shkresën nr. 804/2, prot., 30.05.2019, AKBN ka përcjellë në MIE kërkesën e kompanisë “E.” s.p.a dhe kërkon miratimin nga MIE për shpalljen e njoftimit në website të AKBN për të thirrur subjektet e interesuara për Bllokun “Dumrea”, në tokë.

Interesimi i shfaqur nga kompania vjen pas shqyrtimit të të dhënave gjeologjike dhe fizike lidhur me këtë bllok si dhe takimeve të zhvilluara pranë AKBN midis specialistëve të Drejtorisë Hidrokarbure dhe përfaqësuesve të E. s.p.a, këta të fundit pasi kryejnë vlerësimet e tyre

përkatëse, ekonomike dhe teknike shprehin interesin për të vijuar më tej. Pavarësisht historisë së suksesshme të Kompanisë E., bashkëlidhur nuk ka dokumentacion në lidhje me kapacitetet teknike dhe ekonomike siç e përcakton kuadri ligjor.

Për sa më sipër mban përgjegjësi strukturat drejtuese të MIE.

Me Urdhrin nr. 334, datë 11.09.2019 (nr.7946 prot.) “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për Bllokun e “Dumresë”, i Ministrit të MIE ka urdhëruar fillimin e procedurave për:

- Njoftimin për të ftuar subjektet e interesuara për pjesëmarrjen me anë të aplikimeve për të lidhur marrëveshje hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Bllokun e Dumresë.

- AKBN të publikojë në faqen e saj të internetit hartën e bllokut të Dumresë të kërkimit.

- Formularin e aplikimit, si dhe afati i dorëzimit të aplikimit të jetë 45 ditë nga data e njoftimit.

**Gjetja 1:** Rezulton se Urdhri nr. 334, datë 11.09.2019 (nr.7946 prot.) “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për Bllokun e “Dumresë” i Ministrit të MIE ka përcaktuar afatin e dorëzimit të aplikimit për 45 ditë në kundërshtim me pikën I/2 të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018 “Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse”, e cila përcakton se “*Afati kohor i kësaj ftese është jo më pak se 90 ditë, duke filluar nga datat e njoftimit*”, për nga rëndësia e nivelit të lartë.

Për sa më sipër mban përgjegjësi strukturat drejtuese të MIE.

Me shkresën nr. 5621/2 prot., datë 23.09.2019 “Mbi Urdhrin e Ministrit nr. 334, datë 11.09.2019”, AKBN ka dërguar një kopje të dokumentacionit të publikuar në faqen zyrtare të AKBN:

- Termat dhe Kushtet për aplikim për marrëveshjet hidrokarbure
- Hartën e Bllokut Dumrea dhe koordinatat e bllokut.

Kompania E. I. B.V ka dorëzuar dokumentacionin e aplikimit pranë zyrës së protokollit të AKBN me nr. 5623/3 datë 28.10.2019.

Drejtori Ekzekutivi AKBN me Urdhrin nr. 205 datë 05.11.2019, protokolluar me shkresën nr.5621/4 datë 05.11.2019 ka urdhëruar “Për ngritjen e Grupit të Punës për shqyrtimin e propozimit të ardhur nga Kompania E. I. B.V., për bllokun Dumrea, në tokë”, i përbërë nga:

1. A. M., Këshilltar pranë Drejtorit Ekzekutiv
2. E. K., Drejtor i Drejtorisë Hidrokarbure
3. D. D., Drejtor i Drejtorisë Hidrokarbure
4. B. P., Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore
5. S. M., Shef Sektori i LM dhe MH në fazë Kërkimi.

Me shkresën nr.5621/5 prot., datë 06.11.2019, Anëtarët e Grupit të punës pasi kanë marrë në dorëzim dokumentacionin e aplikimit, kanë përcjellë pranë Drejtorit Ekzekutiv të AKBN informacionin “Mbi shqyrtimin e aplikimit të depozituar nga Kompania E. I. B.V. për Bllokun Dumrea, në tokë” dhe ka renditur të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga Kompania E. I. B.V.

**Gjetja 2:** Informacioni i përgatitur nga grupi i punës nuk përmban analiza të kryera nga vet grupi i punës, është sipërfaqësor, ka karakter përmbledhës, paraqet vetëm listën e dokumentave të dorëzuara nga E. I. B.B. dhe nuk shoqërohet me analiza të detajuara apo vlerësim të plotë në lidhje me dokumentacionin që ka dorëzuar shoqëria në kundërshtim me pikën 1 të Urdhrit të Brendshëm nr. 205, datë 05.11.2020 “Për ngritjen e Grupit të Punës për shqyrtimin e propozimit të ardhur nga Kompania E. I. B.V të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së.

Ky relacion i është përcjellë Ministrit të MIE nga Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së me shkresën nr. 5621/6 prot., datë 07.11.2019 “Mbi propozimin e ardhur për Bllokun Dumrea, në tokë”, ku informohet mbi ecurinë e procedurës për lidhjen e MH, për Bllokun Dumrea, në tokë, si dhe janë përcjellë dokumentat e ofertës së E. I. B.V. për këtë zonë.

Me Urdhrin nr. 424, datë 12.11.2019 (nr. 9754 prot.) “Për ngritjen e grupit negociator për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure për bllokun e kërkimit “Dumreja”, në tokë”, Ministri ka ngritur grupin negociator për fillimin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure në formën e kontratës me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në bllokun “Dumreja”, në tokë, grupi përbëhet nga:

1. I. B., Kryetar, MIE
2. I. Gj., Anëtar, MIE
3. S. D., Anëtar, MIE
4. K. N., Anëtar, MIE
5. M. B., Anëtar, MIE
6. A. B., Anëtar, AKBN
7. D. D., Anëtar, AKBN
8. Q. H., Anëtar, AKBN

Në këtë urdher janë përcaktuar detyrat që ka grupi negociator për negocimin me kompaninë “E. I.” B.V. Procedura që do të ndiqet do të jetë në përputhje me përcaktimet në Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018 “Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” të Ministrit të MIE. Si rezultat i negocimit dhe ballafaqimit të termave të ofertuara u arrit vlerësimi dhe përmirësimi i disa termave të cilët janë listuar në memon e datës 21.11.2019 drejtuar Ministrit të MIE “Mbi negocimin e termave dhe kushteve kryesore të Bllokut Dumre, tokë” (u vendos në dispozicion fotokopje si dhe bashkëlidhur dokumentacioni mbi termat dhe kushtet kryesore është vetëm në gjuhën angleze)

**Gjetja 3:** Gjatë auditimit në terren nuk u vendosën në dispozicion dokumentacioni mbi takimet e organizuara të grupit negociator dhe kontraktorit, procesverbalet, minutat e takimit për negocimin e për termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjes hidrokarbure.

Marrëveshja Hidrokarbure me ndarje prodhimi (nr. 9624/3 prot., datë 20.12.2019) për bllokun e kërkimit “Dumreja”, në tokë është lidhur ndërmjet ministrit të MIE znj. B. B. dhe E. A. B.V. të përfaqësuar nga C. D..

Me shkresën nr.9624/1, datë 19.12.2019, MIE ka dërguar për mendim draft marrëveshjen Avokaturës së Shtetit.

Brenda ditës, Avokatura e Shtetit ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 6203/1, datë 19.12.2019 duke u shprehur se duke pasur parasysh kohën e pakët në dispozicion, vërejnë se kontrata nuk paraqet problematika në aspektin ligjor.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet sistemit E-aktet ka dërguar mendimin në lidhje me Projekt vendimin e Këshillit të Ministrave ku shpreh shqetësimin se:

- Blloku Dumrea përfshihet në zonën me përparësi zhvillimi të turizmit.
- Në këtë zonë ndodhen monumente natyre dhe shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive mund të shkaktojë ndryshime thelbësore në biodiversitet.
- Në lidhje me këtë zonë nuk është kryer asnjë dëgjese publike.

Në përgjigje të pretendimeve të mësipërme me shkresën nr. 910/1, date 23.01.2020, MIE ka sqaruar se:

- Neni 25 e marrëveshjes “*Mbrojtja e mjedisit*” parashikon angazhimin për zbatimin e ligjit në fuqi për mjedisin
- Në pikën 2 të nenit 25, përcakton përgjegjësitë e Kontraktorit në lidhje me ndikimet në mjedis.
- Neni 18 i kontratës është përcaktuar se kjo kontrate do të rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret shqiptare.

- Lidhur me këtë çështje në ligjin bazë që përcakton këtë kontratë neni 5, pika D/2 përcaktohet se “Përjashtohen nga regjimi i stabilitetit ligjet dhe rregulloret që lidhen me sigurinë kombëtare, marrëdhëniet e punës, mbrojtjen e shëndetit të njeriut, mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit etj” Me shkresën nr. 791/1 datë 13.02.2020, Ministria e Turizmit konstaton se nga ana e MIE janë dhënë shpjegimet në mënyrë shteruese për trajtimin e sugjerimeve të MTM.

MIE nëpërmjet sistemit e-aktet ka përcjellë për mendim Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, projekt vendimin e Këshillit të Ministrave “Për kërkim, zhvillim dhe prodhim e hidrokarbureve në tokë Blloku Dumrea”.

Me shkresën nr. 2057, datë 21.01.2020, MEPJ ka kthyer përgjigje se dhënia e mendimit për këtë akt është jashtë fushës së përgjegjësisë.

Me shkresën nr. 11/3 datë 11.03.2020, MIE ka dërguar pranë Këshillit të Ministrave miratimin e projektvendimit të Marrëveshjes Hidrokarbure shoqëruar me relacionin përkatës.

Marrëveshja është vetëm në gjuhën angleze.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ka një mosrakordim të vijueshmërisë së praktikës së miratimit të draft marrëveshjes.

Drafti është dërguar në datë 11.03.2020 ndërsa VKM ka datën 26.02.2020.

Me shkresën nr. 910/4, datë 06.04.2020, MIE dërgon për njohje dhe zbatim VKM nr.187, datë 26.02.2020 AKBN-së.

### **Marrëveshjet Hidrokarbure për Bllokun F me B. P. A. Ltd.**

Për fazën e negocimit deri në miratim të marrëveshjes për Bllokun F me B. P. A. Ltd ,grupit të auditimit nuk i janë vënë të plota dokumentacionet përkatëse. Dokumentacioni i vënë në dispozicion për këtë fazë është një kërkesë e bërë nga kompania B. P. me shkresë nr. 0286/08 Prot., datë 22.09.2008 (protokolluar në AKBN me nr. 1854, datë 23.09.2008) për amendim të aplikimit për Kontratën me Ndarje Prodhimi që reflekton ndryshimet e fundit në legjislacionin për zbatimin e rentës minerare që i paguhet Qeverisë Shqiptare, një shumë e tillë të shpërndahet në 10% gjatë gjithë periudhës së projektit. Në këtë kërkesë kompania B. P. shprehet se ka pasur diskutime të mëparshëm me AKBN, por që grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion. Gjithashtu në këtë shkresë B. P. A. L. shprehet se ka rishikuar të dhënat që AKBN ka për këtë vendburim dhe ka arritur në përfundimin së ka perspektivë eksplorimi brenda zonës që mund të sjellë përfitim ekonomik si për Shqipërinë ashtu edhe për operatorin e suksesshëm. Kompania B. P. A. L. thekson dhe jep informacion në mbështetje të këtij aplikimi duke dhënë si eksperiencë të suksesshme bashkëpunimin e tyre me Albpetrol SHA për vendburimin Patos-Marinzë. Gjithashtu B. P. A. L. ka paraqitur në këtë kërkesë edhe kushtet dhe termat kryesore për këtë propozim.

Me VKM nr.939, datë 17.11.2010 “Për miratimin e kontratës me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, Blloku “F”, Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës të Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), dhe B. P. A. Ltd” miraton Marrëveshjen Hidrokarbure për këtë vendburim. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 169, datë 17.12.2010.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës me anë të shkresës Nr.5979/14 Prot., datë 15.12.2010, drejtuar AKBN dhe B. P. A. Ltd, për njohje dhe zbatim të VKM nr.939, datë 17.11.2010, “Për miratimin e kontratës me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, Blloku “F”, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës të Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), dhe B. P. A. Ltd”, ku kërkohet të merren të gjitha masat e nevojshme organizative dhe administrative brenda kompetencave dhe detyrave që ka secili institucion apo shoqëri me qëllim zbatimin korrekt sipas afateve të përcaktuar të Vendimit.

Data Efektive e kësaj Marrëveshje Hidrokarbure është data 17.11.2010.

## **Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Bllokut Velça.**

Kompania P. P. C. në datën 19.03.2015 (protokolluar në MEI me nr. 2842 prot., datë 25.03.2015) i është drejtuar Albpetrol sha. dhe për dijeni MEI dhe AKBN duke i shprehur interesin për zhvillimin e operacioneve të naftës në Bllokun e Velçës.

Albpetrol sha. në datën 30.04.2015 me shkresën nr. 3772 prot., (protokolluar në MEI me nr. 3635 prot., datë 30.04.2015) i është drejtuar MEI dhe për dijeni AKBN dhe P. P. C., ku kërkon miratim për fillimin e negociatave midis Albpetrol sha. dhe P. P. C. mbi termat bazë të marrëveshjes hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në bllokun e Velçës.

Kompania C. O. & G. i është drejtuar në datën 21.05.2015 (protokolluar pranë MEI me nr. 4079 prot., datë 21.05.2015) Albpetrol sha. dhe për dijeni MEI një kërkesë ku shpreh interes për kryerje Operacionesh Hidrokarbure kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi në objektin naftëmbajtës të Velçës, me vendndodhje në Shqipëri.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë me anë të shkresës nr. 3635/1 prot., datë 04.06.2015 i ka kthyer përgjigje Albpetrol sha. për shkresën nr. 3772 prot., datë 30.04.2015.

Në këtë kthim përgjigje MEI shprehet në parim dakord për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure për bllokun e kërkimit Velçë më kompaninë P. P. C., si dhe njëkohësisht i përcjell në vëmendje për vlerësim dhe kompetence edhe kërkesën e bërë nga kompania C. O. & G. me shkresën e datës 21.05.2015, e cila ka shprehur gjithashtu interes për kërkimin e hidrokarbureve në këtë bllok. Në këtë proces Albpetrol sha. të veprojë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet (kërkim prodhim)” si dhe me Rregulloren për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe Licence Marrëveshjeve si dhe afatet përkatës” të ndryshuar.

Albpetrol sha. i është drejtuar me shkresën nr. 6771/1 prot., datë 17.09.2015 (protokolluar në MEI me nr. 6307 prot., datë 22.09.2015) kompanisë C. O. & G. dhe për dijeni MEI duke i kthyer përgjigje shkresës të datës 14.09.2015, (protokolluar në Albpetrol sha. me nr. 6771 prot., datë 14.09.2015).

Në vijim të shprehjes së interesit nga ana juaj, të rikonfirmuar pas blerjes së paketës së të dhënave teknike për këtë bllok kërkimi, me shkresën nr. 4350/3 prot., datë 13.07.2015, shoqëria Albpetrol sha. ka përcjellë zyrtarisht formatin e Termave dhe Kushteve Kryesore në lidhje me Marrëveshjen Hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në bllokun e Velçës.

Albpetrol sha. me anë të shkresës nr. 8411 prot., datë 17.11.2015 (protokolluar në MEI me nr. 7628 port., datë 23.11.2015) i është drejtuar MEI dhe për dijeni AKBN ku i ka dërguar “Vlerësimin e Albpetrol sha. mbi aplikantët që kanë shprehur interesin për të hyrë në marrëveshje hidrokarbure për kërkim, zhvillim dhe prodhimin e hidrokarbureve në bllokun e Velçës.”

Rekomandimi i Këshillit Tekniko-Shkencor i Shoqërisë Albpetrol sha.

Më datën 7 Gusht 2015, të dy aplikantët kanë paraqitur ofertat e tyre në lidhje me Termat dhe Kushtet Kryesore në lidhje me Marrëveshjen e Hidrokarbureve “Për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në bllokun e Velçës”, si mëposhtë:

- “Application for Production Sharing Contract (Exploration, Development and Production of Petroleum) in Albania Onshore Velça Block” paraqitur nga shoqëria e huaj “P. P. C.” Ltd., më datë 07.08.2015, dhe të protokolluar në Albpetrol sha. me nr. 6105 mod., datë 07.08.2015.
- “Dorëzim oferte për fushën e Velçës dhe dokumentacioni përkatës”, paraqitur nga shoqëria e huaj “C. O. & G.” LLC, më datë 07.08.2015, protokolluar pranë Albpetrol sha. me nr. 6130 Mod., datë 10.08.2015.

Në datën 15 Shtator 2015, Këshilli Tekniko-Shkencor i shoqërisë Albpetrol sha., pasi ka marrë në shqyrtim dhe ka krahasuar treguesit në materialet e paraqitura nga aplikantët, ka vlerësuar si më të favorshme ofertën e paraqitur nga P. P. C. Ltd.

Po kështu, nga krahasimi i dokumentacionit të shoqërive aplikuese dhe në bazë të diskutimeve të mbajtura midis anëtarëve të Këshillit Tekniko-Shkencor dhe përfaqësuesve të shoqërisë P. P. C. Ltd dhe të shoqërisë C. O. & G. LLC, Komiteti Teknik-Shkencor i shoqërisë Albpetrol sha. ka dalë në përfundimin se:

- Shoqëria P. P. C. Ltd, krijon bindjen se është një shoqëri me kapacitete të besueshme financiare dhe teknike;
- Shoqëria C. O. & G. LLC nuk krijon bindjen se ka kapacitetet e duhura financiare dhe teknike për t'i besuar procesin kërkimor në bllokun e Velçës.

Në përfundim, Këshilli Teknik-Shkencor i shoqërisë Albpetrol sha., megjithëse treguesit e ofertave të paraqitura nga të dy aplikantët janë të përafërta, ka rekomanduar që procedura e negociimit dhe të lidhjes së Marrëveshjes Hidrokarbure për bllokun e Velçës, duhet të vazhdojë me shoqërinë P. P. C. Ltd. Kjo shkresë shoqërohet me një dosje nr.65 korrespondencë me institucionet për shoqërinë P. P. C..

Ministria e Energjisë dhe Industrisë me shkresën nr.7628/1 prot., datë 02.12.2015 i është drejtuar Albpetrol sha. ku i jep miratimin për vazhdimin e procedurave për lidhjen e Marrëveshjeve Hidrokarbure me ndarje prodhimi për bllokun e Velçës me shoqërinë P. P. C.. Albpetrol sha. me shkresën nr. 9332 prot., datë 28.12.2015 (protokolluar në MEI me nr. 8478 prot., datë 31.12.2015) i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MEI dhe për dijeni z. D. Gj. Ministër i Energjisë dhe Industrisë dhe AKBN, ku kërkon konfirmim në lidhje me procedurën që do të ndiqet në vazhdim për përgatitjen dhe miratimin e Marrëveshjes Hidrokarbure nga Albpetrol, për bllokun e Velçës.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë me shkresën nr.8478/1 port., datë 21.01.2016 i ka kthyer përgjigje shkresës nr.9332 prot., datë 28.12.2015 të Albpetrol sha.

Në përputhje me procedurat e përcaktuara, ashtu si edhe është konfirmuar me anë të shkresës tone me nr. 7628/1, datë 02.12.2015 mbi procedurat që shoqëria Albpetrol sha. duhet të ndjekë. Me shkresën nr.7338/2 port., datë 11.01.2017 MEI i është drejtuar Albpetrol sha. dhe AKBN për vazhdimin e procedurave për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokarbure me ndarje prodhimi në bllokun e Velçës.

AKBN në datën 30.01.2017 ka dërguar shkresën nr. 5621/1 prot., (protokolluar në MEI me nr. 7338/3 prot., datë 31.01.2017) për vazhdimin e procedurës për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokarbure me ndarje prodhimi për bllokun e Velçës. Bashkëlidhur kësaj shkresë është edhe draft Licencë Marrëveshja.

MEI në datën 21.03.2017 me shkresën nr. 1790 prot., i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ku kërkon mendim mbi projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Marrëveshjes më ndarje, për kërkim, zhvillim dhe prodhimin e hidrokarbureve ndërmjet Albpetrol sha. dhe P. P. C. në tokë, Blloku Velça”.

MEI në datën 03.05.2017 me shkresën nr. 1790/7 i është drejtuar Albpetrol sha. mbi reflektimin e komenteve në draftin e Marrëveshjes me ndarje, për kërkim, zhvillim dhe prodhimin e hidrokarbureve ndërmjet Albpetrol sha. dhe P. P. C. në tokë, Blloku Velça.

MEI në datën 21.03.2017 me shkresën nr. 1790 prot., i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ku kërkon mendim mbi projektvendimin e Këshillit të Ministrave, nga ana e së cilave janë dërguar disa komente.



Albpetrol sha. në datën 12.09.2017 me shkresën nr. 5982 prot., (protokolluar në MEI në datën 12.09.2017 me nr. 7338/10) ka përcjellë draftin e rinegociuar të Marrëveshjes me Ndarje Prodhim “ Për kërkim, zhvillim dhe prodhimin e hidrokarbureve në Bllokun e Velçës”

Albpetrol bën me dije se midis përfaqësuesve të Albpetrol sha. dhe kompanisë P. P. C. u ra dakord që të rinegocion sërish drafti duke marrë parasysh disa nga propozimet e bëra nga Avokatura e Shtetit. Për këtë qëllim u mbajt një takim në datën 26.07.2017 në zyrat e Albpetrol sha., në Tiranë midis përfaqësuesve të të dyja palëve ku u vendos ndryshimi i disa parashikimeve si dhe reflektimi i tyre në draftin e Marrëveshjes.

Përgjegjësi i sektorit SPZHN në datën 21.09.2017 me memon nr. 7338/11 informon ministrin e MIE mbi draftin e rinegociuar të Marrëveshjes ndërmjet Albpetrol sha. dhe P. P. C. referuar shkresës nr. 5982 prot., datë 12.09.2019 nga Albpetrol sha.

Sipas kësaj shkrese Albpetrol sha. nuk i ka marrë në konsideratë të gjitha propozimet e Ministrive dhe Avokaturës së Shtetit.

DPZHH mendon që Albpetrol sha. duhet të reflektojë komentet e Avokaturës së Shtetit dhe të Ministrive në tekstin e drafte Marrëveshjes Hidrokarbure për bllokun e Velçës, të dërguara nga MEI me shkresën nr. 1790/9 prot., datë 08.09.2017

Këshilli i Ministrave ka marrë vendimin nr. 685 datë 22.11.2017 për miratimin e Marrëveshjes me ndarje, për kërkim, zhvillim dhe prodhimin e hidrokarbureve ndërmjet Albpetrol sha. dhe P. P. C. në tokë, Blloku Velça.

Ky vendim është dërguar në datën 23.11.2017 me kartelën shoqëruese të praktikës me nr. 1754/3 port., ( protokolluar në MIE në datën 24.11.2017 me nr. 2336 prot.,)

MIE me shkresën nr. 2336/1 prot., datë 26.12.2017 ka dërguar për njohje dhe zbatim VKM nr. 685, datë 22.11.2017 AKBN dhe Albpetrol sha.

### **Auditimi i Fazës: Për miratimin e Licencë Marrëveshjet**

Me shkresën nr.730/1 prot., datë 24.03.2016 shoqëria Albpetrol i ka përcjellë Ministrisë së Energjitikës dhe Industrisë, për dijeni AKBN, për miratimin e Termave dhe Kushteve Kryesore në lidhje me Marrëveshjen Hidrokarbure “Për Kërkim, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Bllokun Velça” , të nënshkruara nga përfaqësuesit e Albpetrol sha. dhe P. P. C. L..

MEI me anë të shkresës nr. 2234/1 prot., datë 12.05.2016 i është drejtuar shoqërisë Albpetrol për vazhdimin e procedurave për lidhjen e Marrëveshjeve Hidrokarbure me ndarje prodhimi për bllokun e Velçës.

Gjithashtu në shprehjen e miratimit të termave dhe kushteve kryesore, ka kërkuar në të njëjtën kohë që periudha e parë e kërkimit të jetë 2 vjet si dhe të përcaktohet volumi minimal i punimeve sizmike të reja që do të kryhen gjatë kësaj periudhe së bashku me detyrimin minimal financiar që lidhet me to.

Pas marrjes së miratimit nga MEI, Albpetrol sha. me anë të shkresës nr. 3849 prot., datë 23.05.2016 i ka bërë kërkesë AKBN, për dijeni MEI, për t’u pajisur me Licencë Marrëveshje. AKBN me anë të shkresës nr. 4400/2 prot., datë 14.10.2016 në përgjigje të shkresës nr.3849 prot., datë 23.05.2016 të Albpetrol sha. “Kërkesë për tu pajisur me Licencë Marrëveshje” , si dhe shkresës nr.2234/1 port., datë 12.05.2016 të MEI shpreh qëndrimin e saj si mëposhtë:

AKBN kërkon nga shoqëria Albpetrol për marrjen në konsideratë të kërkesave të MEI për disa ndryshime që duhet të kryen në termat dhe kushtet e marrëveshjes, ndryshime të cilat nuk janë depozituar në AKBN pavarësisht çmimit për dërgimin e tyre bashkëlidhur.

Marrja në konsideratë e kërkesave të mësipërme dhe dërgimi në AKBN i termave dhe kushteve të marrëveshjes, të firmosura nga palët duke reflektuar ndryshimet e kërkuara, do të lejojë AKBN të ndërmarrë hapa ligjorë për shqyrtimin e kërkesës dhe pajisjen me Licencë Marrëveshjen e kërkuar.

Me shkresën nr. 7338/2 prot., datë 11.01.2017 MEI kërkon nga shoqëria Albpetrol të vazhdojë procedurat e mëtejshme për negociimin e Marrëveshjes Hidrokarbure si dhe AKBN të pajisë shoqërinë Albpetrol me Licencë Marrëveshje përkatëse.

Marrëveshja për Ndarje Prodhimi për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Tokë në Shqipëri midis Albpetrol sha. dhe P. P. C. në datë 09.10.2017 me nr. 6187/1 port., (dërguar nga MIE me shkresën nr.2336/3 prot., datë 10.05.2018 për AKBN).

Me vendimi nr.685 datë 22.11.2017 Këshilli i Ministrave vendosi miratimin e marrëveshjes me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku Velçës nëpërmjet “Albpetrol” sha. dhe “P. P. C.”.

MIE me anë të shkresës nr. 2288 prot., datë 11.12.2017 ka vendosur në dijeni Drejtorinë e Hidrokarbureve për publikimin e VKM-së nr.685 datë 22.11.2017 “Për miratimin e marrëveshjes me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku Velçës nëpërmjet “Albpetrol” sha. dhe “P. P. C.”, në Fletoren Zyrtare me nr. 210, datë 05.12.2017.

### **Inicimi për Bllokun 2-3**

#### **Faza e aplikimit**

Me shkresën me nr. 1141, datë 16.10.2007, AKBN i është drejtuar z. G. R., Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE), nga ku i kërkon miratimin për fillimin e negociimeve me kompaninë “D. P. A.” dhe “G. P. I.”, si dhe për mundësinë e negociimit të marrëveshjeve për zonat ku përfshihen më shumë se një bllok. Me shkresën me nr. 7754/1, datë 02.11.2007, METE ka autorizuar AKBN mbi fillimin e negociimeve me kompanitë “D. P. A.” dhe “G. P. I.” si dhe mundësinë e negociimit të marrëveshjeve për zonat ku përfshihen më shumë se një bllok.

-Lidhur me aplikimin e kompanive D. P. A.” si dhe “G. P. I.” pjesë të praktikës apo korrespondencës midis (METE) dhe AKBN-së nuk disponohen të dhëna sa i përket aktivitetit të kompanive, eksperiencës së tyre në fushën e operacioneve Hidrokarbure, kontratave apo marrëveshjeve të suksesshme të këtyre kompanive. Pra pjesë të praktikës nuk ka informacion lidhur me këto kompani. Mungesa e informacionit sa i përket kompanive pjesëmarrëse nuk jep garanci në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale gjatë zbatim të MH.

Pas marrjes së miratimit është vazhduar me procedurën e diskutimit të aplikimeve të paraqitura nga kompanitë e mësipërme, plotësimi i kërkesave sipas AKBN-së dhe përmirësimi i termave të paraqitura nga kompanitë. Pas disa seancash diskutimesh dhe pasi propozimet e kompanive u plotësuan sipas kërkesave të AKBN-së, kompanitë paraqiten aplikimet përfundimtare. Nga krahasimi i aplikimeve AKBN përcaktoi që termat e ofruara nga kompania “D. P. A.”, janë më të favorshme se ato të ofruara nga kompania “G. P. I.” me arsyet si më poshtë:

Në Tetor 2007 të dyja kompanitë paraqiten propozimet e tyre të cilat mbulonin blloqet 2-3 në tokë dhe filluan diskutimet midis AKBN-së dhe kompanive. Ne diskutime vëmendja kryesore ishte modifikimi dhe plotësimi i aplikimeve të bëra nga kompanitë, në mënyrë që ato të përmbushin kërkesat dhe termat e aplikimit. Në aplikimin e dytë të bërë nga kompanitë u plotësuan të gjithë kërkesat sipas përmbajtjes dhe formës që duhet të ketë një aplikim. Kompanive ju parashtruan disa opsione për vazhdimin e procedurës:

- 1.Të linin në fuqi aplikimin e paraqitur;
- 2.Të përmirëson më tej aplikimet e tyre;
- 3.Të paraqisnin një aplikim të përbashkët si partnerë në një MH që të përmbante termat më të mirë të propozuar;

Kompanitë paraqitën aplikimet përfundimtare të tyre. “D. P. A.” paraqiti një aplikim të përmirësuar, ndërsa “G. P. I.” rikonfirmoi aplikimin e paraqitur më parë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kompanitë si dhe krahasimi i termave dhe kushteve ndërmjet tyre rezultoi se:

- Kompania “D. P. A.” periudhën e kërkimit e ka ndarë në 3 faza, 3 vjet, 2 vjet, 2 vjet ndërsa “G. P. I.” e ka ndarë në 2 faza 4 vjet, 3 vjet.
- Në programin e punës në çdo periudhë kërkimi, kompania “D. P. A.” ka parashikuar të kryej studime gjeologjike-gjeofizike (G&G) dhe të kryej shpimin e një pusi në thellësi minimale 4000m. Kompania “G. P. I.” parashikon që në fazën e parë të kryej punime të reja sizmike prej 50 km dhe të kryej shpimin e një pusi kërkimi me thellësi minimale prej 2000m ndërsa në fazën e dytë shpimin e një pusi tjetër.

Në krahasim të programeve të punës AKBN ka gjykuar që “D. P. A.” ka program më të përshtatshëm pasi do të shpojë 3 puse kundrejt 2 të kompanisë Italiane, si dhe thellësia e puseve është më e madhe.

Pra në këtë rast nuk është marr parasysh që kosto apo shpenzimet financiare të kompanisë Italiane “G. P. I.” janë në vlerën (16 milion USD) më të ulëta se kompania “D. P. A.”. Në aspektin financiar është marr parasysh vetëm fakti i mos realizimit të programit të punës nga Kontraktori në të cilën parashikohet që në rast mos realizimi të programit të punës do të paguaj detyrimin financiar për pjesën e programit të papërmbyshur.

- Granti për Qeverinë si dhe ndarja e fitimit sipas Faktorit “R” janë pothuajse në vlera të njëjta. Gjithashtu bonusi i nënshkrimit prodhimit dhe fondeve të trajnimit dhe administrimit është pothuajse në vlera të njëjta.

Përfundimisht u vendos që të vazhdohet me negocimin me kompaninë “D. P. A.”.

## II. ZBATIMI I KONTRATËS

1. Auditimi i fazës së investimit të marrëveshjeve hidrokarbure
2. Auditimi i zbatimit të marrëveshjes dhe arritja e objektivave
3. Trajtimi kontabël i standarteve dhe politikave kontabël të marrëveshjeve hidrokarbure
4. Mbi zbatimin e buxhetit të marrëveshjeve hidrokarbure
5. Vlerësimi i ristrukturimit apo ndryshimeve të bëra në marrëveshjes gjatë zbatimit të saj
6. Ndikimi në mjedis dhe adresimi përkatës.

### **Marrëveshjet Hidrokarbure për vendburimin e Povelcës dhe Frakullës.**

Me VKM nr. 401, datë 09.06.2022 “Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror “Frakull”, Këshilli i Ministrave miraton Marrëveshjen Hidrokarbure për këtë vendburim me kompaninë “E. N. G.” Shpk me NIPT M.....T. Data efektive është data e publikimit në fletoren zyrtare datë 13.06.2022.

Me VKM nr. 402, datë 09.06.2022 “Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror “Povelcë”, Këshilli i Ministrave miraton Marrëveshjen Hidrokarbure për këtë vendburim me kompaninë “E. N. G.” Shpk me NIPT M.....T. Data efektive është data e publikimit në fletore zyrtare datë 13.06.2022.

Me shkresën nr. 3824/3 prot., datë 15.06.2022 “Dërgohet për njohje dhe zbatim VKM nr. 401, datë 09.06.2022 dhe VKM nr. 402, datë 09.06.2022”, Sekretari i Përgjithshëm i MIE ka dërguar për njohje dhe zbatim, miratimin e marrëveshjeve hidrokarbure me ndarje prodhimi për vendburimet “Frakull” dhe “Povelcë”. Kjo shkresë i është dërguar AKBN, Albpetrol SHA dhe E. N. G. SHPK.

**Gjetja 1:** Nga auditimi rezulton se këto marrëveshje janë lidhur me të njëjtën kompani, me të njëjtin NIPT, M.....T, në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit 153/2020 “Operacionet e veçanta Hidrokarbure”, “Operacionet hidrokarbure, që i përkasin çdo të drejte hidrokarbure, përbëjnë një operacion të veçantë hidrokarbur”, si dhe pika 2 e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe MIE nr. 21, datë 14.07.2021 “Për operacionet e veçanta

hidrokarbure dhe parashikimet financiare”, “E drejtë hidrokarbure” është e drejta e një personi për të kryer operacione hidrokarbure, duke përfshirë të drejtën e një personi sipas një marrëveshjeje hidrokarbure dhe të drejtën e nënkontraktorit për të cilën zbatohet ligji nr. 153/2020, sipas nenit 2, për të kryer operacione hidrokarbure në emër të një personi tjetër. Në nenin 8, të ligjit nr. 153/2020, përcaktohen rastet kur një operacion hidrokarbur konsiderohet një operacion i veçantë hidrokarbur. Operacionet hidrokarbure, që i përkasin çdo të drejtë hidrokarbure, përbëjnë një operacion të veçantë hidrokarbur. Në përgjithësi operacione të veçanta hidrokarbure janë ato që kryhen nën një dhe vetëm një marrëveshje hidrokarbure dhe në rastet kur brenda kësaj marrëveshjeje hidrokarbure ka më shumë se një zonë zhvillimi të miratuar nga plane të veçanta zhvillimi, operacionet hidrokarbure, që kryhen në çdo zonë zhvillimi, janë operacione të veçanta hidrokarbure. Ky përcaktim ka si qëllim krijimin e një sistemi rrethues për të mbrojtur tatimin mbi fitimin në operacionet hidrokarbure dhe për të krijuar mundësi të barabarta kur është fjala për investimet në operacionet e reja hidrokarbure. Qëllimi i sistemit rrethues është të sigurojë që shpenzimet dhe humbjet nga një operacion i veçantë hidrokarbur nuk kompensojnë të ardhurat nga një operacion tjetër i veçantë hidrokarbur ose jo”.

Referuar këtyre përcaktimeve operatorët ekonomik që kryejnë operacione hidrokarbure llogarisin dhe paguajnë detyrimin e tatimit mbi fitimin të ndarë për secilin “nga operacionet e veçanta hidrokarbure”, kjo do ti jepte fund që shpenzimet një vendburimi ti ngarkoheshin vendburimit tjetër e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të Albpetrol Sha dhe MIE.

**Gjetja 2:** Referuar pikës 26.6 të Marrëveshjeve Hidrokarbure, kontraktori duhet ti paraqesë AKBN-së brenda 60 ditëve nga data efektive një garanci bankare për angazhimin financiar të programit të punës për periudhën përkatëse të vlerësimit.

Me shkresën nr. 2719/9, datë 03.08.2022 “Në lidhje me shkresën tuaj “Kërkesë për konfirmim të Draftit të Garancisë Bankare – Vendburimet Povelçë dhe Frakull”, AKBN, për dijeni Albpetrol SHA dhe MIE i ka kërkuar E. N. G. Shpk që drafti i Garancisë Bankare të jetë në përputhje me aneksin E të marrëveshjes hidrokarbure si dhe garancitë bankare të jenë të veçanta për secilën marrëveshje duke respektuar afatet ligjore.

Kompania, me shkresën nr. 0421/2472 prot., datë 12.08.2022 (protokolluar në AKBN me nr. 2718/7 prot., datë 15.08.2022) “Dërgimi i garancisë bankare të angazhimit financiar të programit të punës për periudhën përkatëse të vlerësimit për vendburimin “Povelcë”, i është përgjigjur AKBN-së dhe për dijeni MIE, duke i vënë në dispozicion Garancinë Bankare nga B. me nr. 631 prot., datë 12.08.2022 për vendburimin “Povelcë”.

Kompania me shkresën nr. 0421/2473 prot., datë 12.08.2022 (protokolluar në AKBN me nr. 2719/14 prot., datë 15.08.2022) “Dërgimi i garancisë bankare të angazhimit financiar të programit të punës për periudhën përkatëse të vlerësimit për vendburimin “Frakull”, i është përgjigjur AKBN-së dhe për dijeni MIE, duke i vënë në dispozicion Garancinë Bankare nga B. me nr. 630 prot., datë 12.08.2022 për vendburimin “Frakull”.

AKBN, me shkresën nr. 2719/12., datë 11.08.2022 “Në lidhje me shkresën tuaj nr. 0421/2472 prot., datë 12.08.2022”, i drejtohet E. N. G. Shpk, për dijeni MIE dhe Albpetrol Sha, ku informon se Garancia Bankare për vendburimin “Povelcë” nuk është në përputhje me kërkesat e aneksit E “Forma e garancisë bankare” dhe kërkon dorëzimin e garancisë siç parashikohet në nenin 26.6 të Marrëveshjes Hidrokarbure,.

AKBN, me shkresën nr. 2719/15 prot., datë 15.08.2022 “Në lidhje me garancitë e paraqitura në AKBN”, i drejtohet E. N. G. Shpk, për dijeni Albpetrol SHA dhe MIE duke e informuar se garancitë e paraqitura nuk janë në përputhje me Aneksin E të MH dhe janë të papranueshme nga AKBN.

Me shkresën nr. 2719/16 prot., datë 15.08.2022, “Në lidhje me garancitë e paraqitura në AKBN”, AKBN i drejtohet Albpetrol SHA, për dijeni MIE duke e informuar se Garancitë e paraqitura nuk janë në përputhje me Aneksin E të MH, si dhe kërkojnë marrjen e masave për paraqitjen e tyre konform MH.

Me shkresën nr. 5957/4 prot., datë 30.08.2022 “Mbi garancitë bankare për marrëveshjet hidrokarbure për vendburimet “Povelçë” dhe “Frakull”, MIE kërkon nga Albpetrol dhe AKBN që të informohet mbi ecurinë e kësaj çështjeje.

Me shkresën nr. 2719/27 prot., datë 14.12.2022 “Mbi njoftimin e dërguar nga E. N. G. Shpk mbi fillimin e shpimit të pusit FR-115, Vendburimi Frakull” AKBN i drejtohet Albpetrol sha dhe për dijeni MIE ku rishpreh se garancitë bankare nuk janë në përputhje me formatin e Aneksit E dhe bëjnë me dije se ende deri në këtë datë (14.12.2022 ose 6 muaj pas datës efektive) garancitë bankare nuk janë dorëzuar në përputhje me formatin e aneksit E.

Me shkresën nr. 2718/14 prot., datë 23.12.2022 (protokolluar pranë MIE nr. 9438/2 prot., datë 28.12.2022) AKBN i drejtohet MIE ku ka përshkruar problematikën në lidhje me garancitë bankare për vendburimet e sipër përmendura. Deri më datë 23.12.2022 problemet në lidhje me garancitë bankare nuk janë zgjidhur pasi përmbajtja e tyre nuk është në përputhje në lidhje kërkesat e Aneksit E.

Në vijim MIE me shkresën nr. 9438/3 prot., datë 10.01.2023 “Mbi problematikën e garancive bankare të marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet “Povelçë” dhe “Frakull” kërkon nga AKBN të zbatojë kushtet dhe klauzolat e Licencë Marrëveshjes dhe Marrëveshjes Hidrokarbure për vendburimet “Povelçë” dhe “Frakull”.

Për zgjidhjen e problemit të Garancisë Bankare, MIE ka vijuar me shkresën nr. 343, prot., datë 12.01.2023 ku ka kërkuar nga Albpetrol SHA të shprehet në lidhje me këto pretendime duke u bazuar në klauzolat e Marrëveshjes Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjes Hidrokarbure për vendburimet Frakull dhe Povelçë.

Problemet në lidhje me garancitë bankare nuk janë zgjidhur edhe pse në datën 04.07.2023 ku me shkresën nr. 0421/2673 prot., datë 04.07.2023, protokolluar në MIE kompania E. N. G. shpk ka kërkuar çlirimin e vlerës prej 500,000 USD pasi është realizuar vlera e angazhimit të investimit minimal të marrë përsipër gjatë periudhës së vlerësimit,

Referuar korrespondencës në vazhdimësi MIE, Albpetrol dhe AKBN kanë vijuar për rreth një vit komunikimin në lidhje me formën dhe përmbajtjen e Garancisë Bankare duke ja përcjellë përgjegjësinë njëri – tjetrit.

Si përfundim, referuar dokumentacionit të mësipërm, kompania E. N. G. Shpk ka dorëzuar garancitë bankare brenda afatit të kërkuar por nuk janë pranuar nga AKBN pasi formati i paraqitur nuk është në përputhje me Aneksin E të MH me pretendimin se garancitë nuk kanë vlefshmëri juridike sepse sipas Aneksit E Garancia duhet të fillonte me shprehjen “Jemi informuar se “E. N. G.” shpk është titullar i vetëm i një MH ...” ndërkohë që në Garancinë e paraqitur nga Kontraktori kjo shprehje është zëvendësuar me “Jemi informuar se “E. N. G.” shpk ka nënshkruar MH ...” dhe nuk u kuptua fakti pse nuk u morr iniciativa për ta përshtatur me formën ligjore sipas aneksit përkatës.

Ka vijuar korrespondenca midis kontraktorit, AKBN, MIE dhe Albpetrol Sha por situata nuk është zgjidhur duke mos respektuar detyrimin ligjor të parashikuar në Nenin 26.6 të MH, ku citohet se:

*“Kontraktori do t’i paraqesë AKBN-së brenda 60 ditëve nga data efektive, një Garanci Bankare për angazhimin financiar të programit të punës për periudhën përkatëse të vlerësimit”, si dhe duke e ekspozuar Albpetrol SHA dhe AKBN ndaj riskut të mos respektimit nga ana e kontraktorit të planit të punës dhe të zhvillimit që ndikon në vijueshmërinë normale të vendburimeve.*

Sa më sipër si dhe Formatit të Garancisë të lëshuar nga B. rezulton si më poshtë:

Kjo Garanci do të hyjë në fuqi jo më vonë se data 12 Gusht 2022 dhe do të mbetet e vlefshme deri në:

1. gjashtë (6) muaj pas përfundimit të Periudhës së Vlerësimit (18 muaj duke filluar nga data efektive);
2. datën në të cilën shuma totale e kësaj Garancie të jetë tërhequr apo reduktuar siç përcaktohet në paragrafin vijues;
3. por në çdo rast, jo më vonë se data 13 Qershor 2024.

Shuma e kësaj Garancie mund të zbritet pas marrjes nga ana jonë të kërkesës për zhblllokim pjesor apo total me shkrim të bërë nga Përfituesi, të firmosur nga firmat e autorizuara të tij. Pra referuar përcaktimeve të bëra si dhe përcaktimit që afati i Garancisë është deri në datën 13.06.2024 (pra garancia është liruar vetë pasi afati maksimal i vlefshmërisë ka kaluar), si dhe faktit që Garancia Bankare është pjesë integrale e MH dhe LM, Albpetrol SHA dhe AKBN ka humbur mbrojtjen, instrumentin ligjor apo garancinë financiare kundrejt Kontraktorit për përmbushjen e detyrimeve kontraktore në lidhje me angazhimin e investimit minimal të Programit të Punës për periudhën e vlerësimit. Si përfundim s'ka garanci të vlefshme bankare dhe për më tepër kjo garanci që ka është çliruar në kundërshtim me nenin 26.6 si dhe Aneksit E të MH dhe LH.

Gjithashtu Albpetrol Sha nuk ka marrë asnjë masë në lidhje me Kompaninë në kundërshtim me Nenin 24, pika 24.3/b , të MH-së ku citohet se:

*“Kontraktori nuk depoziton në AKBN garancinë bankare sipas formatit të përcaktuar në Aneksin E të kësaj Marrëveshje. Me kalimin e afateve të parashikuara në Nenin 24.3 dhe Nenin 26.6 Albpetrol do të dërgojë një shkresë te kontraktori ku e njofton për zgjidhjen e menjëhershme të kësaj marrëveshje dhe zgjidhja e marrëveshjes e bërë në këtë mënyrë do të jetë efektive dhe e vlefshme”* duke e ekspozuar Albpetrol SHA dhe AKBN ndaj riskut të mos respektimit nga ana e kontraktorit të planit të punës dhe të zhvillimit që ndikon në vijueshmërinë normale të vendburimeve e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, Drejtoria Hidrokarbure dhe Drejtoria Ligjore pranë AKBN-së dhe Strukturat drejtuese në Albpetrol Sha.

**Gjetja 3:** Në lidhje me afatet e parashikuara në MH dhe LM konstatohet se Kompania që ka lidhur MH duhet të filloj punën 10 ditë pas datës efektive sipas nenit 8.1 të MH dhe brenda 60 ditëve duhet të miratohet plani i punës ndërkohë që kontraktori ka detyrimin ligjor të paraqesë Garancinë Bankare brenda 60 ditëve (kusht ky që në rast mosplotësimi sjell revokimin e LM dhe MH). AKBN dhe Albpetrol si pasojë e moskoherencës në afate përballen me faktin që operacionet hidrokarbure kanë filluar, plani i punës mund të jetë miratuar ndërkohë që garancia nuk është dorëzuar ose nuk pranohet nga AKBN-ja për arsye të ndryshme. Nisur sa më sipër me synimin që MIE, AKBN, Albpetrol sha të mos përballen me vështirësitë e mësipërme dhe për të siguruar një zbatim normal të MH duhet që kuadri ligjor të ketë koherencë, dorëzimi i garancisë bankare sipas formatit të parashikuar të ketë përparësi juridike në përcaktimin e afateve të tjera e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësisë së lartë.

Një nga termat dhe kushtet e marrëveshjes për vendburimin Frakull është:

- Kohëzgjatja e periudhës së vlerësimit: 18+6 muaj, dhe investimi minimal për këtë vendburim do të jetë në vlerën 500,000 USD.

**Gjetja 4:** Në lidhje me angazhimin minimal prej 500,000 usd, grupi i auditimit konstatoi se kjo vlerë nuk jepet e detajuar për zërat që përmban programi i vlerësimit. Ky program paraqitet si Aneksi G i MH ku jepet i detajuar në aktivitete por pa vlera.

Mos detajimi i vlerave përkatëse sipas zërave të përfshirë në Programin e Vlerësimit sjell paqartësi në gjykimin e përmbushjes së këtij programi në vlerën e angazhimit minimal prej

500,000 USD si kusht kryesor për çlirimin e garancisë bankare si dhe zbatimin e MH-së. Grupi i auditimit gjykon se programi i vlerësimit, që njihet si Aneksi G i MH, të jetë i detajuar në aktivitete me vlera përkatëse si operacione hidrokarbure për të gjykuar mbi realizimin e strukturës së operacioneve të vlerësimit në zëra specifik sipas ofertës teknike e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësishme së lartë.

Referuar LM për stadin aktual të MH-së, kompania duhet të përmbush detyrimet e mëposhtme:  
-Neni 3, pika 4 a,b,c, kontraktori duhet të marrë dhe të përdorë asetet që janë në zonën e kontratës si dhe të dhënat teknike të saj.

Marrja në përdorim e këtyre asetëve nuk nënkupton që kompania bëhet pronare. Ndërkohë dorëzimi i tyre duhet të bëhet me komisione të përbashkëta AKBN – Albpetrol – E., duke u pasqyruar në procesverbale të rregullta.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion praktikantit e kalimit të asetëve paraqiten si më poshtë:

**Për VB Frakull:**

Puset Fr – 19, 109, 36/b procesverbali i kalimit më datë 25.07.2022 (kërkesa kontraktorit për kalim asetesh Nr.0421/2395 Prot., datë 16.06.2022 dhe nr. 0421/2429).

Pusi FR – 30 i kalimit më datë 16.11.2022(kërkesa kontraktorit për kalim asetesh Nr.0421/2496 Prot., datë 22.09.2022).

Pusi FR – 49 i kalimit më datë 12.10.2023(kërkesa kontraktorit për kalim asetesh Nr.0421/2683 Prot., datë 31.07.2023).

**Për VB Povelcë:**

Pusi Pov 1b, 9, 13, 23 i kalimit më datë 06.02.2023(kërkesa kontraktorit për kalim asetesh Nr.0421/2554 Prot., datë 19.12.2022).

**Gjetja 5:** Procesverbalet e kalimit të asetëve kanë bashkëgjatur inventarin e detajuar të çdo pusi por nuk janë të nënshkruara nga të gjithë pjesëmarrësit që përfaqësojnë palët, Albpetrol Sha dhe E. N. G. dhe të miratuara nga Administratorët përkatës.

- U konstatua se në Procesverbalin e datës 12.10.2023 (Fr-49) nuk është nënshkruar nga A.B (përfaqësues Albpetrol Sha) si dhe ky procesverbal në faqen e parë është nënshkruar nga 8 prej 11 anëtarëve.

- U konstatua se në Procesverbalin e datës 25.07.2022 (Fr – 19, 109, 36/b) nuk është nënshkruar nga S.Aj (përfaqësues Albpetrol Sha).

- U konstatua se në Procesverbalin e datës 06.02.2023 (Pov 1b, 9, 13, 23) nuk është nënshkruar nga A.Xh (përfaqësues Albpetrol Sha) si dhe ky procesverbal në faqen e parë është nënshkruar nga 9 prej 13 anëtarëve.

**Gjetja 6:** Në lidhje me detyrimin ligjor që vjen nga neni 7.1 të LM ku citohet se:

*“Operacionet Hidrokarbure sipas kësaj Licence Marrëveshje do fillojnë në Datën Efektive; megjithatë, i LICENCUAR-i do të fillojë Operacionet Hidrokarbure në Zonën e Kontratës, jo më vonë se sa gjashtëdhjetë (60) ditë nga Data Efektive”*

Si dhe neni 8.1 të MH ku citohet se:

*“Po qe se nuk jepet ndryshe këtu, Kontraktori do të fillojë kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure për pusët e përshkruara në Aneksin F jo më vonë se 10 (dhjetë ditë) pasi Albpetrol ti njoftojë Kontraktorit që MH është aprovuar nga Këshilli i Ministrave. Procedura për transferimin e asetëve, operacioneve dhe përgjegjësi që lidhen me këto puse dhe pajisjet e lidhura me ata do të jetë siç përshkruhet në Aneksin F”*

Nga auditimi u konstatua se nuk ka një dokument ku të komunikohet data e fillimit të operacioneve hidrokarbure nga kompania si dhe në lidhje me këtë datë ka një moskoherencë midis neneve përkatëse të MH dhe LM.

Në lidhje sa më sipër, referuar Raport-Progressit të Q3 2022 (Qershor, Korrik - Shtator), Q4 2022 (Tetor-Dhjetor) për vb “Frakull” dhe vb “Povelcë” konstatohet se Operacionet

Hidrokarbure nuk kanë filluar në 10 ditët e mbetur pas datës efektive të muajit Qershor sipas MH si dhe 60 ditë nga data efektive sipas LM, duke mos zbatuar afatet e mësipërme. Në këto situacione shprehen vetëm në mënyrë të përgjithshme se çfarë do të kryhen dhe jo çfarë është kryer faktikisht deri në Dhjetor 2022. Referuar Treguesve Financiarë të raportuar vihet re se shpenzimet kapitale në këtë periudhë janë zero.

Referuar Nenit 18 të MH “Legjislacioni i zbatueshëm” ku përcaktohet qartë që baza e rregullimit dhe interpretimit të kësaj marrëveshje janë ligjet dhe aktet nënligjore shqiptare, në tekstin e kësaj marrëveshje nuk janë parashikuar penalitete ose gjoba në rastet e mos plotësimit në kohë të detyrimeve të kësaj marrëveshje.

#### **PAGESA E BONUSET**

##### **Bonusi i Trajnimit dhe Administrativ për Vb Frakull.**

Referuar Nenit 10.1 të MH Frakull ku citohet:

*“Kontraktori do të shpenzojë 20 000 (njëzet mijë) Dollarë Amerikan për çdo vit kontraktual për qëllime trajnimi të punonjësve të autoriteteve shqiptare ose për qëllime administrative në varësi të kërkesës së Ministrisë. Kontraktori do të paguajë Albpetrolit bonusin e trajnimit dhe administrativ tridhjetë (30) ditë pas fillimit të çdo Viti Kontraktual të Periudhës së Vlerësimit dhe Prodhimit. Në rast se këto periudha nuk fillojnë që në fillim ose nëse nuk përfundojnë në fund të një Viti Kontraktual të plotë, kjo shumë do të përlllogaritet proporcionalisht”*

**Gjetja 7:** Për sa më sipër, kompania E. N. G. për vendburimin “Frakull”, ka paguar Bonusin e Trajnimit dhe Administrativ vetëm për vitin 2022 (për pjesën e mbetur si vit kalendarik dhe jo si vit kontraktual) në vlerën 11,044 USD, datë 15.07.2022 . Pagesa e bonusit të trajnimit për vitin 2023 dhe 6- mujour 2024 është kryer në datën 29.07.2024, në kundërshtim me Nenin nr.10.1 të MH-së për vb Frakull.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Albpetrol Sha për mosmarrjen e masave në kohë për përmbushjen e detyrimeve nga Kontraktori.

#### **PAGESA E BONUSET**

##### **Bonusi i Trajnimit dhe administrativ për Vb Povelcë.**

Referuar Nenit 10.1 të MH Povelcë ku citohet:

*“Kontraktori do të shpenzojë 20 000 (njëzet mijë) Dollarë Amerikan për çdo vit kontraktual për qëllime trajnimi të punonjësve të autoriteteve shqiptare ose për qëllime administrative në varësi të kërkesës së Ministrisë. Kontraktori do të paguajë Albpetrolit bonusin e trajnimit dhe administrativ tridhjetë (30) ditë pas fillimit të çdo Viti Kontraktual të Periudhës së Vlerësimit dhe Prodhimit. Në rast se këto periudha nuk fillojnë që në fillim ose nëse nuk përfundojnë në fund të një Viti Kontraktual të plotë, kjo shumë do të përlllogaritet proporcionalisht”*

**Gjetja 8:** Për sa më sipër, kompania E. N. G. për vendburimin “Povelcë”, ka paguar Bonusin e Trajnimit dhe Administrativ vetëm për vitin 2022 (për pjesën e mbetur si vit kalendarik dhe jo si vit kontraktual) në vlerën 11,044 USD, datë 15.07.2022 . Pagesa e bonusit të trajnimit për vitin 2023 dhe 6- mujour 2024 është kryer në datën 29.07.2024, në kundërshtim me Nenin nr.10.1 të MH-së për vb Povelcë.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Albpetrol Sha për mosmarrjen e masave në kohë për përmbushjen e detyrimeve nga Kontraktori.

##### **Bonusi i Nënshkrimit të MH-së për Vb Frakull .**

- Bazuar në Nenin 10.3 të MH për vendburimin “Frakull” ku citohet:



*“Kontraktori do t'i paguaje Albpetrolit brenda 10 (dhjete) ditëve pas datës efektive shumë prej pesëdhjete mijë dollarë amerikanë 50,000 USD si një bonus nënshkrimi. Bonusi i nënshkrimit nuk do të përfshihet si kosto e rikuperueshme”, kompania E. N. G. ka paguar Bonusin e Nënshkrimit prej 50,000 USD me datë 22.06.2022.*

#### **Bonusi i Nënshkrimit të MH-së për Vb Povelçë .**

- Bazuar në Nenin 10.3 të MH për vendburimin “Povelçë” ku citohet:

*“Kontraktori do t'i paguaje Albpetrolit brenda 10 (dhjete) ditëve pas datës efektive shumë prej pesëdhjete mijë dollarë amerikanë 50,000 USD si një bonus nënshkrimi. Bonusi i nënshkrimit nuk do të përfshihet si kosto e rikuperueshme”, kompania E. N. G. ka paguar Bonusin e Nënshkrimit prej 50,000 USD me datë 22.06.2022.*

#### **Mbi ngritjen e Komitetit Këshillimor për vendburimin Frakull dhe Povelçë:**

**Gjetja 9:** Titullari i Albpetrol Sha nuk ka zbatuar afatin prej 30 ditësh për ngritjen e grupit të përfaqësuesve, nuk ka Urdhër ose Vendim për caktimin e përfaqësuesve të Albpetrol SHA në Komitetin Këshillimor si dhe përfaqësuesit alternative si dhe nuk është mbledhur minimalisht 2 herë në vit (deri në 31.12.2023 kemi vetëm 2 mbledhje) jo në përputhje me nenin nr.5, pikën 5.1.1; 5.1.2; 5.1.3; 5.1.4., të MH-së për vendburimet Frakull dhe Povelçë. Nga auditimi u konstatua se përfaqësuesit e Albpetrol Sha caktohen përpara çdo mbledhje të komitetit nëpërmjet komunikimit elektronik (Email).

Për sa më sipër mban përgjegjësi Titullari i Albpetrol Sha për mosmarrjen e masave për përmbushjen e detyrimeve ligjore e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësishme së lartë.

#### **Planet e Punës dhe Buxhetet për Frakull**

Sipas nenit 7.2 të LM, jo më vonë se 60 ditë pas datës efektive, Kontraktori dorëzon në AKBN një Program pune dhe Buxhet, për pjesën e mbetur të vitit të parë pas datës efektive, në të cilën duhet të përfshihen operacione hidrokarbure të detajuara për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për Fazën e Vlerësimit, me një angazhim minimal total prej 500,000 USD. Paraqitja e këtij programi bëhet në përputhje me procedurën e pasqyruar në nenin 8 të MH dhe nenit 7 të LM.

#### **Për vitin 2022-2023:**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, Mbledhja e Parë Komitetit Këshillimor (EACM) është mbajtur më datë 20.07.2022 në prani të përfaqësuesve të MIE. Referuar korrespondencës, kompania E. me shkresën nr. 0421\2453 prot., datë 19.07.2022, drejtuar AKBN-së, ka propozuar që me datë 20.07.2022 të mbahet mbledhja e Parë e Komitetit Këshillimor midis “Albpetrol” sha dhe “E. N. G.” për të shqyrtuar Programin e Punës dhe Buxhetin për Periudhën e Vlerësimit 2022-2024. Pavarësisht mosdakortësisë që shpreh AKBN për datën 20.07.2022, me pretendimin se koha në dispozicion është e pamjaftueshme për shqyrtimin e materialeve (shkresa për njoftim mbledhje 19.07.2022) e cila është në kundërshtim me nenin 7.1.c të LM të “Frakullës” dhe “Povelçës” “.....Operatori do ti japë njoftim me shkrim AKBN-së të paktën 15 ditë përpara çdo mbledhje të Komitetit Këshillimor, njoftim i cili do të përfshijë axhendën e propozuar dhe materialet mbështetëse, siç do ti shpërndahen Komitetit Këshillimor....” , konstatohet që mbledhja e Parë është mbajtur me datë 20.07.2022.

**Gjetja 10:** Protokolli me minutat e takimit të mbledhjes së Komitetit Këshillimor të datës 20.07.2022 nuk janë të firmosura nga palët, çdo faqe është nënshkruar vetëm nga 3 firma, nuk identifikohen se cilës palë i përkasin duke vënë në dyshim mbajtjen e mbledhjes si dhe vlefshmërinë e vendimeve të marra, jo në përputhje me nenin nr. 5, pikën 5.1.3 të MH-së për vb e “Frakullës” dhe “Povelçës”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të Albpetrol sha për mbushjen e detyrimeve ligjore e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësisë së mesme.

Me shkresën nr. 0421/2494 Prot., datë 20.09.2022, Kompania i ka dërguar AKBN-së për dijeni MIE, Programin e Punës dhe Buxhetin i rishikuar për vitin 2022 dhe për Periudhën e Vlerësimit Qershor 2022 - Dhjetor 2023 për vb Frakull ku ka të reflektuar komentet dhe sugjerimet e anëtarëve të Komitetit Këshillimor.

Buxheti i ndarë në zëra (OPEX, G&A,CAPEX ) për vb Frakull bazuar në programin e punës paraqiten si më poshtë:

**Buxheti E. N. -Frakulla**      Usd

Nr	Zërat e Buxhetit	2022	2023
1	OPEX-Frakulla	165,444	379,258
2	CAPEX-Frakulla	2,140,000	2,502,000
3	G&A-Frakulla	189,726	324,688
	<b>Shuma gjithsej</b>	<b>2,495,170</b>	<b>3,205,946</b>

*Burimi i të dhënave: AKBN*

Kompania E. N. G. ka parashikuar prodhim dhe shitje gazi natyror duke filluar nga muaji Korrik 2023. Për këtë ka parashikuar prodhim gazi nga tre puse; me prodhim mesatar ditor prej 5,000 m<sup>3</sup> në ditë për çdo pus dhe me çmim mesatar rreth \$600 për 1,000 m<sup>3</sup> gaz. Prodhimi i gazit është supozuar të jetë konstant për 6 mujorin e dytë të vitit 2023, kompania për shkak të volumeve modeste që priten nga çdo pus e shikon më të mundshme marketingun e gazit nëpërmjet teknologjisë CNG.

Referuar Raport Progresit të Q3 2023, konstatohet se nuk ka patur prodhim dhe shitje gazi, me pretendimin se kërkohet akoma kohë për të vlerësuar alternativat e mundshme duke i dhënë prioritet prodhimit të gazit CNG. Në lidhje sa më sipër nuk kemi një analizë apo raport nga Albpetrol sha apo AKBN mbi monitorimin e veprimtarisë së prodhimit të gazit.

Buxheti i ndarë në zëra (OPEX, G&A,CAPEX ) për vb Povelçë bazuar në programin e punës paraqiten si më poshtë:

**Buxheti E. N.-Povelçë**      Usd

Nr	Zërat e Buxhetit	2022	2023
1	OPEX-Povelca	137,524	415,598
2	CAPEX-Povelca	546,000	2,690,000
3	G&A-Povelca	189,726	324,688
	<b>Shuma gjithsej</b>	<b>873,250</b>	<b>3,430,286</b>

Kompania E. N. G. ka parashikuar prodhim dhe shitje gazi natyror duke filluar nga muaji Korrik 2023. Për këtë ka parashikuar prodhim gazi nga dy puse; me prodhim mesatar ditor prej 15,000 m<sup>3</sup> në ditë për çdo pus dhe me çmim mesatar rreth \$600 për 1,000 m<sup>3</sup> gaz. Prodhimi i gazit është supozuar të jetë konstant për 6 mujorin e dytë të vitit 2023, gjë e cila vlen për një furnizim konstant të konsumatorit CNG.

Referuar Raport Progresit të Q3 2023 konstatohet se nuk ka patur prodhim dhe shitje gazi, me pretendimin se kërkohet akoma kohë për të vlerësuar alternativat e mundshme duke i dhënë prioritet prodhimit të gazit CNG. Në lidhje sa më sipër nuk kemi një analizë apo raport nga Albpetrol sha apo AKBN mbi monitorimin e veprimtarisë së prodhimit të gazit.

**Për vitin 2023:**

Në mbështetje të korrespondencës, mbledhja e Dytë e Komitetit Këshillimor të Kërkimit (EACM) është mbajtur më datë 14.12.2023 për tu njohur dhe ridiskutuar Programi i Punës dhe Buxhetit të realizuar për Periudhën e Vlerësimit, Qershor 2022- Dhjetor 2023, shqyrtimin e Programit të Punës dhe Buxhetit të propozuar për Periudhën Janar – Qershor 2024 si dhe me kërkesën për aprovimin e shtyrjes me 6 muaj shtesë të Periudhës së Vlerësimit.

Nga dokumentacioni konstatohet aprovimi nga Komiteti Këshillimor i shtyrjes me 6 muaj shtesë të Periudhës Vlerësimit me Vendimin nr. 1 datë 14.12.2023. Grupit të auditimit ju vunë

në dispozicion Minutat e Takimit të nënshkruara dhe Vendimin e Mbledhjes së dytë të Komitetit Këshillimor të mbajtur në ambientet e Hotel “R.”, datë 14.12.2023, ora 10.00.

Buxheti i rishikuar për periudhën e vlerësimit të ndarë në zëra OPEX, G&A,CAPEX për vb Frakull paraqiten si më poshtë:

**Buxheti i rishikuar E. N. -Frakulla** Usd

Nr	Zërat e Buxhetit	2022	2023
1	OPEX-Frakulla	165,444	376,978
2	CAPEX-Frakulla	2,140,000	3,245,334
3	G&A-Frakulla	189,726	242,244
	<b>Shuma gjithsej</b>	<b>2,495,170</b>	<b>3,864,556</b>

Buxheti i rishikuar për periudhën e vlerësimit të ndarë në zëra OPEX, G&A,CAPEX për vb Povelçë paraqiten si më poshtë:

**Buxheti E. N.-Povelca** Usd

Nr	Zërat e Buxhetit	2022	2023
1	OPEX-Povelca	137,524	335,555
2	CAPEX-Povelca	546,000	3,476,000
3	G&A-Povelca	189,726	311,123
	<b>Shuma gjithsej</b>	<b>873,250</b>	<b>4,122,678</b>

Në lidhje sa më sipër duke analizuar Programet e Punës dhe Buxhetet për vb Povelçë dhe vb Frakull për secilin vit konstatohet se janë të unifikuara nga përmbajtja, të detajuara, të specifikuara sipas zërave (OPEX, G&A,CAPEX ) sipas operacioneve teknike të kërkimit që kontraktori planifikon të realizojë gjatë periudhës së vlerësimit.

**Gjetje 11:** Në lidhje me Programet e Punës dhe Buxhetet për vb Povelçë dhe vb Frakull ku Kontraktori paraqet tek Albpetrol dhe AKBN si dokumenti ku parashtron dhe propozon operacionet Hidrokarbure për tu kryer gjatë Periudhës Vlerësimit, si dhe faktit që ky program duhet të jetë konsistent me Programin e Vlerësimit, konstatohet se nuk ka një format tip të planit të punës dhe të buxhetit ku të jetë parashikuar më parë në Marrëveshje (si Aneks) për tu paraqitur në mbledhjet e Komitetit Këshillimor, e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësisë së mesme.

Për sa më sipër Tabela e Kostove të Raportuara dhe Buxhetet përkatës për vb Frakull janë si më poshtë:

Vitet	Raportimet mln CRS	Buxheti i rishikuar
2022	824,171	2,495,170
2023	2,523,792	3,999,515
Kumulative	<b>3,347,963</b>	<b>6,359,726</b>

Në mënyrë të detajuar realizimi i buxhetit sipas zërave:

Në USD

	G&A		OPEX		CAPEX	
	PLAN	Fakt	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT
Q3 2022	108,749	144,374	86,964	51,167	1,664,000	-
Q4 2022	80,977	139,137	78,480	27,493	476,000	462,000
<b>Viti 2022</b>	<b>189,726</b>	<b>283,511</b>	<b>165,444</b>	<b>78,660</b>	<b>2,140,000</b>	<b>462,000</b>
Q1 2023	81755	109641	82890	30672	441000	569,444
Q2 2023	80976	123407	90230	37007	2031000	686,514
Q3 2023	80976	137305	116100	51612	0	439,469
Q4 2023	133494	96715	87760	66452	773334	175,554
<b>Viti 2023</b>	<b>377,201</b>	<b>467,068</b>	<b>376,980</b>	<b>185,743</b>	<b>3,245,334</b>	<b>1,870,981</b>

**Gjetje 12:** Duke analizuar shifrat e mësipërme ndërmjet vlerave të Buxhetit të dakortësuar dhe Raportimit të Shpenzimeve faktike ka një diferencë të madhe edhe pse kontrata ua njeh të drejtën e rishikimit të vlerave të buxhetit (që të ngushtohet diferenca midis planifikimit dhe realizimit) e cila mund të kërkohet për arsye operationale ose si rezultat i veprimtarisë së Kërkimit dhe të Vlerësimit. Sa më sipër në lidhje me Programin e punës dhe Buxhetet respektive konstatohet se E. N. ka raportuar vlera të larta planifikimi por realizimi i tyre është në nivele shumë të ulëta (konkretisht për vitin 2022 është 33% dhe vitin 2023 është 63 %). Kjo vë në dyshim procesin e përgatitjes dhe planifikimit të buxhetit pa një studim të mirëfilltë, monitorimin e zbatimit të buxhetit për performancën financiare si dhe vë në dyshim ekzistencën e kapaciteteve financiare të Kompanisë në kundërshtim me nenin 7.2 të LM dhe nenit 8 të MH për vb Frakull e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësishme së lartë. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të Albpetrol sha, AKBN.

Për sa më sipër Tabela e Kostove të Raportuara dhe Buxhetet përkatës për Vb Povelçë janë si më poshtë:

Vitet	Raportimet mln CRS	Buxheti i rishikuar
2022	39,031	873,250
2023	544,672	4,122,678
Kumulative	<b>583,703</b>	<b>4,995,928</b>

Në mënyrë të detajuar realizimi i buxhetit sipas zërave:

	Në USD					
	G&A		OPEX		CAPEX	
	PLAN	Fakt	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT
Q3 2022	108,747	942	22,444	37,119	20,000	-
Q4 2022	80,976	-	115,080	970	526,000	-
<b>Viti 2022</b>	<b>189,723</b>	<b>942</b>	<b>137,524</b>	<b>38,089</b>	<b>546,000</b>	-
Q1 2023	81,755	43,115	94,080	16,160	1,395,000	46,702
Q2 2023	80,976	63,480	101,180	24,803	1,275,000	43,500
Q3 2023	80,976	64,909	113,150	46,602	20,000	32,234
Q4 2023	67,416	96,715	27,145	66,452	786,000	-
<b>Viti 2023</b>	<b>311,123</b>	<b>268,219</b>	<b>335,555</b>	<b>154,017</b>	<b>3,476,000</b>	<b>122,436</b>

**Gjetje 13:** Duke analizuar shifrat e mësipërme ndërmjet vlerave të Buxhetit të dakortësuar dhe Raportimit të Shpenzimeve faktike ka një diferencë të madhe edhe pse kontrata ua njeh të drejtën e rishikimit të vlerave të buxhetit (që të ngushtohet diferenca midis planifikimit dhe realizimit) e cila mund të kërkohet për arsye operationale ose si rezultat i veprimtarisë së Kërkimit dhe të Vlerësimit. Sa më sipër në lidhje me Programin e punës dhe buxhetet respektive konstatohet se E. N. ka parashikuar për investim vlera të larta, por raportimi i realizimit të tyre është në nivele shumë të ulëta (konkretisht për vitin 2022 është 4,5% dhe vitin 2023 është 13.2 %). Kjo vë në dyshim procesin e përgatitjes dhe planifikimit të buxhetit pa një studim të mirëfilltë, monitorimin e zbatimit të buxhetit për performancën financiare si dhe vë në dyshim ekzistencën e kapaciteteve financiare të Kompanisë në kundërshtim me nenin 7.2 të LM dhe nenit 8 të MH për vb Povelçë e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësishme së lartë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të Albpetrol sha, AKBN.

Shpenzimet e njohura për përmbushjen e angazhimit minimal të periudhës së vlerësimit janë ato të raportuara në zërin CAPEX që për periudhën qershor 2022- dhjetor 2023 janë në vlerën 122,436 USD, ose me një mos realizim në vlerën 377,564 USD (deri në 31.12.2023). Albpetrol Sha dhe AKBN duke parë trendin e mos realizimit të CAPEX në 6 tremujorët duhet rriste monitorimin e realizimit si dhe të diskutohej në mbledhjet e Komitetit Këshillimor.

**Gjetja 14:** Nga auditimi u konstatua se AKBN dhe Albpetrol SHA si institucione monitoruese të zbatimit të kontratës nuk kanë çmime reference (module çmimi) të blerjeve apo shërbimeve që lidhen me investimet në operacione hidrokarbure për vb Frakull dhe vb Povelçë. Nisur nga ky fakt Albpetrol sha, AKBN gjenden përpara riskut që buxheti i paraqitur të jetë i fryrë për shkak të kostove të larta gjatë vlerësimit dhe auditimit të situacioneve të kostove të rimbursueshme (cost recovery 84%) të cilat mund të jenë larta.

**Gjetja 15:** Grupi i auditimit konstatoi se ka një mospërputhje të vlerave të buxheteve fillestare dhe të rishikuara në raportet e progresit të sjella nga kompania. Edhe pse jemi para faktit se si AKBN dhe Albpetrol Sha nuk kanë kryer asnjë auditim të kostove dhe pasqyrave financiare, këto institucione nuk kanë kontrolluar/kuadruar as shifrat e sjella nga kompania.

### **Situacionet e Veprimtarisë (Raport Progresi për tremujor):**

Nga auditimi u konstatua se shoqëria ka dërguar me vonesë vetëm situacionin e Q3 2023 (afati ligjor 30.11.2023) si dhe me një ditë vonesë situacionin Q4 2022(28.02.2023) për vb Frakull dhe Povelçë. Raportet e Progresit për çdo tremujor kanë në përmbajtjen e tyre Realizimin e Treguesve dhe Aktiviteteve Teknike, Realizimin e Treguesve Financiare i ndarë sipas zërave (G&A, OPEX, CAPEX), Realizimin e Treguesve të Shitjes dhe Marketingut si dhe Informacion mbi Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në punë, Mbrojtjen e Mjedisit dhe Marrëdhënien me Komunitetin.

**Gjetja 16:** Në lidhje me detyrimet ligjore të MH , u konstatua se përmbajtja e marrëveshjes në Aneksin C, pika I.2.1 për vendburimin e Gazit “Frakull” dhe “Povelçë”, ka një boshllëk interpretimi në lidhje me detyrimin e dorëzimit të situacioneve tremujore në periudhën e vlerësimit pasi:

*“Kontraktori do ti dorëzoje Albpetrol-it dhe AKBN-s, sa me shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga përfundimi i çdo Tremujori Kalendarik, një Situacion të Veprimtarisë së Zhvillimit sipas Nenit 7 të Marrëveshjes, ku pasqyrohen të gjitha detyrimet dhe kreditimet në lidhje me Zhvillimin dhe Prodhimin për atë Tremujor Kalendarik (Shpenzimet e Zhvillimit dhe Shpenzimet Operative), që të përfshijë totalin për të gjithë vitin dhe detyrimet dhe kreditimet kumulative që prej fillimit, të përmbledhura sipas klasifikimeve të duhura që tregojnë natyrën e tyre”*

**Për sa më sipër periudha e vlerësimit është lënë jashtë interpretimit detyrimit ligjor.**

### **Monitorimi nga AKBN dhe Albpetrol Sha për zbatimin e planit të punës dhe buxhetit.**

Në kuadrin e zbatimit dhe monitorimit të MH për vendburimin e gazit natyror “Frakull” dhe “Povelçë” monitorimi dhe raportimi, janë procese përmes të cilave duhet t’i kushtohet vëmendje ecurisë së zbatimit të saj, përmbushjes së detyrimeve si dhe arritjes së objektivave të vendosura me synimin rritjen e efikasitetit të operacioneve hidrokarbure.

**Gjetje 17:** Në lidhje me Monitorimin, Albpetrol Sha si përfaqësues i autoritetit në kontratë dhe AKBN si përfaqësuese e MIE në LM nuk disponojnë programe apo plane periodike vjetore për të ushtruar kontrole në subjekte si zotërues të lejes Hidrokarbure, konkretisht kompanisë E. N. G. për vendburimin e “Frakullës” dhe të “Povelçës”. Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion informacion apo praktikë të ndjekur në lidhje me Monitorimin, Mbikëqyrjen e përgjithshme të MH apo inspektime për vendburimin e “Frakullës” dhe të “Povelçës” ku të bëhen krahasime apo vlerësime konkrete të treguesve teknologjikë apo të realizimit të investimeve etj, me planet e punës apo buxhetet e fillestare apo të rishikuara me treguesit e raportuar në situacionet përkatës, në kundërshtim me Nenit 12.8 të MH-së, Nenit 16.8. i LM-së, Pikës 9 të Rregullores së Brendshme të AKBN, e cila për nga rëndësia është e lartë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të Albpetrol sha, strukturat drejtuese të AKBN.

### **Auditimi**

**Gjetja 18:** Nga auditimi u konstatua se Albpetrol Sha nuk ka kryer asnjë auditim të pasqyrave të kostove për periudhën e vlerësimit duke e humbur të drejtën e verifikimit dhe certifikimit të situacioneve të operacioneve në periudhën e vlerësimit. Bazuar në datat e dorëzimit të situacioneve (raport progresive) të tremujoreve si dhe përcaktimeve ligjore të mësipërme, konstatohet se Albpetrol Sha nuk mund të shprehet për kostot e raportuar për periudhën: qershor + Q3 2022, Q4 2022, Q1 2023 për vb Frakull dhe vb Povelçë në kundërshtim me Nenin 2, pika 25.1 dhe Aneksin C, Neni I.3.1 të MH për vb Frakull dhe vb Povelçë. Mos kryerja e auditimeve tekniko-financiarë ka sjellë mos certifikimin e situacioneve të mbulimit të kostove hidrokarbure si dhe ka humbur të drejtën e verifikimit dhe certifikimit për periudhat e sipërpërmendura, e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë. Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi Administratori i Albpetrol sha, Drejtoria Hidrokarbure pranë Albpetrol sha.

**Gjetja 19:** - Grupi i auditimit konstatoi se AKBN nuk ka kryer asnjë auditim apo inspektim të librave të llogarisë dhe dokumentacionit kontabël për kostot Hidrokarbure dhe të ardhurat e realizuara për periudhën e vlerësimit në kundërshtim me Nenin 15, pika 15.2 dhe pika 15.3 i LM-së për vendburimin e gazit natyror “Frakull” dhe “Povelçë” e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

Auditet dhe inspektimet financiare ndikojnë në përpilimin e saktë të pasqyrave financiare, parandalojnë shmangien nga regjimi fiskal si dhe rregullimin dhe kontrollin e detyrimit mbi rentën minerare, tatim-fitimin si dhe përpilimin e saktë të pasqyrave financiare.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi Drejtori Ekzekutiv i AKBN, Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure pranë AKBN, Sektori i Auditit të MH pranë AKBN.

-Referuar kuadrit ligjor me nenet përkatëse për Auditimin konstatohet se ka një moskoherencë në lidhje me afatet e kryerjes së auditimit nga Albpetrol dhe AKBN, pasi të gjitha kostot hidrokarbure quhen të certifikuara pas 12 muajsh nga data e raportimit të tyre ndërkohë që AKBN ka të drejtën e auditimit të tyre deri në 3 vjet dhe auditimet e AKBN-së mund të gjenden përpara faktit që kostot të jenë të certifikuara nga Albpetrol. Nisur sa më sipër Grupi i auditimit gjykon të unifikohen afatet që kanë të bëjnë me auditimin dhe certifikimin e kostove hidrokarbure.

### **Marrëveshjet Hidrokarbure për Bllokun 4 me Sh. U. A. & Dumre.**

Kontrata me ndarje prodhimi për Bllokun 4 është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 350, datë 12.06.2018, botuar në fletoren Zyrtare nr. 87, datë 14.06.2018, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Sh. U. A. BV, hyrë në fuqi në 14 Qershor 2019 përcaktuar në nenin 1.44 të KNP ku citohet:

*“Datë e hyrjes në fuqi : në këtë kontratë do të thotë periudha prej dymbëdhjetë (12) Muajsh Kalendarik pas datës në të cilën hyn në fuqi Vendimi i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që miraton këtë kontratë ”.*

Kompania Sh. U. A. BV “S.U.A” në përputhje me nenin 19.2 të KNP, ka transferuar tërësinë e interesit të saj, si mbajtëse e 100 % të interesave të pjesëmarrjes mbi këtë Kontratë, të Sh. A. B. B.V., dëshmuar nga “Akt Transferimi” i nënshkruar më datë 18.07.2019, e cila hyri në fuqi më 06.09.2019, transferim i cili i është njoftuar AKBN-së me anë të shkresës Nr.672, datë 05.08.2019 (protokolluar në AKBN me nr.4949 prot., datë 05.08.2019), duke i vënë në dispozicion AKBN-së, Aktin e Transferimit.

Kjo marrëveshje parashikon kërkimin e hidrokarbureve në këtë Bllok, kërkim i cili do të kryhet në tre faza:

**-Faza e parë** do të zgjasë 3 vite. Gjatë kësaj faze do të kryhen punime sizmike, përpunim dhe interpretim i të dhënave sizmike 2D për 125 km, dhe vlerësimi gjeologjik dhe gjeofizik (G&G). Angazhimi financiar minimal për këtë fazë është 8.57 milion USD.

**-Faza e dytë** do të zgjasë 2 vjet. Gjatë kësaj faze do të kryhen rreth 300 km punime sizmike 2D dhe ripërpunimi i 200 km profile sizmike 2D. Gjatë kësaj faze është opsional shpimi i një pusi kërkimi me thellësi 3000 m. Angazhimi financiar minimal për këtë fazë është rreth 20 milion USD.

**-Faza e tretë** do të zgjasë 2 vjet. Gjatë kësaj faze do të kryhet shpimi i një pusi kërkimi me thellësi minimale 3000m. Angazhimi financiar minimal për këtë fazë është 14 milion USD.

Kohëzgjatja e Kontratës për rastin që do të ketë një zbulim të ri, pra periudha e Zhvillim - Prodhimit, do të jetë 25 vjet me të drejtë zgjatje.

Në zbatim të Marrëveshjes, Kompania ka filluar dhe po kryen punime sizmike sipas angazhimit të fazës së parë që parashikon KNP.

Investimet akumulative nga fillimi i kësaj marrëveshje deri me 31.12.2023 janë rreth 17.7 mln USD.

Ndërkohë buxheti i miratuar për vitin 2023 është 1.7 milion USD.

Kjo marrëveshje u amendua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 652, datë 10.10.2022, duke pezulluar për 24 muaj Periudhën e Parë të Kërkimit. Duke u bazuar në Amendimin e kësaj kontrate, Data Efektive e fillimit të Periudhës së Pezullimit është data 13 Maj 2022 e cila përkon me njoftimin e pezullimit nga Kontraktori tek AKBN-ja.

### **Garancia Bankare**

Referuar pikës 29.4 të KNP, kontraktori duhet të depozitojë pranë AKBN-së brenda 90 ditëve nga data efektive një garanci bankare për kohëzgjatjen e Periudhës përkatëse të kërkimit që përmbush standartet minimale financiare, sipas formatit të parashikuar në Aneksin E të KNP-së për bllokun 4, në tokë.

Në vijim, me shkresën nr. 5, datë 19.09.2019 (protokolluar në AKBN me nr.5291/8, datë 19.09.2019), Sh. A. B. B.V ka paraqitur Garancinë Bankare Nr.IGB1903175 për Periudhën e Parë të Kërkimit të Blloku-4.

Pas verifikimit të Garancisë Bankare, AKBN i konfirmon Kompanisë që Garancia Bankare është në përputhje me formatin e miratuar si Aneksi E i KNP për bllokun-4, në tokë. Për sa më sipër me shkresën nr 5291/12 Prot., datë 18.10.2019, Drejtori Ekzekutiv i AKBN i drejtohet bankës ku kërkon konfirmimin e saj që garancia bankare Nr.IGB1903175 e lëshuar prej saj është e vlefshme. Në kushtet e mos marrjes përgjigje, AKBN, me shkresë nr.934 prot., datë 28.01.2020, i ridrejtohet bankës për të konfirmuar mbi vlefshmërinë e Garancisë Bankare. Me shkresën pa numër, datë 10.02.2020, banka "B. P." i përgjigjet AKBN dhe konfirmon që Garancia Bankare me nr. IGB1903175, e lëshuar më datë 17.09.2019 është e vlefshme.

### **PAGESA E BONUSEVE**

#### **Bonusi i Trajnimit dhe administrativ**

Kompania Sh. A. B. B.V, ka kryer pagesat si më poshtë:

<b>Blloku 4</b>	<b>-Data e</b>	<b>Afati maksimal</b>	<b>Vlera e</b>
<b>trasfertave te bonusit</b>	<b>ligjor për pagesë</b>	<b>ligjor për pagesë</b>	<b>paguar</b>
2019	14.06.2019	14.05.2019	299,966
2020	12.05.2020	14.05.2020	300,002
2021	14.05.2021	14.05.2021	299,998
2022	18.05.2022	14.05.2022	300,003
2023	16.06.2023	14.05.2023	300,002

**Gjetja 1:** Nisur sa më sipër pagesa e kryer nga kontraktori për bonusin e trajnimit dhe administrativ për vitet 2019, 2022 dhe 2023 nuk janë kryer brenda afateve ligjore pasi data efektive e kontratës është 14.06.2019 dhe pagesat duhet të kryhen minimalisht 30 ditë përpara fillimit të vitit kontraktual domethënë pagesat duhet të kryhen brenda datës 14 maj të çdo viti në kundërshtim me nenin 27/3.1 të KNP-së:

*“KONTRAKTORI do të paguaj bonusin e trajnimit dhe administrativ tridhjetë (30) ditë përpara fillimit të çdo Viti Kontraktual të Periudhës së Kërkimit.*

*Në rast se këto periudha nuk fillon që në fillim ose nëse nuk përfundojnë në fund të një viti kontraktual të plotë, kjo shumë do të përllogaritet proporcionalisht”, e cila për nga niveli i rëndësisë është e mesme. Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi AKBN.*

### **Bonusi i Nënshkrimit të KNP dhe Bonusi i Nënshkrimit të Amendimit të KNP**

- Bazuar në Nenin 27.1 të KNP Blloku 4 ku citohet:

*“Kontraktori do ti paguajë AKBN-së, vetëm një herë, një bonus nënshkrimi në vlerën totale prej një milionë e pesëqind mijë dollarë (1.500.000 USD) brenda tridhjetë (30) ditëve pas publikimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që miraton këtë kontratë”.*

Kompania ka paguar bonusin e nënshkrimit prej 1,500,000 USD dhe me shkresën nr. 537, datë 10.07.2018 kërkon nga AKBN konfirmimin e marrjes duke respektuar detyrimin ligjor sipas kontratës.

- Bazuar në VKM Nr.652, datë 10.10.2022 mbi miratimin e Amendimit të kontratës së miratuar me VKM Nr.350, datë 12.06.2019, ku citohet se:

*“Kontraktori do ti paguajë AKBN-së vetëm një herë, një bonus në vlerën totale prej 500,000 USD për pezullimin e lartpërmendur brenda 30 ditëve pas datës së njoftimit të pezullimit nga Kontraktori tek AKBN-ja si dhe Kontraktori do të investojë 1,000,000 USD në projekte të investimeve sociale të lidhura me burimet e rinovueshme dhe tranzicionin energjitik si ka rënë dakort me MIE”.*

Me shkresën nr.608, datë 08.06.2022, (protokolluar në AKBN me shkresën nr. 2663., datë 10.06.2022) Kompania njofton AKBN mbi kryerjen e pagesës së bonusit prej 500,000 USD në datë 26.05.2022, si dhe detajet e pagesës.

**Gjetja 2:** Në lidhje me fondin për investime sociale prej 1,000,000 USD si detyrim i kompanisë gjatë periudhës së pezullimit, rezulton se S. 4 deri në 23.02.2024 ky detyrim nuk është plotësuar, referuar kjo edhe në informacionin e dërguar nga AKBN/Drejtoria e Hidrokarbureve në MIE më datë 23.02.2024 mbi sektorin e kërkimit të hidrokarbureve për vitin 2023 në kundërshtim me VKM Nr.652, datë 10.10.2022 mbi miratimin e Amendimit të kontratës së miratuar me VKM Nr.350, datë 12.06.2019, e cila për nga rëndësia është e nivelit të lartë.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi MIE,AKBN.

### **Planet e Punës dhe Buxhetet**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, AKBN ka respektuar detyrimin ligjor në zbatim të neni 4.6 të KNP ku citohet se:

*“Programi i punës dhe Buxheti i Kërkimit, çdo Program Vlerësimi dhe çdo Plan Zhvillimi do të shqyrtohen nga një komitet i përbashkët që do të ngrihet sëbashku nga AKBN dhe Kontraktori, pas datës së hyrjes në fuqi. Ky Komitet do të referohet si “Komiteti Këshillimor i Kërkimit”, përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë, tre (3) nga të cilët nga AKBN dhe tre (3) nga Kontraktori. Komiteti Këshillimor i Kërkimit do të ngrihet brenda tridhjetë (30) ditëve nga Data e Hyrjes në Fuqi e Kontratës. Kryetari i Komiteti Këshillimor i Kërkimit emërohet nga AKBN-ja midis anëtarëve të propozuar prej saj”.*



Me shkresën nr.4394 prot., datë 11.07.2019, Drejtori Ekzekutiv i AKBN i drejtohet Sh. U. A. BV ka propozuar Përfaqësinë e saj si Institucion në Komitetin Këshillimor të Kërkimit me përbërje si më poshtë:

1. A. B. Kryetar
2. A. M. Anëtar
3. D. D. Anëtar
4. E. K. Vëzhgues
5. S. M. Vëzhgues

Me shkresën nr. 571 Prot., datë 12.07.2019 (protokolluar në AKBN me shkresën nr. 4394, datë 12.07.2019), Kompania i drejtohet AKBN ku njofton anëtarët e Sh. në këtë komitet:

1. Z. R. D. S. Drejtor për Shqipërinë & Menaxher Komercial
2. Z. P. G. Drejtues i Ekipit të eksplorimit dhe Kërkimit për Shqipërinë
3. Znj. S. O. Menaxher Eksplorimi për Europën, Rusinë, Kaspikun.

Referuar pikës 4.6 të sipër sipërcituar dhe 4.5 të KNP, ku citohet se : *“Të paktën tre muaj përpara fillimit të çdo Viti Kalendarik apo në kohën kur mund të bihet dakort ndryshe midis AKBN-së dhe Kontraktorit, Kontraktori do të përgatisë një Program Pune dhe buxhetin përkatës për zonën e Kontratës, duke specifikuar Operacionet e Kërkimit që Kontraktori planifikon të realizojë gjatë vitit Kalendarik pasardhës”*, shqyrtimi i Programit të Punës dhe Buxhetit përkatës, i sugjerimeve të bëra nga Kontraktori, rregullimeve të nevojshme si dhe miratimi përfundimtar i tij është bërë si më poshtë:

**Gjetja 3:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, Mbledhja e Parë Komitetit Këshillimor të Kërkimit (EACM) është mbajtur më datë 17.10.2019. Referuar minutave të takimit objekt i mbledhjes ka qënë diskutimi si dhe vlerësimet e fundit të Planit të Punës dhe Buxhetit për vitin 2019.

Sa më sipër, mban përgjegjësi AKBN pasi nuk ka miratim për planin e punës dhe të buxhetit për vitin 2019.

Tabela e Kostove të Raportuara dhe Buxhetet përkatës janë si më poshtë:

Vitet	Raportimet mln CRS	Buxheti mln(USD)
Para datës efektive	0.38	0.275 Euro + jo më shumë se 0.40 Usd
2019	0.92	2.2
2020	1,99	12.24
2021	12,79	16.4
2022	1,15	2.1
2023	0.44	1.7
Kumulative	17.67	34.64 + kosto para datës efektive

**Gjetja 4:** Në lidhje sa më sipër duke analizuar Programet e Punës dhe Buxhetet e secilit vit, konstatohet:

- Janë përmbledhëse dhe jo te detajuara dhe të pa specifikuar sipas operacioneve të kërkimit që kontraktori planifikon të realizojë gjatë vitit kalendarik pasardhës në kundërshtim me nenin 4.5 të KNP-së e cila për nga rëndësia është e nivelit të mesëm.

Për sa më sipër, për veprime dhe mos veprime mbajnë përgjegjësi AKBN.

-Për Programet e Punës dhe Buxhetet nuk ka formate tip por paraqitet në prezantime power point dhe word, të pa detajuara dhe analizuara të përmbledhura në 3 zëra (sizmik, kosto menaxhimi, të tjera).

Gjithashtu duke analizuar shifrat e mësipërme ndërmjet vlerave të Buxhetit të miratuar dhe Raportimit të Shpenzimeve faktike ka një diferencë të madhe edhe pse kontrata ua njeh të drejtën e rishikimit të vlerave të buxhetit e cila mund të kërkohet për arsye operationale ose si rezultat i veprimtarisë së Kërkimit dhe të Vlerësimit.

### **AMENDIMI I KNP (Pezullimi i PK1)**

Me shkresën nr. 9, datë 10.03.2022 (protokolluar në MIE me shkresën nr.2301 prot., datë 10.03.2022) “Mbi domosdoshmërinë e pezullimit të vendimit tonë për të hyrë në Periudhën e Dytë të Kërkimit (PK2) të KNP Blloku 4, në tokë” Sh. A. B. , i drejtohet Ministrit me kërkesën për të pezulluar vendimin për të vazhduar në Periudhën e Dytë të Kërkimit (PK2) me pretendimin e ndodhjes së Pandemisë Covid si dhe me çrregullimet dhe pasiguritë e tregut të energjisë elektrike duke sjellë rritjen e çmimit të energjisë.

Më tej Kompania shprehet se gjatë “periudhës së pezullimit” do të përfundojë interpretimi sizmik si dhe do të vazhdojnë punimet gjeologjike për nëntokën si dhe do të vazhdojë pagesa për Bonusin e Trajnimit dhe Administrativ sipas KNP.

Në përgjigje sa më sipër MIE me shkresën nr.2301/1 prot., datë 07.04.2022 “Mbi kërkesën tuaj të dërguar në MIE mbi pezullimin e vendimit për të hyrë në Periudhën e Dytë të Kërkimit” MIE i drejtohet SUA4 duke i kërkuar detaje mbi mënyrën e se si do të realizohet periudha e kohore e pezullimit si dhe afati kohor i propozuar për këtë pezullim.

Në vijim me shkresën nr. 12, datë 15.04.2022 “Përgjigje të shkresës tuaj nr.2301/ datë 07.04.2022” SAB4 sugjeron qe pezullimi i vendimit për të hyrë në Periudhën e Dytë të Kërkimit të KNP Blloku 4, mund të arrihet me një amendim të dakortësuar dhe të nënshkruar bashkarisht dhe miratuar me një VKM. Me anë të këtij Pezullimi SAB4 duhet të vendosë të hyjë në Periudhën e Dytë të Kërkimit jo më vonë së 24 muaj pas përfundimit të Periudhës e Parë të Kërkimit.

Në lidhje sa më sipër me Memon e datës 20.04.2022 të përgatitur nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve pranë MIE, i kanë rekomanduar Ministres ngritjen e një Grupi Negociator për amendimin e kontratës.

Me Urdhërin nr. 86, datë 04.05.2022 “Ngritja e Grupit Negociator për amendimin e kontratës me ndarje prodhimi për kërkim, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në tokë në Shqipëri” ka urdhëruar ngritjen e grupit negociator për fillimin e negociatave për amendimin e KNP-së. Ky grup ka këtë përbërje:

1. I. B. Kryetar
2. E. K. Anëtar
3. K. N. Anëtar
4. I. Gj. Anëtar
5. M. B. Anëtar
6. Përfaqësues AKBN Anëtar
7. Përfaqësues AKBN Anëtar

Me shkresën nr.2301/84 prot., datë 11.05.2022 MIE i dërgon AKBN, për njohje dhe zbatim Urdhërin e mësipërm.

Me shkresën nr. 13, datë 13.05.2022 (protokolluar në AKBN me nr. 2201, datë 16.05.2022) “Njoftim i pezullimit të periudhës së parë të kërkimit të KNP, Blloku 4, S. 4, i drejtohet AKBN duke e njoftuar mbi pezullimin e periudhës së parë” si dhe data 13.05.2022 të konsiderohet si data efektive e fillimit të periudhës së pezullimit.

Me shkresën nr.4502 prot., datë 06.06.2022 “Kërkohet mendim për Projektvendimin për amendimin e KNP-së për Bllokun 4” MIE jua dërgon Ministrisë Drejtësisë, Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, MTM dhe Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, ku ju kërkon dhënie mendimi për projektvendimin.

Në vijim të dhënies mendimit institucional, Avokatura e Shtetit me shkresën nr.2636/1 prot., datë 15.06.2022, shprehet se bazuar në nenin nr. 5 dhe 15 të Ligjit nr. 10018., datë 13.11.2008, institucioni jep mendim paraprakisht për projektet e kontratave të organeve të Administratës Publike të cilat kanë pasoja financiare për shtetin. Referuar dokumentacionit shoqërues konstatohet se amendimi i kontratës është nënshkruar më datë 12.05.2022.

Me shkresën nr. 12017 prot., datë 17.06.2022, Ministria e Financës dhe Ekonomisë shprehet dakortësinë në parim.

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit dhe Ministria e Drejtësisë kanë shprehur dakortësinë nëpërmjet sistemit e-akte në lidhje me këtë amendim.

Me shkresën nr.5722 prot., datë 26.07.2022 “Dërgohet për miratim një Projektvendim” MIE dërgon për miratim Projektvendimin për miratimin e amendimit të KNP-së për bllokun 4, shoqëruar me relacion shpjegues.

Me VKM nr.652, datë 10.10.2022 “Për miratimin e amendimit të Kontratës së miratuar me VKM nr. 350, datë 12.06.2018” (botuar në Fletoren zyrtare me nr. 134, datë 12.10.2022), është vendosur periudha e pezullimit për 24 muaj duke filluar nga data 13.05.2022 si dhe gjatë kësaj periudhe kompania do të kryej vetëm punime kërkimi shtesë duke përfshirë përpunimin e të dhënave sizmike, studime gjeologjike dhe punime të tjera të rena dakord midis palëve. Punimet shtesë duhet ti paraqiten AKBN-së për miratim, miratim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

Pagesa e bonusit të nënshkrimit të amendimit 500,000 \$ për AKBN, dhe 1,000,000 \$ do të jenë investime në projekte sociale.

**Gjetja 5:** Në lidhje me praktikën e Amendimit të KNP, u konstatuan:

a. Pezullimi i Periudhës së Parë të Kërkimit (PK1) nuk është parashikuar apo të jetë diskutuar më parë nga EACM më datë 14.12.2021 në lidhje me miratimin e planit të punës dhe buxhetit të vitit 2022. Kompania e lidh pezullimin me Covid 19 (pandemia e vitit 2020) dhe me rritjen e çmimit të energjisë elektrike (periudhe 2020-2021), fakte të njohura për kompaninë por që nuk janë parashtruar para datës 10.03.2022, ose tre muaj para përfundimit të periudhës së parë të kërkimit.

b. Pezullimi si fenomen nuk parashikohet në KNP, as juridikisht dhe as financiarisht.

c. Me shkresën nr. 9, datë 10.03.2022, S. 4, i drejtohet MIE me kërkesën për pezullim pa njoftuar apo vendosur në dijeni AKBN (si autoritet përfaqësues i MIE për zbatim dhe monitorim të KNP), AKBN është vendosur në dijeni më datë 12.05.2022 nga S. 4, datë në të cilën është nënshkruar edhe amendimi i kontratës.

d. Nuk ka negociata mbi kushtet e amendimit të KNP-së, Grupit Negociator i ngritur me Urdhërin nr. 86, datë 04.05.2022, nuk ka të përcaktuar me emra konkret përfaqësuesit e AKBN dhe i përcjell për njohje dhe zbatim me shkresën nr.2301/84 prot., datë 11.05.2022. Amendimi i KNP është dakortësuar dhe nënshkruar në datën 12.05.2022 midis Ministrit i MIE, znj. B. B. dhe Përfaqësuesit Ligjor të S. 4 z. A. M. F. Referuar datave hapësira kohore prej 1 dite (11.05-12.05.2022) e bënë të pamundur njohjen/negocimin dhe dakortësimin e saj.

e. S. 4, AKBN dhe MIE kanë filluar zbatimin e Amendimit të KNP pa pritur miratimin e saj me VKM.

Me shkresën nr. 23, datë 15.05.2024 (protokolluar në AKBN me nr. 2501, datë 15.05.2024) “Njoftim mbi Periudhën e dytë të kërkimit të KNP, Blloku 4”, S. 4 ka njoftuar AKBN se në bazë të nenit 4.1.2, kompania zgjedh të mos hyjë në Periudhën e dytë të kërkimit.

Me shkresën nr. 2501/1 prot., datë 04.06.2024 “Mbi njoftimin për periudhën e dytë të kërkimit të KNP” AKBN, drejtuar S. 4, për dijeni MIE, duke vlerësuar punën dhe bashkëpunimin me kompaninë, ka rikujtuar përmbushjen e angazhimeve të marra nga ana juaj në lidhje me zbatimin e Amendimit të KNP-së, paragrafi 4 te hyrja (investimi prej 1,000,000 USD në projekte të investimeve sociale të lidhura me burimet e rinovueshme dhe tranzicionin energjitik), si dhe depozitimin pranë AKBN-së të studimeve, materialeve dhe të dhënave të pa dorëzuara për Bllokun 4.

**Gjetja 6:** Në lidhje me Programin e punës dhe buxhetet respektive konstatohet se S. 4 gjatë hartimit të programit dhe prezantimin të tij i referohet përdorimit të fjalës së fundit të shkencës dhe teknologjisë së fundit në sektorin hidrokarbur por duke qenë se AKBN si institucion monitorues i zbatimit të kontratës nuk ka çmime reference (module çmimi) gjendet përpara riskut që buxheti i paraqitur është i fryrë për shkak të kostove të larta (pasi teknologjia e fundit kushton) ashtu si edhe gjatë vlerësimit dhe auditimit të situacioneve të kostove të rimbursueshme (cost recovery) të cilat mund të jenë larta.

#### **Situacionet e Veprimtarisë**

Referuar Nenit 4.8 të KNP ku citohet se :

*“Kontraktori do të dorëzojë në AKBN sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga përfundimi i çdo tremujori kalendarik, një situacion të veprimtarisë së kërkimit ku pasqyrohen shpenzimet e kërkimit të bëra dhe të realizuara nga Kontraktori gjatë tremujorit Kalendarik Përkatës (Situacion i Veprimtarisë së Kërkimit). Me shpenzime Kërkimi të bëra dhe të realizuara konsiderohet marrja e faturave të rregullta dhe të pakundërshtueshme nga ofruesit e shërbimeve ose pajisjeve. Regjistrat dhe dokumentet mbështetëse të Kontraktorit duhet të jenë të disponueshëm për inspektim në çdo kohë nga AKBN gjatë orarit të rregullt të punës, për dymbëdhjetë (12) muaj nga data e marrjes së çdo situacioni.*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi përmbushjen e këtij detyrimi u konstatua se shoqëria i ka respektuar afatet e njoftimit dhe dërgimit të informacionit financiarë.

#### **Monitorimi nga AKBN për zbatimin e planit të punës**

**Gjetja 7:** Nga Dokumentacioni i vënë në dispozicion në lidhje me monitorimin na u paraqitën vetëm disa relacione nga Drejtoria Hidrokarbure që i drejtohen Sektorit të Financës si dokument për t’ju bashkangjitur autorizimit të shërbimit që kanë zhvilluar për ecurinë e punimeve sizmike nga Kompania Sh. U. A Blloku 4. Relacionet paraqiten si më poshtë:

1. Relacion i datës 15.04.2021, Për shërbimin e kryer në Tepelenë nga data 06.04.2021-09.04.2021.
2. Relacion i datës 10.05.2021, Për shërbimin e kryer në Gjirokastrë nga data 05.05.2021-07.05.2021.
3. Relacion i datës 31.05.2021, Për shërbimin e kryer në Gjirokastrë nga data 24.05.2021-27.05.2021.
4. Relacion i datës 22.06.2021, Për shërbimin e kryer në Gjirokastrë nga data 15.06.2021-18.06.2021.
5. Relacion i datës 09.07.2021, Për shërbimin e kryer në Gjirokastrë nga data 28.06.2021-01.07.2021.
1. Relacion i datës 24.07.2021, Për shërbimin e kryer në Gjirokastrë nga data 21.07.2021-23.07.2021.
2. Relacion i datës 22.10.2021, Për shërbimin e kryer në Gjirokastrë, Tepelenë, Memaliaj, Këlcyrë, Përmet, Libohovë nga data 18.10.2021-21.10.2021.

Për sa më sipër u konstatua se relacionet e mësipërme janë të përgjithshme, nuk ka konstatime konkrete në lidhje me ecurinë planeve të punës dhe buxhetit si nga ana teknike dhe nga ana financiare në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të AKBN e cila për nga rëndësia është e nivelit lartë.

Në Kuadër të Monitorimit dhe ecurisë së punimeve, ndodhet vetëm një informacion i Drejtorit të Drejtorisë Hidrokarbure i cili me shkresën e brendshme të AKBN nr.2007 prot., datë 20.05.2021 “Informacion mbi ecurinë e punimeve sizmike ne Bllokun 4”, informon titullarin e AKBN mbi ecurinë dhe monitorimin në teren të aktiviteteve dhe punimeve si më poshtë:

*Punimet përgatitore u nisën në muajin Shkurt 2021, ndërsa në muajin Mars sipas parashikimeve u kryen punime topografike në të 145 km. Pas këtij procesi në datën 18.04.2021 kompania zhvilloi një javë testime paraprake të metodës heli-drilling dhe më tej nisi shpimi i*

puseve sizmike në një thellësi prej 12 m. Këto puse do të mbajnë një ngarkesë prej 4 kg eksploziv. Kjo sasi ka ndikim të pa përfillshëm në sipërfaqe. Sa më sipër drejtorja Hidrokarbure ka monitoruar në teren me specialistët e saj dhe ka vënë re:

- Punime topografike janë zhvilluar në përputhje me programin e dërguar në AKBN.
- Logjistika e plotësuar e mjeteve dhe pajisjeve.
- Shpimi nuk gjeneron mbetje apo dëmtim mjedisi.
- Testim i të gjithë pajisjeve gjeofone.
- Zbatimi i masave anticovid.

Sipas informacionit theksohet se aktualisht ka përfunduar shpimi i puseve në linjën 19, në linjat e tjera janë drejt përfundimit, në zonën e Zagorisë linja 11 është në fazë permitimi pas disa problematikash me komunitetin. Drejtori i Drejtorisë ka siguruar titullarin për ndjekje hap pas hapi të programit dhe për ta informuar në vazhdimësi.

**Gjetja 8:** Nga Dokumentacioni i vënë në dispozicion në lidhje me monitorimin u konstatua se: -AKBN si përfaqësues i autoritetit kontraktor në KNP nuk disponon programe apo plane periodike vjetore për të ushtruar kontrole në subjekte, zotërues të lejes Hidrokarbure, konkretisht Sh. A. B.V

-Nuk ka raporte për mbikëqyrjen e përgjithshme apo monitorimin, ku të bëjë krahasime apo vlerësime konkrete të treguesve teknologjike apo të realizimit të investimeve etj. me planet e punës apo buxhetin e miratuar me treguesit e raportuar në situacionet përkatës.

-Nuk u konstatua asnjë ndjekje apo masë e marrë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për rastet e moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve të KNP për Bllokun 4 nga AKBN si përfaqësues i MIE në kontratë.

-U konstatua se KNP, nuk parashikon detaje të kryerjes së Procedurës së Monitorimit si një proces i cili i kushton vëmendje ecurisë së zbatimit të saj, përmbushjes së detyrimeve si dhe arritjes së objektivave të vendosura me synimin rritjen e efikasitetit të operacioneve hidrokarbure.

### **Auditimi**

AKBN ka audituar aktivitetin hidrokarbur të Shoqërisë “Sh. A. B., B.V”, si më poshtë:

- Për periudhën 01.06.2019 - 31.12.2019, auditim i realizuar në vitin 2021
- Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, auditim i realizuar në vitin 2021
- Për periudhën 01.01.2021 - 30.06.2021, auditim i realizuar në vitin 2022
- Për periudhën 01.07.2021 - 31.12.2020, auditim i realizuar në vitin 2022
- Për periudhën 01.01.2022 - 31.03.2022, auditim i realizuar në vitin 2023
- Për periudhën 01.04.2022 - 31.12.2022, auditim i realizuar në vitin 2023

**Për vitin 2019:** Investimet kumulative nga fillimi i kësaj marrëveshje deri me 31.12.2019 janë 1,303,188 USD. Buxheti i paraqitur nga shoqëria dhe i miratuar nga AKBN për vitin 2019 është 2,2 mln USD. Kosto totale e raportuar është në vlerën 923,217 USD, Kosto totale e pezulluar në vlerën 13,251 USD. AKBN, konsideron kosto të pezulluar shpenzimet e kryera nga Kompania New Politics në vlerën 13,251 USD, të cilat i referohen shërbimit për njoftimin në media të dëgjuesave publike për bllokun 4. AKBN vlerëson se monitorimi i medias dhe marrëdhënia me publikun janë investime që kanë të bëjnë me imazhin publik të shoqërisë dhe jo me kryerjen me efektivitet të operacioneve hidrokarbure.

**Për vitin 2020:** Buxheti i paraqitur nga shoqëria dhe i miratuar nga AKBN për vitin 2020 është në vlerën 13,47 milion USD. Kosto totale e raportuar (cost recovery) është në vlerën 1,989,381 USD. Gjatë vitit 2020, shoqëria nuk ka kryer procedure tenderuese apo sponsorizim. Nga totali i koston të raportuar (cost recovery), zërin “Seismic” arrin në vlerën 1,976,498 USD. Kostot e rënduara në kontabilitet përputheshin me tarifat e parashikuara në kontratë.

**Për vitin 2021:** Buxheti i paraqitur nga shoqëria dhe i miratuar nga AKBN për vitin 2021 është në vlerën 16,4 USD. Kosto totale e raportuar (cost recovery) është në vlerën 12,703,831 USD. Kosto totale e pezulluar në vlerën 1,121,227 USD. Nga raportimet cost recovery, gjatë periudhës Q1-Q2 2021 kostot hidrokarbure për Bllokun 4 janë përqëndruar kryesisht në parapërgatitjen për punimet sizmike, ndërsa gjatë periudhës Q3-Q4 2021 kostot hidrokarbure janë përqëndruar kryesisht në kryerjen dhe përfundimin e punimeve sizmike si dhe në përpunimin e materialit fushor sizmik. Në lidhje me Koston Totale të Pezulluar, AKBN sqaron se në raportimet e cost recovery evidentohen 1,095,386 USD kosto hidrokarbure si shërbime nga Kompanitë filiale të shoqërisë Sh. A. , BV sipas parashikimeve të Aneksit C, Neni 6.1 i kontratës me ndarje prodhimi. Shërbimet janë marrë nga shoqëritë Sh. I. L. dhe Sh. I. E. and P. BV. Referuar faturave janë shërbime të punonjësve në këto filiale të cilët një pjesë të kohës së tyre (tarifuar në orë) kanë punuar për projektin e Bllokut 4. Në përputhje me përcaktimet e Nenit 6.1 lidhur me këto shërbime, Kontraktori do i japë AKBN-së një deklaratë auditimi të tillë të pavarur mbi baza vjetore, auditim i cili realizohet nga një zyrë auditimi. Në Kontekst të parashikimeve të KNP, AKBN kërkon nga shoqëria raportin e auditit të pavarur. Nga Shoqëria bëhet me dije se procesi i auditimit të filialeve të Sh. fillon pas përfundimit të vitit fiskal dhe mbyllet së pasqyrave financiare të atij viti.

**Gjetja 9:** Referuar Aneksit C “Procedura kontabël”, pika 3 “Auditimet dhe rregullimet” në lidhje me kostot e kundërshtuara dhe kostot e pezulluara, palët, deri në përfundim të periudhës së auditimit nuk është gjetur një zgjidhje në lidhje me statusin e kostove pezull pasi referuar raporteve të auditimit vlera prej 2,954,441 USD e pagesës së ekspertëve të filialeve të Sh. në vende të tjera për punën e kryer për llogari të Bllokut 4. Në lidhje me këto shërbime kontraktori duhet të paraqesi pranë AKBN një deklaratë auditimi të pavarur mbi baza vjetore, auditim i cili realizohet nga një zyrë kontabiliteti. Deklarata të tilla nuk janë paraqitur nga kontraktori pranë AKBN edhe pse ka kaluar mbi 3 vjet nga konstatimi i këtyre vlerave.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se midis raporteve paraprake dhe raporteve përfundimtare të hartuara nga AKBN ka një afat të gjatë kohor (mbi 1 vit) pasi kontraktori paraqet komentet në lidhje me raportin paraprak në hapësirë kohore të tejzgjatur e cila për nga rëndësia është e nivelit të lartë.

### **Marrëveshjet Hidrokarbure për Bllokun e Dumresë .**

#### **GARANCIA BANKARE**

Referuar pikës 31.3 të KNP, kontraktori duhet të ekzekutojë dhe të dorëzojë pranë AKBN-së brenda 90 ditëve nga data efektive (04.03.2020) një Garanci Bankare për kohëzgjatjen e Periudhës së Kërkimit të lëshuar nga një institucion financiar me reputacion ndërkombëtar, sipas formatit të parashikuar në Aneksin E të KNP-së, forma përfundimtare e së cilës do të pranohet nga AKBN-ja.

Me shkresën e datës 26.05.2020 (protokolluar në AKBN me nr.1625/6, datë 27.05.2020), E. A. B.V., i vë në dispozicion AKBN-së, Garancinë Bankare me nr.G452933, datë 26.05.2020, depozituar pranë bankës “B. B. V. A. S.A, M. B. I.” (hyrë në fuqi më 04 .03.2020) si dhe kërkon nga AKBN-ja konfirmimin e marrjes dhe pranimit të garancisë bankare.

Në lidhje sa më sipër, me shkresën e datës 27.07.2020, (protokolluar në AKBN me nr.1625/11 prot., datë 28.07.2020, B. B. V. A. S.A, M. B. I.” konfirmon lëshimin dhe vlefshmërinë e garancisë bankare me nr.G452933 të lëshuar me 26.05.2020 në interes të E. A. b.v. dhe në favor të AKBN –së.

Kontrata me ndarje prodhimi për Bllokun Dumre është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 187, datë 26.02.2020, botuar në fletoren Zyrtare nr. 27, datë 04.03.2020, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e

Burimeve Natyrore dhe E. A. B.V. Data e publikimit në fletoren zyrtare do të konsiderohet si data efektive e hyrjes në fuqi (04.03.2020).

Me shkresën nr. 1625/1 prot, datë 10.03.2020, AKBN, (vetëm në versionin anglisht) ka njoftuar kompaninë “E. A. B.V.” mbi miratimin e KNP-së për bllokun Dumre, në tokë, si dhe njofton se datat e publikimit në fletoren zyrtare (04.03.2020)do të konsiderohet si data efektive e hyrjes ne fuqi të kësaj kontrate.

Kompania E. A. B.V., është mbajtëse e 100 % të interesave të pjesëmarrjes në këtë kontratë, si dhe Kompania do të paguajë 100 % të gjitha kostove dhe shpenzimeve që lidhen me kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga Zona e Kontratës në bazë të dispozitave të mbulimit të kostos së kësaj kontratë.

Kohëzgjatja e periudhës së kërkimit: 5 vjet nga Data e Hyrjes në Fuqi dhe kontrata mund të zgjatet për dy (2) vite të tjera siç citohet në nenin 4.1.1 të KNP.

Vlera e Investimit për realizimin e Programit Minimal të Punës gjatë Periudhës së Kërkimit për këtë bllok do të jetë 46,000,000 USD si dhe është parashikuar shpimi i një pusi kërkimi. Programi Minimal i Punës do të kryhet do të kryhet si më poshtë:

Periudha e kërkimit	Kohëzgjatja (vjet)	Programin minimal i punës	Angazhimi minimal financiar
Periudha e kërkimit	5	- Vlerësimet G&G	US\$ 5,000,000
		- 200 km ripërpunim sizmik 2D (i mundshëm - jo i angazhuar)	US\$ 1,000,000
		-200 km përvetësim dhe përpunim sizmik 2D	US\$ 4,000,000
		Shpimi i 1 (një) pusi zbulimi	US\$ 35,000,000
		Shpimi pas vlerësimit G&G	US\$ 2,000,000
			<b>US\$ 46,000,000</b>

**Gjetja 1:** Si pasojë e pandemisë Covid 2019 dhe kufizimeve të saj , E. A. b.v, ka regjistruar degën e saj në Shqipëri në QKB 31/03/2021, ndërkohë data efektive është 04.03.2020.

Nga auditimi konstatohet se i gjithë komunikimi dhe KNP me shoqërinë E. A. B. V. është në gjuhën angleze në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimin nr. 4, datë 19.6.2017, neni 4, pika 9, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”.

### **PAGESA E BONUSEVE**

#### **Bonusi i Trajnimit dhe administrativ**

Referuar Nenit 27.3 të KNP Blloku “Dumrea” E. A. B.V, ka kryer të gjitha pagesat si mëposhtë:

Blloku Dumrea -Data e transfertave të bonusit	Afati maksimal ligjor për pagesë	Vlera e paguar usd
2020	06.04.2020	500,000
2021	01.04.2021	500,000
2022	01.04.2022	500,000
2023	03.04.2023	500,000

Nisur sa më sipër pagesa e kryer nga kontraktori për bonusin e trajnimit dhe administrativ për vitet 2021, 2022, 2023 janë kryer brenda afateve ligjore, për vitin 2020 pagesa është bërë dy ditë me vonesë (paguar më 06.04.2020, afati ligjor 04.04.2020), pasi data efektive e kontratës është 04.03.2020 dhe pagesat duhet të kryhen 30 ditë pas fillimit të vitit kontraktual domethënë pagesat duhet të kryhen brenda datës 04 Prill të çdo viti.

Me shkresën nr. 070/2023, datë 30.03.2023 (protokolluar në AKBN me nr. 1793, datë 31.03.2023), “E. A. BV”, kërkon nga AKBN të lëshojë deklaratat e përdorimit nëse fondet janë përdorur sipas qëllimit të bonusit. Në përgjigje, AKBN, me shkresën nr.1793/1 prot., datë 24.04.2023 “Kthim Përgjigje” i drejtohet Kompanisë “E. A. B.V” ku sqaron se fondet e derdhura për periudhën 2020-2022, referuar planifikimit dhe realizimit të buxheteve vjetore të AKBN-së, një pjesë e tyre është përdorur për shpenzime administrative, konsulenca në fushën hidrokarbure, software etj, sipas kërkesave të AKBN-së. Nisur sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi që kjo deklaratë ka vetëm përshkrime të zërave por jo të pasqyruara në vlera për secilin shpenzim të deklaruar.

Në kuadër të trajnimeve profesionale, referuar Nenit 27.4 të KNP-së Blloku “Dumrea” ku citohet se:

*“Kontraktori do të ofrojë programe të tjera trajnimi, kostoja e të cilëve arrin në shumën gjathtëqind mijë dollarë amerikanë (US\$600,000) për çdo vit kontraktual të periudhës së kërkimit. Programi i trajnimit do të përgatitet bashkërisht dhe do të miratohet me bazë vjetore nga Kontraktori dhe AKBN-ja në interes të AKBN-së dhe/ose autoriteteve të tjera shqiptare, dhe/ose personelit të institucioneve, dhe/ose studentëve të universiteteve shqiptare. Gjithashtu, ky program mund të përfshijë trajnime në fushën e industrisë së naftës e gazit, si dhe trajnime profesionale dhe për menaxhimin. Me pjesën e fondit përkatës vjetor që nuk është shpenzuar brenda vitit kontraktual të periudhës së kërkimit, përmes universitetit “E. C.”, mund të organizohet trajnime afatshkurtra dhe afatgjata, të cilat mund të jenë ose standarde ose të porositura dhe mund të zhvillohen për një larmi temash dhe fushash të ekspertizës. Në trajnimet afatshkurtra përfshihen kurset në klasë të organizuara nga universiteti “E. C.”, si dhe seminarët e organizuara nga personeli i po këtij universiteti në mjediset e autoriteteve të përzgjedhura shqiptare. Në trajnimet afatgjata përfshihen trajnimet për menaxhimin, mastera të njohura në shkallë ndërkombëtare dhe trajnime për personelin e universitetit shqiptar, të cilët dëshirojnë t’i pasurojnë njohuritë e tyre për industrinë e naftës dhe të gazit. Trajnimet dhe programet afatgjata mund të ofrohen edhe nga universitete e institucione të tjera si universitetet e Torinos dhe të Peruxhias. Kandidates e propozuar nga AKBN-ja për programet e trajnimit duhet të miratohen edhe nga Kontraktori. Në çdo rast, kostoja do të krahasohet me trajnimet dhe kurset e tjera edukative që kanë të njëjtat standarde”, konstatojmë se sipas një statistike të vënë në dispozicion vlera e trajnimeve të realizuar për vitin 2022 dhe për vitin 2023 paraqitet si më poshtë sipas zërave:*

USD		
Përshkrimi i Zërave	Viti 2022	Viti 2023
Pagës e kursit/trajnimit	233,200	217,080
Dieta ditore	21,950	53,740
Shpenzime për test covid-19	336	-
Akomodim hotel+bileta avioni/treni/etj	90,138	150556
<b>Shuma</b>	<b>345,624</b>	<b>421,376</b>
<b>Nr personave që kane përfituar</b>	<b>102 persona</b>	<b>60 persona</b>

Nisur nga data efektive 04.03.2020, për çdo vit kontraktual AKBN duhej të përfitonte (600,000 \*3 vite) 1,800,000 USD, në fakt vlera gjithsej e realizuar e trajnimeve është 767,000 usd.

**Gjetja 2:** Nga auditimi u konstatua se nga AKBN, nuk u vendos në dispozicion programi i trajnimit mbi baza vjetore i përgatitur bashkërisht (E. dhe AKBN), miratimi i programit (trajnime në fushën e industrisë së naftës e gazit, si dhe trajnime profesionale dhe për menaxhimin), lista e kandidateve të propozuar nga AKBN si dhe miratimet e kësaj liste nga kontraktori, si dhe krahasimet që duhet të bëjë AKBN për efekt kostoje të trajnimeve të ofruara nga kontraktori me trajnimet dhe kurset e tjera edukative që kanë të njëjtat standarde, e cila për nga rëndësia është e mesme.



### **Bonusi i Nënshkrimit të KNP-së**

Bazuar në Nenin 27.1 të KNP Blloku “Dumrea” kompania ka paguar bonusin e nënshkrimit prej 4,000,000 USD më datë 06.04.2020, duke e tejkalluar dy ditë afatin ligjor të pagesës (data efektive 04.03.2020, data pagesës 06.04.2020).

### **Planet e Punës dhe Buxhetet**

**Gjetja 3:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk ka shkresë nga Titullari AKBN-së për të caktuar përfaqësinë si institucion në përbërjen e Komitetit Këshillues si dhe caktimin e Kryetarit të këtij Komiteti siç përcaktohet në nenin 4.6 të KNP ku citohet se:

*“Programi i punës dhe buxheti i kërkimit dhe çdo plan vlerësimi dhe plan zhvillimi do të shqyrtohen nga një komision i përbashkët që do të ngrihet nga AKBN-ja dhe Kontraktori pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj kontrate. Ky komision, të cilit më pas do t’i referohemi si Komiteti Këshillues do të përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, 3 (tre) prej të cilëve do të emërohen nga AKBN-ja dhe 3 (tre) nga Kontraktori. Komiteti Këshillues do të ngrihet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi.*

*Kryetari i Komitetit Këshillues do të caktohet nga AKBN-ja, duke u zgjedhur nga njëri prej anëtarëve të caktuar prej saj”.*

Për nga rëndësia është e nivelit të mesëm.

#### **Për vitin 2020**

Mbledhja e Parë e Komitetit Këshillues nëpërmjet Vidio – Konferencës është mbajtur në datë 08.05.2020 ku morën pjesë përfaqësuesit si më poshtë:

- |               |                 |
|---------------|-----------------|
| 6. A. B. AKBN | 4. A. B. , E.   |
| 7. D. D. AKBN | 5. L. A. , E.   |
| 8. E. K. AKBN | 6. G. C. V. ,E. |

Në kuadër të miratimit dhe diskutimit të Planit të Punës dhe Buxhetit për vitin 2020, ardhur elektronikisht dhe protokolluar në AKBN me shkresën nr.1625/7 prot., datë 28.05.2020 “Miratimi i Planit të Punës dhe buxhetit për vitin 2020” AKBN, shpreh miratimin e këtij Plani dhe Buxheti si dhe gatishmërinë për një bashkëpunim frytdhënës për këtë Projekt. Bashkëlidhur ndodhen edhe minutat e takimit të firmosura nga palët.

**Gjetja 4:** Referuar praktikave të miratimit të planit të punës dhe buxhetit për vitet 2021, 2022 dhe 2023 nuk është respektuar detyrimi ligjor për të paraqitur në AKBN për shqyrtim Planin e Punës dhe Buxhetin prej paktën 3 (tre) muaj para fillimit të çdo viti kalendarik apo të ketë një marrëveshje midis dy palëve për një afat tjetër në kundërshtim me pikën 4.5 të KNP-së Blloku “Dumre”, *“Të paktën 3 (tre) muaj para fillimit të çdo viti kalendarik ose në kohë tjetër, siç mund të bihet dakord reciprokisht nga AKBN-ja dhe Kontraktori, Kontraktori do të përgatisë një program pune dhe buxheti dhe për zonën e kontratës, duke përcaktuar operacionet e kërkimit të cilat Kontraktori planifikon t’i kryejë gjatë vitit pasardhës kalendarik.*

*Çdo program pune dhe buxheti duhet të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit, sipas programit minimal të punës për periudhën që mbulon”,* duke mos pasur hapësirën kohore të nevojshme për të rishikuar dhe analizuar Planin e Punës dhe Buxhetin për vitin pasardhës kalendarik.

Kostot e Raportuara dhe Buxhetet përkatës janë si më poshtë:

Vitet	Raportimet mln CRS	Buxheti mln(USD)
2020	1.025	6.095
2021	1.878	5.417
2022	10.979	12.973
2023	7.913	8.339

Kumulative	21,795	32,824
------------	--------	--------

Në lidhje sa më sipër duke analizuar Programet e Punës dhe Buxhetet konstatohet se ato janë të detajuara në zëra. Gjithashtu duke analizuar shifrat e mësipërme ndërmjet vlerave të Buxhetit të miratuar dhe Raportimit të Shpenzimeve faktike ka një diferencë të madhe edhe pse kontrata ua njeh të drejtën e rishikimit të vlerave të buxhetit e cila mund të kërkohet për arsye operationale ose si rezultat i veprimtarisë së Kërkimit dhe të Vlerësimit.

**Gjetja 5:** Në lidhje me Programin e Punës dhe Buxhetet respektive, konstatohet se E. A. B.V. gjatë hartimit të programit dhe prezantimit të tij i referohet përdorimit të fjalës së fundit të shkencës dhe teknologjisë së fundit në sektorin hidrokarbur, por duke qenë se AKBN si institucion monitorues i zbatimit të kontratës nuk ka çmime reference (module çmimi) gjendet përpara riskut që buxheti i paraqitur është i fryrë për shkak të kostove të larta (pasi teknologjia e fundit kushton) ashtu si edhe gjatë vlerësimit dhe auditimit të situacioneve të kostove të rimbursueshme (cost recovery) të cilat janë të larta.

Nga auditimi konstatohet se ka rishikime të Planit të Punës dhe Buxhetit për vitin 2020 dhe vitin 2021 por këto rishikime janë prezantuar në AKBN në mbledhjen e EACM të zhvilluar në muajin nëntor të viteve respektive duke e humbur kuptimin e rishikimit të buxhetit në fund të vitit (konkretisht rishikim buxheti për vitin 2020 në nëntor 2020, rishikim i buxhetit për vitin 2021 në nëntor 2021) si dhe nuk ka miratim për këto rishikime buxheti.

Nga Dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Komiteti Këshillues (EACM) nuk është mbledhur minimalisht 2 herë në vit siç parashikohet në nenin 4.6 të KNP-së.

#### **Situacionet e Veprimtarisë**

Referuar Nenit 4.8 të KNP shoqëria i ka respektuar përgjithësisht afatet e njoftimit dhe dërgimit të informacionit financiarë që pasqyrojnë Kostot Hidrokarbure në raportimet tremujore në AKBN si më poshtë:

	<i>Data</i>	<i>nr. Prot dërgues</i>	<i>Data e hyrjes</i>	<i>nr. Prot hyrës</i>
<b>Q2 2020</b>	24.09.2020	Email		
<b>Q3 2020</b>	18.11.2020	Email		
<b>Q4 2020</b>	15.02.2021	Email		
<b>Q1 2021</b>	03.05.2021	Email		
<b>Q2 2021</b>	23.07.2021	Email		
<b>Q3 2021</b>	10.11.2021	Email		
<b>Q3 2021 R</b>	24.12.2021	Email		
<b>Q4 2021</b>	24.02.2022	Email		
<b>Q1 2022</b>	30.05.2022	Email		
<b>Q2 2022</b>	31.08.2022	109	02.09.2022	3720
<b>Q2 2022 R</b>	15.06.2023	130	16.06.2023	2914
<b>Q2 2022 R</b>	31.07.2023	146/A	08.08.2023	3673
<b>Q3 2022</b>	30.11.2022	172	01.12.2022	4982
<b>Q3 2022R</b>	30.08.2023	204	01.09.2023	4081
<b>Q4 2022</b>	27.02.2023	52	02.03.2023	1361
<b>Q4 2022 R</b>	30.08.2023	205	01.09.2023	4083
<b>Q1 2023</b>	31.05.2023	112	01.06.2023	2692
<b>Q2 2023</b>	30.08.2023	203	01.09.2023	4082
<b>Q3 2023</b>	24.11.2023	125	30.11.2023	5366

#### **Monitorimi nga AKBN për zbatimin e planit të punës**

**Gjetja 6:** Duke ju referuar sa më sipër, AKBN si përfaqësues i autoritetit në kontratë nuk disponon:

a. Programe apo plane periodike vjetore për të ushtruar kontrolle në subjekte, zotërues të lejes Hidrokarbure, konkretisht E. A..

b. Raporte, relacione për mbikëqyrjen e përgjithshme apo monitorimin, ku të bëjë krahasime apo vlerësime konkrete të treguesve teknologjike apo të realizimit të investimeve etj me planet e punës apo buxhetin e miratuar me treguesit e raportuar në situacionet përkatës.

c. Nuk u konstatua asnjë ndjekje apo masë e marrë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për rastet e moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve të KNP-së për vb e Dumresë nga AKBN si përfaqësues i MIE në kontratë.

d. U konstatua se KNP, nuk parashikon detaje të kryerjes së Procedurës së Monitorimit si një proces i cili i kushton vëmendje ecurisë së zbatimit të saj, përmbushjes së detyrimeve si dhe arritjes së objektivave të vendosura me synim rritjen e efikasitetit të operacioneve hidrokarbure.

### **Auditimi**

Mbështetur në Nenin 15, pika 15.5 të KNP-së , raportet e Auditimit dhe i janë dërguar E. A. me NIPT M11531003C.

Bazuar në nenin 3.1 të Aneksit C “Zëri i kostove në pasqyrën e veprimtarisë së kërkimit dhe vlerësimit do të konsiderohet si një kosto e miratuar pas 12 (dymbëdhjetë) muajsh pas marrjes së pasqyrës nga AKBN-ja, me përjashtim të rastit kur brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve në fjalë AKBN-ja merr një përjashtim me shkrim nga auditi lidhur me këtë pasqyrë, sipas nenit 4.8 të kontratës. Në këtë rast, AKBN-ja dhe Kontraktori do të diskutojnë në kohë dhe do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje, gjatë së cilës Palët në fjalë do të identifikojnë kostot e refuzuara dhe kostot e pezulluara si rezultat i këtij auditi.”

AKBN ka kryer auditimin tekniko – financiar të Shoqërisë “E. A. BV”, për efekt të certifikimit të situacioneve të mbulimit të kostove, si më poshtë:

- Për periudhën Q1 – Q2 i vitit 2020 , auditim i realizuar në vitin 2021
- Për periudhën Q3 – Q4 i vitit 2020, auditim i realizuar në vitin 2021
- Për periudhën Q1 i vitit 2021, auditim i realizuar në vitin 2022
- Për periudhën Q2 – Q4 i vitit 2021, auditim i realizuar në vitin 2022
- Për periudhën Q1 i vitit 2022, auditim i realizuar në vitin 2023
- Për periudhën Q2 i vitit 2022 , auditim i realizuar në vitin 2023
- Për periudhën Q3 i vitit 2022, auditim i realizuar në vitin 2023
- Për periudhën Q4 i vitit 2022, auditim i realizuar në vitin 2024

**Gjetja 7:** Nga data e bërjes efektive të MH 04.03.2020 deri në 31.03.2021 E. S.p.a ka raportuar kosto në vlerën **1,025,037 USD, kjo vlerë** konsiderohet si Kosto e Pezulluar pasi nuk është e raportuar në pasqyrat financiare sipas legjislationit tatimor të degës së hapur ne Shqipëri sepse regjistrimi ne QKB është bërë në 31.03.2021.

**Gjetja 8:** Nga dokumentacioni i vendosur ne dispozicion, konstatohet se midis raporteve paraprake dhe raporteve përfundimtare të hartuara nga AKBN ka një afat të gjatë kohor (mbi 1 vit) pasi kontraktori paraqet komentet në lidhje me raportin paraprak në hapsirë kohore të tejkëqjatur.

### **Marrëveshjet Hidrokarbure për Bllokun F me B. P. A. Ltd.**

#### **1.Faza e Parë e Kërkimit(17.11.2010 - 16.11.2013)**

Në zbatim të Marrëveshjes, Kompania ka kryer dhe përfunduar kërkimin për Fazën e Parë, ku deri në fund të fazës së parë të kërkimit në Bllokun “F” B. ka shpenzuar përafërsisht **6,587,970 USD** si shpenzime kapitale, në këto aktivitete :

- 1.Ripërpunimi, rishikimi dhe analizimi i rreth 700 km në 2D të dhëna sizmike mbi bllokun “F”.
- 2.Përfundimi i një studimi të zgjeruar Gjeokimik mbi Bllokun “F” dhe hedhjen e të dhënave përfundimtare në një CD, e cila i është dërguar AKBN në datën 17.01.2012
- 3.Shpimi i një pusi kërkimi vertikal, 5300, në strukturën e Ardenicës. Gjetja e ranorëve të shumtë më ujë dhe asnjë lloj burimi hidrokarbur. Pusi 5300 u braktis në datën 14 Prill 2012.

4. Shpimi i pusit të dytë të kërkimit 5350 me në fokus zonat turbidite. Pusi u shpua në një thellësi prej 2776 mKB (2693.4 m Thellësi Totale) dhe nuk u gjet asnjë burim hidrokarbur. Me pas shpimet në këtë pus janë pezulluar dhe sonda është larguar në 21.06.2013.

#### **Shpenzime Kapitale Deri në Fund të Fazës së Parë të Kërkimit**

<b>Programi i Fazës së Parë të Kërkimit</b>	<b>Shpenzimet Minimale</b>	<b>Të shpenzuarit deri më 16.11.2013</b>	<b>Mbi/nën</b>
Vlerësimi Gj&Gj (studimi Gjeokimik)	\$ 900,000	\$ 1,021,728	\$ 121,728
Riparimi i të dhënave Sizmike (700 km për 2D)	\$ 100,000	\$ 411,508	\$ 311,508
Pusi i Parë Kërkimor 5300 (2030m THV)	\$ 2,000,000	\$ 2,051,104	\$ 51,104
Pusi i Dytë Kërkimor 5350 (2693m THV)	\$ 2,000,000	\$ 3,103,630	\$ 1,103,630
<b>Shpenzime Total</b>	<b>\$ 5,000,000</b>	<b>\$ 6,587,970</b>	<b>\$ 1,587,970</b>
Programi Trajnues i AKBN (seksioni 6.4)	\$ 257,356	\$ 257,356	\$ -
<b>Totali</b>	<b>\$ 5,257,356</b>	<b>\$ 6,845,326</b>	<b>\$ 1,587,970</b>

Nga të dhënat gjeologo-gjeofizike të marra nga të dy pusët e shpuar, u arrit në përfundimin se në këto puse nuk shfaqen objektet e parashikuara në projekt, kështu që ato rezultuan negative dhe u abandonuan.

Me anë të shkresës Nr. 5897 Prot., datë 07.08.2012, AKBN bie dakort me sugjerimin e kompanisë B. për abandonimin e pusit 5300 në Bllokun F, i kryer në përputhje me klauzolat e parashikuara në Marrëveshjen e Hidrokarbureve. Pas dakortësimit nga AKBN për abandonimin e pusit 5300 në Bllokun F, kompania B. ka dërguar me anë të shkresës nr. 757/12 Prot., datë 17.09.2012, “Planin e Braktisjes” si dhe “Buxhetin e Braktisjes” për miratim nga AKBN. Totali i kostos i parashikuar për këtë procedurë është 4,130,600 lek. AKBN me shkresën nr.5897/1 Prot., datë 26.09.2012 bie dakort me “Planin e Braktisjes” si dhe “Buxhetin e Braktisjes” për pusin 5300 në Bllokun F.

Në datë 24.07.2013 me shkresë nr.768, B. P. i dërgon AKBN-së Planin e Abandonimit të pusit të kërkimit 5350 me arsyetimet teknike përkatëse.

Në përgjigje të kësaj shkrese, AKBN, me shkresën Nr. 5189/1 Prot., datë 06.08.2013, bie dakort me planin tekniko inxhinjeric si dhe atë të braktisjes së pusit 5350 në Bllokun “F”.

Gjithashtu me anë të shkresës nr. 163 Prot., datë 07.02.2014 B. , bazuar në nenin 5.1.1 të kontratës i dorëzon AKBN-së 25% të sipërfaqes të Bllokut F, ku janë përzgjedhur dy zona sipas kordinatave të përcaktuara në shkresë.

Me shkresën nr. 150, datë 04.02.2014 kompania B. P. kërkon :

- Kalimin në Fazën e dytë të kërkimit ;
- Miratimin e Programit të Punës dhe Buxhetit të vitit 2014 ;
- Ekzekutimin dhe dorëzimin në AKBN të Garancisë Bankare për Fazën e dytë të Kërkimit ;
- Lirimin nga ana e AKBN-së të Garancisë Bankare të Fazës së Parë të Kërkimit.

Me shkresën nr. 1961/1 Prot., datë 12.03.2014 AKBN-ja bën me dije kompaninë B. P. se për të miratuar Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2014 pasi të jetë plotësuar detyrimi për dorëzimin e Garancisë Bankare për Fazën e Dytë të Kërkimit dhe pasi të ketë ndërmarrë veprimet e duhura për rehabilitimin e shesheve të puseve 5300 dhe 5350 të shpuara në Bllokun F gjatë fazës së parë.

#### **2.Faza e Dytë e Kërkimit (16.11.2013 – 15.11.2015)**

Në përputhje me parashikimet e marrëveshjes aktualisht, kompania ka përfunduar Fazën e Parë të Kërkimit dhe ka kërkuar zyrtarisht futjen në Fazën e Dytë me datë 08.10.2013.

Hyrja ne Fazën e Dytë, presupozon përmbushjen e të gjitha detyrimeve të Fazës së Parë dhe mandej depozitimim e garancisë Bankare Për Fazën e Dytë.

Kompania ka deklaruar me shkresën Nr.963 Prot., datë 08.10.2013, hyrjen në Fazën e Dytë të Kërkimit dhe për këtë qëllim depozitoi Garancinë Bankare dhe me shkresën Nr.518 Prot., datë 18.04.2014 njofton AKBN për këtë veprim.

Në këto kushte AKBN më shkresën Nr.4956/1 Prot., datë 26.06.2014, ka miratuar kalimin në Fazën e Dytë të Kërkimit, e cila ka një kohëzgjatje prej 2 vjetësh (16.11.2013-15.11.2015) dhe përmbushjen e programit minimal të kësaj faze.

Për fazën e Dytë të Kërkimit, B. deri në datën 30 Shtator, 2014 ka shpenzuar \$1.6 milion USD të cilat lidhen me marrjen e të dhënave sizmike 3D të cilat janë pasqyruar në Tabelën si mëposhtë.

Programi i Fazës së Dytë të Kërkimit	Shpenzimet Minimale	Të shpenzuarit deri më sot 30.09.2014	Mbi/nën
Marrja e të dhënave sizmike 3D	\$ 1,000,000	\$ 1,629,600	\$ 629,600
Pusi i tretë Kërkimit	\$ 2,000,000	\$ 0	(\$ 2,000,000)
Pusi i Dytë Kërkimor 5350 (2693m THV)	\$ 2,000,000	\$ 0	(\$ 2,000,000)
<b>Shpenzime Total</b>	<b>\$ 5,000,000</b>	<b>\$ 1,629,600</b>	<b>(\$ 3,370,400)</b>
Programi Trajnues i AKBN (seksioni 6.4)	\$ 0	\$ 0	\$ 0
<b>Totali</b>	<b>\$ 5,000,000</b>	<b>\$ 1,629,600</b>	<b>(\$ 3,370,400)</b>

Me shkresën Nr. 1521 Prot., datë 14.11.2014, B. ka kërkuar zgjatjen me 1 vit të periudhës së Dytë të Kërkimit. Në lidhje me këtë kërkesë AKBN me anë të shkresës nr. 9931/1 Prot., datë 03.12.2014 është shprehur dakort duke e gjetur atë në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes sipas nenit IV pika 4.1.5 *Në fund të Periudhës së Parë të Kërkimit apo të Periudhës së Dytë të Kërkimit, KONTRAKTORI ka të drejtën, me kusht marrjen e aprovimit nga AKBN-ja, ta zgjasë atë periudhë me një (1) vit. Në këtë rast, kohëzgjatja e Periudhës së Dytë Kërkimore apo të Tretë Kërkimore do të ulet me një vit. Kërkesa për zgjatje të afatit do t'i paraqitet AKBN-së me shkrim të paktën nëntëdhjetë (90) ditë përpara përfundimit të periudhës kërkimore respektive.*

Me këtë zgjatje, Faza e Dytë do të përfundojë në 15.11.2016 dhe nëse kompania do të hyjë në Fazën e Tretë ajo fazë do të jetë vetëm 1 vit dhe do të përfundojë në 15.11.2017.

Për llogari të Fazës së Dytë kompania ka kryer punime sizmike 3D në veri të vendburimit të Patos Marinzës duke filluar në datën 26.07.2014 dhe përfunduar në datë 02.09.2014. U kryen 143 km<sup>2</sup> profile sizmike, nga të cilat 32 km<sup>2</sup> në bllokun F, 62 km<sup>2</sup> në pjesën veriore të Patos Marinzës dhe 30 km<sup>2</sup> në pjesën kryesore të vendburimit të Patos-Marinzës. Identifikimi i prospekteve për shpim ka përfunduar në fund të 6 mujorit të parë 2015. Kompania ka parashikuar të shpoj 2 puse gjatë vitit 2016, një në Q2 2016 (në zonën e Bubullimës) dhe tjetrin në Q4 2016 (në zonën e Kreshpanit). Kompania nuk shprehet në mënyrë të prerë për kohën e shpimit të dy puseve, por e lë të hapur mundësinë e spostimit të tyre në funksion të ndryshimit të çmimit, të sondës në dispozicion dhe interpretimit të të dhënave sizmike. Kosto për operacionet e kërkimit gjatë vitit 2016 parashikohet të shkojë 5.5 milion USD.

AKBN me shkresën Nr. 6106 Prot., datë 12.07.2016 kërkon përmbushjen e detyrimeve të Periudhës së Dytë të Kërkimit në marrëveshjen për Bllokun "F". AKBN shprehet se aktualisht operacionet e hidrokarbureve në Bllokun F ndodhen në Periudhën e Dytë të Kërkimit, e cila përfundon në datë 15.11.2016. Duke ju referuar Nenit 4.12, të Kontratës me Ndarje Prodhimi, Programi i Punës për Periudhën e Dytë të Kërkimit parashikon :

- Kryerjen e punimeve sizmike 3D 20 km<sup>2</sup> ose 2D 50 km<sup>2</sup>, me shpenzime minimale prej 1 milion USD;
- Shpimin e dy Puseve të Kërkimit me thellësi jo më të vogël se 2000 m, me shpenzime minimale prej 4 milion USD.

Deri tani kompania ka përmbushur vetëm detyrimin për kryerjen e punimeve sizmike. Në këto kushte AKBN, duke vlerësuar se Kontraktori ka patur të gjithë kohën e nevojshme për të marrë aprovimin e lejeve të ndryshme dhe realizuar Programin Minimal të Punës për Periudhën e Dytë të Kërkimit, kërkon nga Kontraktori marrjen e masave për përmbushjen e të gjitha detyrimeve për Periudhën e Dytë të Kërkimit, brenda afatit të përfundimit të kësaj periudhe.

Për Fazën e Dytë të Punimeve, kompania B. P. A. L. ka kryer vetëm punimet sizmike 3D me shpenzime minimale prej 1 milion USD.

Bazuar në dokumentacion kompania ka kërkuar përsëri zgjatjen me një vit tjetër të Fazës së Dytë të Kërkimit me shkresën nr. 18 Prot., datë 08.01.2016, kërkesë e cila është e refuzuar nga AKBN-ja me faktin që kjo kërkesë është e pa mbështetur në MH dhe ligjin Hidrokarbur.

AKBN me shkresën nr. 9864/1 Prot., datë 19.12.2016 “Përgjigje shkresës Tuaj Nr. 1198 Prot., datë 09.11.2016, për shtyrjen e Periudhës së Dytë të Kërkimit në Bllokun F” i drejtohet kompanisë B. P. A. L. ku shprehet se: Përfundimisht Periudha e Dytë e Kërkimit ka përfunduar dhe ajo nuk mund të shtyhet më tej.

### **Garancia Bankare**

Në datën 09.06.2011 kompania B. P. A. L. ka depozituar garancinë në vlerën 5,000,000 dollarë, më numër garancie No.114/IBG/2011 e vlefshme deri në 17.05.2014 pranë Raiffeisen Bank.

AKBN me shkresën nr. 1318/1 Prot., datë 20.02.2014 referuar KNP-së , nenit 29.4, AKBN-ja kërkon sa më parë ekzekutimin dhe dorëzimin sa më parë të Garancisë të Fazës së Dytë pasi afati i dorëzimit ka qënë data 17.02.2014.

Kompania B. P. me shkresën nr. 518 Prot., datë 18.04.2014 njofton AKBN për depozitimin e Garancisë Bankare për kalimin në Fazën e Dytë të Kërkimit në Bllokun F, me përfitues AKBN lëshuar nga R. B. Sha në datë 17.04.2014

**Gjetja 1:** Nga grupi i auditimit u konstatua se Garancia Bankare për Fazën e Dytë të Punimeve u depozitua dy muaj me vonesë në kundërshtim me pikën 29.4 të KNP, “*Kontraktori duhet të depozitohet pranë AKBN-së brenda 90 ditëve nga data efektive një garanci bankare për kohëzgjatjen e Periudhës përkatëse të kërkimit që përmbush standardet minimale financiare, sipas formatit të parashikuar në Aneksin E të KNP-së për bllokun F, në tokë. Në rast se KONTRAKTORI vendos të hyjë në çdo njëerën prej Periudhave pasuese të Kërkimit, KONTRAKTORI do të ekzekutojë dhe dorëzojë në AKBN, jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas një vendimi të tillë, një Garanci Bankare në formën e dokumentit bashkangjitur dhe të bërë pjesë të kësaj Kontrate si Aneks "E"*”, për nga rëndësia është e nivelit të lartë. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi AKBN.

Në datë 31.10.2016 me shkresë nr. 7674/4 Prot., AKBN për konfirmimin e pranimin të Amendimin nr. 2 të Garancisë Bankare Nr. 154/CBG/2014, datë 17.04.2014, me aplikant Kompaninë B. P. A. Ltd., me vlerë USD 5,000,000 me vlefshmëri deri në 17.05.2016, ndryshuar me Amendimin nr.1 me vlefshmëri deri në 17.05.2017, përfitues AKBN jep miratimin e saj për amendimin e Garancisë Bankare dhe reduktimin e shumës së kësaj Garancie nga USD 5,000,000 në USD 4,000,000 për përmbushjen pjesërisht të detyrimeve Të Programit Minimal të Punë për Periudhën e Dytë të Kërkimit sipas paragrafit në Aneksin “E” të KNP ku citohet :

*“Shuma e kësaj Garancie do të reduktohet çdo muaj ose tremujor, siç do të bihet dakort me AKBN....si detyrim i Programit të Punës gjatë këtij muaji ose tremujor, reduktime që do të bëhen në përputhje me evidencat e shkruara....”*

Nga ndjekja e zbatimit të Marrëveshjes Hidrokarbure dhe auditimin tekniko-financiar të kompanisë B. P., për operacionet Hidrokarbure të realizuara në Bllokun F, për llogari të Fazës së Dytë të Kërkimit, kompania ka kryer punimet sizmike 3D.

Meqënëse Kontraktori nuk ka arritur të përfundojë detyrimin kontraktual të fazës së dytë, vlera prej 2,505,526 USD ( 4,000,000 USD-1,494,474 USD) duhet ti paguhet AKBN-së nëpërmjet Garancisë Bankare.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion kjo pagesë është bërë në llogari të AKBN-së në vlerën 2,505,526 USD me datë 04.04.2017.

### **Bonusi i nënshkrimit.**

**Gjetja 2:** Data efektive e KNP për Bllokun F është 17.11.2010. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, kompania e ka kryer pagesën e Bonusit në dy vlera pjesore, respektivisht në datën 21.12.2010 është paguar vlera 399,848 USD dhe në datën 02.02.2011 është paguar në vlerën 599,839 USD “Kjo vlerë është jashtë afatit ligjor të përcaktuar në KNP”(17.11.2010 deri në 17.01.2011) në kundërshtim me Nenin XXVII për Pagesën e Bonuseve pika 27.1 të KNP, ku citohet se : *“KONTRAKTORI do t'i paguajë AKBN-së vetëm një herë një bonus nënshkrimi në shumën totale prej një milion Dollarësh Amerikanë (US\$1,000,000). KONTRAKTORI do t'a paguajë shumën totale prej një milion Dollarësh Amerikanë (US\$1,000,000) Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve mbas Datës Efektive.”*, për nga rëndësia është e nivelit të lartë. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi AKBN.

### **Fondet e Kualifikimit**

**Sipas Nenit XVI pika 16.4** KONTRAKTORI do të bashkëpunojë me AKBN për programet e kualifikimit duke shpenzuar deri në një qind mijë Dollarë Amerikane (100,000 US\$) për fondet e kualifikimit gjatë çdo Viti Kontraktual te Periudhës Kërkimit.

16.4.1 Fondet e kualifikimit duhet të përdoren për:

- a) blerjen për AKBN të literaturës teknike të avancuar, të dhënave, software, hardware dhe pajisjeve teknike apo shërbimeve sipas kërkesës së AKBN.
- b) dërgimin e personelit të AKBN në kurse të zgjedhura në fushën e shkencave të hidrokarbureve, në inxhinieri dhe menaxhim; dhe
- c) mbulimin nga AKBN të shpenzimeve administrative lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate.

16.4.2 Në rast se KONTRAKTORI në fund të Vitit Kontraktual nuk ka shpenzuar një qind mijë Dollarë Amerikane (100,000 US\$) sipas Nenit 16.4.1, atëherë KONTRAKTORI me kërkesë të AKBN duhet të transferojë shumën e mbetur në llogarinë bankare të AKBN.

16.4.3 Në rast se këto periudha nuk fillojnë në fillim ose nuk mbarojnë në fund të një Viti të plotë Kontraktual, këto fonde do të rillogariten respektivisht.

**Gjetja 3:** Nga auditimi u konstatua se përgjithësisht janë respektuar afatet ligjore me përjashtim të vitit 2013 është bërë në vitin 2015 në kundërshtim me Nenin XVI pika 16.4 të KNP, për nga rëndësia është e nivelit të mesëm. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi AKBN..

Në lidhje me vitin 2011 sqarojmë se kompania ka përmbushur këtë detyrim 29,990 USD si pagesë në llogarinë bankare të AKBN, ndërsa shuma prej 70,000 USD është përmbushur nga kompania në pajisje kompjuteri për AKBN, të dokumentuar me faturë tatimore shitje datë 02.12.2011 dhe fletë hyrje nr. 61 datë 02.12.2011.

### **Planet e Punës dhe Buxhetet**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, AKBN ka respektuar detyrimin ligjor në zbatim të neni 4.6 të KNP ku citohet se:

*“Programi i Punës dhe Buxheti i Kërkimit dhe çdo Plan Vlerësimi dhe Plan Zhvillimi do të shqyrtohen nga një komitet i përbashkët që do të ngrihet nga AKBN dhe KONTRAKTORI pas Datës Efektive të kësaj Kontrate. Ky komitet, këtu më pas i referuar si "Komiteti Këshillimor i Kërkimit" do të përbëhet prej gjashtë (6) anëtarësh, tre (3) prej të cilëve do të caktohen nga AKBN dhe tre (3) nga KONTRAKTORI. Kryetari i Komitetit Këshillimor të Kërkimit do të*

*caktohet prej AKBN nga njëri prej anëtarëve të caktuar prej saj. Komiteti Këshillimor i Kërkimit do të ngrihet brenda tridhjetë (30) Ditësh nga Data Efektive. Komiteti Këshillimor i Kërkimit do të mbledhet të paktën dy herë në çdo Vit Kalendarik nëse nuk bihet dakort ndryshe nga Operatori dhe AKBN...”.*

**Gjetja 4:** Për çdo mbledhje të bërë të Komitetit Këshillimor të Kërkimit, nga AKBN dhe Kontraktori është respektuar neni IV pika 4.6 e KNP për Programin e Punës dhe Buxheti duke dërguar përfaqësuesit e tyre sipas përcaktimit të nenit, por numri i mbledhjeve të bëra në vit janë një dhe jo të paktën dy herë në vit kalendarik siç e parashikon ky nen, për nga rëndësia është e nivelit të mesëm. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi AKBN.

Mbledhjet e Komitetit Këshillimorë	
Data	Mbledhja
24.02.2011	Komitetit Këshillimor EACM#1
03.11.2012	Komitetit Këshillimor EACM#2
06.12.2013	Komitetit Këshillimor EACM#3
28.01.2014	Komitetit Këshillimor EACM#4
01.12.2014	Komitetit Këshillimor EACM#5
01.12.2015	Komitetit Këshillimor EACM#6
06.07.2016	Komitetit Këshillimor EACM#7

**Gjetja 5:** Referuar pikës 4.6 të sipërcituar dhe 4.5 të KNP, ku citohet se : *“Të paktën tre muaj përpara fillimit të çdo Viti Kalendarik apo në kohën kur mund të bihet dakort ndryshe midis AKBN-së dhe Kontraktorit, Kontraktori do të përgatisë një Program Pune dhe buxhetin përkatës për zonën e Kontratës, duke specifikuar Operationet e Kërkimit që Kontraktori planifikon të realizojë gjatë vitit Kalendarik pasardhës”*, nuk është zbatuar afati i përcaktuar në KNP. Përkatësisht për programet e mëposhtëm :

- Me anë të shkresës Nr.5691 Prot., datë 10.10.2013 ,drejtuar B. P. A. Ltd, AKBN kërkon programin e punës sipas parashikimeve në Marrëveshje, mbështetur në pikat 4.5 dhe 4.6 të Marrëveshjes.
  - Programit i Punës dhe Buxhetit të vitit 2014 është dërguar nga B. P. në datë 23.10.2014 me nr. 6971 Prot.
  - Programit i Punës dhe Buxhetit të vitit 2015 është dërguar nga B. P. në datë 21.11.2014 me nr. 1567 Prot.
  - Në datë 12.11.2015 me shkresë nr. 1650 Prot., kompania B. ka dërguar draftin për Programin e Punës dhe Buxhetit të vitit 2016.
- Për nga rëndësia është e nivelit të lartë.

### **Situacionet e Veprimtarisë**

Raportimet e B. P. A. L. për situacionet e Aktivitetit mbi shpenzimet e kërkimit janë si më poshtë:

<i>Periudha</i>	<i>Data e hyrjes AKBN</i>	<i>Nr. Prot hyrës AKBN</i>	<i>Afati Ligjor</i>
<b>Q1 2012</b>	mungon	mungon	31.05.2012
<b>Q2 2012</b>	03.09.2012	6573	31.08.2012
<b>Q3 2012</b>	mungon	mungon	30.11.2012
<b>Q4 2012</b>	19.02.2013	1769	28.02.2013
<b>Q1 2013</b>	mungon	mungon	
<b>Q2 2013</b>	mungon	mungon	
<b>Q3 2013</b>	mungon	mungon	
<b>Q4 2013</b>	mungon	mungon	
<b>Q1 2014</b>	mungon	mungon	
<b>Q2 2014</b>	18.08.2014	7421	31.08.2014



Q3 2014	mungon	mungon	
Q4 2014	02.03.2015	2783	28.02.2015
Q1 2015	08.06.2015	5941	31.05.2015
Q2 2015	17.08.2015	7808	31.08.2015
Q3 2015	17.11.2015	9863	30.11.2015
Q4 2015	18.02.2016	2090	28.02.2016
Q1 2016	16.05.2016	4219	31.05.2016
Q2 2016	18.08.2016	7441	31.08.2016
Q3 2016	23.11.2016	1286	30.11.2016
Q4 2016	27.02.2017	2034	28.02.2017

**Gjetja 6:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi përmbushjen e këtij detyrimi u konstatua se shoqëria për periudhat **Q1 2012, Q3 2012, Q1 2013, Q2 2013, Q3 2013, Q4 2013, Q1 2014, Q3 2014** nuk ka sjellë raportime të situacioneve të Aktivitetit të Kërkimit, ndërsa për periudhat e tjera raportimet e situacioneve përgjithësisht kanë respektuar afatet ligjore në kundërshtim me Nenin 4.8 të KNP ku citohet se :

*KONTRAKTORI do t'i japë AKBN-së, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) Ditë nga fundi i çdo Tremujori Kalendarik, një situacion të Aktivitetit të Kërkimit, që tregon Shpenzimet e Kërkimit të bëra dhe të realizuara nga KONTRAKTORI gjatë atij Tremujori Kalendarik. Regjistrat dhe dokumentet mbështetës të KONTRAKTORIT do të vihen në dispozicion për inspektim nga AKBN në çdo kohë gjatë orarit zyrtar të punës për tre (3) Muaj nga data e marrjes së çdo situacioni, për nga rëndësia është e nivelit të lartë. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi AKBN.*

### **Monitorimi nga AKBN për zbatimin e planit të punës**

Nga Dokumentacioni i vënë në dispozicion në lidhje me monitorimin na u paraqitën dokumentacionet e mëposhtme :

Nga AKBN është ngritur një grup monitorimi për monitorimin e aktivitetit të kryer nga kompania B. P. në Bllokun F dhe plotësimin e detyrimeve për Fazën e Parë të kërkimit në datat 27 dhe 28.02.2014, me përbërje grupi :

- K. G. - Drejtor i Drejtorisë Hidrokarbure
- A. H. - Shef i Sektorit të Monitorimit
- A. M. - Specialist në Sektorin e Monitorimit
- V. K. - Specialist në Sektorin e Marrëveshjeve

Në përfundim të këtij monitorimi për operacionet e kryera në Bllokun F u konstatuan përfundimet e mëposhtme :

- Ka mospërputhje midis faktit dhe parashikimit në shpimin e puseve 5300 dhe 5350. Specifikisht për pusin 5300, kolonat janë ulur me ndryshime nga projekti, në vend të kolonës 139.7mm, 25.3 kg/m, L-80 u ul 177.8 mm 34.2 kg/m, J-55, ndërsa për pusin 5350 thellësia e shpuar në fakt është 166m më shumë, ndryshime ka dhe për thellësinë e uljes së kolonës 177.8mm, nga 2050mKB e projektuar në 2307.5mKB faktike.
- Planet për abandonimin e puseve 5300 dhe 5350, janë dërguar në AKBN dhe janë aprovuar me dok nr. 5897 Prot., datë 07.08.2012 për pusin 5300 dhe nr. 5189/1 Prot., datë 06/08/2013 për pusin 5350. Planet e abandonimit janë realizuar në përputhje me programet e miratuara.
- Rehabilitimi i tokës nuk është bërë, por janë paguar fermerët për këtë shërbim, të cilat kanë lëshuar Deklarata ( 11deklarata për pusin 5300 dhe 4 deklarata për pusin 5350), nëpërmjet të cilave kanë marrë përsipër që ta kryejnë vetë këtë proces dhe deklaruar që nuk kanë asnjë pretendim të çfarëdo lloji kundrejt B. P..

**Gjetja 7:** Nga monitorimi i bërë nga grupi i punës i ngritur në AKBN për verifikimin e plotësimit të detyrave të Fazës së Parë, rezultoi se rehabilitimi i tokës mbas abandonimit të

puseve 5300 dhe 5350 nuk është bërë nga Kontraktori B. P., por janë paguar fermerët për këtë shërbim, të cilat kanë lëshuar Deklarata ( 11deklarata për pusin 5300 dhe 4 deklarata për pusin 5350), nëpërmjet të cilave kanë marrë përsipër që ta kryejnë vetë këtë proces dhe deklaruar që nuk kanë asnjë pretendim të çfarëdo lloji kundrejt B. P., në mospërputhje me Nenin V pika 5.6 ku citohet se : *“Përpara së të hiqet dorë nga ndonjë pjesë e Zonës së Kontratës në të cilën janë kryer Operacione Hidrokarbure, KONTRAKTORI do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të eliminuar çdo impakt negativ të konsiderueshëm ndaj ambientit të shkaktuar nga Operacionet Hidrokarbure, të gjitha këto në masën e nevojshme sipas kërkesave ligjore në fuqi në Datën Efektive dhe të abandonojë Zonën e Kontratës në përputhje më një Plan Abandonimi të paraqitur dhe miratuar nga AKBN-ja, aprovim i cili nuk do të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme.”*

### **Auditimi i Aktivitetit të Zhvillimit**

Grupit të auditimit ju vu në dispozicion tabela e mëposhtme e auditimit të periudhave të operimit të Kontraktorit në Bllokun F.

#### **Kompania B. P. A. LTD, Blloku F**

**(USD)**

<b>Nr. Prot.</b>	<b>Data</b>	<b>Raport</b>	<b>Periudha e Auditimit</b>	<b>Kosto totale e raportuar /vjetore USD</b>	<b>Kostot e periudhës objekt auditit</b>	<b>Kosto totale refuzuar USD</b>
6257	30.09.2013	Pas Objeksioneve	<b>2011</b>	<b>1,454,362</b>	1,454,362	-
6257	30.09.2013	Pas Objeksioneve	<b>2012</b>	<b>2,174,500</b>	2,174,500	-
			<b>2013</b>	<b>3,227,126</b>		
6257	30.09.2013	Pas Objeksioneve	Q1 ,2013	133,826	133,826	-
			Q2,2013		-	Nuk është audituar
2120/3	16.05.2014	Pas Objeksioneve	01.07.2013-16.11.2013	2,422,629	2,422,629	545,856
			16.11.2013-31.12.2013		-	Nuk është audituar
			<b>2014</b>	<b>1,709,629</b>		
			Q1-Q2 2014		-	Nuk është audituar
1900/4	21.08.2015	Pas Objeksioneve	Q3 2014	1,384,000	1,384,000	220,024
			Q4 2014		-	Nuk është audituar
			<b>2015</b>	<b>226,852</b>		Nuk është audituar
			<b>2016</b>	<b>364,393</b>		Nuk është audituar
			<b>Kosto Totale</b>	<b>9,156,862</b>	<b>7,569,317</b>	<b>765,880</b>

Nisur nga tabela e mësipërme, kostot e hidrokarbureve në total të shpenzuar nga kompania B. P. A. Ltd. për të gjithë periudhën e kërkimit në zonën e Bllokut F është në vlerën **9,156,862 USD**, ndërkohë vlera e audituar e këtyre kostove nga AKBN është **7,569,317 USD**, pra **82.66%** e koston totale. Nga vlera e audituar vetëm **765,880 USD** është kosto e refuzuar, pra **8.36%** e koston totale të deklaruar nga kompania B. P..

**Gjetja 8:** Nuk ka auditime për situacionet e shpenzimeve për vitet **2015** dhe **2016**, ndërsa për vitin **2013** nuk është audituar periudha **Q2** dhe **16.11.2013-31.12.2013**. **Për vitin 2014** nuk janë audituar periudhat **Q1, Q2, Q4** si dhe për periudhat e audituara në vitin **2011** dhe **Q1 2012**

janë kryer jashtë afateve ligjore të përcaktuara në KNP, ku tejkalimi i këtyre afateve sjellë që AKBN të humbë të drejtën e shprehjes në lidhje me statusin e Kostove të Raportuara në kundërshtim me Nenin 4.2 të Aneksit C “PROCEDURA E KONTABILITETIT” ku citohet se: *Çdo zë i koston në një Situacion të Aktivitetit të Zhvillimit do të gjykohet në mënyrë përfundimtare si Kosto e Miratuar pas dymbëdhjetë (12) Muajsh në vijim të marrjes së atij Situacioni nga AKBN, nëse brenda dymbëdhjetë (12) Muajve në fjale AKBN nuk i përjashton nëpërmjet revizionimit me shkrim të tyre. Në rast se AKBN bën përjashtime të tilla nëpërmjet revizionimit me shkrim, AKBN dhe KONTRAKTORI do të bisedojnë në kohë dhe do të përpiqen të arrijnë një zgjidhje, gjatë së cilës Palët në fjalë do të identifikojnë Kostot e Refuzuara dhe Kostot e Pezulluara që rezultojnë nga një revizion i tillë. Dokumentacioni dhe llogaritë mbështetëse do t'i mundësohen AKBN gjatë periudhës së dymbëdhjetë (12) Muajve në fjalë.* Për nga rëndësia është e nivelit të lartë. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi AKBN.

### **Mbyllja e Marrëveshjes**

Praktika e mbylljes së marrëveshjes ka nisur me një kërkesë me shkresën nr. 1198 Prot., datë 09.11.2016 (Kërkesë për shtyrjen e periudhës së Dytë të Kërkimit në Bllokun F) të dërguar nga kompania B. P. pranë AKBN (Protokolluar me nr. 9864 Prot., datë 11.11.2016) në të cilën kërkon shtyrjen e Periudhës së Dytë të Kërkimit. B. P. A. L. e mbështet kërkesën me argumentin se nuk ka përmbushur detyrimin për shpimin e dy puseve, e parashikuar në kontratë, pasi nuk ka arritur të marrë në kohë lejen përkatëse nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit të Republikës. Gjithashtu kompania paraqet si argument për mospërmbushjen e detyrimit edhe faktin e ndërrimit të stafit menaxhues të kompanisë i cili kërkon kohë për tu familjarizuar me këtë projekt si dhe stinën e reshjeve që po vjen, fakt i cili do të pengojë realizimin e shpimit.

Në lidhje sa më sipër, Drejtoria e Hidrokarbureve pranë AKBN ka përgatitur një memo me shkresën e brendshme nr. 1860 Prot., datë 23.11.2016 ku informon Drejtorin Ekzekutiv të AKBN ku shprehet se :

Faza e Dytë e Kërkimit kishte një kohëzgjatje prej dy vjetësh. Ka filluar me 16.11.2013 dhe duhet të përfundonte me 16.11.2015, por B. P. A. L. me shkresën nr. 1521 Prot., datë 14.11.2014 kërkon zgjatjen me një vit e cila është miratuar nga AKBN me shkresën nr. 9931/1 Prot., datë 3.12.2014. Me këtë zgjatje Faza e dytë do të përfundojë me 15.12.2016. Bazuar në dokumentacion kompania ka kërkuar përsëri zgjatjen me një vit tjetër të Fazës së Dytë të Kërkimit me shkresën nr. 18 Prot., datë 08.01.2016, kërkesë e cila është e refuzuar nga AKBN-ja me faktin që kjo kërkesë është e pa mbështetur në MH dhe ligjin Hidrokarbur. Po ti referohemi KNP në lidhje me realizimin e Programit Minimal, kompania ka kryer vetëm punimet sizmike 3D, të cilët kanë përfunduar në 2.09.2014. Janë kryer 143 km<sup>2</sup> profile të reja sizmike dhe më tej kompania bëri interpretimin e tyre dhe projektoi shpimin e puseve. Pavarësisht se në programet vjetore të miratuara është planifikuar dhe miratuar shpimi i tyre, kompania nuk e ka realizuar këtë detyrim kontraktor. Në lidhje me këtë konstatim, AKBN i është drejtuar disa herë kompanisë dhe ka kërkuar marrjen e masave për përmbushjen e detyrimeve ligjore të Periudhës së Dytë të Kërkimit. Lidhur me faktin se periudha e Dytë e Kërkimit do të përfundonte në 15.11.2016, si dhe duke pasur parasysh parashikimet e Nenit 4.1.3 të KNP, i cili obligon kompaninë që një muaj para përfundimit të një Faze duhet të njoftojë AKBN nëse do të ushtrojë të drejtën për të hyrë në fazën tjetër të kërkimit. Në lidhje më këtë kërkesë nuk ka përgjigje nga kompania.

Në lidhje me praktikën e mësipërme, AKBN me shkresën nr. 8642/1 Prot., datë 02.11.2016 bazuar në Nenin 4 pika 4.5 i kërkon kompanisë të dorëzojë Programin e Punës dhe Buxhetin për vitin 2017. Edhe për këtë shkresë AKBN nuk ka marrë përgjigje nga kompania.

Çështja e shpimit të dy puseve është ngritur dhe në mbledhjen e EACM#7 më datë 6.06.2016, por nuk u arrit të merret një vendim nga palët.

Në përfundim sa mësipër, Drejtoria e Hidrokarbureve del në përfundimet e mëposhtme :

- Kompania ka pasur të gjithë kohën e nevojshme për të marrë aprovimin e lejeve të ndryshme dhe për të realizuar Programin Minimal të Periudhës së Dytë të Kërkimit, sepse më datë 02.09.2014 kompania ka përfunduar punimet sizmike 3D, kështu kompania ka pasur kohë të përpunojë dhe të interpretojë të dhënat për të konkretizuar shpimin e dy puseve si dhe faktit që Faza e Dytë e Kërkimit nga 2 vjet u zgjat në 3 vjet.

- Në lidhje me lejen që kompania ka aplikuar në datë 08.07.2016 pranë Këshillit Kombëtar i Rregullimit të Territorit, nuk është njoftuar AKBN/MEI për të lehtësuar procedurat burokratike për miratimin në kohë, si dhe faktit kompania duhet të kishte në konsideratë faktin që ky këshillë kryesohet nga kryeministri si dhe ka një axhendë ku mblidhet jo më shumë se dy ose tre herë në vit.

Në lidhje sa mësipër me argumentimin që B. P. A. L. ka bërë për shtyerjen e Fazës së Dytë duke u bazuar në Nenin 20 të KNP (Forca Madhore), Drejtoria e Hidrokarbureve del në konkluzionin se ky argument nuk është bindës nëse i referohemi ecurisë së kësaj marrëveshje dhe për më tepër kërkesa për shtyerjen e Fazës së Dytë ka ardhur në AKBN me datë 11.11.2016 vetëm katër ditë para se të përfundojë kjo Fazë (15.11.2016).

Duke u bazuar në këtë Memo, AKBN me shkresën nr. 9864/1 Prot., datë 19.12.2016 “Përgjigje shkresës Tuaj Nr. 1198 Prot., datë 09.11.2016, për shtyerjen e Periudhës së Dytë të Kërkimit në Bllokun F” i drejtohet kompanisë B. P. A. L. ku shprehet se: Përfundimisht Periudha e Dytë e Kërkimit ka përfunduar dhe ajo nuk mund të shtyhet me tej.

Duke marrë shkas nga ky vendim, AKBN me shkresën nr. 842 Prot., datë 20.01.2017 në kuadrin e ecurisë së zbatimit të KNP ka rishprehur mosrealizimin e Programit Minimal për Fazën e Dytë si dhe ka kërkuar nga kompania që të zbatohet paragrafi i fundit i Nenit 4.1.5 të KNP, ku parashikon se çfarë duhet të bëjë kontraktori në këtë rast. Në lidhje më sa mësipër, AKBN kërkon nga kompania të informohet në lidhje me statusin e operacioneve të KNP për Bllokun F.

Në lidhje me përfundimin e Marrëveshjes Hidrokarbure për Bllokun F me kompaninë B. P., Drejtori Ekzekutiv me urdhërin nr.123, datë 30.01.2017 “Për Ngritjen e Grupit të Punës për Auditimin dhe realizimin e Programit Minimum të Punës Për Periudhën e Dytë të Kërkimit në Bllokun “F” Nga Kompania Hidrokarbure B. P. A. Ltd” ka urdhëruar :

1. Ngritjen e Grupit të Punës për Auditimin mbi realizimin e programit Minimum të Periudhës së Dytë të Kërkimit në Bllokun F më përbërje :

- Z. A. B. Spec. në Drejtorinë Hidrokarbure
- Znj. B. B. Spec. në Drejtorinë Ekonomike
- Z. V. H. Spec. në Drejtorinë Hidrokarbure

2. Grupi i Punës do të auditojë realizimin e Programit Minimum të punës në zbatim të KNP neni 4 pika 4.1.1 dhe 4.1.2.

3. Grupi i Punës do të realizojë aprovimin për kreditimin e punëve shtesë dhe shpenzimeve të realizuara gjatë Periudhës së Parë të Kërkimit, Periudhës së Dytë të Kërkimit.(Pika 4.1.1)

4. Në përfundim Grupi i Punës do të paraqesë për shqyrtim dhe miratim pranë Drejtorit Ekzekutiv raportin e përgatitur.

AKBN me shkresën nr. 1807/1 Prot., datë 22.02.2017, i ka përcjellë kompanisë raportin për kontrollin dhe aprovimin e kreditimit të punëve shtesë dhe shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës së Parë që do të transferohen në Periudhën e Dytë të Kërkimit sipas Nenit IV të KNP. Pasqyrimi i kreditimit të shpenzimeve është i detajuar si më poshtë:

Programi i Fazës së Parë të Kërkimit (3 vjet) 17.11.2010-17.11.2010	Shpenzimet Minimale	Cost Recovery	Kosto pezulluara nga AKBN	Kosto pas zbritjes së AKBN	Kredimi i B. P. A. L. nga Faza e parë në fazën e dytë
Vlerësimi Gj&Gj (studimi Gjeokimik)	\$ 900,000	\$ 1,021,728		\$ 1,021,728	\$ 121,728
Riparimi I të dhënave Sizmike (700 km për 2D)	\$ 100,000	\$ 411,508		\$ 411,508	\$ 311,508
2 puse kërkimi	\$ 4,000,000	\$ 5,154,734	\$ 93,496	\$ 5,061,238	\$ 1,061,238
<b>Shpenzime Total</b>	<b>\$ 5,000,000</b>	<b>\$ 6,587,970</b>	<b>\$ 93,496</b>	<b>\$ 6,494,474</b>	<b>\$ 1,494,474</b>

Kompania në përfundim të fazës së dytë nuk e ka përbushur Programin Minimum të punës për dy pusët e kërkimit në vlerën 4,000,000 USD dhe sipas Nenit IV pika 4.1.1 i lind e drejta të kreditorëve çdo punë kërkimi shtesë që tejkalon Programin Minimum të shpenzimeve përkundrejt detyrimeve minimale të punës së Kontraktorit në periudhat pasardhëse nga faza e parë në fazën e dytë në vlerën **\$ 1,494,474 USD**. Meqënëse Kontraktori nuk ka arritur të përfundojë detyrimin kontraktual të fazës së dytë, vlera prej 2,505,526 USD ( 4,000,000 USD-1,494,474 USD) duhet t'i paguhet AKBN-së.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion kjo pagesë është bërë në llogari të AKBN-së në vlerën 2,505,526 USD me datë 04.04.2017.

Duke qënë se kompania nuk do të ushtrojë të drejtën për tu futur në periudhën e tretë të kërkimit, AKBN nëpërmjet shkresës nr. 2274 Prot., datë 09.03.2017 ka kërkuar nga kompania respektimin e Nenit 24.1 të KNP i cili parashikon :

*“Kjo Kontratë mund të zgjidhet nga KONTRAKTORI duke dhënë njoftim me shkrim AKBN jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para, me kusht që asnjë zgjidhje nuk e liron KONTRAKTORIN nga ndonjë angazhim i papërbushur apo detyrim tjetër i lindur para kësaj zgjidhje....”*

Gjithashtu Neni 15.5 i KNP që parashikon :

*“KONTRAKTORI do t'i japë AKBN rregullisht kopje të gjithë dokumentacionit teknik (duke përfshirë, por pa u kufizuar në shiritat fushore sizmike, raportet gjeologjike e gjeofizike, karrotazhet dheurvejimet e puseve, informacion dhe interpretim të tyre) që janë në dispozicion të KONTRAKTORIT, duke përfshirë testet e kampioneve, që lidhen me Operacionet Hidrokarbure në kuadrin e kësaj Kontrate....”* Konkretisht dorëzimin e një kopje të printuar dhe elektronikisht të studimeve që ka realizuar kompania gjatë Periudhës së Dytë të Kërkimit të cilat nuk i ka dorëzuar më parë. Gjithashtu, AKBN kërkon që ti vihen në dispozicion lista totale e aseteve të krijuara nga B. P. A. L., për realizimin e kësaj kontrate që nga fillimi i saj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, Kompania B. P. A. L. me shkresën nr.215/1 Prot., datë 04.05.2017 i ka dorëzuar bashkangjitur të dhënat në lidhje me perspektivat e shpimit të puseve F53a/5063 dhe AT76a/5064 si dhe listën totale të aseteve të vëna në dispozicion për zbatimin e kësaj kontrate që në fillim deri në përfundim, si në versionin elektronik dhe të printuar.

Me përfundimin e Marrëveshjes për Bllokun F, AKBN referuar MH ka detyrimin të shprehet ndaj kompanisë B. P. A. L. në lidhje me përbushjen e detyrimeve që parashikon MH, të cilën e ka shprehur me shkresën nr. 2274/2 Prot., datë 30.06.2017 se kompania ka përbushur të gjitha detyrimet e saj të parashikuara nga Marrëveshja Hidrokarbure për BLOKUN F.

### **Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Bllokut Velça.**

Me kërkesën nr. 8747 port., datë 29.12.2017 (protokolluar pranë AKBN në datën 08.01.2018 me nr. 146 ) shoqëria Albpetrol i është drejtuar shoqërisë P. P. C. dhe për dijeni MIE dhe AKBN, për zhvillimin e mbledhjes së Komitetit Këshillimor për Planin e Punës dhe Buxhetin për vitin 2018, për Bllokun e Velçës.

Albpetrol sha. propozon që mbledhja e Komitetit Këshillimor të zhvillohet brenda 15 ditëve të para të muajit Janar. (Nuk kemi informacion në lidhje me pjesëtarët e Komitetit Këshillimor)

Në datën 12.01.2018 me nr. 003 prot., (protokolluar në AKBN me nr. 825 prot., datë 18.01.2018) shoqëria P. P. C. i është drejtuar z. K. B. Kryetari i Komitetit Këshillimor dhe për dijeni AKBN, për procesverbalet dhe vendimet e Komitetit Këshillimor nr.1 për Bllokun Velça. Kjo shkresë është e hartuar në gjuhën angleze dhe nuk është asnjë nga dokumentat që janë shënuar si të bashkangjitur në këtë shkresë (Minutat e Komitetit Këshillimor, vendimet , programin e punës 2018 dhe buxhetin 2018).

Në datën 25.01.2018 Albpetrol sha. i është drejtuar me shkresën nr. 685 prot., shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni MIE dhe AKBN, mbi zbatimin e Nenit 16.4.1 të Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në tokë në Shqipëri, Blloku i Velçës.

Shoqëria P. P. C. i është drejtuar AKBN me shkresën nr. 0005 datë 30.01.2018 ( protokolluar në datë 31.01.2018 me nr. 823/1 prot., në AKBN) për dërgimin e një grupi specialistësh nga shoqëria P. pranë AKBN për të marrë të dhëna gjeologjike për Bllokun Velça.

Shoqëria Albpetrol me anë të shkresës nr.810 port., datë 31.01.2018 (protokolluar në datë 05.02.2018 me nr. 2068 prot., në AKBN) i është drejtuar shoqërisë P. P. A. për dijeni MIE dhe AKBN, mbi zbatimin e Nenit 16/4 të ligjit nr.7746, datë 27.07.1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), të ndryshuar.

Nisur nga parashikimi i këtij neni të merren masat për t’u pajisur me staf të certifikuar sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

Shoqëria Albpetrol me anë të shkresës nr. 870 prot., datë 01.02.2018 ( protokolluar në AKBN me nr. 823/3 prot., datë 05.02.2018) i është drejtuar shoqërisë P. P. A. , për dijeni MIE dhe AKBN, duke i dhënë informacion mbi të dhënat për Bllokun e Velçës.

Ky informacion i është dërguar shoqërisë P. P. A. në vijim të shkresës nr. 0002 prot., datë 12.01.2018 që shoqëria i ka dërguar Albpetrol sha. (kjo shkresë nuk është pjesë e dosjes.)

Albpetrol sha. në datën 07.02.2018 me anë të shkresës me nr. 1107 prot., (protokolluar në AKBN me nr. 2232 prot., datë 12.02.2018) i është drejtuar shoqërisë P. P. A. , për dijeni MIE dhe AKBN, mbi bonusin e Nënshkrimit , në zbatim të Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në tokë në Shqipëri, Blloku i Velçës, ndërmjet “Albpetrol sha.” dhe “P. P. C.”.

Edhe pse afati 60 ditor ka kaluar nga ana e shoqërisë P. P. A. nuk është bërë asnjë pagesë.

Albpetrol sha. me anë të shkresës nr. 455/1 datë 08.02.2018 (protokolluar në AKBN me nr. 825/1 prot., datë 14.02.2018) i është drejtuar shoqërisë P. P. A. për dijeni MIE dhe AKBN duke i përcjellë të nënshkruara nga përfaqësuesit e Albpetrol sha. Minutat dhe Vendimet e Mbledhjes së Komitetit Këshillimor (“ACM”) nr.1 për Bllokun e Velçës. (kjo shkresë nuk ka bashkëlidhur Minutat dhe Vendimet e Mbledhjes së Komitetit Këshillimor (“ACM”) nr.1 për Bllokun e Velçës).

Albpetrol sha. me anë të shkresës nr. 2306 prot., datë 12.03.2018 ( protokolluar në AKBN me nr. 3017 prot., datë 19.03.2018) i ka bërë kërkesë për informacion mbi Garancinë Bankare, shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni AKBN.

Kjo kërkesë është dërguar në bazë të nenit 29.3 të Marrëveshjes Hidrokarbure.

Gjithashtu Albpetrol sha. i ka rikujtuar së është në pritje të pagesës mbi detyrimin e Bonusit të Nënshkrimit. Bonus i cili është në vlerën e njëqind mijë dollarë (\$100.000) dhe nuk është paguar nga shoqëria edhe pse ka kaluar afati 60 ditor sipas nenit 27.1.

AKBN me anë të shkresës nr. 4035 prot., datë 13.04.2018 i është drejtuar shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni Albpetrol sha. ku i kërkohet depozitimi i Garancisë Bankare.

AKBN me anë të shkresës nr. 4059 prot., datë 13.04.2018 i është drejtuar shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni Albpetrol sha. ku i kërkon Programin e Punës dhe Buxhetin për vitin 2018.

AKBN me anë të shkresës nr. 825/2 port., datë 17.04.2018 i është drejtuar Albpetrol sha. ku i kërkon Minutat dhe Vendimet e Mbledhjes së Komitetit Këshillimor “ACM” nr.1 për Bllokun e Velçës.

AKBN informon Albpetrol sha. se shkresa e dërguar nga kjo e fundit e protokolluar në AKBN me nr. 455.1 datë 08.02.2018 ku vendoset për dijeni AKBN për dërgimin e Minutave dhe Vendimeve të Mbledhjes së Komitetit Këshillimor (“ACM”) nr.1 kompanisë P. P. A. , nuk ka bashkëlidhur një kopje të Minutave dhe Vendimeve të Mbledhjes së Komitetit Këshillimor nr.1 (“ACM”) të datës 12.01.2018 të zhvilluar në Tiranë ndërmjet “Albpetrol sha. “ dhe “P. P. A.”. Në zbatim të neneve 8.6.2 dhe 18.1 të Licencë Marrëveshjes midis AKBN dhe Albpetrol sha. për Bllokun e Velçës, ju lutem të dërgohen në AKBN një kopje të Minutave dhe Vendimeve të kësaj ACM-je.

Albpetrol sha. më anë të shkresës nr. 3546 prot., datë 23.04.2018 (protokolluar në AKBN me nr. 825/3 prot., datë 26.04.2018) i drejtohet shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni AKBN mbi Minutat dhe Vendimet e Mbledhjes së Komitetit Këshillimor (“ACM”) nr.1 ndërmjet “Albpetrol sha.” dhe “P. P. C.”.

Albpetrol sha. me anë të shkresës nr. 3997 prot., datë 09.05.2018 ( protokolluar në AKBN me nr.2232/1 port., datë 14.05.2018) i është drejtuar shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni AKBN, duke e njoftuar për korrigjimin e shkeljeve thelbësore, të detyrave dhe detyrimeve themelore të Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në tokë në Shqipëri, Blloku i Velçës, ndërmjet “Albpetrol sha.” dhe “P. P. C.”.

Albpetrol sha. bën me dije se, në rast se nuk kryeni pagesën e Bonusit të Nënshkrimit brenda 3 (tre) muajve nga data e njoftimit të kësaj shkrese, do të njoftoheni zyrtarisht, në përputhje me parashikimet e Nenit 24.2, për mbylljen (zgjidhjen) e Marrëveshjes si edhe për dorëzimin e Bllokut të Velçës.

Në datën 09.05.2018 shoqëria P. P. C. i është drejtuar shoqërisë Albpetrol sha. me një shkresë në lidhje me: “ri-raporti kontabël për tremujorin e parë”

Në përputhje me Marrëveshjen e Ndarjes së Prodhimit në fuqi më 05 dhjetor 2017, bashkangjitur gjeni raportin e përgatitur kontabël për tremujorin e parë 2018. Kjo shkresë është dërguar në gjuhë angleze bashkë me raportet për 3 mujorin e parë të vitit 2018.

MIE me anë të shkresës nr. 2336/3 prot., datë 10.05.2018 (protokolluar në AKBN me nr. 3984.1 prot., datë 11.05.2018) i ka kthyer përgjigje AKBN për shkresën nr.3984 prot., datë 12.04.2018. AKBN me anë të kësaj shkrese ka kërkuar nga MIE versionin anglisht të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për Miratimin e Marrëveshjes Hidrokarbure me Ndarje Prodhimi, për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku i Velçës, ndërmjet “Albpetrol sha” dhe “P. P. C.”. Bashkëlidhur do të gjeni kopjen e

marrëveshjes në versionin anglisht.( kopje e cila nuk është bashkëlidhur dhe pjesë e kësaj dosje.)

AKBN me anë të shkresës nr.4035/1 prot., datë 29.05.2018 i është drejtuar shoqërisë P. P. A. dhe Albpetrol sha. , për dijeni MIE me njoftim për korrigjim të shkeljeve të Licencës dhe Marrëveshjes Hidrokarbure për Bllokun e Velçës.

Albpetrol sha. me anë të shkresës nr. 4468/1 prot., datë 04.06.2018 (protokolluar në AKBN me nr. 5382 prot., datë 06.06.2018) i ka kthyer përgjigje shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni AKBN në lidhje me shkresën e datës 21.05.2018 që shoqëria P. P. A. i ka dërguar. (Kjo shkresë nuk është pjese e dosjes).

Në këtë kthim përgjigje Albpetrol sha. njofton shoqërinë P. P. A. të merren masat menjëherë për shlyerjen e detyrimeve si edhe të dërgohet sa më parë deklarata e Aktivitetit të Kërkimit, sipas afatit të parashikuar në marrëveshje.

Ju rikujtojmë se edhe në rast të zgjidhjes së kësaj Marrëveshje, zgjidhja nuk do ta shkarkojë Kontraktorin nga çdo angazhim i papërbushur apo detyrim tjetër që ka Kontraktori përpara zgjidhjes.

AKBN me anë të shkresës nr. 4059/1 prot., datë 05.06.2018 i është drejtuar shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni Albpetrol sha. dhe MIE, ku i kërkon Deklaratat e shpenzimeve për aktivitetin e kërkimit për tremujorin e parë 2018, në Bllokun e Velçës.

AKBN me anë të shkresës nr.4059/2 datë 29.06.2018 i ka kthyer përgjigje e-mail të datës 25.05.2018 shoqërisë P. P. A. dhe P. P. C. , për dijeni Albpetrol sha.

Në këtë kthim përgjigje AKBN njofton se po ndjek me kujdes zbatimin e Licensave dhe Marrëveshjes ndërmjet Albpetrol sha. dhe P. P. C.. AKBN njofton se është njoftuar shoqëria P. P. C. me shkresat nr.4059 prot., datë 13.04.2018 , nr.4035 prot., datë 13.04.2018, nr.4035/1 prot., datë 29.05.2018 dhe nr.4059/1 prot., datë 05.06.2018 dhe i ka kërkuar që të korrigjonte shkeljet e Licencës dhe Marrëveshjes Hidrokarbure.

Shoqëria P. P. C. në datën 03.07.2018 i është drejtuar AKBN në lidhje me letrën nr.4059 prot., të datës 04.06.2018 në lidhje me Letër Kreditë në favor të AKBN. *(AKBN nuk ka dërguar një letër me nr.4059 port., në datën 04.06.2018, AKBN ka dërguar shkresën me nr. 4059 prot., datë 13.04.2018 ku i drejtohet shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni Albpetrol sha. dhe kërkon Programin e Punës dhe Buxhetin për vitin 2018).*

Me anë të kësaj shkresë shoqëria P. P. C. kërkon një zgjatje një herë të njoftimit të dërguar nga Albpetrol për të tërhequr Marrëveshjen e Ndarjes së Prodhimit në 09.11.2018. Kjo do t'i ndihmonte të gjithë palët për të arritur objektivin e tyre më 14 .02.2017, kur PSA u nënshkrua midis kompanive tona. (kjo shkresë është dërguar në gjuhën angleze dhe e përkthyer në shqip).

AKBN me anë të shkresës nr. 4059/4 prot., datë 13.07.2018 i është drejtuar kompanisë P. P. C., për dijeni MIE dhe Albpetrol sha. duke i kthyer përgjigje letrës që është dërguar në datën 03.07.2018 nga P. P. C..

AKBN e gjen të pabazuar kërkesën tuaj , për shtyrje të afatit të dorëzimit të Garancisë Bankare dhe pret dorëzimin e Garancisë Bankare brenda datës 30.08.2018, në të kundërt do të ndërmarrë të gjitha hapat që parashikon Licenca dhe Marrëveshja Hidrokarbure.

Albpetrol sha. me anë të shkresës nr. 5539/1 prot., datë 23.07.2018 ( protokolluar në AKBN me nr. 4059/5 prot., datë 26.07.2018) i kthen përgjigje kompanisë P. P. C. dhe për dijeni MIE



dhe AKBN në lidhje me shkresën e dërguar nga kjo kompani në datën 02.07.2018. (letra 02.07.2018 nuk është pjesë e dosjes dhe nuk dihet përmbajta e saj)

Albpetrol sha. informon kompaninë P. P. C. se mbështet qëndrimin e AKBN që ka dërguar me shkresën nr. 4059/4 prot., datë 13.07.2018 ku refuzon shtyrjen e afatit për paraqitjen e Garancisë Bankare pas datës 30.08.2018 afat i vendosur nga AKBN për korrigjimin e parregullsive nga ana juaj.

Gjithashtu vlerëson se mos depozitimi i Garancisë Bankare në përputhje me afatet e parashikuara në Licencë Marrëveshje dhe MNP është gjithashtu shkelje materiale e MNP-së, sipas nenit 24.2.5

Theksojmë se përfundimi i Licencë Marrëveshjes sjell automatikisht dhe përfundimin e Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi për bllokun e Velçës ("MPN"), për këtë arsye të merren të gjitha masat e nevojshme për korrigjimin e këtyre shkeljeve.

Albpetrol sha. me anë të shkresës nr. 7113/1 prot., datë 15.08.2018 (protokolluar në AKBN me nr. 4059/6 prot., datë 20.08.2018) i kthen përgjigje kompanisë P. P. C. dhe për dijeni AKBN në lidhje me shkresën e datës 06.07.2018 protokolluar pranë Albpetrol sha. me nr.7113 prot., datë 03.08.2018 me lëndë "*Letter to Albpetrol on possible joint venture cooperation between P. P. and I.-I. N. , d.d regarding the exploration and production activities on Velca Block in Albania*" (kjo shkresë e dërguar nga shoqëria P. P. nuk ndodhet në dosje)

Albpetrol sha. vazhdon ti qëndrojë mendimit të mbajtur në shkresën e saj me nr. 5539/1 prot., datë 23.07.2018 mbi mos depozitimin e Garancisë Bankare pranë AKBN, depozitimi i Garancisë Bankare pranë AKBN është detyrim themelor i MH dhe Albpetrol mund të shprehet për kërkesën tuaj vetëm mbas plotësimit të këtij detyrimi.

Gjithashtu ju rikujtojmë shlyerjen e detyrimeve tuaja ndaj Albpetrol sha. sipas shkresës nr. 4794 prot., datë 06.06.2018.

Albpetrol sha. me anë të shkresës nr. 7955 prot., datë 20.08.2018 (protokolluar në AKBN me nr. 7109 prot., datë 24.08.2018) i është drejtuar shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni AKBN për dërgimin e Programit të Punës dhe Buxhetit për vitin 2019. (Plani për vitin 2019 duket i paqartë pasi nga korrespondenca e deritanishme në dosje nuk gjendet i dërguar akoma plani për vitin 2018 pranë AKBN për të marrë miratimin.)

Albpetrol sha. me anë të shkresës nr.7955/1 prot., datë 27.08.2018 ( protokolluar në AKBN me nr.7109/1 prot., datë 30.08.2018) i është drejtuar përsëri shoqërisë P. P. A. dhe për dijeni AKBN në vijim të shkresës nr. 7955 prot., datë 20.08.2018.

Albpetrol sha. informon shoqërinë P. P. A. se shkresa me nr. 7955 prot., datë 20.08.2018 është e vlefshme vetëm në qoftë se korrigjohet shkelja materiale që lidhet me dorëzimin e garancisë bankare pranë AKBN, brenda afatit të njoftuar nga kjo e fundit dhe si nëse korrigjohen shkeljet materiale ndaj shoqërisë Albpetrol sha..

AKBN me anë të shkresës nr.4035/2 prot., datë 31.08.2018 ka njoftuar shoqërisë P. P. C. dhe Albpetrol sha., për dijeni MIE për heqjen e Licencë Marrëveshjes për Bllokun e Velçës.

Kontraktori nuk arriti të korrigjoj shkeljet e Licencë dhe Marrëveshjes Hidrokarbure, brenda afatit të përcaktuar nga këto dokumenta, AKBN në respektim të nenit 24.3 e përfundon këtë Licencë, duke i hequr të drejtën palëve për vazhdimin e operacioneve hidrokarbure në kuadër të Licencës dhe Marrëveshjes me ndarje prodhimi "Për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve ne tokë, në Shqipëri, në bllokun e Velçës", ndërmjet Albpetrol sha. dhe P. P. C..

Albpetrol sha. me anë të shkresës nr.8885 prot., datë 18.09.2018 (protokolluar në AKBN me nr.2232/2 prot., datë 20.09.2018) ka njoftuar kompaninë P. P. A. dhe për dijeni MIE dhe AKBN mbi pasojat ligjore të heqjes së Licencë Marrëveshjes me Ndarje Prodhim për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në tokë në Shqipëri, Blloku Velçës.

Albpetrol sha. ka njoftuar lidhur me pasojat ligjore të zgjidhjes së Licencë Marrëveshjes nga ana e AKBN.

P. P. C. në datën 15.11.2018 (protokolluar në AKBN me nr.9309 prot., datë 03.12.2018) i është drejtuar AKBN dhe Albpetrol sha. në lidhje me shpenzimet që kjo kompani ka kryer për tremujorin e tretë 2018. (Kjo shkresë dhe dokumentacioni i dërguar bashkëlidhur është në gjuhën angleze)

Albpetrol sha me anë të shkresë nr.12255 prot., datë 13.12.2018 (protokolluar në AKBN me nr.2232/3 prot., datë 17.12.2018) i është përgjigjur kompanisë P. P. A. dhe për dijeni AKBN. Albpetrol sha. njofton kompaninë P. P. A. në lidhje me shkresën datë 15.11.2018 dërguar nga kjo e fundit se AKBN ka dërguar shkresën nr. 4035/2 prot., datë 31.08.2018 ku mbështetur në nenin 24.3 të Licencë Marrëveshjes për Bllokun e Velçës , ka hequr Licencën dhe të drejtën e palëve për vazhdimin e operacioneve hidrokarbure në këtë Bllok.

Gjithashtu Albpetrol sha. me anë të shkresës nr. 8885 prot., datë 18.09.2018 ka bërë me dije se me zgjidhjen e Licencë Marrëveshjes, Marrëveshja Hidrokarbure e lidhur midis palëve (Albpetrol sha. dhe P. P. C.) nuk ka më fuqi.

AKBN me anë të shkresës nr. 9309/1 prot., datë 20.12.2018 i është përgjigjur letrës të datës 15.11.2018 kompanisë P. P. C. dhe për dijeni Albpetrol sha..

AKBN njofton kompaninë P. P. C. se u njoh me letrën e datës 15.11.2018 ose referenca jonë nr. 9309 prot., datë 03.12.2018 ( ky dokument nuk është pjesë e dosjes) , me të cilën ju keni pasqyruar shpenzimet që keni realizuar gjatë tremujorit të tretë, të vitit 2018, për llogari të marrëveshjes që ju keni me kompaninë Albpetrol sha. për Bllokun e Velçës.

AKBN rikujton kompaninë P. P. C. se me anë të shkresës nr. 4035/2 prot., datë 31.08.2018, në respektim të neni 24.3 ka përfunduar Licencën, duke i hequr palëve të drejtën për vazhdimin e operacioneve hidrokarbure në kuadër të Licencës dhe Marrëveshjes me ndarje prodhimi “Për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, në Bllokun e Velçës”, ndërmjet Albpetrol sha. dhe P. P. C..

Për sa më sipër AKBN kërkon që mos dërgohen Progres Raportet që kanë të bëjnë me shpenzime që kjo kompani ka kryer pasi nuk kanë asnjë vlerë dhe nuk do konsiderohen nga AKBN.

Kompania P. P. C. i është drejtuar me një kërkesë në datën 12.11.2019 (protokolluar në AKBN me shkresën nr.6992 datë prot., datë 19.11.2019) AKBN dhe Albpetrol sha. për informacion në lidhje me detyrimet që kompania P. P. C. për Bllokun e Velçës.

Me anë të kësaj kërkesë kompania P. P. C. informon se është shpallur fituese dhe ka nënshkruar Marrëveshjen Hidrokarbure për Bllokun e Velçës. Për arsye të ndryshme kjo kompani ka krijuar disa detyrime financiare te pa shlyera dhe kërkon ti konfirmohet vlera e të gjithë detyrimeve të pashlyera, pasi është në një proces diskutimi dhe negocimi për shitjen e të gjithë të drejtave dhe detyrimeve që ka në lidhje me Bllokun e Velçës, detyrime që do të mbyllen menjëherë nga kompania blerëse. (kjo shkresë është përpiluar në 2 kopje në gjuhën shqip dhe anglisht).

AKBN me anë të shkresës nr. 478 prot., datë 15.01.2020 i ka kthyer përgjigje mbi kërkesën për informim lidhur me detyrimet e kompanisë P. P. C. dhe për dijeni MIE dhe Albpetrol sha.

AKBN pasi është njohur me shkresën e datës 12.11.2019 (protokolluar me nr.6922 prot., datë 19.11.2019) informon se:

Në kushtet kur kompania P. P. nuk arriti të korrigojë shkeljet e konstatuara nga AKBN në zbatim të Licencë Marrëveshjes Hidrokarbure me shkresë nr. 4035/2 prot., datë 31.08.2018, në respektim të nenit 24.3 ka njoftuar kompaninë P. P. C. për përfundimin e kësaj Licencë, duke i hequr të drejtën palëve për vazhdimin e operacioneve hidrokarbure për Bllokun e Velçës, në tokë.

Për sa më sipër, në kushtet kur Albpetrol sha. me shkresën nr. 8885 prot., datë 18.09.2018 ka përfunduar Marrëveshjen Hidrokarbure për Bllokun e Velçës, në tokë, ju bën me dije se kompania P. P. C. i ka humbur të drejtat e saj për Bllokun e Velçës, në tokë.

### **Zbatimi i Marrëveshjes për vendburimin Patos – Marinës me kompaninë B. P. A. LTD:**

Sipas aktit të themelimit të shoqërisë, datë 17.04.2004, dhe vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr 31830/3, datë 17.11.2006, të dorëzuar në QKB, B. P. A. Ltd (ish-S. I. E. LTD-A. B.) është një shoqëri e krijuar sipas ligjeve të ishujve Cayman, e themeluar më datë 15.04.2004, e regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar të C. I. me numër WK-134802, me seli në W. S. L. , W. H. , Mary Street, Grand Cayman, Cayman Islands, British West Indies.

B. P. A. Ltd – Dega në Shqipëri (“Dega”) është krijuar si degë e B. P. A. Ltd. (“Shoqëria mëmë”), një shoqëri e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve të Ishujve Cayman. Dega është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Shqipëri më 28 korrik 2004 dhe është e angazhuar në kërkimin dhe prodhimin e naftës në Shqipëri.

B. P. Ltd zotëron degë të ndryshme, duke përfshirë B. P. I. L. (regjistruar në Ishujt Jersey-Britani e Madhe) i cili zotëron B. P. A. Ltd (regjistruar në ishujt Kajman).

B. i ka shitur të gjitha aksionet e kompanisë A. Ltd. dhe Ch. P. I. L. me një çmim prej 2.20 USD/aksion (B. Sh.). A. Ltd. dhe Ch. P. janë degë të G.-J. P. C.(G.-J.), me qendër në Kinë. Marrëveshja e vlerëson B. në rreth 575 milionë dollarë kanadezë (C\$) përpara vlerësimit të borxheve të papaguara të B.. Kjo shumë është e barabartë me 407 milionë dollarë.

Të dhëna mbi drejtuesit e kompanisë:

Më datë 21.03.2005, drejtorët e shoqërisë kanë vendosur të shkarkojnë A. A. si menaxher dhe përfaqësues i degës në Shqipëri dhe të emërojnë në këtë detyrë z. R.W.

Më datë 11.05.2006, me vendim të drejtorëve të shoqërisë, u shkarkua administratori R.W dhe u emërua në këtë detyrë R. F.

Më datë 06.04.2010, me vendim të drejtorëve të shoqërisë, është larguar administratori R. F. dhe është emëruar administratori L. Ç. .

Më datë 24.12.2015, me vendim të drejtorëve të shoqërisë, u shkarkua z. L.Ç., si përfaqësues ligjor i Degës së shoqërisë së huaj dhe u emërua z. S. K. G. në këtë detyrë.

Më datë 02.05.2016, me vendim të asamblesë së ortakëve, u largua i z.A. F. Z. B. nga pozicioni i drejtorit dhe u emëruan z.J. P. H. dhe z. L.Ç. në pozicionin e drejtorëve të shoqërisë.

Më datë 29.09.2016, me vendim të asamblesë së ortakëve, u shkarkuan nga detyra e drejtorit të shoqërisë: R.P, D.L.F , L.Ç., J. H. dhe u emëruan Ch. Zh. X. , L. H. dhe F. Q. si drejtorë të shoqërisë.

Më datë 01.02.2017, me anë të vendimit me shkrim të drejtorëve të shoqërisë, janë marrë këto vendime:

a) Largimi i F. Q. me efekt të menjëhershëm nga data 01.02.2017

b) Emërimi si drejtor i shoqërisë në detyrën e Kryetarit të Bordit z. L. X.

c) Pranimi i dorëheqjes së W. F. si President dhe Drejtor Ekzekutiv i shoqërisë dhe emërimi i S. K. G. në këtë detyrë.

d) Pranimi i dorëheqjes së D. L.F. si President dhe Drejtor Ekzekutiv i shoqërisë.

Më datë 28.05.2018, me vendim të asamblesë së përgjithshme, është emëruar administratori X. S. dhe është larguar nga detyra administratori S. K. G.

Me date 30.10.2020, me vendim të drejtorëve të shoqërisë, u largua nga detyra administratori X. S. dhe u emërua si administrator i shoqërisë Q. F..

Me date 01.08.2022, me vendim të drejtorëve të shoqërisë, u largua nga detyra administratori Q. F. dhe u emërua si administrator i shoqërisë H. X..

**Disa terma të përgjithshme të Marrëveshjes:**

- a) Data Efektive: 30.07.2004
- b) VKM Nr.477, datë 16.07.2004
- c) Investimet (Periudha e Vlerësimit): 2.000.000 USD
- d) Prodhimi i Gjykuar – PPE (për pusët ekzistues): 32.78 ton/muaj, me rënie 10% në vit
- e) Prodhimi i Gjykuar – PPE (për çdo pus të marrë): 70% e mesatares së prodhimit neto në 6 muajt para marrjes në dorëzim, me rënie 15% në vit
- f) PPA – Faktori R:  $0 \leq 2.0$
- g) PPA – Pjesa e Albpetrol: 1% – 5%
- h) PPA – Nafta për Mbulim Kostoje: 99% - 95%
- i) Ndarja e Fitimit: 50% e fitimit të realizuar
- j) Periudha e Vlerësimit: 18 + 6 muaj
- k) Periudha e Zhvillimit dhe Prodhimit: 25 + 5 vjet

**Nga auditimi konstatohet se:**

Në datën 25 shtator 2015, B. P. A. Ltd (B. P. A. L.) ka depozituar në ICC një kërkesë për arbitrazh (“padia”) kundër Ministria i Infrastrukturës dhe Energjitikës (MIE) përfaqësuar nga AKBN dhe ndaj Albpetrol SHA.

Në datë 16.09.2019 Albpetrol SHA i ka përcjellë Avokaturës së Shtetit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin në lidhje me pretendimet e B. P. A. L., për çështjet e mëposhtme:

1. Auditimi për periudhën (Q1 - Q3) 2013
2. Auditimi për periudhën (Q4) 2013 dhe (Q1-Q4) 2014
3. Mosmarrëveshja për shpenzimet ligjore lidhur me BP Oil
4. Mosmarrëveshjet lidhur me procedurën e tenderimit (B. P. A. L. është tërhequr)
5. Hipotekimi i interesave/ transferimi i pronësisë së aseteve (B. P. A. L. është tërhequr)
6. Kostot e diluentit dhe trajtimit të naftës bruto
7. Shitja e naftës bruto që i takon Albpetrolit
8. Përlllogaritja e rënies eksponenciale të PPE-s
9. Auditimi për periudhën (Q1 – Q4) 2015
10. Auditimi për periudhën (Q1 – Q3) 2017
11. Auditimi për periudhën (Q1 – Q4) 2016
12. Auditimi për periudhën Q4 2017
13. Auditimi për periudhën (Q1 – Q4) 2018

Në datë 27.08.2019, është nënshkruar “S. A.” ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AKBN, B. P. A. Ltd dhe Albpetrol ShA, me objekt pezullimi i procedurave të arbitrazhit prej 3 muaj, me qëllim zgjidhjen me negociim të çështjeve të ngritura midis palëve, por që nuk u arrit.

**Detyrimi i B. P. A. L. ka ndaj Albpetrol SHA në naftë bruto për llogari PPE & PPA, sipas Marrëveshjes Hidrokarbure.**

Detyrimet e shoqërisë “B. P. A.” Ltd për llogari të Prodhimit Para – Ekzistues (“PPE”) dhe të Pjesës së Albpetrol SHA (“PPA”), deri në 31.12.2023.

	Dorëzimi në naftë gjendje (ton)	Dorëzimi në natyrë PPE (ton)	Dorëzimi në natyrë PPA (ton)	Detyrimi naftë gjendje (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPE (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPA (ton)	Diferenca naftë gjendje (ton)	Diferenca PPE (ton)	Diferenca PPA (ton)	Total Diferenca (ton)
<b>Fundi i vitit 2014</b>	0.000	205,701.774	0.000	0.000	198,218.184	33,374.288	0.000	7,483.590	-33,374.288	-25,890.698
<b>Viti 2015</b>	0.000	17,676.215	0.000	0.000	40,053.705	10,915.713	0.000	-22,377.490	-10,915.713	-33,293.203
<b>Viti 2016</b>	0.000	23,653.187	0.000	0.000	34,480.346	8,879.629	0.000	-10,827.159	-8,879.629	-19,706.788
<b>Viti 2017</b>	0.000	66,871.872	0.000	0.000	29,682.761	8,069.488	0.000	37,189.111	-8,069.488	29,119.623
<b>Viti 2018</b>	0.000	51,374.872	0.000	0.000	25,552.445	7,680.618	0.000	25,822.427	-7,680.618	18,141.809
<b>Viti 2019</b>	0.000	27,159.342	0.000	0.000	21,997.914	8,636.947	0.000	5,161.428	-8,636.947	-3,475.519
<b>Viti 2020</b>	0.000	996.368	0.000	0.000	18,937.677	6,553.180	0.000	-17,941.309	-6,553.180	-24,494.489
<b>Viti 2021</b>	0.000	21,100.410	0.000	0.000	16,303.330	8,636.330	0.000	4,797.080	-8,636.266	-3,839.186
<b>Viti 2022</b>	0.000	14,407.612	0.000	0.000	14,035.593	15,843.570	0.000	372.019	-15,848.570	-15,476.551
<b>Viti 2023</b>	0.000	20,816.044	0.000	0.000	12,083.429	15,456.844	0.000	8,732.615	-15,456.844	-6,724.249
<b>Total prej fillimit</b>	<b>0.000</b>	<b>449,757.696</b>	<b>0.000</b>	<b>0.000</b>	<b>411,345.383</b>	<b>124,051.543</b>	<b>0.000</b>	<b>38,412.313</b>	<b>-124,051.543</b>	<b>-85,639.230</b>

**Gjetja 1:** Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure rezulton se detyrimi i B. për PPE & PPA për periudhën nga fillimi i lidhjes së marrëveshjes deri në 31.12.2023 është 535,396.93 ton naftë.

Shoqëria Albpetrol ShA ka tërhequr 449,757.69 ton naftë bruto për llogari të PPE&PPA, dhe nuk ka tërhequr 85,639.24 ton naftë nga detyrimi për PPE & PPA për periudhën nga fillimi i lidhjes së marrëveshjes deri në 31.12.2023.

Sasia totale prej 54,009.978 Ton naftë bruto, e pa tërhequr për vitin 2019 - 2023 për llogari të Prodhimi Para Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol SHA (PPA) sipas Marrëveshjes Hidrokarbure është 18,659,033.93 USD, vlerë e cila përfaqëson të ardhur të munguar për Albpetrol SHA, e cila për nga niveli është e lartë. Për sa më sipër mban përgjegjësi MIE, AKBN dhe Albpetrol Sha.

#### **Detyrimet e B. P. A. L. për llogari të PPE & PPA për 5 vitet e fundit:**

Bazuar në sasinë e naftës së pa tërhequr për llogari të PPE & PPA për periudhën objekt auditimi rezulton se:

Viti	Sasia e naftës që B. P. A. L. i detyrohet Albpetrol SHA (Ton)	Çmimi mesatar i shitjes (\$/Ton)	Vlera \$
Tremujori I – 2019	-150.23	306.01	-45,945.59
Tremujori II – 2019	-354.78	331.54	-117,168.22
Tremujori III – 2019	-2,912.56	299.59	-868,027.34
Tremujori IV – 2019	-57.96	311.29	-17,958.91
<b>Total 2019</b>	<b>-3,475.53</b>		<b>-1,049,100.07</b>
Tremujori I – 2020	-7,101.591	236.93	-1,682,579.96
Tremujori II – 2020	-5,806.681	157.45	-914,273.54
Tremujori III – 2020	-6,399.677	208.38	-1,333,532.69
Tremujori IV – 2020	-5,186.540	208.86	-1,083,276.30
<b>Total 2020</b>	<b>-24,494.489</b>		<b>-5,013,662.49</b>
Tremujori I – 2021	-5,893.396	301.06	-1,774,242.23
Tremujori II – 2021	1,124.949	345.31	388,450.51
Tremujori III – 2021	2,135.582	364.98	779,451.13
Tremujori IV – 2021	-1,206.321	405.68	-489,380.30
<b>Total 2021</b>	<b>3,839.186</b>		<b>-1,095,720.89</b>
Tremujori I – 2022	-7,579.823	516.67	-3,916,289.89
Tremujori II – 2022	-7,525.420	597.16	-4,493,887.33
Tremujori III – 2022	-2,774.318	539.11	-1,495,651.48
Tremujori IV – 2022	2,403.013	463.43	1,113,637.93

<b>Total 2022</b>	<b>-15,476.548</b>		<b>-8,792,190.77</b>
Tremujori I – 2023	4,821.048	401.15	-1,933,953.76
Tremujori II – 2023	-925.505	386.12	-357,355.99
Tremujori III – 2023	-1,667.754	423.19	-705,776.82
Tremujori IV – 2023	<b>690.082</b>	418.40	288,726.86
<b>Total 2023</b>	<b>-6,724.225</b>		<b>-2,708,359.71</b>
<b>Totali 2019-2023</b>	<b>-54,009.978</b>		<b>-</b>
			<b>18,659,033.93</b>

Sasia totale prej 54,009.978 Ton naftë bruto, e pa tërhequr për vitin 2019 - 2023 për llogari të Prodhimi Para Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol SHA (PPA) sipas Marrëveshjes Hidrokarbure është **18,659,033.93 USD**, vlerë e cila përfaqëson të ardhur të munguar për Albpetrol SHA.

*Shënim: çmimi i shitjes së naftës është marrë nga progres raportet tremujore të kontraktorit*

### Monitorimi dhe supervizimi i marrëveshjes hidrokarbure

Aktiviteti i Sektorit të Monitorim – Supervizim është i përqendruar në shumë në 1 prej vendburimeve pasi ai është edhe vendburimi më i madh i naftës (Patos - Marinës). Sektori i Monitorimit dhe Supervizimit të Marrëveshjes Hidrokarbure merret me monitorimin dhe supervizimin e gjithë aktivitetit hidrokarbur operacional, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes. Grupit të auditimit ju vendosën në dispozicion nga Albpetrol SHA raportet ditore të monitorimit të vendburimeve.

Bazuar në këto raporte konstatohet se problematikat janë të ndryshme por kryesisht:

- Matjen e prodhimit;
- Sasinë e ujit të prodhuar dhe injektuar
- Shitjen e naftës në pikën e lëvrimit Fier – hub, shitje brenda vendit

### Ecuria e Faktorit R të deklaruar nga kontraktori pa reflektimin e Vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
R	0.52	0.5	0.51	0.63	0.7	0.73	0.75	0.77	0.83	0.91	0.95	0.942	0.953	0.967	0.967	0.974	0.976	1.0056	1.0197	1.0266

Në varësi të faktorit R është edhe ndarja e prodhimit PPE, konkretisht:

R>1 Albpetrol SHA merr 3% të PPA

R<1 Albpetrol SHA merr 1% të PPA(situatë që pretendohet nga kontraktori)

### Informacion mbi arbitrazhin ndërkombëtar B. P. A. Ltd (“B. P. A. L.”) kundër ish-Ministria e Energjisë dhe Industrisë (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë “MIE”) e përfaqësuar (në marrëveshje) nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (“AKBN”) dhe Albpetrol SHA – ICC Case 21349/GR

Në Shtator 2015 B. P. A. L. ka paraqitur Kërkesë për Arbitrazh në arbitrazhin ndërkombëtar të ICC (International Chamber of Commerce) kundër MIE/AKBN dhe Albpetrol SHA (“Institucionet Shqiptare”), duke pretenduar që Institucionet Shqiptare janë në shkelje të marrëveshjeve të lidhura me të, përkatësisht Licencë Marrëveshjes (“LM”) dhe Marrëveshjes Hidrokarbure (“MH”) për vendburimin e Patos - Marinës, për shkak të mosnjohjes së kostove të pretenduara si kosto hidrokarbure në një vlerë që tejkalon shumë \$600,000,000.00 (gjashtëqind milion USD).

### Historiku i mosmarrëveshjeve

Në Mars 2014, grupi i auditimit të AKBN, i përbërë nga përfaqësues të saj dhe të autoriteteve tatimore, kreu auditimin e kostove dhe shpenzimeve të B. P. A. L. për vitin 2011 dhe nxori raportin e auditimit përkatës, ku konstatoi një vlerë prej \$299,000,000.00 (dyqind e nëntëdhjetë

e nëntë milion USD) si kosto të panjohura nga totali i kostove prej \$384,000,000.00 (treqind e tetëdhjetë e katër milion USD).

Në vijim, autoritetet tatimore proceduan me nxjerrjen e njoftim-vlerësimit tatimor përkatës në bazë të raportit të auditimit për 2011 dhe i kërkuan B. P. A. L. pagesën e tatimit përkatës.

B. P. A. L. kundërshtoi si raportin e auditimit ashtu edhe njoftim-vlerësimin tatimor në arbitrazhin ndërkombëtar të ICC dhe në gjykatën shqiptare, përkatësisht, duke kërkuar gjithashtu edhe masë sigurimi për pezullimin e zbatimit të njoftim-vlerësimit tatimor si në arbitrazhin ndërkombëtar ashtu edhe në gjykatën shqiptare. Përfundimisht, masat e sigurimit nuk iu dhanë nga asnjë prej forumeve të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Pas observacioneve të paraqitura, u konkludua në shumën prej 247 584 845 USD si kosto të parikuperueshme.

Më pas, B. P. A. L. lidhi marrëveshje ("Marrëveshja") me autoritetet tatimore për pagesën me këste të detyrimit të përcaktuar në Njoftim-Vlerësim. Në bazë të Marrëveshjes, autoritetet tatimore janë të angazhuara të ri përlllogaritnin detyrimin tatimor në momentin e një Vendimi Përfundimtar të Arbitrazhit Ndërkombëtar ose Marrëveshjeje Përfundimtare të lidhur ndërmjet B. P. A. L. dhe AKBN për raportin e auditit të vitit 2011.

Është për t'u theksuar se në po të njëjtën datë të depozitimit të kërkesës për arbitrazh në ICC dhe kërkesë padisë në autoritetet gjyqësore shqiptare, në 25.09.2015, B. P. A. L. lidhi marrëveshje me MEI/AKBN për përcaktimin e Termave të Referencës ("ToR") për zgjidhje të mosmarrëveshjeve nga auditi i vitit 2011 me Ekspert, në bazë të nenit 25.4 të LM.

Krahas procedimit në arbitrazh, B. P. A. L., pas nënshkrimit të ToR për procedimin me Ekspertë, vazhdon të të shkëmbente korrespondencë me AKBN-në, duke i kërkuar kësaj të fundit të procedonte me vlerësimin e propozimeve për identifikimin e kandidatëve të mundshëm për t'u përzgjedhur si ekspertë, për të shqyrtuar dhe vlerësuar mosmarrëveshjet e rrjedhura nga auditi i vitit 2011.

Në Janar 2016 u zhvillua seanca përkatëse në arbitrazhin ndërkombëtar mbi menaxhimin e çështjes, Termat e Referencës, përfshirë pranimin ose jo të disa pretendimeve shtesë të B. P. A. L. kundrejt AKBN dhe Albpetrol SHA, si edhe aplikimin e B. P. A. L. për masën e sigurimit. Përfaqësimi i Albpetrol SHA u realizua nga firma Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP. Trupa e gjykimit në arbitrazh vendosi pranimin e pretendimeve shtesë të B. P. A. L. dhe mos vendosjen e masës së sigurimit të kërkuar nga B. P. A. L.. Kjo siguroi që shteti Shqiptar të vijonte mbledhjen e detyrimeve ndaj B. P. A. L. dhe uljen e tij në tavolinën e bisedimeve. Referuar Termave të Referencës të dakortësuar për këtë proces, pretendimet e Paditësit do të përmblihdeshin si më poshtë:

- Mosmarrëveshje mbi njohjen e kostove të rrjedhura nga Auditi i vitit 2011;
- Mosmarrëveshje mbi njohjen e shpenzimeve ligjore;
- Mosmarrëveshjet mbi përjashtimet e TVSH-së dhe përdorimit të diluentit në periudhën 2012/2013;
- Mosmarrëveshje mbi njohjen e kostove të periudhës Q1-Q3 2013;
- Mosmarrëveshje mbi njohjen e kostove të rrjedhura nga Auditi i vitit 2012;
- Mosmarrëveshje mbi njohjen e kostove të rrjedhura nga auditi i periudhës Q4/2013 dhe Q1 – Q4/2014;
- Mosmarrëveshje mbi njohjen e kostove të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga B. P. A. L.;
- Mosmarrëveshje mbi hipotekimin e aseteve;
- Mosmarrëveshje mbi transferimin e titullit; dhe
- Mosmarrëveshje mbi ASP dhe PEP, të detyrueshme për t'iu dhënë Albpetrol SHA.

Pas refuzimit të dhënies së masës së sigurimit nga trupa e gjykimit në arbitrazh, B. P. A. L. i vazhdoi negociatat me AKBN për të zgjidhur mosmarrëveshjet e auditit të 2011 me ekspertë

ndërkombëtarë dhe si pasojë e këtyre negociatave, palët dakortësuan për të pezulluar procesin e arbitrazhit, duke paraqitur një shkresë të përbashkët në Mars 2016.

Trupa e gjykimit në arbitrazh vendosi pezullimin e tij në Mars 2016 deri në një njoftim të dytë të palëve mbi përfundimin e procesit të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve me ekspertë.

Në këtë fazë të gjykimit në arbitrazh, pra vetëm për procesin e shqyrtimit të mosmarrëveshjeve me ekspertë, AKBN u përfaqësua nga Avokatura e Shtetit dhe Studioja Ligjore "C."

Vlera financiare e kostove, objekt shqyrtimi para Panelit të Ekspertëve Ndërkombëtarë ishte \$247,584,845 (dyqind e dyzetë e shtatë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katërmijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë USD) dhe pas zhvillimit të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve bashkë me provat përkatëse, Paneli i ekspertëve ndërkombëtarë vendosi se vlera totale e kostove të panjohura ishte 526,621 USD dhe jo 247,584,845 USD e konstatuar nga auditi i AKBN-se.

Avokatura e Shtetit/AKBN e ankimoi Vendimin e Panelit të Ekspertëve Ndërkombëtarë duke rifilluar procesin e arbitrazhit ndërkombëtar vetëm për mosmarrëveshjet e Auditit të vitit 2011. Vendimi i arbitrazhit u shpall në Shkurt 2018 duke lënë përfundimisht në fuqi vendimin e eksperteve i cili kishte vendosur se vlera totale e kostove të panjohura ishte 526,621 USD dhe jo 247,584,845 USD.

Trupa e gjykimit në arbitrazh pas shqyrtimit të ankimit të AKBN dhe ngarkoi këtë të fundit me pagesën e kostove të këtij nënprocesi në vlerën rreth 1.161.309 USD.

Me daljen e vendimit të mësipërm të tribunalit lidhur me procesin e apelimit të vendimit të eksperteve, përfunduan edhe efektet e autorizimit me të cilin ishte pajisur studioja ligjore për përfaqësimin dhe mbrojtjen e kësaj çështjeje. Përfundimi i marrëdhënieve me këtë studio ligjore u shoqërua me faturën përkatëse për shërbimet e përfaqësimit të ofruara për MIE/AKBN dhe Albpetrol SHA, faturë e cila është likuiduar nga Albpetrol SHA.

Pas përfundimit me sukses në favor të tij të çështjes lidhur me Auditin e vitit 2011 dhe me synimin për të trajtuar këtë rast si precedent, B. P. A. L. kërkoi rifillimin e procesit të arbitrazhit dhe shtimin e pretendimeve (pas nënshkrimit të Termave të Referencës të arbitrazhit), duke kundërshtuar edhe auditet e AKBN-se për vitet 2012, 2013, 2014 e 2015 (Auditin e vitit 2012, aktualisht, është i përfshirë në gjykim në arbitrazh, ndërsa për Auditet e viteve 2013, 2014 e 2015 i është bërë kërkesë Tribunalit nga B. P. A. L. për t'i përfshirë edhe këto në të njëjtin proces).

Në kushtet kur, marrëdhëniet me studion ligjore kishin përfunduar, nga ana e Avokaturës së Shtetit, iu kërkua kohë shtesë Tribunalit për t'i dhënë mundësi MIE/AKBN-së për të zgjedhur një avokat për ta përfaqësuar në këtë proces.

B. e kundërshtoi këtë kërkesë të Avokaturës e Shtetit dhe nga ana e saj trupa e gjykimit, bëri të ditur vendimin e saj për refuzimin e kohës shtesë të kërkuar nga Avokatura e Shtetit dhe ka kërkuar që palët të shprehen mbi disponueshmërinë e tyre për zhvillimin e një seance procedurale (conference call) mbi aplikimin e B. për të shtuar mosmarrëveshje të reja në gjykim (Auditin e vitit 2013, 2014 dhe 2015 sipas korrespondencës me Avokaturën e Shtetit)

Në këtë fazë të gjykimit të çështjes, Tribunali njoftoi datën 24.05.2019 për zhvillimin e një "Conference call" për të diskutuar: "... B.'request to add to claims to the arbitration...".

Në datë 24.05.2019 u zhvillua seanca në fjalë në të cilën u shqyrtua kërkesa e B. P. A. L. sipas së cilës përveç çështjeve të auditit 2013 e 2014 të shtohet edhe auditin e vitit 2015. Lidhur me këtë kërkesë të B. P. A. L. Trupa Gjyquese vendosi që palët pjesëmarrëse në këtë proces B. P. A. L., MIE/AKBN dhe Albpetrol SHA të shprehnin qëndrimet e tyre brenda datës 31.05.2019. Lidhur me këtë kërkesë nga ana e MIE-s u njoftua Avokatura e Shtetit që draft raportet e auditeve në fjalë të mos përfshihen në procesin e arbitrazhit.

Duke patur parasysh mënyrën se si u trajtua dhe përfundoi çështja lidhur me Auditin e vitit 2011, kostoja që pati ky proces për shtetin shqiptar vetëm në këtë fazë, si dhe mundësitë që kjo



çështje të trajtohej nga B. P. A. L. si precedent edhe në të ardhmen, nga ana e MIE-s u negociua me B. P. A. L. mundësia për pezullimin e procesit të arbitrazhit.

Si rezultat i këtyre negociatave, u nënshkruan marrëveshjet si më poshtë:

- “Standstill Agreement” date 27.08.2019;
- “Amendment to the Standstill Agreement dated August 27, 2019” date 19.12.2019;
- “Second Amendment to the Standstill Agreement dated August 27, 2019” datë 30.04.2020.

Sipas informacioneve nga Avokatura e Shtetit e cila ndjek këtë proces në cilësinë e përfaqësueses së RSH, në lidhje me zhvillimet për çështjen ICC Case 21349/EMT/GR: B. P. A. Ltd. vs. The Ministry of Energy and Industry and Albpetyl SHA, në datë 12 shkurt 2021 B. ka vijuar me paraqitjen e pretendimeve të tij për mosmarrëveshjet aktualisht objekt i këtij procesi Arbitrazhi, sipas kalendarit. Objekti i mosmarrëveshjes së arbitrazhit shtrihej mbi auditin e 2012, dhe draft auditet e 2013, 2014, 2015 dhe më pas, B. P. A. L. kërkoi shtimin e objektit të padisë edhe me auditet e viteve 2016 e 2017. Me ri çeljen e procedurës së Arbitrazhi, pas një pezullimi Gusht 2019- Korrik 2020, palët u ulen në negociata për hartimin e një kalendarit procedural për zhvillimin e këtij procesi, i cili u miratua nga tribunali dhe vijoi me shkëmbimin e dokumentacionit midis palëve ndërgjyqësore, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjore.

Ndërkohe me 23 Gusht 2021, nga ana e Avokaturës së Shtetit është nënkontraktuar studio ligjore Hogan&Lovells e cila do të përfaqësonte interesat e shtetit shqiptar (MIE e cila në LM përfaqësohet nga AKBN) në këtë proces.

**Gjetja 2:** Pas mbarimit të gjitha procedurave të këtij procesi më 7 Qershor 2024 nga ana e Tribunalit u lëshua “Final Award” lidhur me të gjitha çështjet objekt gjykimi.

Në mënyrë të përmbledhur Tribunali vendosi 70% me 30% në favor të B. P. A. L., por që në vetvete përkthehet me mosnjohjen e rreth 236M USD si kosto të panjohura nga totali prej rreth 800M USD, për nga niveli është e lartë.

Nga ky vendim AKBN iu dhanë të drejta lidhur me trajtimin e një sërë çështjeve objekt auditimi të paraqitura në tabelën si më poshtë:

No	Categories of Disputed petroleum Costs Audit-Related Claims	Total costs USD
1	Diluent for 2012-2014	20.700.000
2	Tendering 2012-2017	2.459.175
3	HOH	0
4	Inventory	0
5	Legal Expenses	21.214.854
6	Bad Debt	17.279.865
7	Other Issues	55.116.450
8	Open Letter	103.285.972
9	Costs withdrawn by B.	16.053.150
		<b>236.109.466</b>

## **Auditimet e ushtruara nga Albpetyl SHA bazuar në detyrimet e marrëveshjes hidrokarbure**

Në bazë të nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure:

*“Albpetyl ka të drejtë të auditojë për një periudhë 12 mujore nga marrja e secilës **deklaratë të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse** në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione .... Albpetyl dhe Kontraktori do të bien dakord për çdo rregullim të kërkuar. Dokumenta Shtesë dhe llogaritë do të bëhen të disponueshme për Albpetyl gjatë periudhës 12 mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës dymbëdhjetë (12) muaj Albpetyl nuk ka këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë quhet e aprovuar.”*

Albpetrol SHA ka kryer auditime vjetore dhe rezultat e tyre në vite janë kontestuar nga B. dhe janë çuar për gjykim në Gjykatën e Arbitrazhit.

Albpetrol SHA në zbatim të nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimit dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos - Marinzë” ka kryer auditimit e raporteve të tremujorit Q1, Q2, Q3, Q4 të vitit 2018, auditim i cili është kryer në 2019 dhe ka rezultuar:

- Shpenzime të kryera për shërbime mediatike në vlerën 451,817 USD (Ilogaria 6631)
- Shpenzimet për zhvillimin e komunitetit në vlerën 537,254 USD (Ilogaria 2662)
- Shpenzime të kategorizuara si Sponsorizime/Donacione (Ilogaria 6631) në vlerën 9,777 USD
- Shpenzimeve për qiratë e tokës në vlerën 156,093 USD, si diferencë midis çmimit reference të tokës (269 USD/m<sup>2</sup>) dhe çmimit të deklaruar nga kontraktori (400 USD/m<sup>2</sup>).
- Shpenzimet për qira toke 2,000,000 USD kontrata “Hazendari”
- Shpenzime për Gjoha dhe/ose Penalitete (Ilogaria 2660) vlera 27,220 USD
- Shpenzime për Interesa, shpenzime bankare dhe të ngjashme (Ilogaria 6631) vlera 50,000 USD.

Për vitin 2018 rezulton se nga Albpetrol SHA nuk janë njohur si kosto hidrokarbure ndaj B. P. A. L. vlera **3,232,161 USD**, vlerë e cila duhet të zbritet nga shpenzimet hidrokarbure të vitit 2018.

### **Shpenzimet hidrokarbure të deklaruara por të panjohura nga Albpetrol SHA për vitin 2019 janë:**

- Shoqëria “B. P. A.” LTD ka lidhur kontrata për “Shërbime publicitare dhe mediatike”. Të gjitha këto kontratat e lidhura janë të përcaktuara me një kosto fikse mujore ose 3 – mujore. Vlera e paguar prej **345,129.32 USD**.
- Verifikimet e shpenzimeve për qiratë e tokës, ndryshimi tarifës për metër të qerasë tokës. Diferenca prej 131 lekë / metër katror. Shpenzim Hidrokarbur i panjohur është **275,543 USD**.
- Shpenzime të kategorizuara si Sponsorizime / Donacione, gjatë kontrollit nga Albpetrol SHA janë konstatuar shpenzime për donacion pa miratimin nga AKBN në vlerën **6,000 USD**.
- Shpenzime për qira toke kontratë “H.”, vlera **2,000,000 USD**.
- Shpenzime të ndryshme operationale, nga kontrolli i shpenzimeve operationale rezultoi se B. ka klasifikuar si shpenzime të rikuperueshme shpenzimet për: festë Viti i Ri, dhurata, dekorime në vlerën 31,428.33 USD, shpenzime mirëmbajtje 2,729.94 USD, shpenzime lule 1024.83 USD, shpenzime abonim TV 2,248 USD, mirëmbajtje 4,741.7 USD. Në total shpenzime operative të panjohura janë **42,172.8 USD**.
- Shpenzimet e kryera për kompaninë H. O. S. Ltd, H. është një shoqëri që është kontraktuar për të kryer shërbimin e prokurimit për blerjen e materialeve të B. P. A. L. dhe për këtë shërbim merr një tarifë 2-3% të vlerës së blerjeve. Shërbimet e kryera nga HOH nuk mund të verifikohen pasi B. P. A. L. nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetëse. Nga verifikimet e kryera nga Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure ka rezultuar se HOH është shitës mallrash dhe jo agjenti blerjeve për llogari të B. P. A. L.. Tarifa e prokurimit për periudhën Q1 - Q4 2019 është në vlerën **325,100 USD**.
- Shpenzimet administrative të BPL në funksion të B. P. A. L. jashtë Republikës së Shqipërisë të aplikueshme ndaj operationeve hidrokarbure janë në vlerën **60,926.18 USD**. Në mungesë të një kontrate Albpetrol SHA e ka të pamundur të verifikojë dhe vlerësojë shpenzimeve si kosto hidrokarbure.
- Shpenzime të kryera për pagesën e studiove ligjore si “Pagesë suksesi (fee) për çështjet gjyqësore” në vlerën 548,763.11 USD, të cilat nuk klasifikohen si kosto hidrokarbure.

Për vitin 2019 rezulton se nga Albpetrol SHA nuk janë njohur si kosto hidrokarbure ndaj B. P. A. L. vlera **3,605,196.79 USD**, vlerë e cila duhet të zbritet nga shpenzimet hidrokarbure të vitit 2019.

### **Shpenzimet hidrokarbure të deklaruara por panjohura nga Albpetrol SHA për vitin 2020 janë:**

- Shoqëria “B. P. A.” LTD ka regjistruar në “Kostot e deklaruara si të rikuperueshme” për vitin 2020 shpenzimet për gjoba në vlerën **549 USD**, pasi është në kundërshtim me nenin 10, pika 10.2, gërma d e LM.
- Shpenzime për qira toke kontratë “H.”, vlera **2,000,000 USD**.
- Përfshirja e kostos së shërbimit të konsulencës nga A. Y. si kosto e rikuperueshme, pasi nuk mund të përcaktohet nëse konsulenca i ka shërbyer operacioneve hidrokarbure në vlerën **91,525 USD**.
- Përfshirja e kostos së shërbimit të konsulencës nga E. Sh. si kosto e rikuperueshme, pasi nuk mund të përcaktohet nëse konsulenca i ka shërbyer operacioneve hidrokarbure në vlerën **28,473.32 USD**.
- Përfshirja e kostos së shërbimit të konsulencës nga F. K. si kosto e rikuperueshme, pasi nuk mund të përcaktohet nëse konsulenca i ka shërbyer operacioneve hidrokarbure në vlerën **76,088.51 USD**.
- Përfshirja e kostos së shërbimit të konsulencës nga “H. L. & T.” si kosto e rikuperueshme, pasi nuk mund të përcaktohet nëse konsulenca i ka shërbyer operacioneve hidrokarbure pasi në faturat e vendosura në dispozicion nuk specifikohet lloji i konsulencës në vlerën **428,690.79 USD**.
- Përfshirja e kostos së shërbimit të konsulencës nga “H. C. M.” si kosto e rikuperueshme, pasi nuk mund të përcaktohet nëse konsulenca i ka shërbyer operacioneve hidrokarbure në vlerën **5,640.58 USD**.
- Përfshirja e kostos së shërbimeve publicitare dhe mediatike si kosto e rikuperueshme, pasi BPL nuk posedon asnjë kontratë me mediat televizive, në vlerën **4,254.13 USD**.
- Për vitin 2020 rezulton se nga Albpetrol SHA nuk janë njohur si kosto hidrokarbure ndaj B. P. A. L. vlera **2,635,221 USD**, vlerë e cila duhet të zbritet nga shpenzimet hidrokarbure të vitit 2020.

### **Shpenzimet hidrokarbure të deklaruara por të panjohura nga Albpetrol SHA për vitin 2021 janë:**

- Shpenzime për qira toke kontratë “H.”, vlera **2,000,000 USD**. (Auditimi është në fazë projektraporti dhe priten objeksionet e B. P. A. L.)
- Përfshirja e kostos së shpenzimeve me përshkrimin “R. O. & L. P.” si të rikuperueshme në vlerën **161,803.27 USD**.
- Përfshirja e kostos së shërbimeve publicitare dhe mediatike si kosto e rikuperueshme, pasi BPL nuk posedon asnjë kontratë me mediat televizive, në vlerat **169,214.59 USD dhe 108,109.36 Euro**.
- Përfshirja e kostos së shërbimeve ligjore me “S. L. Ç.” si kosto e rikuperueshme, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **316,108.6 Euro**.
- Përfshirja e kostos së shërbimeve ligjore me avokat B. Ç. si kosto e rikuperueshme, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **648,000 USD**.
- Përfshirja e kostos së shërbimeve ligjore nga “H. L. & T.” si kosto e rikuperueshme, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **285,508.73 Euro dhe 57,637.29 USD**.

- Përfshirja e kostos së shërbimeve konsulencë financiare nga “K. C.” dhe konsulencë ligjore nga E. Sh., pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerat respektive **92,410.96 Euro dhe 25,014.99 Euro.**
  - Përfshirja e kostos së shërbimit të kryer nga “A. B.” Shpk, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **220,200.03 USD.**
  - Përfshirja e kostos së shërbimit të kryer nga “P. E.U.V.B.”, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **59,754 USD.**
  - Përfshirja e kostos së shërbimit “Transport i mbetjeve të rrezikshme” nga “Q. S.” Shpk, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **61,752,436.23 Lekë.**
  - Përfshirja e kostos së shërbimeve të transportit të mbetjeve të rrezikshme nga “S.I.A K.” Shpk, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **52,610,369 Lekë.**
  - Përfshirja e kostos së shërbimeve nga “A.” Shpk, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **30,775,090 Lekë.**
- Për vitin 2020 rezulton se nga Albpetrol SHA nuk janë njohur si kosto hidrokarbure ndaj B. P. A. L. vlera **3,097,168.62 USD, 817,552.64 Euro dhe 380,774,215.23 Lekë (përfshinë detyrimin 235,636,320 lekë Energji Elektrike)**, vlerë e cila duhet të zbritet nga shpenzimet hidrokarbure të vitit 2021.

**Shpenzimet hidrokarbure të deklaruara por të panjohura nga Albpetrol SHA për vitin 2022 janë:** (Auditimi është në faze projektraporti dhe priten objeksionet e B. P. A. L.)

- Shpenzime për qera toke kontratë “H.”, vlera **2,000,000 USD.**
- Përfshirja e kostos së shpenzimeve me përshkrimin “R. O. & L. I. P”si të rikuperueshme në vlerën **16,139.62 Euro dhe 250,843.97 USD.**
- Përfshirja e kostos së shërbime publicitare dhe mediatike si kosto e rikuperueshme, pasi BPL nuk posedon asnjë kontratë me mediat televizive, në vlerat **364,452.79 Euro**
- Përfshirja e kostos së shërbimeve ligjore me “S. L. Ç.” si kosto e rikuperueshme, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **184,130.36 Euro.**
- Përfshirja e kostos së shërbimeve ligjore me avokat B. Ç.si kosto e rikuperueshme, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **1,104,000 USD.**
- Përfshirja e kostos së shërbimeve ligjore nga “H. L. & T.” si kosto e rikuperueshme, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **30,623.42 Euro.**
- Përfshirja e kostos së shërbimeve ligjore “C. P.”, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **58,889.53 Euro.**
- Përfshirja e kostos së shërbimeve ligjore “S. L. A.”, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **70,202.74 Euro.**
- Përfshirja e kostos së shërbimit të kryer nga “V.” Shpk, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **12,214.08 Euro.**
- Përfshirja e kostos së shërbimit si shpenzime dhurata për Krishtlindje “A. M.”, në vlerën **84,059.56 Euro.**
- Përfshirja e kostos së shërbimit të kryer nga “P. E.U.V.B.”, pasi nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues, në vlerën **73,600 USD.**

Për vitin 2020 rezulton se nga Albpetrol SHA nuk janë njohur si kosto hidrokarbure ndaj B. P. A. L. vlera **3,428,443.97 USD, 820,712.10 Euro dhe 693,734,356 Lekë (përfshinë detyrimin Energji Elektrike)**, vlerë e cila duhet të zbritet nga shpenzimet hidrokarbure të vitit 2022.

**Auditet e AKBN**

Bazuar në nenin 15, pika 15.3 “E drejta e AKH (AKBN)” të LM ku citohet se:

*“Shpenzimin dhe koston e vetme të AKH, AKH do të ketë të drejtën të inspektojë dhe auditojë librat e llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të të Licensuarit në lidhje me*

*Operacionet Hidrokarbure, por jo më shpesh se 1 herë në një vit fiskal, për veç se kur bihet dakord ndryshe me Operatorin. Kjo e drejtë auditit do të përfundojë 3 vjet pas datës në të cilën i licensuari i dorëzon dokumentacionin e tij të kontabilitetit për atë fiskal, për ndryshe, ky dokumentacion kontabiliteti gjykohet të jetë i saktë dhe më vonë nuk mund të jetë objekt kundërshtimi”*

**Shpenzimet hidrokarbure të deklaruara por të panjohura nga AKBN për vitin 2019 janë:**  
(Auditimi është në faze projektraporti dhe priten objeksionet e B. P. A. L.)

<b>Nr.</b>	<b>Kosto të parikuperueshme nga raporti i auditit për vitin 2019</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera USD</b>
1	Inventari	Blerje materialesh	10,415,656
2	E. T. ( C. ) L.	Fee qeveritare ( Intercompany)	4,520
3	H. O. S. LTD	Kontratë shërbimi me procedurë prokurimi për blerje dhe transport mallrash	351,639
4	Shërbime marketingu dhe mediatike	Shërbime auditive për reklama publicitet transmetim i evente etj.	376,372
5	N. R. F.	Mungesë kontrate	14,449
6	E. Group shpk	Tarifa përmbarimi	23,434
7	H&A L. F , H. L. T. , PCG shpk , E. G. Shpk	Success fee	1,171,537
8	Sponsorizime dhe donacione	Mungesa e marrjes së miratimit për sponsorizime dhe donacione	6,863
9	Shpenzime të ndryshme	Shpenzime të ndryshme për festa , akomodime ,ushqim dekorime etj.)	499,509
10	Marrëdhënia me komunitetin	Donacione apo kontribute për të cilën ka kryer për të tretët	1,380,782
11	Kontratat e qirasë për akomodimin e personelit të shoqërisë B. P. A. L.	Qira për akomodim personeli	253,530
12	Sigurimi shëndetësor privat për B. P. A. L. ( S. U. G.A. dhe G. B. A.)	Sigurimi shëndetësor privat	449,704
13	Sigurimi i jetës ( S. U. G.A	Mungesë dokumentacioni	34,643
14	Sigurimi i pronës - ( S. U. G.A , A.	Shpenzim për sigurim përgjegjësie për sigurimin OEE dhe CGL	179,817
15	P.Sh. & 3- Sh shpk	Mallra konsumi	741,108
16	Qiratë e tokave	Shpenzime për qira toke	8,865,422
17	Shpenzimet e Dieselit të automjeteve ( Diesel Vehicle)	Diesel për nënkontraktorët	17,316
18	Shërbime të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike nga shoqëria Myrto dhe Serjani	Shërbim i rënduar për Sherwood	31,745
19	Gjoha dhe penalitet nga Drejtoria e MZSH/Bashkia Fier	Gjoha dhe penalitete	21,182
20	Shpenzime udhëtimi dhe akomodimi	Shpenzime që nuk figurojnë në listat emërore të B. P. A. L.	110,876
21	E. B.	Konsulencë inxhinierike që mungon produkt i punës	60,242
22	Shërbime konsulence teknike	Mungesë dokumentacioni	4,755,895
23	Shpenzime për administrimin e mbetjeve nga shpimi i puseve	Shpenzim për administrim e mbetjeve	2,517,495
24	Shpenzimet e konsulentit A.Y. Y.	Konsulencë për financim	42,086
25	Tenderat	Mungesë procedure tenderuese	11,665,457
	<b>Total kosto te parikuperueshme për vitin 2019</b>		<b>43,991,279</b>

**Shpenzimet hidrokarbure të deklaruara por panjohura nga AKBN për vitin 2020 janë:**  
(Auditimi është në faze projektraporti dhe priten objeksionet e B. P. A. L.)

Nr.	Kosto të parikuperueshme nga raporti i auditit për vitin 2020	Përshkrimi	Vlera USD
1	Inventari	Blerje materialesh	- 495,399
2	H. O. S. LTD	Kontratë shërbimi me procedure prokurimi për blerje dhe transport mallrash	690,980
3	Shërbime marketingu dhe mediatike	Shërbime audizive për reklama publicitet transmetim i evente etj.	315,472
4	E. G. shpk & Zyra përmbarimore B.	Tarifa përmbarimi	105,223
5	S. F. H & A Law Firm , H. L. T. , PCG shpk , C.	Success fee	1,102,588
6	Sherbim ligjore H&A L. F. , PCG shpk , C. , T.P.	Mungesë dokumentacioni dhe produkt pune etj.	429,282
7	J. & B.	Mungesë dokumentacioni dhe produkt pune etj.	25,920
8	G. Z.	Mungesë dokumentacioni dhe produkt pune, faturë me përshkrim "fees for criminal complaint"	13,455
9	A. Y.	Konsulence për financim	92,350
10	D. L. shpk	Raport due diligence	58,950
11	Sponsorizime dhe donacione	Mungesa e marrjes së miratimit për sponsorizime dhe donacione	6,236
12	Shpenzime të ndryshme	Shpenzime të ndryshme për festa , akomodime ,ushqim dekorime etj.)	494,280
13	Marrëdhënia me komunitetin	Donacione apo kontribute për të cilën i ka kryer për të tretë	231,112
14	Kontratat e qerasë për akomodimin e personelit të shoqërisë B. P. A. L.	Qira për akomodim personeli	164,602
15	Sigurimi shëndetësor privat për B. P. A. L. ( S.U. G. A. dhe G. B .A.)	Sigurimi shëndetësor privat	391,590
16	Sigurimi I pronës - S.U. G. A , A.	Shpenzim për sigurim përgjegjësie për sigurimin OEE dhe CGL	135,714
17	Qiratë e tokave	Shpenzime për qira toke	6,242,359
18	Shërbime të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike nga shoqëria M. dhe S.	Shërbim i rënduar për Sherwood	29,562
19	E. B.	Konsulence inxhinierike që mungon produkt i punës	27,050
20	ECCAT	Mungesë dokumentacioni dhe produkt pune etj.	59,100
21	Shërbime konsulence teknike	Mungesë dokumentacioni dhe produkt pune etj.	703,240
	<b>Total kosto të parikuperueshme për vitin 2020</b>		<b>10,823,666</b>

Për vitin 2021 auditimi është në proces ndërsa për vitet në vijim 2022, 2023 nuk janë kryer auditimet ende pasi AKBN ka afat 3 vjet nga dorëzimi i dokumentacionit kontabël.

Referuar përcaktimeve ligjore të LM dhe MH parashikohet kryerja e auditimeve nga Albpetrol SHA dhe AKBN, konkretisht Albpetrol SHA ka bazë ligjore:

Në bazë të nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure:

“Albpetrol ka të drejtë të auditojë për një periudhë 12 mujore nga marrja e secilës **deklaratë të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse** në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione .... Albpetrol dhe Kontraktori do të bien dakord për çdo rregullim të kërkuar. Dokumenta Shtesë dhe llogaritë do të bëhen të disponueshme për Albpetrol gjatë periudhës 12 mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës dymbëdhjetë (12) muaj Albpetrol nuk ka këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë quhet e aprovuar.”

Ndërsa AKBN ka bazë ligjore:

Bazuar në nenin 15, pika 15.3 “E drejta e AKH (AKBN)” të LM ku citohet se:

*“Shpenzimin dhe koston e vetme të AKH, AKH do të ketë të drejtën të inspektojë dhe auditojë librat e llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të Licencuarit në lidhje me Operacionet Hidrokarbure, por jo më shpesh se 1 herë në një vit fiskal, për veç se kur bihet dakord ndryshe me Operatorin. Kjo e drejtë auditit do të përfundojë 3 vjet pas datës në të cilën i licencuari i dorëzon dokumentacionin e tij të kontabilitetit për atë fiskal, për ndryshe, ky dokumentacion kontabiliteti gjykohet të jetë i saktë dhe më vonë nuk mund të jetë objekt kundërshtimi”*

**Gjetja 3:** Albpetrol SHA ka objekt auditimi raportet e kostove hidrokarbure (Raportet tremujore Q1, Q2, Q3, Q4) në lidhje me përfshirjen e kostove të kryerja nga B. P. A. L. si kosto hidrokarbure të shpenzimeve që nuk i kanë shërbyer operacioneve hidrokarbure (si kosto të rikuperueshme). Këto auditime do ti shërbejnë Albpetrol SHA në monitorimin e raportimeve dhe verifikimin e llogaritjes së faktorit R nga vlera që raporton B. P. A. L. për çdo tremujor dhe ndikon direkt në sasinë e PPA&PPE.

Ndërsa AKBN ka për objekt auditimi *librat e llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të B. P. A. L.*, si cilat duhet të ishin dorëzuar nga kompania 45 ditë pas përfundimit të çdo 6-mujori. Këto auditime do ti shërbejnë AKBN në lidhje me rregullsinë e regjistrimeve dhe pasqyrimin të kostove hidrokarbure në librat e llogarive kontabël, si dhe të shprehen në lidhje me përlllogaritjen e rezultatit financiar dhe të tatim fitimit.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion AKBN ka audituar vetëm raportet e kostove hidrokarbure (Raportet tremujore Q1, Q2, Q3, Q4) dhe jo librat e llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të B. P. A. L. në kundërshtim me nenin 15, pika 15.3 “E drejta e AKH (AKBN)” të LM.

Për sa më sipër mban përgjegjësi për dhe mos veprimet Drejtoria Hidrokarbure, Sektori i Ndjekjes së LM dhe MH në Prodhim, Drejtoria Ekonomike, Sektori Auditimit pranë AKBN.

## Të dhëna mbi treguesit e B. P. A. Ldt

Programi i Punës dhe Buxheti i vitit:

2022, me Nr. 5018 Prot., date 04.07.2022.

2023, me Nr. 7179 Prot., date 04.10.2022.

2021, me Nr. 5262 Prot., date 05.10.2020.

2020, me Nr. 3342 Prot., date 11.06.2020.

2019, me Nr. 12277 Prot., date 13.12.2018.

Treguesit	Niveli Matese	01.01.2019 - 31.12.2019			01.01.2020 - 31.12.2020			01.01.2021 - 31.12.2021			01.01.2022 - 31.12.2022			01.01.2023 - 31.12.2023		
		Programi Punës dhe Buxheti	Fakt	Realizimi në % (Fakti/PP&B)	Programi Punës dhe Buxheti	Fakt	Realizimi në % (Fakti/PP&B)	Programi Punës dhe Buxheti	Fakt	Realizimi në % (Fakti/PP&B)	Programi Punës dhe Buxheti	Fakt	Realizimi në % (Fakti/PP&B)	Programi Punës dhe Buxheti	Fakt	Realizimi në % (Fakti/PP&B)
Pace aktive		576	419	73%	405	392	97%	350	383	109%	411	400	97%	443	399	90%
Prodhimi ditur	BBtd	14,546	15,208	105%	11,963	11,519	96%	10,348	10,373	100%	10,682	9,258	87%	9,656	8,974	93%
Prodhimi	MBd	5,312	5,551	104%	4,379	4,216	96%	3,773	3,786	100%	3,900	3,379	87%	3,525	3,376	93%
Prodhimi	Tm	885,692			674,256			602,078	607,114	101%		542,321			527,311	
Prodhimi i shitur	MBd	5,480			4,101			3,866				3,355			3,314	
Bruto	SdH	64	80%		39	42	106%	47	71	150%	70	101	145%	90	83	92%
% e Brerit	SdH	1	77	9898%		1		1	1	103%	1	1	99%	1	1	98%
Çmimi mesatar i shites	SdH	62	50	80%	30	34	111%	36	56	155%	59	85	144%	73	66	90%
Çmimi mesatar i shites	S/Tm	311			210			354			551		529		407	
Të ardhura Bruto	MS	330,177	356,972	108%	132,800	141,965	106%	137,337	215,101	157%	228,820	286,779	125%	253,179	214,773	85%
PPF	Tm	22,200	21,998	99%	18,900	18,938	100%	16,000	16,303	102%	14,000	14,036	100%	12,100	12,083	100%
PPA	Tm	8,100	8,637	107%	6,800	6,553	96%	5,800	8,636	149%	16,900	15,849	94%	14,500	15,457	107%
PP&A PPA	Tm	30,300	30,635	101%	25,700	25,491	99%	21,800	24,940	114%	30,900	29,894	97%	28,600	27,540	104%
Vlera e PPA	MS	3,689	6,845	186%	3,451	3,970	115%	3,665	5,776	158%	5,212	7,422	142%	5,525	4,922	89%
Vlera e PPA	MS	3,215	2,688	84%	1,293	1,374	106%	1,339	3,060	229%	6,297	8,381	133%	6,616	6,296	95%
Vlera e PP&A PPA	MS	11,904	9,533	80%	4,744	5,344	113%	5,004	8,836	177%	11,509	15,803	137%	12,141	11,217	92%
Të ardhura nga shites	MS	318,273	272,082	85%	128,055	137,507	107%	132,333	217,733	165%	217,311	284,739	131%	241,038	217,593	90%
Bruto	MS	32,149	35,013	109%	12,935	13,739	106%	13,367	20,932	157%	22,360	27,936	125%	24,765	20,985	85%
Oper&Oil Inventory	MS	77,530			53,105			54,656				58,314		66,567		
Shpenzime Transporti	MS	8,115	11,812	146%	13,853	11,710	85%	8,562	12,812	150%	18,780	16,344	88%	17,000	19,730	116%
G&A	MS	18,118	16,007	89%	14,607	13,291	91%	15,408	11,326	69%	15,576	12,152	78%	13,246	15,048	114%
OP&EX Total	MS	85,568	78,080	91%	66,821	54,561	82%	60,859	54,244	90%	62,253	59,025	95%	70,439	65,716	93%
OP&EX-Shpenzime Transporti+G&A	MS	112,801	105,968	94%	95,280	79,562	84%	85,629	78,482	92%	96,624	87,611	91%	100,685	101,494	101%
CAPEX	MS	157,733	108,919	69%	23,780	21,598	91%	27,057	16,207	60%	66,176	40,394	61%	97,284	51,687	53%
Konto Total	MS	270,531	214,887	79%	119,090	101,160	85%	112,686	94,588	84%	162,800	128,005	79%	197,969	153,181	77%
Costs Flow from operation	MS	173,323	131,101	76%	19,840	44,205	223%	33,337	118,319	355%	99,327	169,192	172%	115,588	95,114	82%
Cost Recovery	MS	15,900	22,182	140%	(3,940)	22,607	-574%		102,112		32,151	128,798	401%	18,304	43,427	237%

## Dorëzimi i raporteve mujore

Bazuar në Nenin 15, pika 15.2 “Regjistrimet që i jepen AKH (AKBN)” të LM, ku citohet se:

*“Jo më vonë se 45 ditë (dyzet e pesë ditë) pas përfundimit të çdo periudhe 6 mujore i Licencuari i dorëzon AKH kopje të dokumentacioneve të llogarive që pasqyrojnë Kostot Hidrokarbure që*

*i Licencuari realizoi gjatë asaj periudhe 6 mujore. Dokumentacioni llogaritës i dhënë nga i licencuari do të jetë me hollësi të mjaftueshme për të lejuar AKH të përcaktojë rregullsinë e Kostove Hidrokarbure të realizuara. Në shtesë të sa më sipër i licencuari do ti jap AKH kopje te regjistrave të operacioneve hidrokarbure, ashtu si ato janë kryer”*

Dhe në Aneksin B, neni 4 “Raportet Financiare që dorëzohen të Albpetrol SHA të MH:

*“4.2 Kontraktori do të dorëzojë te Albpetrol brenda 45 ditëve nga fundi i çdo Tremujori Kalendarik:*

*4.2.1 Një raport të shpenzimeve dhe faturave sipas MH të analizuara me buxhetin duke treguar:*

*a. Shpenzimet aktuale dhe faturat për 3-mujorin kalendarik në diskutim*

*b. Shpenzimet aktuale kumulative në atë datë*

*c. ndryshimet ndërmjet shpenzimeve të buxhetuara dhe shpenzimeve aktuale dhe shpjegimet e tyre”*

**Gjetja 4:** Nga auditimi i zbatimit të detyrimeve të raportimit dhe afateve ligjore për dorëzimin e progres raporteve me kostot respektive u konstatua se:

- B. P. A. L. dorëzon pranë AKBN dhe Albpetrol SHA progres raporte mujore dhe tremujore (jo sipas parashikimit në LH 6 mujore për AKBN) si dhe se të gjithë raportet e mësipërme janë dorëzuar me vonesë duke mos zbatuar afatin maksimal prej 45 ditësh nga përfundimi i periudhës raportuese në kundërshtim me në Nenin 15, pika 15.2 “Regjistrimet që i jepen AKH (AKBN)” të LM dhe neni 4 të Aneksit B “Procedurat llogaritëse” të MH.

- B. P. A. L. nuk ka dorëzuar pranë AKBN deklaratën e të ardhurave dhe humbjeve për çdo vit fiskal, jo më vonë se 90 ditë pas përfundimit të këtij viti, me qëllim që të nxjerr në pah Fitimin apo humbjen neto të tij në lidhjet me operacionet hidrokarbure për atë Vit Fiskal sipas Nenin 15, pika 15.4 “Deklarimet e të ardhurave dhe humbjeve” të LM, për nga rëndësia e nivelit të lartë. Për sa më sipër mban përgjegjësi AKBN dhe Albpetrol Sha.

## **Monitorimi**

Shoqëria Albpetrol nga matjet që ka zhvilluar tek kontraktori B. P. A. L., ka evidentuar mospërputhje me progres raportet në lidhje me sasinë e prodhimit të puseve

Aktiviteti i Sektorit të Monitorim-Supervizimit është i përqendruar më shumë në vendburimin Patos-Marinës, i cili administrohet nga kontraktori B. P. A. L. duke qenë se është edhe vendburimi më i madh i naftës.

Spektori i Monitorim dhe Supervizimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure merret me monitorimin dhe supervizimin e gjithë aktivitetit hidrokarbur operacional, në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure lidhur me nxjerrjen e naftës dhe gazit.

Funksionet dhe detyrat kryesore të Sektorit të Monitorim dhe Supervizimit janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të Albpetrolit.

## **Nga dokumentacioni i vendosur ne dispozicion nga Albpetrol, rezulton, se:**

Spektori i Monitorim dhe Supervizimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure, gjatë periudhës ne auditimit ka kryer monitorim të operacioneve hidrokarbure, të cilat janë zhvilluar nga kontraktorët në vendburimet përkatëse të naftës dhe gazit, duke monitoruar operacionet si:

- Monitorim të prodhimit.
- Monitorim të sondave të shpimit të puseve.
- Monitorim të sondave të remontit nëntokësor.
- Monitorim të përdorimit të diluentit/solar.
- Monitorim të puseve të injektimit të ujit dhe prodhimit të ujit, në vendburim.
- Monitorim të shitjes të naftës pranë pikës të lëvrimit, Hub Fier, PIA dhe të tjera.
- Monitorim të punimeve ndërtimore.
- Monitorim të mjedisit.



Sektori i Monitorim-Supervizimit gjatë monitorimeve të kryera ka konstatuar problematika të ndryshme, kryesisht, mbi:

Matjen e prodhimit. Albpetrol në matjet që ka zhvilluar tek kontraktori B. P. A. L., ka evidentuar mospërputhje me progres raportet në lidhje me sasinë e prodhimit të puseve.

Sasisë se ujit te prodhuar dhe injektuar. Albpetrol ka konstatuar mos rakordim të shifrave me të dhënat e kontraktorit.

Shitjen e naftës në pikën e lëvrimit Fier-Hub, shitjet brenda vendit. Albpetrol ka konstatuar që në depozitën pritëse të naftës është shkelur standardi i shitjes së naftës pasi kjo depozite duhet të jetë vetëm për grumbullim dhe jo edhe për shitje të naftës bruto.

Për të gjithë tremujoret, prodhimi i përgjithshëm i deklaruar nga kompania është realizuar ose tejkaluar. Përsa i përket të ardhurave, diferencat që krijohen duke krahasuar sasinë e naftës bruto të prodhuara (fakti) me programin e punës dhe buxhetin edhe pse prodhimi është me i lartë, ka ndikuar çmimi i bursës së naftës e cila ka pësuar rënie me rreth 23%. Kontraktori ka realizuar mesatarisht rreth 76% të treguesve të programuar. Gjithashtu, për shkak të çmimit të ulët të shitjes ka ndikuar edhe në vlerat e ulëta si: PEP, ASP, Të Ardhura Nga Shitja dhe Renta Minerare.

Shpenzimet Operative (OPEX) për të tre tremujoret kanë qenë nën buxhetin e parashikuar. Realizimi i (OPEX) për të gjithë tremujoret është realizuar mesatarisht në masën 83% kundrejt shifrave të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetit të vitit 2019 dhe 2020. Realizimi i G&A për të gjithë tremujoret është realizuar mesatarisht në masën 86% kundrejt shifrave të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetit të vitit 2019 dhe 2020 (Q3-2019 84%, Q4-2019 96% dhe Q1-2020 77%). Realizimi i Shpenzimeve Kapitale (Capex) për të gjithë tremujoret është realizuar mesatarisht në masën 63% kundrejt shifrave të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetit të vitit 2019 dhe 2020 (Q3-2019 73%, Q4-2019 57% dhe Q1-2020 61%).

Shumë nga projektet kapitale janë ndjeshëm nën parashikimin e bërë në buxhet për shkak të vonesave, por në fokus ka qenë gjithashtu edhe përdorimi i pajisjeve të përdorura për të kompletuar pjesë të projekteve, atje ku është e mundur, në vend që të bliheshin pajisje të reja. Realizimi i Capex për Projektin Termal për të gjithë tremujoret është realizuar mesatarisht në masën 24%. (Q3-2019 24%, Q4-2019 46% dhe Q1-2020 0 %).

Gjithashtu, theksojmë se Capex për Projektin Termal nuk futet në kostot e rikuperueshme nëse nuk del projekt me fitim.

Programi i Punës dhe Buxheti i vitit 2019 është miratuar nga ana e Albpetrol dhe AKBN. Programi i Punës dhe Buxheti i vitit 2020 u miratua nga ana e Albpetrol me propozimet e parashtruara nga anëtarët e KTSH.

### **Shpallja e Forcës Madhore**

Shoqëria B. P. A. Ltd, nëpërmjet shkresës së dërguar me nr. 304 prot., datë 31.03.2020 ka dërguar Njoftim Për shpallje të Forcës Madhore dhe mbylljen përkohësisht dhe pjesërisht të vendburimit Patos – Marinzë, pasi blerësi C. dhe Qeveria Spanjolle ka ndaluar çdo aktivitet duke përfshirë edhe operacionet që kryhen në rafineri, për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid – 19.

Shoqëria Albpetrol SHA me shkresën Nr. 1891/1, datë 10.04.2020 ka sqaruar se Grupi i punës i Sektorit të Monitorimit – Supervizimit të Albpetrol SHA gjatë inspektimit në terren konstatoi se në vendburimin Patos – Marinzë nuk ka patur ndërprerje të operacioneve hidrokarbure në lidhje me prodhimin e naftës në puset e këtij vendburimi.

Ndërkohë me shkresën nr. 304/4 prot. Datë 10.04.2020 B. P. A. Ltd. Ka njoftuar mbylljen e përkohshme të operacioneve për nxjerrjen e naftës në vendburimin Patos – Marinzë për shkak të pamundësisë për të eksportuar prodhimin dhe për të gjetur blerës të tjerë.

B. P. A. Ltd me shkresën nr. 330/2, datë 14.05.2020 ka njoftuar rifillimin e operacioneve të nxjerrjes dhe trajtimit të vendburimit Patos – Marinzë. Ndërkohë i është kërkuar nga Albpetrol SHA një sqarim i detajuar në lidhje me shpalljen e forcës madhore.

Nëpërmjet shkresës nr. 3797 prot., datë 03.07.2020, Albpetrol SHA sqaron se ngjarja e njoftuar nga B. P. A. L. nuk i përmbush kushtet kumulative për t'u konsideruar Forcë Madhore dhe ndërkohë kërkon nga kjo e fundit vënien në dispozicion të dokumentacion justifikues përkatës si kontratën e shitblerjes me C., njoftimin e C. drejtuar B. P. A. L. për Forcën Madhore dhe njoftim të mëtejshëm për tërheqjen e naftës bruto, planin e menaxhimit të situatës, etj.

### **Programi i punës i dorëzuar nga kontraktori**

Shoqëria B. P. A. ka dorëzuar pranë Albpetrol SHA Programin e punës dhe buxhetin me shkresën nr. 9382, datë 28.09.2018.

Bazuar në Nenin 8 “Programi Vjetor dhe Buxhetet”, pika 8.2 të MH, ku citohet se:

*“Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas Datës Efektive, Palët do të paraqesin tek AKH-ja Program vjetor dhe Buxhet duke parashtruar Operacionet Hidrokarbure të cilat Kontraktori i propozon për tu kryer (ose tashmë ka filluar kryerjen) gjatë Periudhës së Vlerësimit. Në përputhje me Nenin 6.3, ky Program Vjetor dhe Buxhet do të jetë konsistent me Programin e Vlerësimit, por me gjykim të Kontraktorit, ai mund të përfshijë me shumë aktivitete dhe buxhete kapitale sesa Programi i Vlerësimit. Gjatë Periudhës së Vlerësimit nuk kërkohet as aprovimi i Albpetrolit dhe as i Komitetit Këshillimor për ndonjë Program vjetor dhe Buxhet. Kontraktori mund të kërkojë amendimin e Programit Vjetor dhe Buxhetin gjatë Periudhës së Vlerësimit për aq kohë sa ky Program Vjetor dhe Buxhet i rishikuar përfshin të paktën aktivitetet dhe buxhetin kapital të Programit të Vlerësimit. Një kopje e secilit Program vjetor dhe Buxhet do ti jepet nga Kontraktori Albpetrolit dhe AKH-së”*

Pika 8.3 të MH-së ku citohet se:

*“Të paktën nëntëdhjetë (90) ditë para fundit të Vitit Fiskal të parë pas aprovimit të Planit të Zhvillimit dhe çdo Vit Fiskal pas tij, ose në kohë të tilla siç do të bihet dakord nga Palët, Kontraktori do të përgatisë dhe dorëzojë në Komitetin Këshillimor për aprovim një Program Vjetor dhe Buxhet të propozuar për Vitin Fiskal pasardhës. Çdo Program Vjetor dhe Buxhet do të jetë konsistent me Planin e Zhvillimit. Nëse përfaqësuesit e Albpetrolit në Komitetin Këshillimor dëshirojnë të propozojnë një rishikim në lidhje me disa veçori specifike të Programit Vjetor dhe Buxhetit në fjalë, brenda njëzet e një (21) ditëve pas marrjes nga Komiteti Këshillimor ai do të njoftojë njësoj Kontraktorin, duke specifikuar me detaje te arsyeshme arsyet e tij për këtë. Menjëherë pas kësaj, Palët do të takohen dhe do të përpiqen të bien dakord mbi rishikimin e propozuar nga përfaqësuesit e Albpetrolit. Kontraktori do të japë atë që i takon në lidhje me propozimet e përfaqësuesve të Albpetrolit, me kusht që Albpetrolit do ti kërkohet të aprovojë çdo Program vjetor dhe Buxhet që është konsistent me Planin e Zhvillimit, dhe çdo rishikim i propozuar ndaj një Programi Vjetor dhe Buxheti që janë konsistent me Planin e Zhvillimit nuk ka nevojë të pranohet nga Kontraktori. Në rast të lindjes së ndonjë konflikti në lidhje me aprovimin e një Programi Vjetor dhe Buxheti, në përputhje me Nenin 19.10, çështja do të çohet për përcaktim Eksperti. Para zgjedhjes të çdo konflikt të tillë, Programi Vjetor dhe Buxheti i propozuar nga Kontraktori, do të gjykohet i aprovuar për qëllime operacionesh të brendshme gjatë zgjidhjes”.*

### **Detyrimet për energjinë elektrike**

**Gjetja 5:** Prej vitit 2003 Albpetrol SHA zotëron të drejtën e furnizimit dhe tregtimin me energji elektrike të klientëve të kualifikuar.

Në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion shuma totale e detyrimit financiar të papaguar në lidhje me furnizimin me energji elektrike, është:

Deri më 31.12.2019 detyrim i palikujduar është 469,217,864 lekë (sipas shkresës nr. 3668/2 prot. datë 29.06.2020 që Albpetrol Sha i dërgon B. P. A. L.)

Deri më 31.12.2020 detyrim i palikujduar është 1,099,475,784 lekë (sipas shkresës nr. 2583/2 prot. datë 16.04.2021 që Albpetrol Sha i dërgon B. P. A. L.)

Deri më 31.12.2021 detyrim i palikujduar është 1,116,601,821 lekë (sipas shkresës nr. 2418/2 prot. datë 18.03.2022 që Albpetrol Sha i dërgon B. P. A. L.)

Deri më 31.12.2022 detyrim i palikujduar është 587,046,364 lekë (sipas shkresës nr. 2462 prot. datë 19.04.2023 që Albpetrol Sha i dërgon B. P. A. L.)

Deri më 31.12.2023 detyrim i palikujduar është 1,654,040,397 lekë (sipas shkresës nr. 2607 prot. datë 08.05.2024 që Albpetrol Sha i dërgon B. P. A. L.)

Detyrimi në total i B. P. A. L. për energjinë elektrike ndaj Albpetrol SHA deri në 31.12.2023 **1,654,040,397 lekë.**

Albpetrol SHA nuk i vuri në dispozicion grupit të auditimit asnjë kontratë shërbimi për ofrimin e energjisë elektrike me B. P. A. L.. Gjithashtu Albpetrol SHA nuk aplikon penalitete apo kamat vonesa për mos likuidim në kohë të faturave të energjisë elektrike nga B. P. A. L. si dhe nuk ekziston asnjë plan masash për rregullimin e problematikës së mësipërme. Për nga rëndësia është e nivelit të lartë. Për sa më sipër mban përgjegjësi MIE dhe Albpetrol SHA.

### **Inventarizimi i Aseteve**

Referuar Pikës 2.4.2 e Marrëveshjes Hidrokarbure:

*“Në intervale të arsyeshme, të paktën çdo vit, do të bëhen nga Kontraktori inventarë për të gjithë Materialet e Kontrollueshëm, dhe në vijim të çdo inventari, do të rregullohen librat e Llogarive dhe regjistrimet për të reflektuar rezultatet e inventarit. Kontraktori do të njoftojë me shkrim tridhjetë (30) ditë për qëllim të inventarëve të tillë për të lejuar Albpetrolin për të zgjedhur nëse do të përfaqësohet apo nuk do të përfaqësohet kur të kryhet inventari.”*

Me shkresën nr. 1369, datë 04.12.2019 “Inspektim i inventarëve të fundvitit 2019” B. P. ka njoftuar Albpetrol SHA për fillimin e procesit të inventarizimit, si pjesë të detyrimeve të Marrëveshjes. Nga Albpetrol SHA nuk u vendos në dispozicion asnjë dokument shkresor mbi përgjigjen e kthyer për kontraktorin.

Me shkresën nr. 1124, datë 16.12.2020 “Inspektim i inventarëve të fundvitit 2020” B. P. ka njoftuar Albpetrol SHA për fillimin e procesit të inventarizimit, si pjesë të detyrimeve të Marrëveshjes. Nga Albpetrol SHA nuk u vendos në dispozicion asnjë dokument shkresor mbi përgjigjen e kthyer për kontraktorin.

- Shoqëria “Albpetrol” SHA me shkresën me Nr. 10641 Prot., datë 24.12.2021 dërgon shkresë në lidhje me personat që do të marrin pjesë në procesin e inventarizimit të fundvitit 2021. (inventarizimin e materialeve dhe atë të naftës bruto).
- Shoqëria “Albpetrol” SHA, me shkresën me Nr. 1051 Prot., datë 03.02.2022, kërkon nga B. P. A. L. që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2021, për vendburimin Patos-Marinzë.
- Në mungesë të një përgjigje nga ana e shoqërisë “B. P. A.” Ltd., me shkresën me Nr. 1051/1 Prot., datë 22.04.2022, shoqëria “Albpetrol” Sha dërgon një kërkesë të përsëritur.
- Shoqëria “B. P. A.” Ltd., me shkresën me Nr. 9145 Prot., datë 20.12.2022, njofton për procesin e inventarizimit të fundvitit 2022.
- Shoqëria “Albpetrol” SHA, me shkresën me Nr. 1067 Prot., datë 13.2023, kërkon nga B. P. A. L. që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2022, për vendburimin Patos-Marinzë.

**Gjetja 6:** Në bazë të MH Albpetrol Sha zotëron të drejtën e monitorimit dhe pjesëmarrjes në procesin e inventarizimit të B. P. A. L.. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u

konstatua se strukturat drejtuese te Albpetrol SHA me anë të mosveprimit të tyre kanë lenë në mungesë monitorimi gjendjen e aseteve të dhëna në përdorim si dhe blerjen e aseteve të reja nga kontraktori si dhe ecuria e jetëgjatësisë së tyre në kundërshtim me pikën 2.4.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure. Për nga rëndësia është e nivelit të lartë. Për sa më sipër mban përgjegjësi Albpetrol SHA.

### **Zbatimi i marrëveshjes për Bllokun 2-3**

-Marrëveshje Hidrokarbure me objekt **“Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve në tokë”**, e lidhur ndërmjet **Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore/AKBN dhe **D. P. A.**, në datën **07.11.2008**(Kontrata Fillestare).

-Marrëveshje Hidrokarbure me objekt **“Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve në tokë”**, e lidhur ndërmjet **Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore/AKBN dhe **Sh. U. A. B.V**, në datën **23.12.2019** (Amendimi Kontratës).

Qeveria Shqiptare përmes Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë, dhe Energjitikës të Shqipërisë (tani Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), (e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, këtu e në vijim referuar si “AKBN”), në përputhje me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993, “Ligji për Hidrokarburet(Kërkimi Prodhimi), si njëra palë, e përfaqësuar nga z. G. R. dhe “D. P. A.” pala tjetër, një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas Ligjeve të Zvicrës, (emri i të cilës është ndryshuar zyrtarisht është bërë P. A. GmbH) kanë lidhur kontratë me ndarje prodhimi për blloqet 2-3 në tokë në Shqipëri, më datë 27 nëntor 2008, (Kontratë Fillestare) të miratuar me V.K.M nr. 754, datë 08.07.2009 të botuar në fletoren zyrtare nr.116, datë 31.07.2009.P. A. GBMH i ka kaluar kompanisë Sh. U. A. B.V të gjitha interesat e saj në kontratën fillestare, me marrëveshjen e shit-blerjes datë 02.02.2016 dhe nga akti-transferimi më datë 01.04.2016, transferim i cili është miratuar nga AKBN me shkresë me nr. 1670/2 prot, datë 10.02.2016.

Amendimi i kontratës është nënshkruar me datë 23.12.2019, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga znj. B. B. si njëra palë dhe Sh. U. B.V, (këtu e në vijim referuar si “Sh.”), e përfaqësuar nga R. D. me numër regjistrimi të Dhomës së Tregtisë të Den Haag, Holandë, Nr.8..... si pala tjetër (këtu e në vijim “Kontraktori”).Kjo Kontratë/Marrëveshje me objekt, “kërkimin, zhvillimin, dhe prodhimin e Hidrokarbureve në tokë”, ka për qëllim kryerjen e të gjithë operacioneve të kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të Hidrokarbureve në dhe përmes zonës së kontratës si dhe përmbushjen e detyrimeve dhe gëzimin e të drejtave që ka si Kontraktor “Sh.” ndaj AKBN në përputhje me kushtet e përgjithshme të kontratës fillestare. Operacionet Hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë rregullohen nga Ligjet e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993, “Ligji për Hidrokarburet”, i ndryshuar; AKBN është e autorizuar nga Qeveria Shqiptare për të kryer të gjitha operacionet Hidrokarbure në Shqipëri, përfshirë, Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin.

Pra referuar sa më sipër Sh. U. A. B.V është bërë Operatori në kontratën me ndarje prodhimi për blloqet 2-3 në tokë, në Shqipëri dhe është përgjegjës për kryerjen e të gjithë operacioneve të kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të Hidrokarbureve, në dhe përmes zonës së Kontratës. AKBN i ka dhënë Kontraktorit të drejtën ekskluzive për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në zonën e kontratës për bllokun 2-3 sipas hartës treguese të zonës së kontratës. *Kjo marrëveshje/kontratë e lidhur bazuar në Ligjin për Hidrokarburet dhe rregulloren për marrëveshjet Hidrokarbure ka të përcaktuar terma dhe kushte që duhet të përmbushin palët si më poshtë;*

**Neni 4, (periudha e kërkimit, programi i punës dhe shpenzimet e parashikuara).**

Periudha e kërkimit e përcaktuar është ndarë në 3(tre) faza. *Faza e parë e kërkimit* është përcaktuar 3 vite kontraktuale. Gjatë kësaj faze Kontraktori do të zbatojë programin minimal të punës si më poshtë:

	<b>Programim minimal i punës</b>		<b>Shpenzimet minimale në USD</b>
1	Vlerësimi G&G		400.000
2	Ripërpunim sizmik	150 km	100.000
3	Pus kërkimi blloku 2	4 km	8.000.000
	<b>Angazhim total</b>		<b>8.500.000</b>

Vlerësimi G&G: mbledhje e të dhënave teknike, ripërpunimi i linjave sizmike, të përzgjedhura, interpretimi, i të dhënave gjeologjike, gjeofizike dhe të pusit. Studimet rajonale gjeologjike dhe strukturore(hartografike, balancim i profileve tërthore).

Pus kërkimi: Një pus në thellësinë vertikale minimale 4000 m, ose deri sa të arrijë karbonatet e Eocenit ose të Kretakut, cilado të ndodhë e para.

Gjatë periudhës së parë të kërkimit, përveç përmbushjes së programit minimal të punës të përcaktuar, kontraktori mund të zgjedhë të kryejë punime kërkimi shtesë, punime dhe përpunime sizmike, punime fushore gjeologjike dhe studime mekanike të shkëmbinjve. Punimet shtesë dërgohen në AKBN për miratim, miratim i cili nuk do refuzohet pa arsye.

**Lidhur me fazën e parë të kërkimit** e parashikuar me një kohëzgjatje 3 vjetësh sipas nenit 4 të sipërcituar, **rezulton se:** Kontraktori me shkresën me nr. 079 prot, datë 14.05.2010 ka depozituar (**garancinë bankare**) në zbatim të **nenit 29.4** dhe më pas ka realizuar programin minimal të punës ku përfshihen studimet gjeologjike-gjeofizike me vlerë (400.000 USD), ripërpunim i 150 km sizmike ekzistuese 2 D me vlerë (100.000 USD) si dhe shpimin e pusit me detyrim financiar (8 milion USD).Duhet theksuar se garancia bankare është dorëzuar 6 muaj me vonesë.

Kompania gjithashtu realizoi shtesë dhe një volum prej 550 km sizmik 2 D si pjesë të strategjisë për të kuptuar më mirë strukturat gjeologjike në këtë bllok. Pusi i shpuar është Shpirag-2.Faza e parë është zgjatur me (1 vit dhe 6 muaj) për shkak të testimit të naftë-gazmbajtës të pusit, e cila është e parashikuar nenin 4.3 të kontratës ku shpreh: *Periudha e parë, periudha e dytë dhe periudha e tretë e kërkimit do të zgjatet automatikisht me periudhën e kohës së nevojshme për të lejuar përfundimin e shpimit apo testimit të një pusi dhe/ose vlerësimin e rezultateve nga shpimi apo testimi i një pusi, megjithatë me kusht që një periudhë e tillë vlerësimi të mos i kaloj 6 muaj.*

Operacionet e testimit të pusit Shpirag-2 përfunduan në datën 03.12.2013.Kompania me shkresën me nr.755 prot, datë 13.12.2013 të dërguar në AKBN deklaroi se ka bërë zbulim në pusin Shpirag-2 nga ku ka paraqitur dhe një plan vlerësimi me objektiv provimin e komercialitetit të pusit Shpirag-2 në zbatim të nenit 6.1, neni 6.2 të kontratës e cila u miratua nga palët në Komitetin Këshillimor në datën 12.03.2014 në përputhje me nenin 6.5 të Kontratës.

*Faza e dytë e kërkimit*, e parashikuar në kontratë zgjat 2 vjet me kusht që të ketë përfunduar programi minimal i punës për periudhën e parë të kërkimit apo që Kontraktori ti ketë paguar AKBN-së shumën përkatëse në USD, të kësaj kontrate, Kontraktori do të ketë alternativën e shtyrjes së periudhës së kërkimit me një periudhë shtesë prej 2(dy) vitesh (periudha/faza e dytë e kërkimit).Kjo alternativë ushtrohet duke njoftuar me shkrim AKBN-në jo më pak se 30 ditë përpara përfundimit të periudhës së parë të kërkimit. Kontraktori ka detyrimin të realizoj kryerjen G&G me (300.000 USD) si dhe shpimin e 1 pusi kërkimi (8 milion USD).Kontraktori me shkresën me nr. 335 prot, datë 02.05.2014, ka njoftuar AKBN për hyrjen në fazën e dytë të kërkimit, më pas ka konfirmuar depozitimin e **garancisë bankare** me shkresën me nr. 477 prot, datë 19.06.2014 brenda afateve pra në përputhje me **nenin 29.4**. AKBN pas përmbushjes së detyrimeve nga Kontraktori ka miratuar hyrjen në fazën e dytë të kërkimit. Ne fazën e dytë u parashikua shpimi i puseve Molisht-1 dhe Shpirag-3.

**Lidhur me fazën e dytë të kërkimit, rezulton se:** Në mbledhjen e Komitetit Këshillimor më datë 30.04.2014 u analizua ecuria e vitit dhe u miratua plani punës dhe buxheti për vitin 2015. Për vitin 2015 u parashikua që të vazhdohet me shpimin e pusit Molisht-1 ST3 (Devijimi 3) dhe testimin e tij si dhe përgatitjen për pusin Shpirag-3. Kompania nisi shpimin e pusit Molisht-1 nga ku 2 here u arrit objekti karbonatik i Eocenit i cili është potencialisht objektivi i kërkuar respektivisht në thellësinë 4175m dhe 4247m. Pusi Molisht-1 u pezullua në datën 06.11.2014 pasi sonda e instaluar nuk përballonte problematikat teknike që pusi shfaqte. Kontraktori me shkresën me nr. 8739 prot, datë 06.10.2015, paraqiti në AKBN programin e mbledhjes dhe dokumentin prezantues për diskutim dhe miratim nga Komiteti Këshillimor. AKBN në mbledhjet e mëparshme i ka kërkuar Kontraktorit kalendarin e operacioneve hidrokarbure që do të kryej në kuadër të kërkimit dhe vlerësimit në blloqet 2-3. Kontraktori nuk i ka vënë në dispozicion AKBN-së asnjë dokumentacion në lidhje me këtë çështje por i ka paraqitur këto dokumenta në mbledhjen pasuese. Pra nga ana e Kontraktorit nuk ka korrektësi në lidhje me vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nga AKBN. Nga materialet e paraqitura nga Kontraktori në rezulton se zona e zbulimit shtrihet dhe në jug të pusit Molisht-1, 9 km. Nuk përcaktohet qartë çfarë detyre ka Molisht-1 në një kohë që AKBN sipas raporteve të auditimit e ka konsideruar si pus me detyrë kërkimi dhe jo vlerësimi nga ku më pas është pranuar nga kompania në takimet e zhvilluara. Pusi Shpirag-3 filloi shpimin në datën 05.06.2016 me qëllim për të vlerësuar naftë-gazmbajtjen në gëlqerorët e Eocen-Kretës. Ecuria e pusit Shpirag-3 është shoqëruar me mjaft komplikacione gjatë shpimit në të cilën trangu i pusit ka devijuar 7 herë. Në datën 09.11.2017 kompania vendosi pezullimin për tu rikthyer pas përfundimit të pusit Shpirag-4. Pusi Shpirag-4 filloi më datë 05.01.2018 dhe përfundoi në datën 28.08.2018 në thellësinë 5643 nga 6100 m të parashikuar si pasojë e një bllokimi në trangu e hapur. Më pas u kryen përgatitjet e nevojshme për kryerjen e operacioneve të testimit të cilat filluan 20.09.2018. Në datën 09.07.2019 kompania u rikthye në Shpirag-3 me qëllim rifillimin e shpimit të pusit. Në thellësinë 4467 instrumenti i shpimit u bllokua. Në datën 06.11.2019 në thellësinë 4496 instrumenti shpimit u bllokua përsëri. Pra Kontraktori ka shtyrë afatin në mënyrë të pa justifikuar. AKBN i është drejtuar kompanisë nga ku i ka shprehur që duhet të dilet me një konkluzion sa i përket vlerësimit nga ku është tejzgjatur kjo periudhë. Deklarimi i zbulimit është bërë në datën 13.12.2013 për Shpirag-2 dhe duhet të përfundonte pas 6 muajsh 13.06.2014. Edhe me amendimin e Ligjit për Hidrokarbure ku parashikon kohëzgjatjen e periudhës së vlerësimit deri në 3 vjet përsëri Kontraktori është jashtë afateve të parashikuara, pra duhet ta përfundonte në datën 13.12.2016. Në lidhje me planin e vlerësimit dhe aktivitetin që do të kryhet rezulton se plani i paraqitur nga kompania me shkresën me nr. 57 prot, datë 06.02.2014 ku ka si objektivi të provojë komercialitetin e pusit Shpirag-2 është jashtë afateve dhe është tejzgjatur. Referuar kontratës me ndarje prodhimi (KNP) në të cilën përcaktohet që Kontraktori brenda (60 ditësh), pas njoftimit të zbulimit do njoftojë AKBN me shkrim nëse Kontraktori e konsideron zbulim që ja vlen të vlerësohet si zbulim komercial rezulton se afati i përcaktuar është tejkaluar dhe është zgjatuar gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe gjysmën e 2019 duke mos e argumentuar këtë periudhë zgjatje. Pra nga ana e Kontraktorit nuk ka një program të veçantë të mirë argumentuar në të cilën të përcaktoj arsyet që çuan në shtyrjen e afatit që në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme. Një plan tjetër vlerësimi është paraqitur nga Sh. në tetor 2016, nga ku sipas parashikimeve të kompanisë për periudhën 2016-2021 parashikohen të shpohen 5 puse të tjera (Shpiragu-3 A-1, Golemaj-1, Shpiragu-5 dhe Shpiragu-6). Më vonë në muajin nëntor 2017, Sh. ka parashikuar që për periudhën nga viti 2017-2024 të operojë me një sondë dhe të shpoj 5 puse të reja vlerësim (Shpiragu-4, Shpiragu-S, Shpiragu-6 dhe 2 puse të pa emërtuara). Të gjitha këto operacione janë parashikuar deri në vitin 2024 duke mos u parashikuar përsëri një deadline të përfundimit të periudhës së vlerësimit. Kryerja e punimeve sizmike 3 D është lënë opsionale, në funksion të rezultateve të vlerësimit dhe testimit afatgjatë të puseve të vlerësimit. Kontraktori nuk ka paraqitur në AKBN projektin gjeologjik dhe atë të

shpimit të pusit Shpirag-3 i cili duhet të njihej dhe supervizohej nga AKBN. E thënë ndryshe që nga fillimi i Marrëveshjes në vitin 2009 mos përcaktimi i saktë i afateve kohore, zgjatja e afateve të pa argumentuara ka bërë që gjatë 15 viteve, Kontraktori të mos zbatojë detyrimet kontraktuale të përcaktuara. Pra Kontraktori pas (15vitesh) duhet të ishte në fazën e prodhimit të Hidrokarbureve. Duhet theksuar që në të gjitha rastet referuar operacioneve hidrokarbure përcaktimi i kushteve, termave, afateve në kontratë pavarësisht se kemi të bëjmë me një punë e cila kryhet në kushte jashtëzakonisht të vështira përsëri zbatimi i afateve të përcaktuara është detyrim i Kontraktorit duke qenë se konsiderohet pasuri kombëtare e Shtetit Shqiptar dhe çdo vonesë jashtë afateve të kontratës nënkupton humbje nga Shtetit Shqiptar. Duhet përmendur gjithashtu që si rrjedhojë e shtyrjes çdo kosto shtesë jashtë afatit është në dëm të Shtetit pasi referuar nenit 7 citohet që: *Kontraktori do të mbulojë të gjitha kostot dhe shpenzimet sipas kontratës nga pjesa e hidrokarbureve të disponueshme, që në vijim referohen sipas rastit nafta bruto për mbulimin e kostos, gazi për mbulimin e kostos. Pjesa e hidrokarbureve të disponueshme që do të përcaktohen si Hidrokarbure për mbulim kostoje është 90% pas heqjes së rentës minerare dhe grantit të Qeverisë.* Pra të gjitha shpenzimet e kryera të njohura nga AKBN në fazën e prodhimit do ti përfitoj Kontraktori në sasi Hidrokarburesh. Faza e kërkimit dhe faza e vlerësimit është hartuar në përputhje me Legjislacionin ndërkombëtar e cila nuk parashikon sanksione për mospërmbushje detyrimesh kontraktuale.

**Neni 6, (zbulimi, vlerësimi, zhvillimi).** Bazuar në kushtet e përcaktuara në Kontratë në momentin e zbulimit të Hidrokarbureve në zonën e kontratës do të njoftojë AKBN brenda (30) ditëve nga zbulimi i tyre. Nëse Kontraktori gjykon se një zbulim ka nevojë për vlerësim do të dërgojë për miratim në AKBN sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se (6) muaj pas përfundimit të Pusit të kërkimit në fjalë, një program të detajuar vlerësimi dhe buxhetin përkatës. Programi i vlerësimit duhet të përshkruajë zonën e zbulimit dhe vendndodhjen, shtrirjen dhe madhësinë e përllogaritur të zbulimit dhe duhet të përfshijë gjithashtu planin për vlerësimin e zbulimit dhe periudhën e nevojshme të vlerësimit për të përfunduar programin e vlerësimit. Brenda (90) ditësh nga përfundimi i vlerësimit, Kontraktori do të dorëzojë një raport te Komiteti Këshillimor i kërkimit për rezultatet e programit të vlerësimit. Raporti duhet të përfshijë të gjitha të dhënat përkatëse teknike dhe ekonomike dhe duhet të specifikojë nëse është zbulim tregtar. Kontraktori raporton se një zbulim është zbulim tregtar do të përgatis një plan zhvillimi dhe do të dorëzojë në AKBN për miratim. Plani i zhvillimit duhet të jetë në përputhje me kushtet e kontratës. Kontraktori duhet të mbajë të shënim të dhënat lidhur me sasinë e Hidrokarbureve të disponueshme dhe ujit të prodhuar çdo muaj kalendarik sipas kontratës ku tregohet pjesa korresponduese e Hidrokarbureve Fitimi për secilën palë sipas kësaj kontrate. Këto të dhëna do të dorëzohen çdo muaj pranë AKBN dhe tek autoritet tatimore përkatëse Shqiptare. Statistikat ditore ose javore lidhur me prodhimin nga zona e kontratës duhet të jenë të disponueshme në çdo kohë.

Kontraktori do të dorëzojë në AKBN, brenda (60) ditësh nga përfundimi i çdo tremujori kalendarik një situacion të veprimtarisë së zhvillimit ku pasqyrohen të gjitha detyrimet dhe kreditimet në lidhje me zhvillimin dhe prodhimin për atë tremujor kalendarik të përmbledhura sipas klasifikimit të duhur që tregojnë natyrën e tyre përfaqësuesit e autorizuar të AKBN.

**Sa i përket zbulimit** në lidhje me Operacionet e testimit të pusit Shpirag-2 **rezulton se:** operacionet përfunduan në datën 03.12.2013. Kompania me shkresën me nr.755 prot, datë 13.12.2013 të dërguar në AKBN deklaroi se ka bërë zbulim në pusin Shpirag-2 nga ku ka paraqitur dhe një plan vlerësimi me objektiv provimin e komercialitetit të pusit Shpirag-2 në zbatim të nenit 6.1, neni 6.2 të kontratës e cila u miratua nga palët në Komitetin Këshillimor në datën 12.03.2014 në përputhje me nenin 6.5 të Kontratës. Nga momenti i zbulimit që përkon me fundin e vitit 2013 nga ana e Kontraktorit nuk ka një përgjigje të plotë ku të përcaktohet se çfarë fazë janë operacionet Hidrokarbure. Pra në lidhje me planin e vlerësimit dhe aktivitetin që do të kryhet rezulton se plani i paraqitur nga kompania me shkresën me nr. 57 prot, datë

06.02.2014 ku ka si objektiv të provojë komercialitetin e pusit Shpirag-2 është jashtë afateve dhe është tejzgatur. Referuar kontratës me ndarje prodhimi (KNP) në të cilën përcaktohet që Kontraktori brenda (60 ditësh), pas njoftimit të zbulimit do njoftojë AKBN me shkrim nëse Kontraktori e konsideron zbulim që ja vlen të vlerësohet si zbulim komercial rezulton se afati i përcaktuar është tejkaluar dhe është zgatur gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe gjysmën e 2019 dhe akoma nga kompania nuk ka përgjigje zyrtare për përfundimin e fazës së vlerësimit .Kjo kontratë referuar afateve të përcaktuara duhet të ishte në fazën e prodhimit.

**Neni 7, (mbulimi i kostove dhe shpenzimeve, ndarja e prodhimit dhe hidrokarburet fitim, dhe kostot e pambulueshme).** Kontraktori do të mbulojë të gjitha kostot dhe shpenzimet sipas kontratës nga pjesa e hidrokarbureve të disponueshme, që në vijim referohen sipas rastit nafta bruto për mbulimin e kostos, gazi për mbulimin e kostos. Pjesa e hidrokarbureve të disponueshme që do të përcaktohen si Hidrokarbure për mbulim kostoje është 90% pas heqjes së rentës minerare dhe grantit të Qeverisë. Kontraktori ka të drejtë ti marr Hidrokarburet për mbulimin e kostos në natyrë, ti eksportojë lirisht dhe ti përdor ato. Shpenzimet operative duhet të jene të arsyeshme, domethënë në përputhje me praktikën e Industrisë Ndërkombëtare të Hidrokarbureve dhe çmimet e tregut për shërbimet, pajisjet dhe materialet e të njëjtit lloj dhe cilësie që janë të disponueshme në kohën kur këto shërbime, pajisje dhe materiale kërkohen sipas kontratës. Çdo muaj kalendarik Kontraktori do të marr na natyrë në pikën e matjes dhe do të disponojë Hidrokarbure për mbulim kostoje, plus pjesën e vet të Hidrokarbureve Fitim.

**-Lidhur me mbulimin e kostos, kostos së rikuperueshme(cost recovery) rezulton se:** Kontraktori i ka dorëzuar AKBN-së për vitet 2009-2023 raportet e kostove që nga fillimi i MH të cilat janë 886.043.920 USD

Për sa më sipër AKBN ka kryer auditime mbi certifikimin e kostove sipas viteve respektive, por për vitet Gusht 2009-Shtator 2013 rezulton se nuk janë kryer auditime dhe si rrjedhojë kostot e raportuara nga Kontraktori merren të mirëqena. Veprimet e kryera janë në kundërshtim me kushtet e kontratës Aneksi C(*Procedura kontabël*), neni 2 (*Situacioni veprimtarisë*), neni 3 (*Auditimet dhe rregullimet*). Kostot e raportuara nga Kontraktori për periudhën e pa audituar janë në vlerën 142.601.422 USD .Ndërkohë që në lidhje me pjesën e audituar nga ana e AKBN-së pas auditimeve të kryera nga totali i kostos së raportuar, AKBN nuk i ka njohur 153.271.551 USD. Kontraktori ka paraqitur objeksionet përkatëse nga ku nuk është dakort me konstatimet e AKBN-së, të cilat nuk janë pranuar nga kjo e fundit. Kosto e rikuperueshme nga Kontraktori është 886.043.803 USD e cila do të rikuperohet në fazën e prodhimit Hidrokarbure.

-Siç është theksuar më sipër lidhur me mbulimin e kostos 90%, pas heqjes së rentës minerale dhe grantit të Qeverisë, në të cilën Kontraktori referuar kontratës do ta përfitojë duke marr sasinë e Hidrokarbureve në natyrë pas fazës së vlerësimit dhe hyrjes në prodhim, **grupi auditimit gjykon që:** Nga ana e AKBN duhet ti kushtohet rëndësi e veçantë pjesës së auditimit të kryer, pra certifikimit të kostos si dhe monitorimit të kontratës pasi shpenzimet operative siç është theksuar dhe në kontratë, duhet të jenë të arsyeshme dhe domethënëse në praktikën e Industrisë Ndërkombëtare të Hidrokarbureve dhe çmimet e tregut për shërbimet, pajisjet dhe materialet. Pra referuar sa më sipër është e rëndësishme që shpenzimet që do ti njihen Kontraktorit ndikojnë drejtpërdrejtë në sasinë e Hidrokarbureve që do përfitoj Kontraktori pas prodhimit. Gjithashtu sa i përket kostos për njohjen e shpenzimeve mungojnë çmimet reference, nuk ka modul çmimesh dhe në çdo rast lë hapësirë për fryrjen e kostos nga ana e Kontraktorit me ndikim financiar negativ.

#### **Ndarja e Hidrokarbureve Fitim-Faktori “R”**

Për çdo muaj kalendarik, të gjitha Hidrokarburet e disponueshme të mbetura pasi zbritet renta minerare, Granti për Qeverinë dhe të gjitha shpenzimet dhe kostot e mbulueshme, sipas kontratës për atë muaj kalendarik do jenë Hidrokarbure Fitim. Pjesa përkatëse apo përqindja e Hidrokarbureve fitim që i takon AKBN-së do të ndahen. Faktori “R” do të përdoret me qëllim përcaktimin e të drejtës përkatëse të Palëve në Hidrokarburet Fitim dhe Grantin për Qeverinë



në çdo muaj kalendarik. Faktori “R” është dhe llogaritet si raporti i të ardhurave kumulative të Kontraktorit që nga data e hyrjes në fuqi deri në fund të vitit kalendarik pararendës ndaj shpenzimeve kumulative të Kontraktorit të realizuara që nga data e hyrjes në fuqi të vitit pararendës.

-Të ardhurat kumulative janë vlera totale e përcaktuar, pjesa Hidrokarbure, fitim i Kontraktorit, plus Hidrokarburet për mbulimin e kosto, minus tatim fitimin e Kontraktorit.

-Shpenzimet kumulative janë vlera totale e të gjithë kostove, shpenzimeve dhe harxhimeve të realizuara më parë nga Kontraktori sipas kontratës, si shpenzimeve zhvillimi, shpenzime kërkimi, shpenzime operative. Përqindja e Hidrokarbureve fitim që përbën dhe pjesën përkatëse të AKNB llogariten sipas tabelës së mëposhtme:

Faktori “R”	Nafta		Gazi
	Pjesa kontraktorit	Pjesa AKBN	
0<R<1.50	99%	1%	0%
1.50<R<2.00	95%	5%	0%
2.00<R<2.50	90%	10%	0%
2.50<R	85%	15%	0%

Përveç pjesës së saj AKBN do të marr dhe Grantin për Qeverinë e cila llogaritet si më poshtë: Faktori “R”, 0<R<1.50, Granti për Qeverinë 0%; 1.50<R<2.00, Granti për Qeverinë 2.5%; 2.00<R,

Llogaritjet ekonomike janë bërë duke u mbështetur në të ashtuquajtur Faktori “R” i cili është përdorur në të gjitha kontratat e lidhura nga AKH pas vitit 1995. Ky faktor siç është theksuar më sipër shpreh raportin ndërmjet të ardhurave kumulative të Kontraktorit ndaj shpenzimeve kumulative deri në momentin korrent. Kjo do të thotë që në momentin kur vlera R=1, pra të ardhurat e kontraktorit barazohen me shpenzimet, projekti fillon e gjeneron fitim për Kontraktorin dhe për këtë arsye pas këtij momenti dhe në vazhdim gjatë rritjes së mëtejshme të vlerave “R”, raporti fillon e përmirësohet në favor të Shtetit. Nga AKBN është theksuar që avantazhi i përdorimit të Faktori “R” si kriter për të përcaktuar ndarjen e fitimit në vend të ndarjes klasike sipas të cilës kriter për ndarjen e fitimit është niveli prodhimit, qëndron në faktin që midis të tjerash faktori R, konsideron dhe koniukturën e çmimit të naftës e i cili hyn si faktor kontribues në llogaritjen e të ardhurave të Kontraktorit

-Përcaktimi i ndarjes së fitimit sipas faktorit “R”, grupi auditimit gjykon që raporti i të ardhurave kumulative ndaj shpenzimeve kumulative të Kontraktorit i krijon vështirësi AKBN-së pasi sa i përket auditimit në pjesën e shpenzimeve pasi nuk ka çmime referencë, module çmimesh të dhëna të saktë mbi teknologjinë që përdor dhe shumë gjëra të tjera teknike të cilën lë hapësirë për fryrjen e kostove të raportuara nga Kontraktori.

Raporti sipas faktorit “R” nuk mund të kryhet pasi është ezauruar vetëm faza e kërkimit e ndarë në 3 periudha (3 vjet, 2 vjet, 2 vjet), e përcaktuar në nenin 4(periudha e kërkimit, programi i punës dhe shpenzimet e parashikuara) pasi rezulton se Kontraktori është në fazën e zbulimit dhe vlerësimit, përcaktuar në nenin 6(zbulimi, vlerësimi, zhvillimi dhe njehësimi i vendburimit), nga ku ka dërguar në AKBN njoftimin me të gjitha detajet e disponueshme duke e deklaruar si zbulim tregtar por që nuk ka dal akoma me një konkluzion zyrtar. Pra referuar sa më sipër pas fazës së vlerësimit në momentin e hyrjes në prodhim është e rëndësishme që Raporti sipas faktorit “R” duhet të auditohet dhe monitorohet në mënyrë rigoroze pasi përqindja (%) e fitimit të Kontraktorit ndikon drejtpërdrejtë në (%) e fitimit të Qeverisë dhe AKBN-së.

## Pagesat e Bonuseve

### Neni 16.4, Bonusi trajnimit.

Kontraktori do të bashkëpunojë me AKBN për programet e kualifikimit si më poshtë:

Kontraktori do ti paguaj AKBN-së, brenda (30 ditëve) nga fillimi i çdo viti kontraktual (100.000 USD) gjatë periudhës së kërkimit. Kontraktori ka paguar bonuset e trajnimit për vitet respektive, detyrimet kontraktuale për çdo vit kërkimit në vlerën (2.299.863 USD).

Nisur nga sa mësipër pagesat e kryer nga kontraktori për bonusin e trajnimit dhe administrativ për vitet 2011, 2014, 2016, 2020, 2021 nuk janë kryer brenda afateve ligjore pasi data efektive e kontratës është 31.07.2009 e botuar në fletoren zyrtare dhe pagesat duhet të kryhen brenda 30 ditëve për çdo vit kontraktual domethënë pagesat duhet të kryhen brenda datës 31 Gusht të çdo viti.

#### **Neni 27, pagesat e bonusit të nënshkrimit, prodhimit dhe trajnimit.**

Kontraktori do ti paguajë AKBN-së vetëm njëherë një bonus nënshkrimi në vlerën totale prej 400,000 USD. Kontraktori do të paguaj nga kjo shumë prej 400.000 USD) brenda (60 ditësh) pas datës efektive shumë prej 160.000 USD. Pjesa e mbetur prej 240.000 USD do të përdoret nga Kontraktori për të kopjuar të dhëna sizmike. Nëse kosto totale për kopjimin e të dhënave është më e vogël se 240.000 USD, Kontraktori do të paguaj diferencën e mbetur AKBN. Në rast se vlera e kopjimit të të dhënave është më e lartë se 240.000 USD AKBN do mbuloj kostot shtesë nëpërmjet fondit të trajnimeve. Nga dokumentacioni rezulton se Kontraktori ka paguar fillimisht 160.000 USD ndërkohë që ka tërhequr më pas pjesën tjetër prej 240.000 USD, pra e cila nuk është mbajtur nga Kontraktori për kopjimin e të dhënave sizmike sipas parashikimeve të nenit të sipërcituar. Kontraktori do ti paguajë AKBN-së një bonus 30 ditë pas datës së prodhimit të parë tregtuar vetëm njëherë 250,000 USD. Kontraktori do ti paguajë AKBN-së brenda 30 ditësh pas datës që prodhimi mesatar ditor arrin 15.000 Fuçi Naftë në ditë 750.000 USD. Kontraktori do ti paguajë AKBN-së 1.500.000 USD vetëm njëherë pas datës që prodhimi mesatar ditor arrin 30.000 fuçi naftë në ditë. Kontraktori do ti paguajë AKBN-së bonus trajnimi dhe administrativ në shumën 300.000 USD për çdo vit kontraktual të periudhës së kërkimit

### **7. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për marrëveshjet hidrokarbure dhe identifikimi i risqeve nga ana e strukturave përgjegjëse.**

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për MH është kryer bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, të cituara rast pas rasti përgjatë trajtimit. Në kuptimin e ligjit të lartpërmendur, menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, me qëllim për të adresuar risqet dhe për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njesisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Referuar nenit 19 të ligjit për MFK, zbatimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kryhet sipas komponentëve të mëposhtëm të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. *Mjedisi i kontrollit.*
2. *Menaxhimi i riskut.*
3. *Veprimtaritë e kontrollit.*
4. *Informacioni dhe komunikimi.*
5. *Monitorimi.*

## Mjedisi i kontrollit

Grupi i parë i komponentëve të kontrollit të brendshëm përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli (i brendshëm) në një njësi të caktuar. Tek mjedisi i kontrollit do të përfshihen integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politika menaxheriale dhe stili i punës, struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Nga vlerësimi i mjedisit të kontrollit, rezultuan parregullsitë, si më poshtë:

Në kuadrin e zbatimit dhe monitorimit të MH, monitorimi dhe raportimi, janë procese përmes të cilave duhet t'i kushtohet vëmendje ecurisë së zbatimit të saj, përbushjes së detyrimeve si dhe arritjes së objektivave të vendosura me synimin rritjen e efikasitetit të operacioneve hidrokarbure.

*Strukturat përgjegjëse për monitorimin e MH-së:*

1. **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës**, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të kësaj kontrate, strukturat përgjegjëse për monitorimin e saj sipas detyrave funksionale të pozicionit.
2. **AKBN**, në cilësinë e përfaqësuesit të autoritetit në kontratë në LM, strukturat përgjegjëse për monitorimin e saj sipas detyrave funksionale të pozicionit.
3. **Albpetrol SHA**, në cilësinë e palës kontraktore në MH, strukturat përgjegjëse për monitorimin e saj sipas detyrave funksionale të pozicionit.

Roli dhe përgjegjësia e AKBN-së, Albpetrol sha në plotësimin e kuadrit ligjor për monitorimin e MH-së për vendburimin e gazit natyror "Frakull" dhe "Povelçë" është e përcaktuar si më poshtë:

-Neni 12 të MH-së, "Të Drejtat dhe Detyrimet e palëve", pika 12.8 ku citohet se:

*"Kontraktori do të lejojë përfaqësuesit e Albpetrolit të inspektojnë, në të gjitha kohët e arsyeshme Operacionet Hidrokarbure sipas kësaj Marrëveshje", si dhe pikës 12.10 ku citohet se "Albpetrol dhe AKBN-ja do të sigurojnë që Kontraktori, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi :*

*(a) të kryejë Operacionet Hidrokarbure në përputhje me këtë Marrëveshje dhe*

*(b) të prodhojë, transportojë, të shesë brenda dhe jashtë vendit të gjitha ose një pjesë të prodhimit siç jepet në këtë Marrëveshje dhe Ligjin Hidrokarbure".*

Si dhe Neni 16.8. "Mbikëqyrja dhe Kontrolli i Instrumentave Matëse" i LM ku citohet se:

*"Gjatë Operacioneve Hidrokarbure përfaqësuesit e autorizuar të AKBN kanë të drejtën të mbikëqyrin dhe kontrollojnë mjetet, pajisjet dhe instrumentet e përdorura për matjen sasiore dhe cilësore të Hidrokarbureve. Kjo mbikëqyrje dhe kontroll kryhet në mënyrë të arsyeshme me qëllim që të mos pengojë sigurinë dhe efektivitetin e Operacioneve Hidrokarbure. I LICENCUAR-i u jep përfaqësuesve të autorizuar të AKBN asistencën e arsyeshme për realizimin e kësaj mbikëqyrje dhe kontrolli. Këta përfaqësues u binden rregullave dhe standarteve të sigurimit të LICENCUAR-it kur vizitojnë Zonën e Kontratës dhe planifikojnë në mënyrë të arsyeshme këto vizita me të LICENCUAR-in në mënyrë që të mos pengojnë operacionet. I LICENCUAR-i u ofron këtyre përfaqësuesve, gjithë privilegjet dhe lehtësitë, brenda kufijve të arsyes, që i janë akorduar punonjësve të tij në terren dhe u jep atyre pa pagesë në përdorim hapësirë të arsyeshme zyrash dhe strehim të mobiluar në mënyrë të përshtatshme ndërkohë që ata janë në vendburim për të lehtësuar objektivat e këtij Seksioni 16.8."*

-Pikës 9.1 d të Rregullores së Brendshme ku përcaktohen qartë misioni, detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë Hidrokarbure ku citohet se: *"Organizon dhe drejton punën për promovimin e burimeve hidrokarbure , negocimin e marrëveshjeve hidrokarbure si dhe ndjekjen e zbatimi të planeve të zhvillimit të tyre",*

- Pikës 9.1 f të Rregullores së Brendshme ku citohet se: “Mban kontakte të rregullta me të gjitha Kompanitë që operojnë në kuadër të marrëveshjeve hidrokarbure të ratifikuara nga Këshilli i Ministrave”.

- Pikës 9.1 g të Rregullores së Brendshme ku citohet se: “Informon periodikisht Drejtorin Ekzekutiv në lidhje me ecurinë Marrëveshjeve dhe Licencave Hidrokarbure”

-Pikës 9.2.b të Rregullores së Brendshme ku citohet se: “Shefi i Sektorit të Ndjekjes së Licencë-Marrëveshjes dhe Marrëveshjeve Hidrokarbure ka detyrë dhe përgjegjësi të ndjek zbatimin e detyrimeve të kontraktorëve të licencuar për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, si dhe aspekte të veçanta të marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura midis Albpetrol dhe Kontraktorëve”,

-Pikës 9.2.d të Rregullores së Brendshme ku citohet se: “Shefi i Sektorit të Ndjekjes së Licencë-Marrëveshjes dhe Marrëveshjeve Hidrokarbure ndjek kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure duke ndihmuar që ato të kryhen në përputhje me planet e zhvillimit, programeve dhe buxheteve vjetore të miratuara si dhe standarteve të njohura për këto procese ”.

- Pikë 9.2 g të Rregullores së Brendshme ku citohet se: “Merr pjesë në grupe pune të ngritura për Inspektime Teknike dhe Auditime Tekniko-ekonomike të veprimtarisë së kontraktorëve të licencuar për kryerjen e operacioneve hidrokarbure për zhvillimin e vendburimeve të naftës dhe të gazit”

**Gjetja 1:** Nga auditimi procesit të monitorimit grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion informacion apo praktikë të ndjekur në lidhje me Monitorimin, Mbikëqyrjen e përgjithshme, inspektime të MH, ku të bëhen krahasime apo vlerësime konkrete të treguesve teknologjikë apo të realizimit të investimeve etj, me planet e punës apo buxhetet e fillestare apo të rishikuara me treguesit e raportuar në situacionet përkatës, me synimin rritjen e efikasitetit të operacioneve hidrokarbure. Gjithashtu u konstatua që Albpetrol Sha si përfaqësues autoritetit në kontratë dhe AKBN si përfaqësuese e MIE në LM nuk disponojnë programe apo plane periodike vjetore për të ushtruar kontrolle në subjekte, zotërues të lejes Hidrokarbure për nga niveli I rëndësisë është I nivelit të lartë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të Albpetrol sha, strukturat drejtuese të AKBN

### **Trajnimi**

**Gjetja 2:** Nga auditimi u konstatua se MH e kanë të përcaktuar bonusin e trajnimit që paguhet nga kontraktori për çdo vit kontraktual në vlera të konsiderueshme por nga strukturat përgjegjëse të AKBN dhe Albpetrol nuk e kanë shfrytëzuar sa duhet mundësinë e trajnimit të stafit, e drejtë kjo që rrjedh nga MH si dhe nuk u vendos në dispozicion programi i trajnimit mbi baza vjetore i përgatitur, miratimi i programit (*trajnime në fushën e industrisë së naftës e gazit, si dhe trajnime profesionale dhe për menaxhimin*), lista e kandidatëve të propozuar nga AKBN. Referuar planifikimit dhe realizimit të buxheteve vjetore të AKBN-së, një pjesë e tyre është përdorur për shpenzime administrative, konsulenca në fushën hidrokarbure, software etj, sipas kërkesave të AKBN-së. Nisur sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi që kjo deklaratë ka vetëm përshkrime të zërave por jo të pasqyruara në vlera për secilin shpenzim të deklaruar e cila për nga niveli i rëndësisë është i nivelit të mesëm.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të Albpetrol sha, strukturat drejtuese të AKBN

### **Menaxhimi i riskut**

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave.

Referuar korrespondencave të vazhdueshme mbi risqet që mund të cenojnë eficientësinë e këtij shërbimi, nga auditimi rezultoi se AKBN/Drejtoria e MH kanë hartuar regjistrin e riskut për MH.

Referuar gurmës c të pikës 2.2.9 të Kapitullit II “Rolet dhe aktorët në sistemin e MFK-së” të Manualit të MFK, Menaxherët e njësive publike janë përgjegjës për identifikimin dhe zhvillimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që rrezikojnë arritjen e objektivave dhe përmbushjen e suksesshme të veprimtarive të strukturës për të cilën janë përgjegjës brenda njësisë.

### **Veprimtaritë e kontrollit**

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve.

3.1. Harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit dhe plani i kontrollit të brendshëm

Përgatitja e një *harte me proceset e punës* garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Baza e lidhjes së MH është Ligji 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet” i ndryshuar, Rregullorja “Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” të Ministrit të MIE, miratuar me Urdhërin nr.246, datë 12.03.2018.

**Gjetja 3:** Konstatohet se kjo rregullore është e lidhur vetëm me përcaktime të afateve kohore të institucioneve të përfshira nga iniciimi deri në lidhjen e MH por nuk përcakton procedura ligjore apo kritere minimale teknike dhe financiare që duhet të plotësojnë subjektet për përfitimin e të drejtës së MH si dhe nuk ka të përcaktuar afate kohore për procedurën e inicimit deri në shpalljen e ftesës për aplikim, nuk ka afat për procedurën e negocimit të Termave dhe Kushteve Kryesore si dhe negocimit të tekstit të Marrëveshjes duke ju lënë hapësirë zvarritjes së përgatitjes dhe miratimit të MH, e cila për nga rëndësia është e nivelit të mesëm.

**Gjetja 4:** Referuar dokumentacionit konstatohet se nuk ka një MH (kontratë) tip ku të jenë të përcaktuar detyrimet kryesore që duhet të përmbushin subjektet që kanë shprehur interes dhe të lihet hapësirë vetëm negocimit të termave ekonomike të MH-së.

*Gjurma e auditimit* është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar, si dhe për t’i verifikuar ato. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Gjurma e auditimit e pajis menaxhimin e lartë me një vizion të qartë për:

- Ecurinë e proceseve;
- Objektivat e proceseve;
- Strukturat brenda dhe jashtë njësisë që përfshihen në proces;
- Aktivitetet e ndryshme të procesit;
- Sistemet e TI-së që mbështesin proceset;
- Afatin e zbatimit të aktiviteteve që janë pjesë e proceseve;
- Burimet e përdorura dhe produktet e përfutuara;

- Boshllëqet e mundshme të kontrolleve dhe/ ose kontrollet e mbivendosura;
- Dokumentet ligjore, financiare, ose të një natyre tjetër, që rregullojnë dhe mbështetin aktivitetet që janë pjesë e këtyre proceseve.

*Plani i Kontrollit të Brendshëm* është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.

Kontrollet duhet të sigurojnë:

- Autorizimet;
- Përputhshmërinë ligjore;
- Ndarjen e detyrave;
- Plotësinë;
- Efikasitetin & Efektivitetin.

**Gjetja 5:** Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion mbi hartimin dhe miratimin e hartës së procesit të punës, gjurmës së auditimit dhe planit të kontrollit të brendshëm, sipas formatit të kërkuar nga manuali i MFK, për procesin e inicimit, përgatitjes dhe miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure; njësitë përgjegjëse për procesin sipas hallkave përkatëse, etj e cila për nga rëndësia është e lartë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese të Albpetrol sha, strukturat drejtuese të AKBN

### **Dokumentimi, arkivimi dhe ruajtja e informacionit/dokumentacionit**

Procedurat për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike. Dokumentimi përfshin hartimin e provave të shkruara për vendimet e marra, ngjarjet e ndodhura, veprimet dhe transaksionet e kryera, etj. Dokumentimi duhet të jetë i plotë, i saktë dhe në kohën e duhur. Procedurat e dokumentimit përfshijnë procedurat që lidhen me qarkullimin e dokumentacionit, të cilat përmbajnë urdhrin për qarkullimin dhe përdorimin e dokumenteve të prodhuara dhe të marra. Procedurat e dokumentimit duhet të mundësojnë ndjekjen e çdo dokumenti, veprimi, apo procesi në njësi ku të tregohet saktësisht se kush ka kryer çfarë, kur dhe ku, qëllimin dhe llojin e aktit/dokumentit që është lëshuar me këtë rast. Rakordimi i të dhënave. Titullari duhet gjithashtu të garantojë se të dhënat nga dokumente, apo burime të ndryshme krahasohen për t'u siguruar për përputhshmërinë e tyre.

**Gjetja 6:** Nga auditimi u konstatua se dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk ishte i inventarizuar, përbëhej kryesisht nga dokumentacion origjinal, korrespondencat nuk ishin të plotësuara si një praktikë e vetme si dhe disa prej dokumenteve ishin në formate të papërfunduara në versionin final, në kundërshtim me Normat Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” e cila për nga rëndësia është e lartë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi MIE, strukturat drejtuese të Albpetrol sha, strukturat drejtuese të AKBN.

### **Monitorimi**

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës. Në kuadrin e MH, monitorimi dhe raportimi janë procese përmes të cilave të mund t'i kushtohet vëmendje ecurisë së zbatimit të saj, përmbushjes së detyrimeve si dhe arritjes së objektivave të vendosura.

Procedurat e vendosura për monitorim duhet të jenë në përputhje me kulturën dhe rregullat e brendshme të njësisë, si dhe të garantojnë përshtatshmërinë me rregullat. Monitorimi i vazhdueshëm mundëson vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të sistemeve të kontrollit, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit. Vlerësimi dhe monitorimi bëhet nëpërmjet:

- Monitorimit të vazhdueshëm;
- Vetëvlerësimit;
- Auditimit të MH.

**Gjetja 7: Nga auditimi u konstatua se nuk ka plan vjetor auditimi të miratuar nga Titullari.** Nuk ka manual për hartimin e raporteve të auditimit si dhe afate për përpunimin e informacionit sipas etapave deri në hartimin e raportit përfundimtar (nuk është i detajuar mbi punën e kryer, kampionet e zgjedhur, materialiteti, etj.).

Në lidhje me raportet e auditimit dhe gjetjet përkatëse nuk ka një koordinim dhe bashkërendim midis institucioneve të Shtetit Shqiptar si MIE, AKBN, Albpetrol sha, Organet tatimore. E cila për nga rëndësia është e lartë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi MIE, strukturat drejtuese të Albpetrol sha, strukturat drejtuese të AKBN.

### **Trajtimi i observacioneve**

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga MIE me shkresën nr. 3447/12, datë 05.11.2024 “Dërgimi i komenteve në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH “Mbi auditimin e përputhshmërisë, për marrëveshjet hidrokarbure të lidhura në RSH”, protokolluar në KLSH me praktikën nr. 544/9, datë 06.11.2024, ku pretendoni se:

*“1. Në përmbledhjen ekzekutive në faqen 3, e cila ka të bëjë me shprehjen e interes të një kompanie sqarojmë se në momentin që një subject shpreh interes për të lidhur një marrëveshje hidrokarbure për vendburimin ekzistues apo bllok kërkimi referuar “Rregullore për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” (rregullore) miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 246, datë 12.03.2018, nuk është i detyruar që të paraqesë një Ekstrakt Historik të QKB apo ndonjë dokument tjetër që do të shërbejnë si bazë për vendimmarrjen e mëtejshme të Ministrisë, që lidhet me vazhdimin apo jo të procedurave për lidhjen e Marrëveshjeve Hidrokarbure.*

*2. Gjetja nr. 4 në faqen 17, ku shpreheni se MIE ka përcjellë me vonesë aplikimin e kompanisë pranë Albpetrol SHA saktësojnë se procedurat e ndjekura deri sa u miratua Urdhri i Ministrisë nr. 317, datë 30.10.2020 “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet ekzistuese të gazit natyror ‘Povelçë’ dhe ‘Frakull’, i cili është dërguar në Albpetrol SHA për ndjekje dhe zbatim me shkresën e MIE nr. 3825/4, datë 05.11.2020, lidhen me fazën e inicimit për lidhje të marrëveshjeve hidrokarbure të cilat janë bërë sipas pikes 2 të kapitullit 1 ‘Procedurat për inicimin e marrëveshjeve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve’.*

*3. Gjetja nr. 2 në faqen 54, në lidhje me fondin për investime sociale prej 1,000,000 USD si detyrime të kompanisë Sh. që do të investojë gjatë periudhës së pezullimit, sqarojmë se në këto praktika theksohet angazhimi i Sh. për të përmbushur detyrimin prej 1 milionë USD për projekte për investime sociale që lidhen me tranzicionin energjetik dhe burimet e energjisë së rinovueshme, kjo në përputhje me VKM nr. 652, datë 10.10.2022 “Për miratimin e amendimit të kontratës së miratuar me vendimin nr. 350, datë 12.06.2018, të Këshillit të Ministrave, me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku 4, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Sh. A. B. b.v”. Sh. me shkresën nr. 667, datë 04.07.2024 ka marrë hapa konkrete për përzgjedhjen e disa nga 163 shkollave publike në*

*juriksionin e 6 bashkive ku ndoshen blloqet 2-3 dhe blloku 4, bazuar në kriteret si metra katror, numrin e kateve, viti i ndërtimit kapacitetet, numri aktuali nxënësve dhe Sh. është duke punuar për konkretizimin e këtij investimi. Aktualisht, Sh. është në fazën e vlerësimit përfundimtar për shkollat në të cilat do të implementohet ky projekt.*

*4. Në faqen 61, në lidhje me amendimin e Kontratës me ndarje Prodhimi për bllokun 4 të kërkitimit ju sqarojmë përsëri se amendimet e kësaj kontrate janë bërë duke marrë në konsideratë se koncepti i pezullimit”*

*Për sa më sipër ju sqarojmë se ka një vonesë prej 6 muajsh në përcjelljen e interest të kompanisë E., si dhe në asnjë rast nuk ka fakte të reja apo dokumentacion të ri që gurpit të auditimit nuk ju vendos bë dispozicion gjatë periudhës së auditimit në terren, keni thjesht argumentuar situatën.*

*Në lidhje me observacionin e paraqitur nga Albpetrol SHA me shkresën nr. 2687/7, datë 04.11.2024 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit në MIE, AKBN dhe Albpetrol SHA.”, protokolluar në KLSH me praktikën nr. 544/10, datë 07.11.2024, ku pretendoni se:*

*“1. Në asnjë pikë të urdhërave të mësipërme nuk përmendet se duhet bërë një analizë e detajuar, por pa e detajuar, por kërkohet vetëm plotesimi i kapaciteteve..*

*2. Rregullorja nuk e ka të përcaktuar qartë se cilat janë dokumentat që se cilat janë dokumentat financiar që duhet të dorëzohen.*

*3. Në asnjë nen të MH nuk përmendet Albpetrol për garancinë bankare.”*

*Për sa më sipër ju sqarojmë se grupi i punës nuk keni sjell asnjë fakt apo dokumentacion që të ndryshojë qëndrimin e grupit të auditimit, për sa i përket trajtimit të observacioneve të aktkonstatimeve ato janë trajtuar në mënyrë të detajuar në projektraport.*

*Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AKBN me shkresën nr. 2456/18, datë 04.11.2024 “Dërgimi i komenteve në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH “Mbi auditimin e përputhshmërisë, për marrëveshjet hidrokarbure të lidhura ne RSH”, protokolluar në KLSH me praktikën nr. 544/8, datë 06.11.2024, ku pretendoni se:*

*“1. Është e pamundur përcaktimi i një liste apo manuali për çmimet e referencës i cili të parashikojë gamën e gjerë të teknologjisë, produkteve, mallrave apo shërbimeve të cilat përfshihen në kryerjen e operacioneve hidrokarbureve. Teknologjitë apo mallrat e shërbimit të përzgjidhen vet nga kompanitë duke qenë se investimet në sektor janë me 100% risqet e tyre aq më tepër që teknologjitë, mallrat apo shërbimet e ndryshme mund tërbimet e ndryshme mund të ndryshojnë me kohën. AKBN gjatë auditimit kontrollon mënyrën e shpenzimit ashtu sikurse procedurën si dhe gjithmonë është kërkuar optimizimi dhe eficaenca e kryerjes së shpenzimit.*

*2. Përgatitja e gjithë dokumenteve, qoftë edhe ato të shprehjes së interesit, duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e marrëveshjeve hidrokarbure respektive sipas nenit 26, pasi që, edhe trajtimi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që lindin gjatë implementimit të këtyre marrëveshjeve nga organet gjyqësore (ekspertët apo arbitrazhet), bëhet në përputhje me këto MH, ku në shumicën e tyre mbizotëron gjuha angleze.*

*3. Në përputhje me parashikimin e MH, licencë marrëveshjet për zhvillimin e vendburimeve ekzistuese miratohen automatikisht me miratimin me VKM të MH dhe nuk ka procedurë tjetër për miratimin e saj. Për sa i përket përgatitjes së LM, kjo është bërë gjithmonë në afat pasi bëhet fjalë për licencimin e Albpetrolit dhe jo direkt kontraktorëve, me miratimin e MH midis Kontraktorit dhe Albpetrolit, kjo licencë i atribuohet dhe kontraktorit duke u bërë së bashku me Albpetrolin njëra palë përballë AKBN, si pala tjetër.*

*4. Nga ana jonë do të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Megjithatë, duam të qartësojmë pozicionin e AKBN në këtë çështje. AKBN ka qenë e prirur dhe ka kërkuar që forma e garancisë bankare të ishte në përputhje me Aneksin E të MH. Në asnjë rast nuk jemi*



*pajtuar me formatin e paraqitur nga kompania. Këtë e kemi shprehur me shkresa në komunikimin me kompaninë por dhe me MIE dhe Albpetrolin.*

*5. Nga ana AKBN, në MH në kërkim, janë kërkuar gjithmonë ndarja e vlerave financiare sipas operacioneve hidrokarbure, evidente kjo në MH aktualisht në fuqi. Sqarojmë se AKBN nuk ka qenë pjesë ndonjëherë në negociata lidhur me MH për vendburimet ekzistuese. Megjithatë nga ana jonë do të merren masa me qëllim zbatimin e këtij rekomandimi.*

*6. Në praktikën tonë nuk është arritur konkluzion për përgatitjen e një formati “model” për programin e punës dhe buxhetin, mjafton që kompania të respektojë kërkesat e pasqyruara në LM ose në MH në lidhje me këtë program. Termat “Program Vjetor” dhe “Buxheti” janë terma të përkufizuar në MH dhe LM... “si paraqitje e zbërthyer e operacioneve hidrokarbure që do të kryhen gjatë një viti, brenda ose në lidhje me zonën e kontratës si dhe afatet kohore të tyre”.*

*7. Pavarësisht vlerave të paraqitura në projekt buxhetet vjetore të përgatitura nga kompania, të cilat merren të mirëqena dhe pa kaluar për miratim nga ACM ose AKBN, nga shqyrtimi i informacioneve periodike të dërguara nga Kompania arrijmë në përfundimin se nga 500 mijë US të parashikuara në “Minimum Commitment” për MH për vendburimin Frakull, janë realizuar 3,676.6 mijë USD, nga të cilat 2,257.4 mijë USD Capex (përfshirë dhe kostot për shpimin e pusit Fr. 115, pra gati 4.5 herë më shumë se Minimum Commitment) dhe 435.3 mijë USD dhe 983.9 mijë USD respektivisht Opex dhe G&A.*

*Mosrealizimi për vendburimin e Povelçës ka ndodhur si rezultat i pengesave të krijuara nga ente shtetërore të ruajtjes së Zonave të Mbrojtura mjedisore, të cilat për një periudhë gati dy vjeçare nuk lejuan kryerjen e operacioneve capex në vendburim. Me gjithë përpjekjet e saj duke vënë në lëvizje dhe MIE, kompania nuk mundi të sigurojë lejet e nevojshme.*

*8. Pavarësisht konstatimit të mësipërm, dërgimi i informacioneve periodike nga ana e kompanisë është bërë për çdo tremujor dhe jo vetëm 6-mujor, sikurse dhe marrëveshjet e tjera janë efektive, në përputhje me nenin 15.2 të LM “regjistrimet që i dërgohen AKBN”, pa identifikuar Fazën në të cilën ndodhet MH, vlerësim apo zhvillim. Rekomandimi juaj në këtë rast gjen zbatim te ky nen i LM.*

*9. Përsa i përket fondit për investimin social prej 1,000,000 USD si detyrim i Amendimit të Kontratës të miratuar me VKM nr. 350, datë 12.06.2019, AKBN nuk ka qenë e përfshirë drejtpërdrejtë në ndjekjen e këtij detyrimi pasi sipas Amendimit të KNP për Bllokun 4, ky projekt është dakordësuar dhe ndjekur drejtpërdrejtë nga MIE. Përsa më sipër po ju përcjellim shkresën nr. 3870 prot, datë 07.08.2024 në të cilën MIE i drejtohet kompanisë lidhur me vijimin e projektit, dhe ku AKBN është në dijeni.*

*10. Krahas raporteve periodike Q1, Q2, Q3 dhe Q4, grupi i auditimit, gjatë kryerjes së procesit të kryerjes së procesit të auditimit, kërkon nga kompania dhe trajton dhe vlerëson një dokumentacion mjaft të gjerë, ku njihet me natyrën dhe vlerat e kostove, sistemimin e tyre në kontabilitet si dhe pozicionin e tyre në grupin e kostove të rikuperueshme apo jo.*

*11. Për shkak të mos plotësimit të detyrimeve nga kompania P. P. C., AKBN ka zbatuar të gjitha hapat dhe procedurat e parashikuara në Marrëveshjen e Licencës, sipas neneve përkatëse, nga dërgimi i njoftimeve për korigjim të shkeljeve deri në përfundimin e plotë të kësaj marrëveshje licencimi. Të gjitha veprimet dhe procedurat e ndërmarra nga AKBN janë raportuar tek Ministria dhe Albpetroli, si palë të përfshira në këtë marrëveshje. Vlen të theksohet se ndjekja e këtyre hapave është mjeti i vetëm ligjor në dispozicion të AKBN-së. Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në marrëveshje dhe shkeljet me natyrë administrative kanë qenë faktorët kryesorë që çuan në mbylljen e kësaj marrëveshje.”*

*Për sa më sipër ju sqarojmë se:*

*1. AKBN mund të hartojë një manual me çmime tavan të cilat të shërbejnë si udhëzues për njohjen e kostove.*

2. Pavarësisht mënyrës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me zbatimin e kontratës, hartimi i dokumentacionit zyrtar në gjuhën shqipe është detyrim që rrjedh nga legjislacioni shqiptar.
3. Kostatimi është nxjerr nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për procedurën e lidhjes së LM.
4. Problemi i grancisë bankare është trajtuar gjerësisht në material si dhe përgjegjësia juaj qëndron në mos marrjen e hapave për zgjidhjen e MH sipas neneve të MH.
5. Realizimi i planit të investimit është detyrim ligjor dhe detajimi i vlerave është i nevojshëm për monitorimin e realizimit të këtij investimi.
6. Unifikimi i modeleve të raportimit do të ndihmojë në një monitorim të vazhdueshëm të MH dhe LM.
7. Në lidhje me këtë konstatim nuk është dhënë asnjë argument shtesë nga MIE/AKBN/Alpetrol SHA.
8. Dokumenti i vetëm që rregullon marrëdhënien midis kontraktorit dhe autoritet kontraktor është MH dhe këto nen që ju keni paraqitur nuk janë përfshirë në MH.
9. Afati i periudhës objekt auditimit është deri në 31.12.2023 dhe të gjitha kostatimet janë deri në këtë periudhë.
10. Grupi i auditimit ka shqyrtuar edhe raportet e auditimit dhe në asnjë rast nuk janë shprehur mbi këto pretendime që ju keni.
11. Detyrimet e kompanisë vazhdojnë të jenë edhe pse MH është zgjidhur dhe duhet të vijohet me masa për arkëtimin e tyre.

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:**

##### **B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të inicimit, propozimit dhe shprehjes së interesit të paraqitur nga shoqëria “E. N. G.” shpk rezultoi se:

- Kompania “E. N. G.” shpk e cila ka shprehur interesin për shfrytëzimin e vendburimeve të lira “Frakull” dhe “Povelçë”, nuk ka të bashkëlidhur me dokumentin e Shprehjes së Interesit, CV me profilin e shoqërisë ose një prezantim të shkurtër për sipërmarrje të njëjta me objektin e shprehjes së interesit.

Duke konsideruar rëndësinë e këtij sektori për ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare, institucionet shtetërore përgjegjëse duhet të garantojnë përfshirjen në këto procese me përparësi të lartë kompani me potenciale dhe kapacitete të larta profesionale (veçanërisht kompanitë që kanë një eksperiencë të konsoliduar në këtë sektor) në përputhje me Ligjin Nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet” i ndryshuar neni 5, pika 2.

- Në momentin e shprehjes së interesit, referuar Ekstraktit historik të QKB-së, aktiviteti i operacioneve hidrokarbure, nuk është pjesë e objektit të aktivitetit të shoqërisë “E. N. G.” shpk. Referuar sa lart, kompania E. rezulton se nuk ka eksperiencë në fushën e kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit natyror jo në përputhje me Ligjin Nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet” i ndryshuar neni 5, pika 2. Ndryshimit i objektit të aktivitetit të kompanisë është bërë në 16.12.2020, ndërsa propozimi daton në Maj 2020. Ky fakt duhet të çonte në skualifikimin e propozimit dhe ndërprerjen e procesit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 16 të Raportit të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** MIE të marrë masat për përmirësimet e mundshme në Rregulloren e Brendshme “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure,

*Licencë Marrëveshjes si dhe Afatet Përkatëse*” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018 të Ministrit të MIE në pikën II.1:

a) Të merret në konsideratë shprehja e interesit për kompanitë që kanë eksperiencë në fushën e hidrokarbureve, bashkëlidhur aplikimit të subjektit të interesuar CV me profilin e shoqërisë, me qëllim ndihmën e strukturat përgjegjëse në shqyrtimin e potencialeve teknike/financiare të subjektit aplikues.

b) Aplikimit të subjektit të interesuar ti bashkëlidhen ekstrakti historik i shoqërisë nga QKB, ku aktivitetet, operacionet hidrokarbure, të jenë të përfshira në objektin e aktivitetit si dhe në rastet e mungesës së eksperiencës, shprehjes së interesit ti bashkëngjitet dokumentacioni me elementët e bashkëpunimit, kooperimit me kompani me objekt, përvojë, eksperiencë në fushën e operacioneve hidrokarbure.

*Në vijimësi*

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se:

- Nga MIE, AKBN dhe Albpetrol sha nuk janë hartuar dhe miratuar specifikimet ekonomike, teknike e objektive që duhet të plotësojnë operatorët pjesëmarrës në procedura (kriteret bazë të nevojshme). Grupi i punës për vlerësimin e aplikantëve nuk ka shprehur një gjykim apo vlerësim mbi kriteret objektive por thjesht që mendojmë ose gjykojmë pa një vlerësim objektiv mbi zëra specifike se çfarë nuk plotësojnë operatorët, bazuar kjo edhe në Nenit 5, pika 2 e Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 18-19 të Raportit të Auditimit)*

- Referuar dokumentacionit konstatohet se nuk është hartuar një (kontratë) tip për Marrëveshjet Hidrokarbure ku të jenë të përcaktuara detyrimet kryesore që duhet të përmbushin subjektet që shprehin interes duke lënë hapësirë vetëm negocimit të termave ekonomike.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 117-118 të Raportit të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** MIE të marrë masat për përmirësimet e mundshme në Rregulloren e Brendshme “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë Marrëveshjes si dhe Afatet Përkatëse” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018 të Ministrit të MIE në pikën II.2.i: ku të listohen qartë kriteret bazë të nevojshme në zbatim të Ligjit nr. 7746 datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, si dhe hartimin një (kontratë) tip për Marrëveshjet Hidrokarbure me qëllim lehtësimin e punës.

*Në vijimësi*

**3.Gjetje nga auditimi:** AKBN dhe Albpetrol sh.a si institucione monitoruese të zbatimit të kontratës nuk kanë hartuar çmime reference (module çmimi) të blerjeve apo shërbimeve që lidhen me investimet në operacionet hidrokarbure. Nisur nga ky fakt Albpetrol sh.a, AKBN gjenden përpara riskut që buxhetet e paraqitur të jenë të fryra për shkak të kostove të larta gjatë vlerësimin dhe auditimit të situacioneve të kostove të rimbursueshme (cost recovery) të cilat mund të jenë të larta. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 45 të Raportit të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Nisur nga fakti që një pjesë e konsiderueshme e kostove të njohura rimburohen, si dhe teknologjia e përdorur në sektorin e hidrokarbureve është e kushtueshme, MIE, Albpetrol sh.a dhe AKBN të hartojnë dhe miratojnë manuale për çmimet referencë dyshe dhe tavan për të mënjeluar fryrjen e buxheteve dhe situacioneve të kostove të rimbursueshme.

*Në vijimësi*

## C. MASA ORGANIZATIVE

**1.Gjetje nga auditimi:** Vlerësimi paraprak i të dhënave teknike për të dy vendburimet “Frakull” dhe “Povelçë” është vetëm në gjuhën angleze dhe nuk ka asnjë nënshkrim apo elementë që të faktojnë apo të vërtetojnë që ky raport është hartuar nga kompani konsulente të

fushës I. P. T. dhe P. E. T., ashtu sikurse citohet në shkresën ku shprehet interesi për shfrytëzim të vendburimeve të lira “Frakull” dhe “Povelçë”, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimin nr. 4, datë 19.6.2017, neni 4, pika 9, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”, e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë. (Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 16 të Raportit të Auditimit)

**1.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, AKBN dhe Albpetrol sh.a që dokumentacioni i shprehjes së interesit, vlerësimet paraprake të të dhënave teknike të pranohen vetëm në gjuhën shqipe duke e lënë opsionale shoqërimin me variantin në gjuhën angleze.

*Në vijimësi*

**2.Gjetje nga auditimi:** Relacioni i hartuar nga grupi i punës për vlerësimin e aplikantëve nuk përmban analiza të kryera nga vet grupi i punës, është sipërfaqësor, ka karakter përmbledhës, paraqet vetëm konkluzione dhe nuk shoqërohet me analiza të detajuara apo vlerësim të plotë në lidhje me dokumentacionin që ka dorëzuar shoqëria në kundërshtim me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar Nenit 5, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 19 të Raportit të Auditimit)

**2.1.Rekomandimi:** Grupi i punës për vlerësimin e aplikimeve, të hartojë dhe të paraqesë në Ministri Relacionin me analiza të detajuara si skema financiare (value for money), mbi vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe financiare sipas dokumentacionit të dorëzuar nga kompania e interesuar, konkurrenca apo aftësia e projektit për të tërhequr subjekte të tjera të mundshëm dhe financime private dhe të mos mjaftohet vetëm me listim dokumentacioni të paraqitur duke argumentuar vendimin mbi zgjedhjen e kompanisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i formularit të ofertës të paraqitur nga “E. N. G.” shpk për vendburimet “Povelçë” dhe “Frakull” në lidhje me vlerësimin e kapaciteteve financiare dhe teknike u konstatua se:

- Kompania nuk rezulton rentabël (me rezultat pozitiv) për vitet 2018 dhe 2019 si dhe vlera e likuiditeteve të lira, gjendje në bankë janë të pamjaftueshme për angazhime në sektorin hidrokarbur.

- Kompania e bazon financimin e projektit me një marrëveshje huaje me O. B., e cila ka pasigurinë e aprovimit nga autoritetet e bankës si dhe marrëveshja e huasë ka efekte në të ardhmen me risqet që mund të përballet vetë shteti shqiptar me rastin e mungesës së likuiditetit apo pamundësie paguese të kompanisë të huasë.

- Në lidhje me kapacitetet teknike në dokumentet e ofertës së paraqitur është një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë “I. C.” shpk (person juridik shqiptar regjistruar pranë QKB me Nipt M.....S), marrëveshje e cila nuk është e lidhur para noterit. Referuar sa më sipër, edhe kompania bashkëpunuese nuk ka eksperiencë dhe përvojë në fushën e hidrokarbureve pasi ka objekt aktiviteti “Konsulencë për biznesin”.

Nisur sa më sipër, kompania nuk disponon Burimet Financiare si dhe Kapacitetet Teknike për të përmbushur detyrimet e kontraktorit që vijnë nga lidhja e një Marrëveshje Hidrokarbure në kundërshtim me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar Nenit 5, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 19-20 të Raportit të Auditimit).

**3.1.Rekomandimi:** Të merren masa që grupet e punës që ngrihen për vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe financiare të aplikantëve të argumentojnë marrjen e vendimeve mbi bazën e

vlerësimeve të mirëfillta teknike-financiare në përputhje me kriteret ligjore të cilat sjellin pasoja në lidhjen dhe zbatimin e MH.

Organet drejtues të MIE, si organ vendim marrës, të sigurohen që relacionet mbi vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe financiare të kanë ekspertizën e nevojshme teknike financiare për tu bindur nëse subjekti i interesuar mund të sigurojë burimet financiare dhe kompetencën teknike të kërkuar për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit nën Marrëveshjen e Hidrokarbureve.

*Në vijimësi*

**4.Gjetje nga auditimi:** Referuar praktikës për përgatitjen dhe miratimin e MH rezultoi se:

- Për vendburimet “Frakull” dhe “Povelcë” nuk janë respektuar afatet ligjore në lidhje me përcjelljen e dokumentacionit të nevojshëm të vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe financiare në Ministri, në kundërshtim me pikën II/2/i të Rregullores “*Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse*” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018, të Ministrit të MIE. Kjo vonesë ka sjellë marrjen e vendimeve jo në përputhje me afatet ligjore të parashikuara e cila për nga niveli i rëndësisë është e mesme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën I , faqe 20-22 të Raportit të Auditimit).*

- Për zonën e kërkimit Blloku 4 referuar praktikës të vendosur në dispozicion nuk justifikohet vonesa në kohë e vijimit të procedurave të miratimit të finalizimit të MH-së. Ministri i MIE më datë 31.07.2015, ka autorizuar AKBN të vazhdojë procedurat e mëtejshme me subjektet e interesuara për të negociuar për Termat dhe Kushtet Kryesore të MH respektive. Afërsisht një vit më vonë, me datë 20.07.2016 (31.07.2015- 20.07.2016) AKBN i ka dërguar MIE për miratim termat dhe kushtet kryesore për të lidhur Marrëveshjet Hidrokarbure për vendburimet respektive. Në Rregulloren “*Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse*” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018, të Ministrit të MIE, kjo kohë nuk është parashikuar, afatet kohore janë parashikuar vetëm pas nënshkrimit të Termave dhe Kushteve Kryesore të MH nga grupi negociator. Kjo vonesë ka sjellë në zvarritjen e praktikës dhe procedurës për përgatitjen dhe miratimin e MH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën I , faqe 25-26 të Raportit të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga Albpetrol sh.a dhe AKBN që në të ardhmen të respektohen afatet ligjore në lidhje me paraqitjen në MIE të dokumentacionit të nevojshëm të vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe financiare të kompanisë së interesuar.

**4.2.Rekomandimi:** Te merren masa nga MIE në përcaktimin e afateve të proceseve gjithëpërfshirëse të mirëpërcaktuara për fazën e negociimit të termave dhe kushteve kryesore si dhe negociimit të tekstit të MH me finalizimin e procedurave pa vonesa.

*Në vijimësi*

**5.Gjetje nga auditimi:** Referuar procedurës për miratimin e LM, rezultoi se nuk janë respektuar afatet ligjore në lidhje me hartimin e Draft Licence Marrëveshjes nga AKBN, konkretisht kërkesa e ardhur nga Albpetrol sh.a datë 14.05.2021 dhe Drafti i Licencë Marrëveshjes është përcjell nga AKBN në Albpetrol datë 13.07.2021, në kundërshtim me pikën III/2 të Rregullores “*Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse*” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018 të Ministrit të MIE. Kjo vonesë ka sjellë marrjen e vendimeve jo në përputhje me afatet ligjore të parashikuara e cila për nga niveli i rëndësisë është e mesme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën I , faqe 22-23 të Raportit të Auditimit).*

**5.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga AKBN që në të ardhmen të respektohen afatet ligjore në lidhje me miratimin e LM.

*Në vijimësi*

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se MH për vb “Povelçës” dhe “Frakullës” janë lidhur me të njëjtën kompani “E. N. G.” shpk, me të njëjtin NIPT, M.....T, në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit 153/2020 “Operacionet e veçanta Hidrokarbure” dhe pikën 2 e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe MIE nr. 21, datë 14.07.2021 “Për operacionet e veçanta hidrokarbure dhe parashikimet financiare”. Referuar këtyre përcaktimeve, operatorët ekonomik që kryejnë operacione hidrokarbure llogarisin dhe paguajnë detyrimin e tatimit mbi fitimin të ndarë për secilin “nga operacionet e veçanta hidrokarbure”, kjo do t’i jepte fund që shpenzimet e një vendburimi t’i ngarkoheshin vendburimit tjetër duke parandaluar shmangien e regjimit fiskal. (Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 37 të Raportit të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, Albpetrol sh.a që çdo operacion të veçantë hidrokarbur të lidhen dhe të miratohen MH me persona juridike me numra të veçantë NIPTI, kjo do të ndikojë në forcimin e kontrollit fiskal, mbledhjen e të ardhurave tatimore, shmangien e evazionit si dhe në respektimin e legjislacionit tatimor në Sektorin Hidrokarbur.

*Në vijimësi*

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se:

-Nga MIE, AKBN, Albpetrol sh.a nuk është zgjidhur problemi i Garancisë Bankare duke mosrespektuar detyrimin ligjor të parashikuar në Nenin 26.6 të MH. Referuar dokumentacionit, Garancia Bankare është paraqitur nga subjekti por nuk është pranuar nga AKBN me pretendimin se Garancitë Bankare të paraqitura nga subjekti për vb Povelcë dhe vb Frakull nuk janë sipas Aneksit E “Forma e garancisë bankare” të parashikuar në MH dhe nuk kanë vlefshmëri juridike. Pavarësisht korrespondencës midis kontraktorit, MIE, AKBN DHE Albpetrol SHA, ky problem nuk është zgjidhur duke i ekspozuar këto institucione ndaj riskut të mos respektimit nga ana e kontraktorit të planit të punës, të vlerës së angazhimit të investimit minimal në Periudhën e Vlerësimit për vb Povelcë dhe vb Frakull (secila në vlerën 500,000 usd) e cila ndikon në vijueshmërinë normale të procesit të zbatimit MH.

- Edhe sikur ti Referohemi Formatit të Garancisë të lëshuar nga B., të paraqitur nga kompania, kjo garanci është e vlefshme deri më 13.06.2024 (pra garancia është liruar vetë pasi afati maksimal ka kaluar) si dhe faktit që Garancia Bankare është pjesë integrale e MH dhe LM, Albpetrol sh.a dhe AKBN kanë humbur mbrojtjen, instrumentin ligjor apo garancinë financiare kundrejt Kontraktorit për përmbushjen e detyrimeve kontraktore në lidhje me angazhimin të investimit minimal financiar të Programit të Punës për periudhën e vlerësimit. Si përfundim, s’ka garanci të vlefshme bankare dhe për më tepër kjo garanci që ka është çliruar në kundërshtim me nenin 26.6 si dhe Aneksit E të MH dhe LH.

-Gjithashtu Albpetrol sh.a nuk ka marrë asnjë masë në lidhje me kompaninë, ku kuadri ligjor e shpreh qartë që mos paraqitja e Garancisë Bankare bëhet shkak për zgjidhjen e menjëhershme të këtyre marrëveshjeve duke vepruar jo në përputhje me Nenin 24, pika 24.3/b të MH. (Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 37-39 të Raportit të Auditimit)

**7.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, AKBN, Albpetrol sh.a për intensifikimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për identifikimin dhe zgjidhjen në kohë të problemeve dhe mangësive që lindin gjatë fazave të miratimit dhe zbatimit të MH.

**7.2.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, AKBN, Albpetrol sh.a për të ndjekur dhe për të realizuar paraqitjen e Garancisë Bankare brenda afatit ligjor për vetë rëndësinë që ka si pjesë integrale e MH-së dhe LM-së dhe si instrument ligjor mbrojtje për përmbushjen e detyrimeve kontraktore në lidhje me realizimin e angazhimit të investimit minimal financiar të Programit të Punës për periudhën e vlerësimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me afatet e parashikuara në MH dhe LM konstatohet se kompania që ka lidhur MH duhet të fillojë punën 10 ditë pas datës efektive sipas nenit 8.1 të

MH dhe brenda 60 ditëve duhet të miratohet plani i punës, ndërkohë që kontraktori ka detyrimin ligjor të paraqesë Garancinë Bankare brenda 60 ditëve (kusht ky që në rast mosplotësimi sjell revokimin e LM dhe MH). AKBN dhe Albpetrol si pasojë e moskoherencës në afate përballen me faktin që operacionet hidrokarbure kanë filluar, plani i punës mund të jetë miratuar, ndërkohë që garancia si instrument ligjor mbrojtës nuk është dorëzuar ose nuk pranohet nga AKBN-ja për arsye të ndryshme, vështirësi serioze këto për një zbatim normal të MH.

- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, grupi i auditimit ka konstatuar se edhe pse kompania P. P. C. nuk ka bërë asnjë pagesë për Garancinë Bankare, Bonusin e Nënshkrimit dhe Bonusin e trajnimeve është lejuar të vijojë me operacione hidrokarbure.

P. P. C. nuk ka marrë masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 39-40 të Raportit të Auditimit)*

**8.1 Rekomandimi:** Për një zbatim normal të MH, të merren masa nga MIE, AKBN, Albpetrol sh.a për vendosjen në koherencë të afateve gjatë hartimit dhe miratimit të MH dhe LM si dhe paraqitja dhe pranimi i garancisë të jetë si kusht themelor për fillimin e operacioneve hidrokarbure.

**8.2 Rekomandimi:** Nisur nga fakti që baza e MH janë ligjet dhe aktet nënligjore shqiptare strukturat përkatëse të MIE, AKBN, Albpetrol sh.a gjatë fazës së hartimit të marrëveshjeve hidrokarbure të parashikohen penalitete dhe gjoha në rastin e mosplotësimin në kohë të detyrimeve të kësaj marrëveshje me qëllim garantimin e barazisë në të drejtat dhe detyrimet e palëve.

*Në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me angazhimin minimal të investimit në vlerën prej 500,000 USD, grupi i auditimit konstatoi se kjo vlerë nuk jepet e detajuar për zërat që përmban programi i vlerësimit. Ky programi paraqitet si Aneksi G i MH ku jepet i detajuar në aktivitete por pa vlera.

Mos detajimi i vlerave përkatëse sipas zërave të përfshirë në Programin e Vlerësimit të investimit sjell paqartësi në gjykimin e përmbushjes së këtij programi në vlerën e angazhimit minimal të investimit prej 500,000 USD si kusht kryesor për çlirimin e garancisë bankare si dhe zbatimin e MH-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 40 të Raportit të Auditimit)*

**9.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, AKBN, Albpetrol sha që programi i vlerësimit, që njihet si Aneksi G i MH-së, të jetë i detajuar në aktivitete dhe me vlera përkatëse si operacione hidrokarbure për të gjykuar mbi realizimin e strukturës së operacioneve të vlerësimit në zëra specifik sipas ofertës teknike.

*Në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Procesverbalet e kalimit të aseteve dhe të dhënave teknike kanë bashkangjitur inventarin e detajuar të çdo pusi por nuk janë të nënshkruara nga të gjithë pjesëmarrësit që përfaqësojnë palët, Albpetrol sh.a dhe “E. N. G.” shpk dhe të miratuara nga Administratorët përkatës siç përcaktohet në Nenin 3, Pika 4 a, b, c të LM si dhe në Aneksin F të MH.

- U konstatua se në Procesverbalin e datës 12.10.2023 (Fr-49) nuk është nënshkruar nga A. B. (përfaqësues Albpetrol sh.a) si dhe ky procesverbal në faqen e parë është nënshkruar nga 8 prej 11 anëtarëve.

- U konstatua se në Procesverbalin e datës 25.07.2022 (Fr – 19, 109, 36/b) nuk është nënshkruar nga S. A. (përfaqësues Albpetrol sh.a).

- U konstatua se në Procesverbalin e datës 06.02.2023 (Pov 1b, 9, 13, 23) nuk është nënshkruar nga A. Xh. (përfaqësues Albpetrol Sha) si dhe ky procesverbal në faqen e parë është nënshkruar nga 9 prej 13 anëtarëve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 40-41 të Raportit të Auditimit)*

**10.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga Albpetrol sh.a dhe AKBN që proces-verbalet e kalimit të aseteve dhe të të dhënave teknike për vetë rëndësinë e procesit të jenë të nënshkuara nga gjithë anëtarët e komisioneve të përbashkëta të ngritura për këtë qëllim. (AKBN-Albpetrol-E.).

*Në vijimësi*

**11.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me Programet e Punës dhe Buxhetet që kontraktori paraqet tek Albpetrol dhe/ose AKBN si dokumenti ku parashtron dhe propozon operacionet Hidrokarbure për tu kryer gjatë Periudhës Vlerësimit, si dhe faktit që ky program duhet të jetë konsistent me Programin e Vlerësimit, konstatohet se nuk ka një format tip të planit të punës dhe të buxhetit ku të jetë parashikuar më parë në Marrëveshje (si Aneks) për t'u paraqitur në mbledhjet e Komitetit Këshillimor, e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësishme së mesme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 44-45 të Raportit të Auditimit)*

Programet e Punës dhe Buxhetet e paraqitura nga Sh. U. A. paraqitet në prezantime power point dhe word, të pa detajuara dhe analizuara të përmbledhura në 3 zëra (sizmik, kosto menaxhimi, të tjera). *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 55-57 të Raportit të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga “Albpetrol” Sha dhe AKBN për një unifikim të formatit (Programi i Punës dhe Buxhetit) si dokument ku Kontraktori parashtron Operacionet Hidrokarbure dhe i propozon AKBN, Albpetrol sh.a për tu kryer gjatë periudhës Vlerësimit duke e parashikuar në Marrëveshje (si Aneks) gjatë fazës së hartimit të MH.

*Në vijimësi*

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk ka një dokument ku të komunikohet data e fillimit të operacioneve hidrokarbure nga kompania. Në lidhje me fillimin e operacioneve, referuar Raport-Progressit të Q3 2022(Qershor, Korrik-Shtator), Q4 2022 (Tetor-Dhjetor) për vb “Frakull” dhe vb “Povelcë” konstatohet se Operacionet Hidrokarbure nuk kanë filluar në 10 ditët e mbetur pas datës efektive të muajit Qershor sipas MH si dhe 60 ditë nga data efektive sipas LM, duke mos zbatuar afatet e mësipërme. Në këto situacione shprehen vetëm në mënyrë të përgjithshme se çfarë do të kryhen dhe jo çfarë është kryer faktikisht deri në Dhjetor 2022. Referuar Treguesve Financiarë të raportuar vihet re se shpenzimet kapitale në këtë periudhë janë zero në kundërshtim me afatet e përcaktuara në neni 7.1 të LM si dhe neni 8.1 të MH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 41 të Raportit të Auditimit)*

**12.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga Drejtoria Hidrokarbure pranë AKBN dhe Albpetrol sha për të kryer analiza të mirëfillta dhe të vlerësojë informacionet teknike në lidhje me Operacionet Hidrokarbure si dhe të reflektojë çdo angazhim apo detyrim teknik në planet dhe buxhetet 3/mujore dhe situacionet që raporton kompania pranë AKBN dhe Albpetrol sh.a.

*Në vijimësi*

**13.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me zbatimin e afateve të pagesës së Bonusit të Trajnimit u konstatua se:

Kompania E. N. G. ka paguar Bonusin e Trajnimit dhe Administrativ vetëm për vitin 2022 (për pjesën e mbetur si vit kalendarik dhe jo si vit kontraktual). Pagesa e bonusit të trajnimit për vitin 2023 dhe 6-mujor 2024 është kryer në datën 29.07.2024 rreth një vit me vonesë, në kundërshtim me Nenin nr.10.1 të MH-së për vb Frakull.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Albpetrol sh.a për mosmarrjen e masave në kohë për përmbushjen e detyrimeve nga Kontraktori. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 41 të Raportit të Auditimit)*

- Kompania Sh. U. A. për vitet 2019, 2022 dhe 2023 nuk ka zbatuar afatet ligjore për kryerjen e pagesës pasi data efektive e kontratës është 14.06.2019 dhe pagesat duhet të kryhen minimalisht 30 ditë përpara fillimit të vitit kontraktual domethënë pagesat duhet të kryhen



brenda datës 14 maj të çdo viti në kundërshtim me nenin 27/3.1 të KNP. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 54 të Raportit të Auditimit)*

**13.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga Albpetrol Sha dhe AKBN për zbatimin e afateve të pagesës së Bonusit të Trajnimit nga kontraktori si një nga përfitimet që ka nga nënshkrimi i marrëveshjeve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**14.Gjetje nga auditimi:** Nuk është ngritur brenda afatit grupi i Komitetit Këshillimor për vendburimet Frakull dhe Povelçë. Titullari i Albpetrol sh.a nuk ka zbatuar afatin prej 30 ditësh për ngritjen e grupit të përfaqësuesve, nuk ka Urdhër ose Vendim për caktimin e përfaqësuesve të Albpetrol sh.a në Komitetin Këshillimor si dhe përfaqësuesit alternative jo në përputhje me nenin nr.5, pikën 5.1.1, 5.1.2, 5.1.3 të MH-së për vendburimet Frakull dhe Povelçë. Nga auditimi u konstatua se përfaqësuesit e Albpetrol sh.a, caktohen përpara çdo mbledhje të Komitetit nëpërmjet komunikimit elektronik (e-mail).

-nuk është mbledhur minimalisht 2 herë në çdo vit fiskal (deri në 31.12.2023 kemi vetëm 2 mbledhje) jo në përputhje me nenin nr.5, 5.1.4., të MH-së për vendburimet Frakull dhe Povelçë.  
-Protokolli me procesverbalin me minutat e takimit të mbledhjes së Komitetit Këshillimor të datës 20.07.2022 nuk janë të firmosura nga palët, çdo faqe është nënshkruar vetëm nga 3 firma, nuk identifikohen se cilës palë i përkasin duke vënë në dyshim mbajtjen e mbledhjes si dhe vlefshmërinë e vendimeve të marra, jo në përputhje me nenin nr. 5, pikën 5.1.3 të MH-së për vb e “Frakullës” dhe “Povelçës”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 42 të Raportit të Auditimit)*

**14.1.Rekomandimi:** Për një zbatim normal të Marrëveshjeve Hidrokarbure, Titullari i Albpetrol sha në të ardhmen të marrë masa për ngritjen e Komitetit Këshillimor brenda afatit ligjor të parashikuar në MH, të respektohet periodiciteti ligjor i mbajtjes së mbledhjeve të këtij Komiteti si dhe në fund të çdo takimi të përgatitet nga Kontraktori protokollin me minutat e takimit dhe të miratohen duke u nënshkruar në çdo faqe nga palët.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**15.Gjetje nga auditimi:** Duke analizuar përqindjen e realizimit ndërmjet vlerave të buxhetit të dakortësuar dhe Raportimit të Shpenzimeve faktike për vb Frakull dhe vb Povelcë, ka një diferencë të madhe edhe pse kontrata ua njeht të drejtën e rishikimit të vlerave të buxhetit (që të ngushtohet diferenca midis planifikimit dhe realizimit) e cila mund të kërkohet për arsye operacionale ose si rezultat i veprimtarisë së Kërkimit dhe të Vlerësimit. Sa më sipër, në lidhje me Programin e punës dhe Buxhetet respektive konstatohet se E. N. ka raportuar vlera të larta planifikimi por realizimi i tyre është në nivele shumë të ulëta (konkretisht për vb Frakull vitin 2022 është 33% dhe vitin 2023 është 63 % dhe për vb Povelcë për vitin 2022 është 4,5% dhe vitin 2023 është 13.2 %). Kjo vë në dyshim procesin e përgatitjes dhe planifikimit të buxhetit pa një studim të mirëfilltë, monitorimin e zbatimit të buxhetit për performancën financiare si dhe vë në dyshim ekzistencën e kapaciteteve financiare të Kompanisë në kundërshtim me nenin 7.2 të LM dhe nenit 8 të MH për vb Frakull dhe Povelcë e cila për nga niveli i rëndësisë gjykohet të jetë e rëndësishme së lartë.

- Konstatohet se për vb Povelcë shpenzimet e njohura për përmbushjen e angazhimit minimal të periudhës së vlerësimit janë ato të raportuara në zërin CAPEX që për periudhën qershor 2022- dhjetor 2023 janë në vlerën 122,436 USD, ose me një mos realizim në vlerën 377,564 USD (deri në 31.12.2023). Albpetrol sh.a dhe AKBN duke parë trendin e mos realizimit të CAPEX në 6 tremujorët duhet rriste monitorimin e realizimit si dhe të diskutohej në mbledhjet e Komitetit Këshillimor.

- Grupi i auditimit konstatoi se ka një mospërputhje të vlerave të buxheteve fillestare dhe të rishikuara në raportet e progresit të sjella nga kompania. Edhe pse jemi para faktit se si AKBN

dhe Albpetrol sh.a nuk kanë kryer asnjë auditim të kostove dhe pasqyrave financiare, këto institucione nuk kanë kontrolluar/kuadruar as shifrat e sjella nga kompania. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 46 të Raportit të Auditimit)*

**15.1.Rekomandimi:** Të merren masat nga Albpetrol sh.a, AKBN, Komiteti Këshillimor që në të ardhmen diskutimin në lidhje me përcaktimin e Buxhetit dhe realizimin e tyre ti paraprijë analiza dhe studime të mirëfillta tekniko-financiare, të nxjerrin shkaqet e mosrealizimit, të bëhen verifikime dhe rishikime si dhe të merren hapat e nevojshme për tu orientuar në monitorimin e MH në kuadër të vlerësimit të performancës së saj dhe vlerës së shtuar që ofron kompania.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**16.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me detyrimet ligjore të MH, u konstatua se përmbajtja e marrëveshjes në Aneksin C, pika I.2.1 për vendburimin e Gazit “Frakull” dhe “Povelcë”, ka një boshllëk interpretimi në lidhje me detyrimin e dorëzimit të situacioneve tremujore në periudhën e vlerësimit pasi:

*“Kontraktori do ti dorëzoje Albpetrolit dhe AKBN-së, sa me shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga përfundimi i çdo Tremujori Kalendarik, një Situacion të Veprimtarisë së Zhvillimit sipas Nenit 7 të Marrëveshjes, ku pasqyrohen të gjitha detyrimet dhe kreditimet në lidhje me Zhvillimin dhe Prodhimin për atë Tremujor Kalendarik (Shpenzimet e Zhvillimit dhe Shpenzimet Operative), që të përfshijë totalin për të gjithë vitin dhe detyrimet dhe kreditimet kumulative që prej fillimit, të përmbledhura sipas klasifikimeve të duhura që tregojnë natyrën e tyre”.* Për sa më sipër periudha e vlerësimit është lënë jashtë interpretimit detyrimin ligjor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 47 të Raportit të Auditimit)*

**16.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, Albpetrol sh.a, AKBN që në të ardhmen nëpërmjet intensifikimit dhe bashkëpunimit ndër institucional gjatë fazës së hartimit të MH dhe LM të përfshijë të gjithë detyrimet dhe të drejtat e palëve sipas fazave të operacioneve hidrokarbure.

*Në vijimësi*

**17.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në lidhje me Monitorimin e MH, Albpetrol Sha dhe AKBN si përfaqësues i autoritetit në kontratë nuk disponojnë programe apo plane periodike vjetore për të ushtruar kontrole në subjekte si zotërues të lejeve Hidrokarbure. Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion informacion apo praktikë të ndjekur në lidhje me Monitorimin, Mbikëqyrjen e përgjithshme të MH apo inspektime për vendburime ku të bëhen krahasime apo vlerësime konkrete të treguesve teknologjikë apo të realizimit të investimeve etj, me planet e punës apo buxhetet e fillestare apo të rishikuara me treguesit e raportuar në situacionet përkatës, në kundërshtim me Nenet e MH-së dhe LM-së respektive sipas marrëveshjeve të vendburimeve, Pikës 9 të Rregullores së Brendshme të AKBN. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 47 të Raportit të Auditimit)*

**17.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga strukturat drejtuese të Albpetrol Sha, strukturat drejtuese të AKBN, që në të ardhmen të merren hapa konkretë në lidhje me Monitorimin dhe mbikëqyrjen e MH drejt vlerësimit të performancës së saj dhe vlerës së shtuar të angazhimit të subjekteve privat në këtë sektor, si hartimi i planeve vjetore te detajuar për të ushtruar kontrole në subjekte që ushtrojnë të drejtën e operacioneve hidrokarbure.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**18.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- Albpetrol sh.a nuk ka kryer asnjë auditim të pasqyrave të kostove për periudhën e vlerësimit duke e humbur të drejtën e verifikimit dhe certifikimit të situacioneve të operacioneve në periudhën e vlerësimit. Bazuar në datat e dorëzimit të situacioneve (raport progresive) të tremujoreve si dhe përcaktimeve ligjore të mësipërme, konstatohet se Albpetrol sh.a nuk mund të shprehet për kostot e raportuar për periudhën: qershor + Q3 2022, Q4 2022, Q1 2023 për vb Frakull dhe vb Povelçë në kundërshtim me Nenin 2, pika 25.1 dhe Aneksin C, Neni I.3.1 të MH për vb Frakull dhe vb Povelçë. Mos kryerja e auditimeve tekniko-financiarë ka sjellë mos certifikimin e situacioneve të mbulimit të kostove hidrokarbure si dhe ka humbur të drejtën e verifikimit dhe certifikimit për periudhat e sipërpërmendura, e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

- AKBN nuk ka kryer asnjë auditim apo inspektim të librave të llogarisë dhe dokumentacionit kontabël për kostot Hidrokarbure dhe të ardhurat e realizuara për periudhën e vlerësimit në kundërshtim me Nenin 15, pika 15.2 dhe pika 15.3 i LM-së për vendburimin e gazit natyror “Frakull” dhe “Povelçë” e cila për nga niveli i rëndësisë është e lartë.

-Referuar kuadrit ligjor me nenet përkatëse për Auditimin konstatohet se ka një moskoherencë në lidhje me afatet e kryerjes së auditimit nga Albpetrol dhe AKBN, pasi të gjitha kostot hidrokarbure quhen të certifikuar pas 12 muajsh nga data e raportimit të tyre ndërkohë që AKBN ka të drejtën e auditimit të tyre deri në 3 vjet dhe auditimet e AKBN-së mund të gjenden përpara faktit që kostot të jenë të certifikuar nga Albpetrol. Nisur sa më sipër Grupi i auditimit gjykon të unifikohen afatet që kanë të bëjnë me auditimin dhe certifikimin e kostove hidrokarbure.

- Nga auditimi i MH për Blloku 2-3 sa i përket auditimeve për certifikimin e kostove rezulton se AKBN ka kryer auditime mbi certifikimin e kostove sipas viteve respektive, por për vitet Gusht 2009-Shtator 2013 rezulton se nuk janë kryer auditime dhe si rrjedhojë kostot e raportuara nga kontraktori janë marr të mirëqena. Kostot e raportuara nga Kontraktori për periudhën e pa audituar janë në vlerën 142,601,422 USD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 47-48 të Raportit të Auditimit)*

**18.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga strukturat drejtuese të Albpetrol sh.a dhe AKBN të unifikojnë afatet e ushtrimit të të drejtës së auditimit të zotëruesit të marrëveshjes.

Të merren masa nga strukturat drejtuese të Albpetrol sh.a dhe AKBN në hartimin e planeve vjetore të auditimit dhe kryerjen e tyre duke respektuar afatet e përcaktuara në MH.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**19. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me praktikën e Amendimit të KNP, (Kontrata me Ndarje Prodhimi) u konstatuan:

f. Pezullimi i Periudhës së Parë të Kërkimit (PK1) nuk është parashikuar apo të jetë diskutuar më parë nga EACM më datë 14.12.2021 në lidhje me miratimin e planit të punës dhe buxhetit të vitit 2022. Kompania e lidh pezullimin me Covid 19 (pandemia e vitit 2020) dhe me rritjen e çmimit të energjisë elektrike (periudhe 2020-2021), fakte të njohura për kompaninë por që nuk janë parashtruar para datës 10.03.2022, ose tre muaj para përfundimit të periudhës së parë të kërkimit.

g. Pezullimi si fenomen nuk parashikohet në KNP, as juridikisht dhe as financiarisht.

h. Me shkresën nr. 9, datë 10.03.2022, S. 4, i drejtohet MIE me kërkesën për pezullim pa njoftuar apo vendosur në dijeni AKBN (si autoritet përfaqësues i MIE për zbatim dhe monitorim të KNP), AKBN është vendosur në dijeni më datë 12.05.2022 nga S. 4, datë në të cilën është nënshkruar edhe amendimi i kontratës.

i. Nuk ka negociata mbi kushtet e amendimit të KNP-së, Grupit Negociator i ngritur me Urdhrin nr. 86, datë 04.05.2022, nuk ka të përcaktuar me emra konkret përfaqësuesit e AKBN dhe i përcjell për njohje dhe zbatim me shkresën nr.2301/84 prot., datë 11.05.2022. Amendimi

i KNP është dakortësuar dhe nënshkruar në datën 12.05.2022 midis Ministrit i MIE, znj. B. B. dhe Përfaqësuesit Ligjor të S. 4, z. A. M. F.. Referuar datave hapësira kohore prej 1 dite (11.05-12.05.2022) e bënë të pamundur njohjen/negocimin dhe dakortësimin e saj.

j. S. 4, AKBN dhe MIE kanë filluar zbatimin e Amendimit të KNP pa pritur miratimin e saj me VKM. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 57-58 të Raportit të Auditimit)*

**19.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, Albpetrol sh.a, AKBN që në të ardhmen gjatë fazës së hartimit dhe negocimit të termave kryesore dhe tekstit të marrëveshjeve hidrokarbure të parashikohet koncepti i amendimit të marrëveshjeve me gjithë elementët përbërës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Referuar Aneksit C “Procedura kontabël”, pika 3 “Auditimet dhe rregullimet” të MH për Bllokun 4 në lidhje me kostot e kundërshtuara dhe kostot e pezulluara, palët, deri në përfundim të periudhës së auditimit nuk kanë gjetur një zgjidhje në lidhje me statusin e kostove pezull, në vlerën 2,954,441 USD (pagesë e ekspertëve të filialeve të Sh. në vende tjera për punën e kryer për llogari të Bllokut 4). Në lidhje me këto shërbime kontraktori duhet të paraqesë pranë AKBN një deklaratë auditimi të pavarur mbi baza vjetore, auditim i cili realizohet nga një zyrë kontabiliteti ndërkombëtare. Deklarata të tilla nuk janë paraqitur nga kontraktori pranë AKBN edhe pse ka kaluar mbi 3 vjet nga konstatimi i këtyre vlerave. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se midis raporteve paraprake dhe raporteve përfundimtare të hartuara nga AKBN ka një afat të gjatë kohor (mbi 1 vit) pasi kontraktori paraqet komentet në lidhje me raportin paraprak në hapësirë kohore të tejzgjatur. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 60-61 të Raportit të Auditimit)*

**20.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga AKBN për vendosjen e afateve për dorëzimin e pretendimeve të kontraktorëve në lidhje me raportet paraprake të auditimit të kryera nga AKBN dhe raporteve të zyrave të kontabilitetit ndërkombëtare mbi kostot e pezulluara.

*Në vijimësi*

**21. Gjetje nga auditimi:** Për procedurën e lidhjes së marrëveshjes për Bllokun Dumrea me E. S.p.a rezulton se Urdhri nr. 334, datë 11.09.2019 (nr.7946 prot.) “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për Bllokun e “Dumresë” i Ministrit të MIE ka përcaktuar afatin e dorëzimit të aplikimit për 45 ditë në kundërshtim me pikën I/2 të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse” miratuar me Urdhrin nr. 246, datë 12.03.2018 “Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse”, e cila përcakton se “Afati kohor i kësaj ftese është jo më pak se 90 ditë, duke filluar nga datat e njoftimit”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën I , faqe 28-29 të Raportit të Auditimit)*

**21.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga Titullari i MIE për respektimin e afatit kohor prej jo më pak se 90 ditë për paraqitjen e ofertave për të rritur konkurrencën dhe pjesëmarrjen e kompanive me potencial teknik dhe financiar më të mirë.

*Në vijimësi*

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të KNP me shoqërinë E. A. B.V. u konstatua se si pasojë e pandemisë Covid 2019 dhe kufizimeve të saj, E. A. b.v, ka regjistruar degën e saj në Shqipëri në QKB 31.03.2021, ndërkohë data efektive është 04.03.2020. E. S.p.a ka raportuar kosto për këtë periudhë në vlerën 1,025,037 USD. Kjo vlerë konsiderohet si Kosto e Pezulluar pasi nuk është e raportuar në pasqyrat financiare sipas legjislacionit tatimor të degës së hapur

ne Shqipëri sepse regjistrimi në QKB është bërë në 31.03.2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 67-68 të Raportit të Auditimit)*

**22.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga AKBN për sqarimin dhe dhënien e statusit përfundimtar për koston e pezulluar për periudhën e fillimit të marrëveshjes (04.03.2020-31.03.2021).

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**23. Gjetje nga auditimi:** Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion mbi hartimin dhe miratimin e hartës së procesit të punës, gjurmës së auditimit dhe planit të kontrollit të brendshëm, sipas formatit të kërkuar nga manuali i MFK, për procesin e inicimit, përgatitjes dhe miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure; njësitë përgjegjëse për procesin sipas hallkave përkatëse, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 117-118 të Raportit të Auditimit)*

**23.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga AKBN, Albpetrol sh.a për hartimin dhe miratimin e hartës së proceseve të punës, gjurmës së auditimit dhe planit të kontrollit të brendshëm, sipas formatit të kërkuar nga manuali i MFK, për procesin e inicimit, përgatitjes dhe miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure; njësitë përgjegjëse për procesin sipas hallkave përkatëse.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**24. Gjetje nga auditimi:** Pas mbarimit të gjitha procedurave të këtij procesi të arbitrazhit për mosmarrëveshjet e njohjes së kostove midis B. P. A. Ltd dhe Albpetrol sh.a dhe AKBN më datë 07.06.2024 nga ana e Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar u lëshua vendimi final lidhur me të gjitha çështjet objekt gjykimi.

Në mënyrë të përmbledhur Gjykata vendosi 70% me 30% në favor të B. P. A. L., por që në vetvete përkthehet me mosnjohjen e rreth 236.109.466 USD si kosto të panjohura nga totali prej rreth 800 milion USD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 92-95 të Raportit të Auditimit)*

**24.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE, AKBN dhe Albpetrol SHA për ngritjen e një grupi pune dhe bashkërendimin me B. P. A. L. për detajet e zbatimit të vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**25. Gjetje nga auditimi:** Albpetrol sh.a ka objekt auditimi raportet e kostove hidrokarbure (Raportet tremujore Q1, Q2, Q3, Q4) në lidhje me përfshirjen e kostove të kryerja nga B. P. A. Ltd si kosto hidrokarbure të shpenzimeve që nuk i kanë shërbyer operacioneve hidrokarbure (si kosto të rikuperueshme). Këto auditime do t'i shërbejnë Albpetrol sh.a në monitorimin e raportimeve dhe verifikimin e llogaritjes së faktorit R nga vlera që raporton B. P. A. L. për çdo tremujor dhe ndikon direkt në sasinë e PPA&PPE.

Ndërsa AKBN ka për objekt auditimi *librat e llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të B. P. A. L.*, si cilat duhet të ishin dorëzuar nga kompania 45 ditë pas përfundimit të çdo 6-mujori. Këto auditime do të shërbejnë AKBN në lidhje me rregullsinë e regjistrimeve dhe pasqyrimin të kostove hidrokarbure në librat e llogarive kontabël, si dhe të shprehen në lidhje me përlllogaritjen e rezultatit financiar dhe të tatim fitimit.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion AKBN ka audituar vetëm raportet e kostove hidrokarbure (Raportet tremujore Q1, Q2, Q3, Q4) dhe jo librat e llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të B. P. A. L. në kundërshtim me nenin 15, pika 15.3 “E drejta e AKH (AKBN)” të LM. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 95-101 të Raportit të Auditimit)*

**25.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga AKBN për auditimin e librave të llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të B. P. A. Ltd si detyrim i LM.

## *Menjëherë dhe në vijimësi*

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të detyrimeve të raportimit dhe afateve ligjore për dorëzimin e progres raporteve me kostot respektive u konstatua se:

- B. P. A. Ltd dorëzon pranë AKBN dhe Albpetrol sh.a progres raporte mujore dhe tremujore (jo sipas parashikimit në LH 6 mujore për AKBN) si dhe se të gjithë raportet e mësipërme janë dorëzuar me vonesë duke mos zbatuar afatin maksimal prej 45 ditësh nga përfundimi i periudhës raportuese në kundërshtim me në Nenin 15, pika 15.2 “Regjistrimet që i jepen AKH (AKBN)” të LM dhe nenit 4 të Aneksit B “Procedurat llogaritëse” të MH.

- B. P. A. L. nuk ka dorëzuar pranë AKBN deklaratën e të ardhurave dhe humbjeve për çdo vit fiskal, jo më vonë se 90 ditë pas përfundimit të këtij viti, me qëllim që të nxjerr në pah Fitimin apo humbjen neto të tij në lidhjet me operacionet hidrokarbure për atë Vit Fiskal sipas Nenin 15, pika 15.4 “*Deklarimet e të ardhurave dhe humbjeve*” të LM, për nga rëndësia e nivelit të lartë. Për sa më sipër mban përgjegjësi AKBN dhe Albpetrol sh.a. (*Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 102 të Raportit të Auditimit*)

**26.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga AKBN dhe Albpetrol sh.a për përmbushjen e detyrimeve të llojit raporteve (për Albpetrol Progres raportet 3 mujore, për 6 mujore për AKBN si dhe deklaratën vjetore të të ardhurave dhe humbjeve për AKBN) sipas periudhave dhe afateve të përcaktuara të MH dhe LM nga ana e B. P. A. Ltd.

## *Menjëherë dhe në vijimësi*

**27. Gjetje nga auditimi:** Prej vitit 2003 Albpetrol sh.a zotëron të drejtën e furnizimit dhe tregtimin me energji elektrike të klientëve të kualifikuar, siç janë kontraktorët e MH.

Konstatohet se B. P. A. Ltd nuk paguan detyrimin për energjinë elektrike ndaj Albpetrol sh.a, vlerë e cila deri në 31.12.2023 është **1,654,040,397 lekë**.

Albpetrol sh.a nuk i vuri në dispozicion grupit të auditimit asnjë kontratë shërbimi për ofrimin e energjisë elektrike me B. P. A. L.. Gjithashtu Albpetrol sh.a nuk aplikon penalitete apo kamat vonesa për mos likuidim në kohë të faturave të energjisë elektrike nga B. P. A. L. si dhe nuk ekziston asnjë plan masash për rregullimin e problematikës së mësipërme. (*Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 105 të Raportit të Auditimit*)

**27.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga MIE dhe Albpetrol sh.a hartimin e një marrëveshje me B. P. A. L. për likuidimin e detyrimeve të prapambetura si dhe shlyerjen e detyrimeve vijuese korrente.

## *Menjëherë dhe në vijimësi*

**28. Gjetje nga auditimi:** Në bazë të MH Albpetrol sh.a zotëron të drejtën e monitorimit dhe pjesëmarrjes në procesin e inventarizimit të B. P. A. L.. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua se strukturat drejtuese të Albpetrol sh.a me anë të mosveprimit të tyre kanë lenë në mungesë monitorimi gjendjen e aseteve të dhëna në përdorim si dhe blerjen e aseteve të reja nga kontraktori si dhe ecuria e jetëgjatësisë së tyre në kundërshtim me pikën 2.4.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure. (*Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 105-106 të Raportit të Auditimit*)

**28.1.Rekomandimi:** Nga ana e Albpetrol sh.a të merren masa për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të saj në komisionet e përbashkëta të inventarizimit të aseteve me qëllim monitorimin e gjendjes së aseteve të dhëna në përdorim si dhe atyre të krijuara në vijimësi.

## *Menjëherë dhe në vijimësi*

**29. Gjetje nga auditimi:** Mos përmbushja e detyrimeve të marrëveshjes për blloku “Velçës” nëpërmjet Albpetrol sh.a dhe “P. P. C.”.

Nga auditimi i zbatimit të marrëveshjes për bllokun Velçës nëpërmjet Albpetrol sh.a dhe kompanisë P. P. C. u konstatua se nuk janë zbatuar nenet e VKM-së nr.685 datë 22.11.2017 “Për miratimin e marrëveshjes me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku Velçës nëpërmjet “Albpetrol” sha. dhe “P. P. C.”, konkretisht:

1.Kompania “P. P. C.” nuk ka paguar Garancinë Bankare me vlerën 500,000 \$ ndaj AKBN duke shkelur nenin 29.3 të kontratës. Mos pagesa e Garancisë Bankare edhe pas shtyrjes së afatit nga AKBN ka sjellë që në datën 31.08.2019 AKBN të heqë Licencë Marrëveshjen duke sjellë dhe prishjen e kontratë pasi mospasja e Licencë Marrëveshje sipas nenit 4 të Ligji nr.7746, datë 28.07.1993 Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi) i ndryshuar.

Gjithashtu kjo kompani nuk ka paguar Bonusin e Nënshkrimit me vlerën 100.000 \$ sipas nenit 27.1 të kontratës dhe pagesën prej 70.000 \$ për programet e trajnimit të stafit të Albpetrol sh.a, pagesë e cila bëhet çdo 30 ditë nga fillimi i çdo viti kalendarik sipas nenit 16.4.1 të kontratës. Kjo situatë ka sjellë dhe prishjen e Marrëveshjes Hidrokarbure midis Albpetrol sh.a dhe kompanisë P. P. C..

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion shoqëria Albpetrol sh.a dhe AKBN nuk ka marrë asnjë masë tjetër përveç njoftimit me disa shkresa të kompanisë P. P. C. për mbledhjen e këtyre detyrimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 81-87 të Raportit të Auditimit)

**29.1.Rekomandim:** AKBN dhe Albpetrol sh.a të marrin masat për ndjekjen e te gjithë hapave ligjorë për mbledhjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **D. TË ARDHURA, INVESTIME TË MUNGUARA**

**1. Gjetje nga auditimi:** Sh. U. A. nuk ka përmbushur detyrimin në lidhje me fondin për investime sociale prej 1,000,000 USD si detyrim i kompanisë gjatë periudhës së pezullimit, referuar kjo edhe në informacionin e dërguar nga AKBN/Drejtoria e Hidrokarbureve si dhe MIE, konkretisht bazuar në VKM Nr.652, datë 10.10.2022 “Kontraktori do të investojë 1,000,000 USD në projekte të investimeve sociale të lidhura me burimet e rinovueshme dhe tranzicionin energjetik si ka rënë dakort me MIE”. (Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 54-55 të Raportit të Auditimit)

**1.1.Rekomandimi:** Të merren masa MIE dhe AKBN për nxitjen dhe përshpejtimin e realizimit të projekteve të investimeve sociale të lidhura me burimet e rinovueshme dhe tranzicionin energjetik si është rënë dakord midis palëve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga AKBN nuk është shfrytëzuar mundësia e trajnimit në institucione ndërkombëtare të stafit të AKBN, e drejtë kjo që rrjedh nga Neni 27.4 të KNP-së Blloku “Dumrea” në vlerën 600,000 euro për vit kontraktual për periudhën e kërkimit si dhe nuk u vendos në dispozicion programi i trajnimit mbi baza vjetore i përgatitur bashkërisht (ENI dhe AKBN), miratimi i programit (trajnime në fushën e industrisë së naftës e gazit, si dhe trajnime profesionale dhe për menaxhimin), lista e kandidatëve të propozuar nga AKBN si dhe miratimet e kësaj liste nga kontraktori, si dhe krahasimet që duhet të bëjë AKBN për efekt kostojë të trajnimeve të ofruara nga kontraktori me trajnimet dhe kurset e tjera edukative që kanë të njëjtat standarde. (Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 64-65 të Raportit të Auditimit)

**2.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga AKBN për shfrytëzimin e kësaj të drejte që ja jep KNP për ngritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të AKBN si dhe përfshirjen në këto programe edhe të institucioneve të tjera që përfshin industria e hidrokarbureve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure rezulton se detyrimi i B. për PPE & PPA për periudhën nga fillimi i lidhjes së marrëveshjes deri në 31.12.2023 është 535,396.93 ton naftë.

Shoqëria Albpetrol sh.a ka tërhequr 449,757.69 ton naftë bruto për llogari të PPE&PPA, dhe nuk ka tërhequr 85,639.24 ton naftë nga detyrimi për PPE & PPA për periudhën nga fillimi i lidhjes së marrëveshjes deri në 31.12.2023.

Sasia totale prej 54,009.978 Ton naftë bruto, e pa tërhequr për vitin 2019 - 2023 për llogari të Prodhimi Para Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol sh.a (PPA) sipas Marrëveshjes Hidrokarbure është 18,659,033.93 USD, vlerë e cila përfaqëson të ardhur të munguar për Albpetrol sh.a. (*Më hollësisht trajtuar në pikën II , faqe 89-91 të Raportit të Auditimit*)

**3.1.Rekomandimi:** Të merren masa nga Albpetrol sh.a në bashkëpunim me B. P. A. Ltd për hartimin e një skeduli me sasitë dhe afate konkrete për tërheqjen e të gjithë sasisë së naftës të akumuluar ndër vite si detyrim i B. P. A. L. ndaj Albpetrol sh.a.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **E 1. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2, Statut-Rregulloren e Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, neni 26, si dhe kontratës kolektive dhe kontratave individuale të punës, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *për marrëveshjen e hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Povelcë” dhe “Frakull”*, i rekomandohet Administratorit “Albpetrol” Sha Patos për punonjësit e mëposhtëm fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore “*Vërejtje*”, për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për 6 punonjës si më poshtë:

1. **Z. A. P.**, në cilësinë e Kryetarit të Grupi të punës për vlerësimin e aplikantëve “*Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Povelcë” dhe “Frakull”*”.
2. **Znj. F. H.**
3. **Z. R. C.**
4. **Znj. G. X.**
5. **Z. Z. M.**
6. **Z. A. L.**, në cilësinë e anëtarëve të Grupi të punës për vlerësimin e aplikantëve “*Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Povelcë” dhe “Frakull”*”, për arsye se:
  - Relacioni i hartuar nga grupi i punës nuk përmban analiza të kryera nga vet grupi i punës, është sipërfaqësor, ka karakter përmbledhës, paraqet vetëm konkluzione dhe nuk shoqërohet me analiza të detajuara apo vlerësim të plotë në lidhje me dokumentacionin që ka dorëzuar shoqëria në kundërshtim me pikën 1 të Urdhrit të Brendshëm nr. 258, datë 24.11.2020 “*Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e aplikantëve për vendburimet ekzistuese të gazit natyror “Frakull” dhe “Povelcë” të Administratorit të Albpetrol sh.a si dhe Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”*”, i ndryshuar Nenit 5, pika 2. Kjo ka sjellë marrjen e vendimeve jo mbi bazën e vlerësimeve të mirëfillta teknike - financiare në përputhje me kriteret ligjore të cilat sjellin pasoja në zbatimin MH.
  - Kompania nuk rezulton rentabël (me rezultat pozitiv) për vitet 2018 dhe 2019 si dhe vlera likuiditeteve të lira gjendje në Bankë janë të pamjaftueshme për angazhime në operacione hidrokarbure.



- Në lidhje me kapacitetet financiare, dokumenti i paraqitur nuk përfaqëson asnjë angazhim apo detyrim të ndërsjellë midis palëve. Për sa më sipër në lidhje me kapacitetet financiare, grupi i auditimit, konstaton se kompania e bazon financimin e projektit me një marrëveshje huaje me O. B., e cila ka pasigurinë e aprovimit nga autoritetet e Bankës si dhe marrëveshja e huasë ka efekte në të ardhmen me risqet që mund të përballet vetë shteti shqiptar në rastin e mungesës së likuiditetit apo pamundësisë paguese të kompanisë.
- Në lidhje me Kapacitetet teknike në dokumentet e ofertës së paraqitur është edhe një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë I. C. (person juridik shqiptar regjistruar pranë QKB me Nipt M.....S), marrëveshje e cila nuk është e lidhur para Noterit. Referuar sa më sipër edhe kompania bashkëpunuese nuk ka eksperiencë dhe përvojë në fushën e hidrokarbureve pasi ka objekt aktiviteti “Konsulencë për biznesin”.
- Kompania nuk disponon Burimet Financiare si dhe Kapacitetet Teknike për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit që vijnë nga lidhja e një Marrëveshje Hidrokarbure në kundërshtim me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar Nenit 5, pika 2.

**7. Z. I. K.**, me detyrë Drejtor i MH në Albpetrol sh.a, për arsye se:

- Nuk është zgjidhur problemi i Garancisë Bankare duke mosrespektuar detyrimin ligjor të parashikuar në Nenin 26.6 të MH. Referuar dokumentacionit, Garancia Bankare është paraqitur nga subjekti por nuk është pranuar nga AKBN me pretendimin se Garancitë Bankare të paraqitura nga subjekti për vb Povelcë dhe vb Frakull nuk janë sipas Aneksit E “Forma e garancisë bankare” të parashikuar në MH dhe nuk kanë vlefshmëri juridike. Pavarësisht korrespondencës midis kontraktorit, MIE, AKBN DHE Albpetrol sh.a, ky problem nuk është zgjidhur duke i ekspozuar këto institucione ndaj riskut të mos respektimit nga ana e kontraktorit të planit të punës, të vlerës së angazhimit të investimit minimal në Periudhën e Vlerësimit për vb Povelcë dhe vb Frakull (secila në vlerën 500,000 usd) e cila ndikon në vijueshmërinë normale të procesit të zbatimit MH.
- Edhe sikur ti Referohemi Formatit të Garancisë të lëshuar nga B., të paraqitur nga Kompania, kjo garanci është e vlefshme deri më 13.06.2024 (pra garancia është liruar vetë pasi afati maksimal ka kaluar) si dhe faktit që Garancia Bankare është pjesë integrale e MH dhe LM, Albpetrol sh.a dhe AKBN kanë humbur mbrojtjen, instrumentin ligjor apo garancinë financiare kundrejt Kontraktorit për përmbushjen e detyrimeve kontraktore në lidhje me angazhimin të investimit minimal financiar të Programit të Punës për periudhën e vlerësimit. Si përfundim s’ka garanci të vlefshme bankare dhe për më tepër kjo garanci që ka është çliruar në kundërshtim me nenin 26.6 si dhe Aneksit E të MH dhe LH.
- Gjithashtu nuk ka marrë asnjë masë në lidhje me Kompaninë, ku kuadri ligjor e shpreh qartë që mos paraqitja e Garancisë Bankare bëhet shkak për zgjidhjen e menjëhershme të këtyre marrëveshjeve duke vepruar jo në përputhje me Nenin 24, pika 24.3/b të MH.

## **E 2. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2, Statut-Rregulloren e Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, neni 26, si dhe kontratës kolektive dhe kontratave individuale të punës, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për marrëveshjen e hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Povelcë” dhe “Frakull”, i rekomandohet Drejtorit Ekzekutiv të AKBN dhe Administratorit Albpetrol sh.a Patos, për punonjësit e mëposhtëm fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore “Vërejtje”, për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për 2 punonjës si më poshtë:

**1. Z. E. K.** me detyrë Drejtor i MH ne AKBN, për arsye se:

- Nuk është zgjidhur problemi i Garancisë Bankare duke mosrespektuar detyrimin ligjor të parashikuar në Nenin 26.6 të MH. Referuar dokumentacionit, Garancia Bankare është paraqitur nga subjekti por nuk është pranuar nga AKBN me pretendimin se Garancitë Bankare të paraqitura nga subjekti për vb Povelcë dhe vb Frakull nuk janë sipas Aneksit E “Forma e garancisë bankare” të parashikuar në MH dhe nuk kanë vlefshmëri juridike. Pavarësisht korrespondencës midis kontraktorit, MIE, AKBN DHE Albpetrol sh.a, ky problem nuk është zgjidhur duke i ekspozuar këto institucione ndaj riskut të mos respektimit nga ana e kontraktorit të planit të punës, të vlerës së angazhimit të investimit minimal në Periudhën e Vlerësimit për vb Povelcë dhe vb Frakull (secila në vlerën 500,000 usd) e cila ndikon në vijueshmërinë normale të procesit të zbatimit MH.

- Edhe sikur ti Referohemi Formatit të Garancisë të lëshuar nga B., të paraqitur nga Kompania, kjo garanci është e vlefshme deri më 13.06.2024 (pra garancia është liruar vetë pasi afati maksimal ka kaluar) si dhe faktit që Garancia Bankare është pjesë integrale e MH dhe LM, Albpetrol sh.a dhe AKBN kanë humbur mbrojtjen, instrumentin ligjor apo garancinë financiare kundrejt Kontraktorit për përmbushjen e detyrimeve kontraktore në lidhje me angazhimin të investimit minimal financiar të Programit të Punës për periudhën e vlerësimit. Si përfundim s’ka garanci të vlefshme bankare dhe për më tepër kjo garanci që ka është çliruar në kundërshtim me nenin 26.6 si dhe Aneksit E të MH dhe LH.

### **E 3. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *për marrëveshjen e hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Povelcë” dhe “Frakull”*, i rekomandohet Titullarit të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje**”, sipas pikës “a” të nenit 58, si më poshtë vijon:

**1. Z. I. Gj.**, në cilësinë e anëtarëve të Grupi të punës për vlerësimin e aplikantëve “*Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Povelcë” dhe “Frakull”*”, i cili me veprimet dhe mosveprimet ka lejuar kualifikimin e kompanisë E..

- Relacioni i hartuar nga grupi i punës nuk përmban analiza të kryera nga vet grupi i punës, është sipërfaqësor, ka karakter përmbledhës, paraqet vetëm konkluzione dhe nuk shoqërohet me analiza të detajuara apo vlerësim të plotë në lidhje me dokumentacionin që ka dorëzuar shoqëria në kundërshtim me pikën 1 të Urdhrit të Brendshëm nr. 258, datë 24.11.2020 “*Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e aplikantëve për vendburimet ekzistuese të gazit natyror “Frakull” dhe “Povelcë”*” të Administratorit të Albpetrol sh.a si dhe Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “*Për Hidrokarburet*”, i ndryshuar Nenit 5, pika 2. Kjo ka sjellë marrjen e vendimeve jo mbi bazën e vlerësimeve të mirëfillta teknike - financiare në përputhje me kriteret ligjore të cilat sjellin pasoja në zbatimin MH.

- Kompania nuk rezulton rentabël (me rezultat pozitiv) për vitet 2018 dhe 2019 si dhe vlera likuiditeteve të lira gjendje në Bankë janë të pamjaftueshme për angazhime në operacione hidrokarbure.

- Në lidhje me kapacitetet financiare, dokumenti i paraqitur nuk përfaqëson asnjë angazhim apo detyrim të ndërsjellë midis palëve. Për sa më sipër në lidhje me kapacitetet financiare, grupi i auditimit, konstaton se kompania e bazon financimin e projektit me një marrëveshje

huaje me O. B., e cila ka pasigurinë e aprovimit nga autoritetet e Bankës si dhe marrëveshja e huasë ka efekte në të ardhmen me risqet që mund të përballlet vetë shteti shqiptar në rastin e mungesës së likuiditetit apo pamundësisë paguese të kompanisë.

- Në lidhje me Kapacitetet teknike në dokumentet e ofertës së paraqitur është edhe një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë I. C. (person juridik shqiptar regjistruar pranë QKB me Nipt M.....S), marrëveshje e cila nuk është e lidhur para Noterit. Referuar sa më sipër edhe kompania bashkëpunuese nuk ka eksperiencë dhe përvojë në fushën e hidrokarbureve pasi ka objekt aktiviteti “Konsulencë për biznesin”.

- Kompania nuk disponon Burimet Financiare si dhe Kapacitetet Teknike për të përmbushur detyrimet e Kontraktorit që vijnë nga lidhja e një Marrëveshje Hidrokarbure në kundërshtim me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, i ndryshuar Nenit 5, pika 2.

#### **E 4. MASA DISIPLINORE NË KOPETENCË TË TITULLARIT**

Bazuar në shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në tërësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, hapësirës së madhe kohore të shtrirjes së zbatimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure, ristrukturimeve të ndodhura përgjatë kësaj periudhe, i rekomandohet Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtorit Ekzekutiv të AKBN dhe Administratorit të Albpetrol sh.a Patos për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të analizojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës, me qëllim fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore.

*Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.*

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**